UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË DHE PEDAGOGJISË
PROGRAM I DOKTORATËS

Tema:

ARSIMI JOPUBLIK PARAUNIVERSITAR
RISI NË PROCESIN E ZHVILLIMEVE DEMOKRATIKE NË SHQIPËRI

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore "Doktor"

nga MA. Eranda BILALI (HALLUNI)

Udhëhequr nga:

Prof.As.Dr. Zenel ORHANI

DEKLARATË STATUORE

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tërë ose në pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Emri, Mbiemri:
Eranda BILALI (HALLUNI)

Firma:

© Copyright, ERANDA BILALI (HALLUNI)
Të gjitha të drejtat të rezervuara
2015

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË DHE PEDAGOGJISË
PROGRAM I DOKTORATËS

Tema:

ARSIMI JOPUBLIK PARAUNIVERSITAR
RISI NË PROCESIN E ZHVILLIMEVE DEMOKRATIKE NË SHQIPËRI

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore "Doktor"

nga MA. Eranda BILALI (HALLUNI)

Udhëhequr nga:

Prof.As.Dr. Zenel ORHANI

Juria e mbrojtjes

1._____Kryetar Jurie (oponent)
2._____Anëtar (oponent)
3._____Anëtare
4._____Anëtare
5._____Anëtar

TIRANE, 2015

ABSTRAKT

Zhvillimet demokratike në Shqipëri hapën perspektiva të reja për arsimin privat. Një arritje e rëndësishme në fushën e demokratizimit të institucioneve të edukimit është zgjerimi i arsimit privat.

Qëllimi i këtij studimi është të përshkruajë dhe të analizojë organizimin dhe funksionimin e sistemit të arsimit jopublik parauniversitar në nivel kombëtar, duke u bazuar në zhvillimin historik të tij nga fillimet e deri në ditët e sotme si dhe përmes të dhënave e indikatorëve analitikë dhe sintetikë për çdo etapë e nivel shkollimi, duke analizuar veçanërisht arsimin privat në rrethin e Shkodrës si një rast përshkrues studimor**.** Ky studim pasqyron risitë që solli në jetën arsimore shqiptare, sëbashku me faktorët që kanë ndikuar në zhvillimin e tij, duke e krahasuar me përvojën europiane. Në këtë studim janë përdorur tre instrumente të kërkimit cilësor, si: analiza bibliografike, shqyrtimi dhe interpretimi cilësor i të dhënave nga raportet zyrtare dhe intervista gjysmë e strukturuar**.**

Përmes shfrytëzimit të burimeve bibliografike, burimeve arkivore, analizës statistikore të raporteve vjetore të hartuara nga MAS, në studim u pasqyruan zhvillimet e arsimi jopublik. Analiza statistikore e raporteve vjetore statistikore të arsimit, sipas indikatorëve të performancës së shërbimit arsimor jopublik, na mundësoi vlerësimin e arritjeve të arsimit jopublik në krahasim me vendet e BE-së. Rasti studimor i fokusuar në rrethin e Shkodrës i analizuar përmes indekseve të performancës së shërbimit arsimor jopublik si: infrastruktura, shërbimet shkollore, financimi, drejtuesit, mësuesit e nxënësit, krahas eksplorimit empirik në thellësi të fenomenit, kishte si qëllim përshkrimin e kushteve të organizimit dhe funksionimit të institucioneve arsimore jopublike, si një tregues i zhvillimeve kryesore në sistemin parauniversitar jopublik.

Studimi evidentoi se shkollat private nuk janë një dukuri e re, por ato funksionuan shekuj më parë se shkollat shtetërore dhe vunë themelet e arsimit tonë kombëtar. Shkollat private, krahas rritjes dhe zgjerimit në të gjitha drejtimet, zënë një vend të konsiderueshëm në arsimin shqiptar. Ekziston një bazë ligjore e plotësuar për sa i përket licencimit, organizimit dhe funksionimit të institucioneve jopublike private. Institucionet jopublike kanë infrastrukturë funksionale, numër të vogël nxënësish në klasë, autonomi e fleksibilitet në organizim dhe na prezantohen me një shumëllojshmëri formash dhe modelesh të vlefshme edhe për arsimin publik.

Gjithashtu, studimi evidentoi se nuk ka dallime me vendet e BE-së për sa i përket bazës ligjore, licencimit, dokumentacionit, kërkesave në lidhje me stafin, kurrikulat, dhe lëvizjes së mësuesve nga publiku te privati e anasjellas. Bazuar nga të dhënat e këtij studimi dhe nga analiza e zhvillimeve dhe praktikave të vendeve të BE-së, alternativa e arsimit jo publik kërkon më shumë partneritet, përkujdesje e mbështetje nga ana e shtetit, me qëllim që të rritet, të zhvillohet dhe të zgjerohet në të gjitha nivelet si një alternativë me vlera që sjell progres në fushën e arsimit dhe si një element i demokracisë e ekonomisë së tregut.

Fjalë kyçe: *sistem arsimor parauniversitar, shkollë jopublike, alternativë, organizim, funksionim.*

ABSTRACT

Democratic developments opened up new prospects for the private education in Albania. An important achievement in the field of democratization of institutions of education is the expansion of private education.

The purpose of this study is to describe and analyze the organization and functioning of the private pre-university education system, based on the historical development of its beginnings to the present day as well as through data indicators analytic and synthetic analysis at every stage of schooling, looking specifically at private education in Shkodra as a descriptive case study. This study reflects the innovations that brought in the Albanian educational life, along with the factors that have contributed to its development, compared with the European experience. In this study we used three research instruments of qualitative research: bibliographic analysis, qualitative review and interpretation of data from official reports and semi-structured interviews.

Through the use of bibliographic sources, archival sources and statistical analysis of annual reports, developed by MAS in the study were reflected the developments of the non-public education. Statistical analysis of the annual education statistics, according to performance indicators of non-public educational service, enabled us to assess the achievements of non-public education in comparison with EU countries. The case study focused on the district of Shkodra analyzed through indices of performance of non-public education service such as infrastructure, education services, financing, management, teachers and students, along with in depth empirical exploration of the phenomenon, aimed at describing the conditions of organization and operation of non-public educational institutions, as a leading indicator of developments in pre university non-public system.

The study showed that private schools are not a new phenomenon, but they functioned centuries before the state schools and laid the foundations of our national education. Private schools, besides their growth and expansion in all directions, occupy a significant place in the Albanian education. There is a complete legal basis in terms of licensing, organization and operation of non-public private institutions. Non-public institutions have functional infrastructure, small number of students in the classroom, autonomy and flexibility in organizing and presenting us with a variety of forms and models available for public education.

Also, the study showed that there are no differences with the EU countries in terms of legal framework, licensing, documentation, requirements related to staff, curricula, and movement of teachers from the public to a private and vice versa.

Based on the data of this study and the analysis of developments and practices of the EU countries, the alternative of non-public education requires more partnerships, care and support by the state, in order to grow, develop and expand at all levels as an alternative to the value that brings progress in education and as an element of democracy and market economy.

Keywords: *pre-university education system, non-public school, alternative, organization, operation.*

MIRËNJOHJE

Falënderoj udhëheqësin tim, Prof.As.Dr. Zenel ORHANI, për ndihmën e pakursyer, gatishmërinë, predispozicionin, profesionalizmin e treguar në realizimin e të gjithë hapave të punimit tim.

Shpreh respektin për lektorët e Departamentit të Psikologjisë dhe Pedagogjisë të Universitetit të Tiranës, për mbështetjen në rrugëtimin e studimeve të mia të doktoraturës.

Falënderoj të gjithë punonjësit e MAS-it, veçanërisht miken time të ngushtë Marjanën, mësuesit, drejtorët e shkollave, prindërit, drejtuesit dhe punonjësit e tjerë të DAR-it Shkodër, pa ndihmën e të cilëve nuk mund të finalizoja këtë studim.

Një falënderim shkon edhe për punonjësit e Muzeut të Shkodrës të cilët më vunë në dispozicion arkivin e këtij muzeu.

Nuk mund të lë pa përmendur punonjësit e bibliotekës ″Marin Barleti″ të Shkodrës dhe asaj universitare, pa harruar sugjerimet që më dhanë kolegët, drejtuesit, mësuesit dhe prindër të nxënësve të shkollave private të qytetit tim, Shkodrës.

TABELA E PËRMBAJTJES

Abstrakt iv
Abstract v
Mirënjohje vi
Indeksi i grafikëve dhe tabelave x

Hyrje
Prezantimi i problemit xii
Qëllimi dhe objektivat xiii
Baza e nisjes xiii
Pyetjet kërkimore të studimit xiii
Rëndësia e studimit xiv
Përkufizimi i koncepteve xv
Organizimi i studimit xv

Kapitulli I
METODOLOGJIA E STUDIMIT

1.1 Hartimi i kërkimit 1
1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit 1
1.3 Pyetjet kërkimore të studimit 1
1.4 Historiku i kërkimit. 2
1.5 Metoda e studimit 2
1.5.1 Instrumentet e kërkimit 4
1.5.2 Përzgjedhja e pjesëmarrësve 5
1.6 Kufizimet e studimit 6
1.7 Etika e studimit 7

Kapitulli II
KËNDVËSHTRIM HISTORIK I SHTRIRJES DHE FUNKSIONIMIT TË SHKOLLLAVE PRIVATE NË SHQIPËRI NGA FILLIMET DERI MË 1946

2.1 Shkollat në sistemin iliro-shqiptar të edukatës 9
2.2 Arsimi dhe mendimi pedagogjik në Mesjetë 10

2.3 Sistemi i edukatës popullore 12
2.4 Arsimi dhe shkollat prevate në Mesjetën e vonë 17
2.5 Zhvillimi i arsimit në shek. XVII-XVIII....23
2.5.1 Kuvendi i Arbrit (15 janar 1703)....23
2.6 Zhvillimi i arsimit në shekullin XVIII deri në shpalljen e Pavarësisë....28
2.6.1 Kompleksi arsimor-kulturor i Voskopojës 29
2.6.2 Kompleksi arsimor-kulturor i pashallëkut të Bushatllinjve në Shkodër 31
2.6.3 Kolegji Saverian....38
2.6.4 Mësonjëtorja shqipe e Korçës 49
2.7 Shkollat private pas shpalljes së Pavarësisë....52
2.7.1 Gjimnazi "Illyricum" 53
2.7.2 Medreseja e vitit 1925 në Shkodër....70
2.7.3 Medreseja e Xhamisë Plakë, viti 1944 71
2.7.4 Medreseja e Përgjithshme, Tiranë 74

Kapitulli III
ZHVILLIMET E ARSIMIT JOPUBLIK PAS VITEVE '90

3.1 Zhvillimi i arsimit jopublik pas viteve '90 77
3.1.1 Organet përgjegjëse dhe roli i tyre për arsimin jopublik....77
3.1.2 Kuadri ligjor i përgjithshëm për hapjen dhe funksionimin e institucioneve parauniversitare jo publike....79
3.1.2.1 Kriteret për dhënien e licencës 79
3.1.2.2 Kushtet për të hapur një shkollë private 80
3.1.3 Standardet normative që duhet të përmbushë/in objekti/et që do të funksionojnë si institucione arsimore 81
3.1.4 Kërkesat që duhet të plotësojë stafi mësimdhënës 83
3.1.5 Kontrolli i shtetit mbi arsimin privat....83
3.1.6 Financimi publik dhe i grandeve....84
3.1.7 Tarifat në shkollat private....84
3.1.8 Mbështetja për familjet në nevojë....85
3.1.9 Ekuivalentimi i kurrikulave dhe kualifikimit 85
3.1.10 Organizimi i provimeve dhe certifikatat/dëftesat e lëshuara për nxënësit 85
3.1.11 Statusi i mësuesit....85
3.1.11.1 Lëvizja e mësuesve nga sektori publik në atë privat....85
3. 2. Zhvillimet e arsimit privat në vendet e Bashkimit Evropian 100
3.2.1 Shpërndarja e nxënësve....100
3.2.2 Kushtet për ngritjen e shkollave private....100
3.2.2.1 Kushtet fizike për hapjen e shkollave private....101
3.2.3 Numri i nxënësve në klasë 101

3.2.4 Kërkesat për stafin e mësuesve 101
3.2.5 Kërkesat lidhur me përmbajtjen 101
3.2.6 Kontrolli i shtetit 102
3.2.7 Ekuivalenca e kurrikulës dhe kualifikimit.....102
3.2.8 Financimi publik i granteve 103

Kapitulli IV
STUDIM RASTI - ARSIMI PRIVAT NË RRETHIN E SHKODRËS NË PERIUDHËN 2010-2014

4.1 Institucione.....107
4.2 Infrastruktura.....109
4.3 Shërbimet në shkolla.....113
4.4 Financimi 115
4.5 Drejtimi i shkollës 116
4.6 Mësuesi 117
4.7 Nxënësi 142

Kapitulli V
DISKUTIME 155

Kapitulli VI
PERFUNDIME DHE REKOMANDIME.....192

BIBLIOGRAFI 205
Aneks.....212

INDEKSI I GRAFIKËVE DHE TABELAVE

Grafiku 1. Numri i institucioneve të licencuara. 86
Grafiku 2. Numri i institucioneve të licencuara sipas llojit (1995-2012). 86
Grafiku 4. Numri i institucioneve të arsimit bazë në shkallë Republike (2004-2015). 89
Grafiku 5. Institucionet e arsimit të mesëm sipas llojit publik/privat dhe sipas profilit (2004-2015). 89
Grafiku 6. Numri i institucioneve sipas tipit dhe niveleve/arsimi parashkollor (2004-2015). 90
Grafiku 7. Numri i institucioneve sipas tipit dhe niveleve/arsimi 8/9-vjeçar (2004-2015). 91
Grafiku 8. Numri i institucioneve sipas tipit dhe niveleve/arsimi i mesëm (2004-2015) 91
Grafiku 9. Përqindja e institucioneve arsimore publike dhe jopublike për arsimin parauniversitar për periudhën 2003-2015. 92
Grafiku 10. Numri i mësuesve në arsimin bazë në vite sipas gjinisë e vendndodhjes së shkollës (Republika, 2004-2015) 93
Grafiku 11. Numri i mësuesve në arsimin e mesëm në vite sipas gjinisë e vendndodhjes së shkollës (Republika, 2004-2015) 94
Grafiku 12. Niveli arsimor i mësueseve në kopshtet publike e jopublike.(Republika 2004-2015). 95
Grafiku 13. Niveli i arsimit të mësuesve në arsimin bazë (Republika 2004-2015) 96
Grafiku 14. Niveli i arsimit të mësuesve në arsimin e mesëm, Republika 2004-2015 97
Grafiku 15. Nxënës të regjistruar (në përqindje, në të gjithë Republikën, 2004-2015) sipas viteve në arsimin bazë AF, AMU. 99
Grafiku 16. Përqindja e drejtueseve femra në arsim. 117
Grafiku 17. Numri i mësueseve femra në arsimin bazë. 118
Grafiku 18. Përqindja e mësueseve femra në arsimin e mesëm të lartë. 118
Grafiku 19. Kopshtet private - Niveli arsimor i edukatoreve ndër vite. 119
Grafiku 20. Niveli arsimor i mësuesve në ciklin fillor të arsimit të detyruar, 2010-2011. 119
Grafiku 21. Niveli arsimor i mësuesve në ciklin fillor të arsimit të detyruar, 2011-2012. 120
Grafiku 22. Niveli arsimor i mësuesve në ciklin fillor të arsimit të detyruar, 2012-2013. 120
Grafiku 23. Niveli arsimor i mësuesve në ciklin fillor të arsimit të detyruar, 2013-2014. 121
Grafiku 24. Arsimi privat - Niveli arsimor i mësueseve në Ciklin e Ulët sipas viteve. 121
Grafiku 25. Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të ulët, 2010-2011. 122
Grafiku 26. Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të ulët, 2011-2012. 123
Grafiku 27. Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të ulët, 2012-2013. 123
Grafiku 28. Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të ulët, 2013-2014. 124
Grafiku 29. Arsimi privat- Niveli arsimor i mësueseve në arsimin e mesëm të ulët sipas viteve. 124
Grafiku 30. Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2010-2011. 125
Grafiku 31. Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2011-2012. 125
Grafiku 32. Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2012-2013. 126
Grafiku 33. Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2013-2014. 126
Grafiku 34. Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë. 127
Grafiku 35. Kopshtet Private - Grupmosha e edukatoreve në vitin 2010-2011 127
Grafiku 36. Kopshtet private - Grupmosha e edukatoreve në vitin 2011-2012. 128
Grafiku 37. Kopshtet private - Grupmosha e edukatoreve në vitin 2012-2013. 128
Grafiku 38. Kopshtet private - Grupmosha e edukatoreve në vitin 2013-2014. 129
Grafiku 39. Grupmosha e mësuesve në arsimin fillor privat, 2010-2011. 129
Grafiku 40. Grupmosha e mësuesve në arsimin fillor privat, 2011-2012. 130

Grafiku 41. Grupmosha e mësuesve në arsimin fillor privat, 2012-2013. 130
Grafiku 42. Grupmosha e mësuesve në arsimin fillor privat, 2013-2014. 131
Grafiku 43. Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të ulët privat, 2010-2011. 131
Grafiku 44. Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të ulët privat, 2011-2012. 132
Grafiku 45. Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të ulët privat, 2012-2013. 132
Grafiku 46. Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të ulët privat, 2013-2014. 133
Grafiku 47. Arsimi privat-Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2010-2011. 133
Grafiku 48. Arsimi privat-Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2011-2012. 134
Grafiku 49. Arsimi privat-Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2012-2013. 134
Grafiku 50. Arsimi privat-Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2013-2014. 135
Grafiku 51. Përvoja e mësuesve në arsimin bazë ndër vite. 135
Grafiku 52. Përvoja e mësuesve në arsimin e mesëm të lartë ndër vite 136
Grafiku 52. Përqindja e fëmijëve të regjistruar në kopshte publike dhe private. 142
Grafiku 53. Kopshtet private: Raporti qytet – fshat. 143
Grafiku 54. Kopshtet private - Numri i fëmijëve të regjistruar ndër vite sipas grupmoshave. 144
Grafiku 55. Përqindja e nxënësve të regjistruar në shtator në arsimin bazë. 144
Grafiku 56. Përqindja e nxënësve në klasën e parë të arsimit të detyruar. 145
Grafiku 57. Përqindja e nxënësve femra të regjistruara në shtator në arsimin e detyruar. 145

Tabela 1. Përhapja e shkollave sipas rretheve. 27
Tabela 2. Plani mësimor për 6 klasa me të cilat punonte shkolla në vitin 1902. 37
Tabela 3. Plani mësimor i Kolegjit Saverian, Shkodër. 40
Tabela 4. Organizimi i shkollës stigmatine. 47
Tabela 5. Të dhëna mbi përfundimin e shkollës nga nxënësët maturante. 49
Tabela 6. Pasqyrë përmbledhëse për numrin e shkollave private 1924-1930. 55
Tabela 7. Pasqyrë përmbledhëse statistikore për vitin shkollor 1925-1926, në Shkodër. 56
Tabela 8. Shkollat e mesme në Shkodër 1924-1925 deri më 1928-1929. 56
Tabela 9. Shkollat e mesme në prefekturën e Shkodrës 57
Tabela 10. Statistika të shkollave private dhe akatolike të mbyllura 61
Tabela 11. Shkollat që u mbyllën sipas reformës arsimore. 62
Tabela 12. Ndryshimet statistikore mbi gjendjen së arsimit shqiptar në vitet 1938-1939. 65
Tabela 13. Të dhëna mbi Medresenë. 72
Tabela 14. Tarifat e institucioneve arsimore. 84
Tabela 15. Numri i fëmijëve/nxënësve, institucioneve dhe mësuesve për periudhën 1997-2015 ISCED 0-598
Tabela 16. Lista e kopshteve private të rrethit Shkodër. 107
Tabela 17. Lista e shkollave private të arsimit 9 vjeçar në rrethin Shkodër. 108
Tabela 18. Lista e shkollave private të arsimit të mesëm në rrethin Shkodër. 109
Tabela 19. Numri klasave në arsimin jopublik të mesëm sipas viteve. 113

Hyrje

Ky punim është në fushën e edukimit dhe ka në fokus arsimin jopublik parauniversitar. Nëpërmjet studimit synohet të bëhet një analizë e ecurisë të këtij arsimi në Shqipëri (që nga licencimi, aspektet organizative, ligjore, në përmbushjen e standardeve në mësimdhënie, nxënie, infrastrukturë, kualifikim, etj.) duke e krahasuar me praktikat e vendeve të BE-së e më gjerë. Ky krahasim është i domosdoshëm në mënyrë të veçantë për të demonstruar se pavarësisht diferencave ndërmjet vendeve të ndryshme, të gjithë duhet ta shikojnë arsimin jopublik si një alternativë me vlera, që sjell progres në fushën e arsimit, dhe si një element të demokracisë e të ekonomisë së tregut.

Prezantimi i problemit

Sot, sistemi arsimor përballet me sfidat e filozofisë së re te jetës, të ekonomisë se tregut të lirë dhe integrimit evropian te vendit tonë, ku arritja e standardeve evropiane ndeshet me probleme delikate që kërkojnë zgjidhje. Në zhvillimet aktuale e perspektive, reformat në arsimin parauniversitar, mbartin me vete prirjen e brendshme për zhvillim, me synim integrimin e shoqërisë shqiptare në zhvillimet rajonale dhe evropiane.

Sfida që duhet të përballojmë në periudhën e tranzicionit për të adoptuar funksionimin e jetës ekonomiko-shoqërore mbi bazën e mekanizmit të institucioneve të tregut dhe të demokracisë perëndimore, kërkon që arsimi publik e privat të zhvillohen, konsolidohen dhe të ndjekin tendencën e arsimit të vendeve perëndimore.

Arsimi është një ndër prioritetet kryesorë për të ardhmen e Shqipërisë, një faktor themelor për rritjen ekonomike, vendosjen e barazisë, uljen e varfërisë dhe formimin e qytetarit të shoqërisë demokratike. Shqiptarët, historikisht e kanë konsideruar dhe vazhdojnë ta konsiderojnë arsimin një trashëgimi të çmuar. Duke ndjekur traditën e brezave paraardhës, jo vetëm në vite, por edhe në shekuj, arsimi vazhdon të jetë një nga vlerat themelore të shoqërisë shqiptare dhe një nga çelësat e së ardhmes së saj.

Një arritje e rëndësishme në fushën e demokratizimit të institucioneve të edukimit, e veçanërisht arsimit, është zgjerimi i arsimit privat. Zhvillimet demokratike të vendit tonë hapën perspektiva të reja edhe për arsimin privat. Arsimi ynë kombëtar, dhe bashkë me të shoqëria shqiptare, ka nevojë për krijimin e përfytyrimit të një shkolle të ardhshme, me baza shkencore, një shkolle të vërtetë, që të përmbush të gjitha parametrat e nevojshëm.

Arsimi privat krijon kushte shumë të favorshme për t'u shërbyer indirekt prindërve dhe nxënësve, sepse u realizon nevojat, aspiratat, dëshurat që kanë për arsimimin, kur dihet se të gjithë njerëzit duan të marrin atë arsim që dëshirojnë. Është e kuptueshme që shkolla private lidhet më tepër me perspektivën ekonomike të vendit, që do të thotë i përgatit moshat e reja në përputhje me nevojat e tregut.

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij studimi është të përshkruajë dhe të analizojë organizimin dhe funksionimin e sistemit të arsimit jopublik parauniversitar në nivel kombëtar[1], duke u bazuar në zhvillimin historik të tij nga fillimet e deri në ditët e sotme, si dhe përmes të dhënave e indikatorëve analitikë dhe sintetikë për çdo etapë e nivel shkollimi, duke analizuar veçanërisht arsimin privat në rrethin e Shkodrës si një rast përshkrues studimor.

Objektivat e studimit

- Identifikimi i ndryshimeve strukturore dhe funksionale që ka pësuar sistemi arsimor parauniversitar privat në trevat shqiptare[2], duke u ndalur në zhvillimet dhe risitë e tij.
- Evidentimi i zhvillimeve kryesore në sistemin arsimor parauniversitar privat në nivel kombëtar të shprehura përmes indikatorëve analitikë e sintetikë e krahasuar me indikatorët respektivë të vendeve të BE.
- Përshkrimi dhe analiza e organizimit dhe funksionimit të institucioneve private të arsimit parauniversitar në rrethin e Shkodrës për çdo etapë e nivel shkollimi.
- Identifikimi i risive që ofron alternativa e sistemit privat parauniversitar dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse.

Baza e nisjes

Kërkimet e autorëve shqiptarë dhe të huaj përbëjnë bazën e nisjes të këtij punimi. Në hartimin e tij kemi pasur gjithnjë parasysh aksiomat që: arsimi është një ndër prioritetet kryesore për të ardhmen e Shqipërisë, është faktor vendimtar për rritjen ekonomike, vendosjen e barazisë, uljen e varfërisë dhe formimin e qytetarit në një shoqëri demokratike. Në të njëjtën kohë, arsimi duhet t'i krijojë mundësinë çdo individi për të rritur maksimalisht potencialin e vet. Në zhvillimet aktuale e perspektive, reformat në arsim, mbartin me vete prirjen e brendshme për zhvillim, me synim integrimin e shoqërisë shqiptare në zhvillimet evropiane.

Pyetjet kërkimore të studimit

Ky studim synon do t'u japë përgjigje këtyre pyetjeve:

- Cilat janë zhvillimet historike të arsimit parauniversitar privat në Shqipëri që nga fillimet e tij e deri në vitin 1946?
- Cila është shtrirja, organizimi dhe funksionimi i institucioneve private nga vitet '90 e deri në ditët tona?
- Cilat janë ndryshimet strukturore dhe funksionale që ka pësuar sistemi arsimor parauniversitar privat në Shqipëri?
- Cilat janë tendencat e sotme të zhvillimit të arsimit privat parauniversitar në Shqipëri krahasuar me atë në botë?
- Cilat janë modalitetet e MAS- it për arsimin parauniversitar privat?
- Cila është tabloja e shtrirjes dhe funksionimit të shkollave private në rrethin e

1 Nivel kombëtar - term i përdorur vetëm për Republikën e Shqipërisë.
2 Trevat shqiptare - përfaqëson shkollat shqipe edhe jashtë teritoreve të Republikës së Shqipërisë.

Shkodrës?

- Cili është këndvështrimi i drejtuesve të shkollave private në lidhje me indikatorët respektivë për organizimin dhe funksionimin e institucioneve jopublike parauniversitare në rrethin e Shkodrës?

Rëndësia e studimit

Arsyet që zgjodha këtë temë janë të shumta. Zhvillimet demokratike të vendit tonë hapën perspektiva të reja edhe për arsimin privat. Arsimi ynë kombëtar dhe bashkë me të shoqëria shqiptare ka nevojë për krijimin e përfytyrimit të një shkolle të ardhshme, me baza shkencore, një shkolle të vërtetë, që të përmbushë të gjitha parametrat e nevojshme.

Nga ana tjetër shkolla private krijon kushte shumë të favorshme për t'u shërbyer indirekt prindërve dhe nxënësve, sepse u realizon atyre nevojat, aspiratat, hobet që kanë për arsimim, kur dihet se të gjithë njerëzit duan të marrin atë arsim që dëshirojnë.

Hapja, funksionimi dhe zhvillimi i shkollave private është bërë me ligje të miratuara nga instancat më të larta ndërkohë që përbënte risi për legjislacionin tonë, por ligji me të drejtë kërkon zbatimin me rigorozitet të legjislacionit shqiptar dhe të rendit publik, ashtu si edhe të normave morale, së bashku me kushtet ku do të zhvillohet veprimtaria shkollore si dhe një kuadër mësimor të kualifikuar e të përshtatshëm.

Ndonëse hapja e shkollave private fillimisht shërbeu si model, ritmi i hapjes së shkollave private nuk është i papërfillshëm dhe numri i tyre ka ardhur gjithnjë në rritje.

Numri jo i pakët i shkollave private të hapura më Shqipëri duhet parë në dy këndvështrime: në dobinë që sjellin dhe në mangësitë që kanë në përmbushjen e këtyre standardeve.

Standardet arsimore si koncept, hartimi dhe zbatimi i tyre në praktikë në arsimin publik dhe atë jopublik janë çështje shumë të rëndësishme për sistemin arsimor shqiptar. Fakti që përballë arsimit publik është një alternativë tjetër, e detyron arsimin publik që të punojë për të rritur standardet e tij.

Arritja e qëllimeve të shtetit dhe shoqërisë sonë për integrimin evropian ka përfshirë ristrukturimin e të gjithë institucioneve. Në realizimin e këtyre qëllimeve, arsimi dhe shkolla jonë po punon për të realizuar standardet perëndimore, pjesë e të cilave janë edhe shkollat private.

Sfidat e reja të shek. XXI, kërkojnë reformimin e arsimit, diktuar nga zhvillimet e shpejta të shoqërisë si dhe nga nevoja e edukimit të brezit të ri, i cili duhet të shkollohet, të jetë i përgatitur dhe të jetë i aftë që të bëhet pjesë e kësaj shoqërie. Politikat arsimore janë ato që e përmirësojnë ose jo sistemin arsimor. Përvoja e institucioneve jopublike, e cila do të evidentohet nëpërmjet këtij studimi, do te jetë me vlerë pasi kjo përvojë mund të na shërbejnë si shembull, e ky shembull pse jo të praktikohet në arsimin tonë.

Një arsye tjetër pse zgjodha këtë temë ka të bëjë me faktin se, si lektore e lëndës "Histori e mendimit pedagogjik" jam e interesuar të hulumtoj në kërkime teorike në kontekstin shqiptar për rolin e arsimit privat në zhvillimin e mendimit pedagogjik.

Ky punim do të përbëjë një kontribut shkencor në fushën e edukimit. Kontributi i studimit do të jetë në planin teorik e praktik, si rrjedhojë, punimi do të jetë i vlefshëm për komunitetin në tërësi, por edhe për politikëbërësit në fushën e arsimit. Është e domosdoshme që të gjithë të kemi njohuri për këtë alternativë të edukimit, të njihemi me përvojën e vendeve të tjera, si një mundësi, jo vetëm vlerësimi, por edhe përmirësimi

të cilësisë së këtij shërbimi në mënyrë që të bëjmë më të mirën për fëmijët tanë.

Si përfundim nuk mund të lë pa përmendur edhe një fakt tjetër: Si prindër jemi në mes të alternativës: kë të zgjedh shkollën publike apo atë jopublike?

Përkufizimi i koncepteve

Përkufizimi i koncepteve kryesore të përdorura në këtë studim po përshkruhet si më poshtë:

"Arsimi parauniversitar" përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas "Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit", të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997, përkatësisht:

a) "Niveli me kodin 0", arsimi parashkollor;

b) "Niveli me kodin 1", arsimi fillor;

c) "Niveli me kodin 2", arsimi i mesëm i ulët;

ç) "Niveli me kodin 3", arsimi i mesëm i lartë.

"Arsimi bazë": përfshin arsimimin në nivelet 1 dhe 2; "Niveli 1" përfshin arsimin fillor; "Niveli 2" përfshin arsimin e mesëm të ulët (Ligji 69, 2012).

"Institucion arsimor" është kopshti ose shkolla.

"Kopsht" është institucioni arsimor që ofron shërbim arsimor të nivelit me kodin 0.

"Kurrikula bërthamë" është kurrikula e përbashkët për të gjithë nxënësit e një klase në sistemin arsimor.

"Mësues" - "Ai që jep mësim në një shkollë tetëvjeçare a të mesme; arsimtar; mësimdhënës", sipas Kostallari (1984). Ndërsa sipas ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar" (2012), "Mësues është personi që ka fituar të drejtën të ushtrojë profesionin në nivelet 0, 1, 2, 3"; ("Niveli 1" përfshin arsimin fillor; "Niveli 2" përfshin arsimin e mesëm të ulët; "Niveli 3" përfshin arsimin e mesëm të lartë).

"Kurrikula" është tërësia e dokumentacionit si: korniza kurrikulare, plani shkollor, programi mësimor, teksti dhe materiale të tjera të një lënde ose fushe të të nxënit dhe e tërë veprimtaria e organizuar në mjedisin e të mësuarit, që shërben për të siguruar një formim të caktuar të atyre që nxënë.

"Ministri" është ministri që mbulon çështjet e arsimit parauniversitar.

"Ministria" është ministria që mbulon çështjet e arsimit parauniversitar.

"Nxënës" është personi që arsimohet në arsimin parauniversitar.

"Shkollë" është institucioni që ofron shërbim arsimor për nivelet me kodet 1, 2, 3.

"Shkollë private" është shkolla jopublike, e cila nuk themelohet, financohet dhe administrohet nga qeveria qendrore ose vendore.

Organizimi i studimit

Punimi që po paraqesim përbëhet nga seksioni hyrës, 6 kapituj, bibliografia dhe shtojcat.

Në seksionin e parë, të titulluar "Hyrja", trajtohen prezantimi i problemit, qëllimi i studimit, pyetjet e studimit, rëndësia e studimit, përkufizimi i koncepteve kryesore dhe organizimi i studimit.

Në kapitullin e parë trajtohet metodologjia që është përdorur për të kryer studimin, jepen në mënyrë të hollësishme qëllimi dhe objektivat e studimit, metodat kërkimore të përdorura për mbledhjen dhe analizën e të dhënave si dhe kufizimet e studimit.

Në kapitullin e dytë paraqitet një historik i shkollave private nga fillimet e tyre deri në vitin 1946. Janë trajtuar shkollat private jo vetëm në territoret e shtetit të sotëm shqiptar, por edhe në të gjitha trojet shqiptare. Mbështetur mbi baza dokumentare historike, sidomos përmes shfrytëzimit të burimeve bibliografike, burimeve arkivore, teksteve e botimeve të periudhës së paraçlirimit, fondeve të bibliotekave private, botimeve të veçanta për historinë e shkollës dhe mendimit pedagogjik, botuar në organe të ndryshme si "*Mësuesi*", *"Arsimi popullor", "Revista Pedagogjike",* koleksioneve të organeve të shtypit të periudhës së paraçlirimit, *"Posta shqiptare", Hylli i dritës", "Shkolla e re"* etj, si dhe intervistave me ish-nxënës e mësues të shkollave, të cilët më kanë dhënë një ndihmë konkrete me kujtimet e tyre, madje më kanë ndihmuar edhe me libra e fletore të cilat i kanë ruajtur me shumë kujdes, kemi ndërtuar një panoramë të zhvillimeve të këtyre shkollave në periudha të ndryshme historike, rolin që luajtën gjatë shekujve për arsimimin e popullit, duke ndriçuar punën e mësuesve dhe nxënësve të këtyre shkollave, rolit që këto shkolla kanë luajtur në edukimin e breznive të rinj dhe përhapjen e dijeve, për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës shqipe, pasi problemi i shkollave asnjëherë nuk mund të ndahet nga ai i gjuhës.

Kontributi i këtyre shkollave nuk është parë vetëm në përhapjen e arsimit në popull, por edhe në ndihmesën që dhanë në edukimin moral, qytetar e atdhetar të breznive të reja, në rrënjosjen e dashurisë për dije e përparim.

Ky prezantim hedh dritë mbi punën e atyre mësuesve të palodhur që kanë kontribuar në përhapjen e mendimit pedagogjik më të përparuar të kohës dhe në përpunimin e mendimit pedagogjik shqiptar.

Në kapitullin e tretë pasqyrohet zhvillimi i arsimit jopublik nga viti '90 e deri në ditët e sotme, pasi ndryshimet demokratike të pas viteve '90-të sollën edhe kërkesën për rivendosjen e arsimit jopublik. Në këtë kapitull kemi paraqitur dhe trajtuar probleme që lidhen me zhvillimin e politikave arsimore, të cilat pasqyrohen përmes kuadrit ligjor për arsimin privat parauniversitar, që nga hapja dhe funksionimi i institucioneve parauniversitare jo publike, kriteret për dhënien e licencës, kushtet për të hapur një shkollë private, kërkesat që duhet të plotësojë stafi mësimdhënës, financimin, tarifat, ekuivalentimi i kurrikulave dhe kualifikimit, organizimi i provimeve e certifikatat, etj. Mbështetur në analizën statistikore të raporteve vjetore statistikore të arsimit, të hartuara nga MASH (sot MAS) në këtë kapitull kemi pasqyruar zhvillimet që ky arsim ka pësuar pas viteve '90, sipas indikatorëve të performancës së shërbimit arsimor jopublik, tregues që do të na mundësojnë në vlerësimin e arritjeve në krahasim me vendet e rajonit dhe ato të BE-së.

Në kapitullin e katërt përshkruhet zhvillimi i arsimit jopublik në rrethin e Shkodrës në periudhën 2010-2014**.** Arsyeja që u zgjodh Shkodra për studim rasti është fakti se në rrethin e Shkodrës, në krahasim me rrethet e tjera të Shqipërisë, kemi të gjitha institucionet jopublike të arsimit parauniversitar duke filluar nga kopshtet, shkolla vetëm të ciklit të ulët, shkolla të arsimit bazë, gjimnaze klasike, shkollë fetare, shkollë tekniko-profesionale. Përmes një procedure që harmonizon të dhënat nga baza e të dhënave e Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër dhe mbështetur në intervistat gjysmë të strukturuara, e të realizuara me drejtuesit e shkollave private të rrethit të Shkodrës, u ndërtua tabloja e organizimit dhe funksionimit të institucioneve

private të arsimit parauniversitar, i cili përbën një tregues të zhvillimeve kryesore në sistemin parauniversitar jopublik të shprehura përmes indekseve analitikë e sintetikë të performancës së shërbimit arsimor jopublik si: Institucione (kopshte, arsimi 9 vjeçar, arsimi i mesëm); Infrastruktura *(mjediset, klasat, mjetet mësimore dhe didaktike)*; Shërbimet shkollore *(transporti, trajtimi me ushqim, shërbimi mjekësor dhe psikologjik);* Financimi; Drejtuesit *(niveli arsimor, të dhëna demografike)*; Mësuesit *(arsimimi, të dhëna demografike, niveli arsimor i mësuesve sipas cikleve të shkollimit, grupmosha e mësuesve, përvoja e mësuesve në arsim, përbërja e stafit, përzgjedhja e stafit, kualifikimi i stafit, komunikimi me prindërit);* Nxënësit *(kontingjenti që ndjek shkollat private, numri i nxënësve, nxënësit e talentuar, uniforma shkollore, kurrikula, veprimtaritë jashtëshkollore).*

Në kapitullin e pestë, trajtohen diskutimi i të dhënave të studimit dhe gjetjet e studimit.

Në kapitullin e gjashtë jepen përfundimet dhe rekomandimet si dhe sugjerime për studime të mëtejshme.

Në fund të punimit paraqiten lista e referencave dhe shtojcat.

KAPITULLI I

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Në metodologjinë e studimit jepen në mënyrë të hollësishme plani i kërkimit dhe metodat kërkimore të përdorura për mbledhjen e të dhënave, procedurat dhe instrumentet, kriteret e përzgjedhjes së pjesëmarrësve, kufizimet dhe etika e studimit.

1.1 Hartimi i kërkimit

Në Shqipëri ka mungesë të studimeve të plota në lidhje me zhvillimin e arsimit jopublik. Studimi ynë pasqyron zhvillimin e arsimit jopublik nga fillimet e tij deri në ditët e sotme, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit, duke u bazuar jo vetëm në statistikat zyrtare, por edhe në përvojat e drejtuesve të shkollave private.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është të përshkruajë dhe të analizojë organizimin dhe funksionimin e sistemit të arsimit jopublik parauniversitar në nivel kombëtar, duke u bazuar në zhvillimin historik të tij nga fillimet e deri në ditët e sotme si dhe përmes të dhënave e indikatorëve analitikë dhe sintetikë për çdo etapë e nivel shkollimi, duke analizuar veçanërisht arsimin privat në rrethin e Shkodrës si një rast përshkrues studimor.

Objektivat e studimit

- Identifikimi i ndryshimeve strukturore dhe funksionale që ka pësuar sistemi arsimor parauniversitar privat në trevat shqiptare, duke u ndalur në zhvillimet dhe risitë e tij.
- Evidentimi i zhvillimeve kryesore në sistemin arsimor parauniversitar privat në nivel kombëtar, të shprehura përmes indikatorëve analitikë e sintetikë, krahasuar me indikatorët respektivë të vendeve të BE-së dhe më gjerë.
- Përshkrimi dhe analiza e organizimit dhe të funksionimit të institucioneve private të arsimit parauniversitar në rrethin e Shkodrës, për çdo etapë e nivel shkollimi.
- Identifikimi i risive që ofron alternativa e sistemi privat parauniversitar si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse.

1.3 Pyetjet kërkimore të studimit

Ky studim synon tu japë përgjigje këtyre pyetjeve:

- Cilat janë zhvillimet historike të arsimit parauniversitar privat në Shqipëri që

nga fillimet e tij e deri në vitin 1946?

- Cila është shtrirja, organizimi dhe funksionimi i institucioneve private nga vitet'90 deri në ditët tona?
- Cilat janë ndryshimet strukturore dhe funksionale që ka pësuar sistemi arsimor parauniversitar privat në Shqipëri?
- Cilat janë tendencat e sotme të zhvillimit të arsimit privat parauniversitar në Shqipëri krahasuar me atë ndërkombëtar?
- Cilat janë modalitetet e MAS-it për arsimin parauniversitar privat?
- Cila është tabloja e shtrirjes dhe funksionimit të shkollave private në rrethin e Shkodrës?
- Cili është këndvështrimi i drejtuesve të shkollave private në lidhje me indikatorët respektivë për organizimin dhe funksionimin e institucioneve jopublike parauniversitare në rrethin e Shkodrës?

1.4 Historiku i kërkimit.

Realizimi i këtij kërkimi ka nisur në mesin e vitit 2010, kur kërkuesja ka zgjedhur fushën e kërkimit, dhe ka përfunduar me paraqitjen shkrimore të tij. Fusha e arsimit jopublik, organizimi dhe funksionimi i këtij arsimi, modalitetet e MAS-it, krahasimi me praktikat e vendeve të BE-së, kanë qenë në interes të kërkueses, pasi në universitet jep edhe lëndën e Historisë së Arsimit dhe Mendimit Pedagogjik.

Përzgjedhja e fushës së studimit lidhet ngushtë me eksperiencën e saj disa vjeçare jo vetëm si lektore, por edhe si studiuese në fushën e historisë e mendimit pedagogjik botëror dhe shqiptar. Hulumtimet në zhvillimin e arsimit jo vetëm në Shqipëri, por edhe në trevat shqiptare dhe më gjerë, kanë evidentuar njëanshmëri për sa i përket trajtimeve, si edhe pasaktësi në trajtimin e shumë shkollave apo qëndrime jo të drejta. Pikërisht kjo, ka nxitur tek kërkuesja një ndjeshmëri më të lartë ndaj ngjarjeve dhe zhvillimeve të historisë së arsimit dhe atyre që kanë kontribuar për arsimimin e brezit të ri. Në vitet në vazhdim, kërkuesja ka realizuar një sërë kërkimesh, në funksion të krijimit të një panorame më të plotë të zhvillimeve të arsimit privat nga fillimet deri në vitin 1946 kur ato u mbyllën, duke u ndalur në trajtimin e shkollave, programeve që janë përdorur, mësuesve që kanë shërbyer në to dhe teksteve që janë punuar; shkollat femërore, institucionet fetare private, zhvillimet e arsimit jopublik pas viteve '90, që nga kriteret e ligjshmëria për hapjen dhe funksionimin, por edhe shtrirja dhe tendencat e këtij arsimi, krahasuar edhe me praktikat e vendeve të BE-së.

1.5 Metoda e studimit

Në përzgjedhjen e metodave të studimit është mbajtur në fokus qëllimi dhe objektivat e studimit, çështjet që do të trajtohen dhe lloji i të dhënave që duhen mbledhur dhe analizuar për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore të studimit.

Në këtë studim është përdorur metoda cilësore. Kërkimi cilësor ka si qëllim të përshkruajë dukuri dhe sjellje sociale nëpërmjet të dhënave kontekstuale të larmishme. Ndryshe nga kërkimi sasior, kërkimi cilësor përpiqet ta eksplorojë dhe shpjegojë botën nëpërmjet përvojave të aktorëve socialë (Mays & Pope, 1995) dhe duke nxjerrë në dritë të dhëna që nuk janë shumë lehtë të aksesueshme nga kërkimi sasior.

Sipas Corbin dhe Strauss (2008), të bësh kërkim cilësor do të thotë ta shohësh botën

me sytë e pjesëmarrësve, të arrish një kuptim të thelluar të fenomenit nga perspektiva e njerëzve. Sipas Nurani (2008), kur aplikohet kërkimi cilësor, kërkuesi interpreton popullatën ose fenomenin që ka nën vëzhgim duke përdorur zërat e pjesëmarrësve në studim. Wiersma (1986), theksonte se nëpërmjet kërkimit cilësor, kërkuesi mund të arrijë njerëzit dhe të ndërveprojë me ata, të shikojë sesi sillen ata dhe të mësojë se cilat janë shqetësimet, pikëpamjet dhe përjetimet e tyre. Kërkimi cilësorë është bërë një mjet shumë i dobishëm nëpërmjet të cilit nxirren në pah përvojat e njerëzve që pësojnë ndryshime në kontekstin e zhvillimit (Tinker, 1990). Kërkimi cilësor është efektiv në sigurimin e informacioneve specifike që kanë të bëjnë më vlerat sociale, opinionet, besimet, qëndrimet dhe emocionet e një popullate të veçantë. Është e rëndësishme të theksohet se thelbi i kërkimit cilësor bazohet në atë që është natyrore, duke studiuar personat e vërtetë në mjediset natyrore dhe jo në izolim artificial (Marshall, 1996). Kërkimi cilësor i ka bazat në një pozicion filozofik që është gjerësisht "interpretues", në kuptimin që përqendrohet në atë sesi është interpretuar, kuptuar, përjetuar ose krijuar bota sociale (Beauchamp & Childress, 1985).

Nga kjo pikëpamje e metodologjisë, si u theksua edhe më sipër, për këtë studim është përdorur metoda cilësore për të përshkruar zhvillimin e arsimit jopublik parauniversitar në nivel kombëtar dhe në mënyrë specifike është përdorur rasti studimor përfaqësues/ tipik ku përshkruhet zhvillimi i arsimit jopublik në rrethin e Shkodrës në periudhën 2010-2014**.** Arsyeja që u zgjodh Shkodra për studim rasti është fakti se në rrethin e Shkodrës, në krahasim me rrethet e tjera të Shqipërisë, kemi të gjitha institucionet jopublike të arsimit parauniversitar duke filluar nga kopshtet, shkolla vetëm të ciklit të ulët, shkolla të arsimit bazë, gjimnaze klasike, shkollë fetare, shkollë tekniko-profesionale. Rasti studimor është dhe një strategji kërkimore e cila bazohet në eksplorimin empirik në thellësi të një fenomeni të vetëm ose të një numri shumë të vogël rastesh (rast brenda rasti). Kjo strategji ka për synim investigimin e secilit rast, kontekstit të tij dhe formimit të tij si 'rast', si dhe të nxjerrë në dritë karakteristikat tipike të këtij rasti. Në rastin i këtij lloj studimi, qëllimi i studiuesit është të përshkruajë kushtet/rrethanat/mundësitë e ekzistencës të një situate krejt të zakonshme e ndoshta dhe të përditshme. Në rastin studimor përfaqësues/tipik, rastet studimore zgjidhen jo sepse janë të rralla apo të veçanta, por sepse simbolizojnë/përfaqësojnë një grup shumë më të madh dhe sepse shpesh ofrojnë kontekstin e duhur në të cilin një pyetjeje kërkimore mund t'i jepet përgjigje (Ragin 2000: 64–87). Nisbet dhe Watt (1984: 78), sugjerojnë tri faza kryesore në ndërmarrjen e një studimi rasti, ku sipas tyre është e këshillueshme që të fillojë me një fushë shumë të gjerë në fokus, një fazë të hapur, pa selektivitetit ose paragjykim. Kjo gjë i mundëson studiuesit qe të fokusohet më pas në një fushë më të ngushtë të rastit brenda rastit ku identifikohen në mënyre specifike çështjet kryesore për fazat e mëvonshme dhe trajektorja për mbledhjen e të dhënave. Në fazën e tretë është e përgatitja e draftit interpretativ, i cila duhet të kontrollohet me specialist**ët dhe** pjesëmarrësit **në studi**m para se të paraqitet në formën e tij përfundimtare.

Në këtë studim është përdorur metoda cilësore, pasi ajo ofron një kompleksitet të çështjeve, një kuptim të thelluar dhe fleksibilitet në eksplorimin e subjekteve, duke qenë se studimi është i interesuar edhe për perceptimet, përvojat, qëndrimet e njerëzve (Schroepf, 1991). Connolly (1998), shpjegon se kërkimet cilësore, zakonisht, nuk bëjnë përgjithësime të jashtme statistikore, sepse qëllimi i tyre nuk është nxjerrja e konkluzioneve në lidhje me popullatën, por është një përpjekje për t'u informuar në veçanti për proceset arsimore, sociale, familjare si dhe për praktikat që ekzistojnë

brenda një vendi dhe konteksti të caktuar (cituar nga J. Onwuegbuzie, A., L. Leech, N., 2007). Në kërkimet cilësore, të dhënat mblidhen duke përdorur teknika të ndryshme, si vëzhgimi i pjesëmarrësve, intervista gjysmë e strukturuar, shënimet në terren, memot, dokumentet, raportet, ditarët, (Noll- Hoskins & Mariano, 2004).

1.5.1 Instrumentet e kërkimit

Për qëllime të këtij studimi, të dhënat u mblodhën duke përdorur tre instrumente kryesore të kërkimit cilësor, si:

a) *Analiza bibliografike*
b) Shqyrtimi dhe interpretimi cilësor i të dhënave nga raportet zyrtare
c) Intervista gjysmë e strukturuar

Më poshtë jepet në mënyrë më të detajuar përdorimi i këtyre instrumenteve kryesore të kërkimit cilësor të alternuara me fazat kërkimore.

a) Analiza bibliografike - Në fazën e parë të studimit, hulumtohet mbi zhvillimin historik të shkollave private nga fillimet e tyre deri në vitin 1946, jo vetëm në territoret e shtetit të sotëm shqiptar, por në të gjitha trojet shqiptare. Ky hulumtim u mbështet mbi shqyrtimin dhe analizën e dokumenteve historike, sidomos përmes shfrytëzimit të burimeve bibliografike, burimeve arkivore, teksteve e botimeve ***të veçanta për historinë e shkollë***s dhe mendimit pedagogjik, botuar në organe të ndryshme si "Mësuesi", "Arsimi popullor", "Revista Pedagogjike", koleksioneve ***të organeve të shtypit të periudhës së paraçlirimit*** "Posta shqiptare", "Hylli i dritës", "Shkolla e re", fondeve ***të bibliotekave*** private e të institucioneve fetare, studimeve e artikujve të autorëve të ndryshëm që janë marrë me problemet e arsimit, duke filluar me Prof. Jup Kastratin, Prof. Shefik Osmanin, Prof. Ludovik Shllakun, Prof. Faik Lulin, Islam Dizdarin, Prof. Musa Krajën, prof. Njazi Kazazin, etj.

b) Shqyrtimi dhe analiza e të dhënave nga raportet zyrtare. Në fazën e dytë të kërkimit shqyrtohet dhe analizohet kuadri ligjor për arsimin privat parauniversitar pas viteve '90[3], që nga hapja dhe funksionimi i tyre, ku përfshihen kriteret për dhënien e licencës, kushtet për të hapur një shkollë private, kërkesat që duhet të plotësojë stafi mësimdhënës, financimin, tarifat, ekuivalentimin e kurrikulave dhe kualifikimit, organizimin e provimeve, certifikatat, etj. Gjithashtu u shqyrtuan raportet vjetore statistikore të arsimit, të hartuara nga MASH (sot MAS) për periudhën (2003-2015) dhe më pas u shqyrtuan dhe u analizuan të dhënat nga baza e të dhënave e Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër në lidhje më treguesit e organizimit të institucioneve private të arsimit parauniversitar në rrethin e Shkodrës gjatë periudhës 2010-2014.

3 Kushtetuta e Shqipërisë, neni 57; Ligji nr. 8387, datë 30.07.1998, "Për sistemin arsimor parauniversitar"; Ligji nr. 7952, datë 21.06.1995, "*Për sistemin arsimor parauniversitar"*; Ligji nr. 8387, datë 30.07.1998, Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995, *"Për sistemin arsimor parauniversitar"*; Ligji nr. 10081, datë 23.2.2009 "*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*"; Ligji Nr. 10 140, datë 15.05.2009 "*Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me këshillin e ministrave";* Ligji nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*".

c) **Intervista gjysmë e strukturuar.** Në fazën e tretë të kërkimit u realizuan intervistat gjysmë të strukturuara me drejtuesit e shkollave private të rrethit të Shkodrës, pasi ato janë një mjet i përshtatshëm për mbledhjen e të dhënave cilësore. Intervistat kanë qenë një shtyllë e kërkimit sasior dhe cilësor për dekada të tëra, dhe janë në thelb "biseda me një qëllim" (Burgess, 1984) edhe pse forma dhe struktura e tyre mund të ndryshojnë. Intervistat, si një metodë kërkimore, varen tek premisa se "është e mundur të hetohen elementët e sociales duke ju kërkuar njerëzve të flasin si dhe të mblidhen apo ndërtohen njohuri duke dëgjuar dhe interpretuar atë që ata thonë dhe mënyrën se si e thonë" (Silverman, 2000). Intervistat gjysmë të strukturuara janë zgjedhur si një qasje e mirë për të fituar informacion të lirshëm rreth një sërë çështjesh të rëndësishme. Intervistat janë më fleksibël në mbledhjen e informacionit për një ngjarje dhe kontekst të caktuar, pasi në to paraqiten realiteti, qëndrimet dhe eksperiencat e shprehura nga pjesëmarrësit. Intervista gjysmë e strukturuar lejon nivele të ndryshme parashkrimi dhe improvizimi. Në intervistat gjysmë të strukturuara pyetjet zakonisht janë të specifikuara, por intervistuesi është më i lirë për të shqyrtuar përtej përgjigjeve dhe të hyjë në dialog me të intervistuarit.

1.5.2 Përzgjedhja e pjesëmarrësve

Pjesa më e madhe e studiuesve të kërkimit cilësor që bazohen tek intervistat sugjerojnë përzgjedhjen e një kampioni të qëllimshëm. Kampionimi i qëllimshëm bazohet në përpjekjen e vetëdijshme nga ana e studiuesit për të përzgjedhur përfituesit që të plotësojnë kriteret për hulumtim (Coyne, 1997), dhe ata përzgjidhen për shkak të përvojave apo opinioneve të tyre lidhur me temën e hulumtimit. Pjesëmarrësit përzgjidhen mbi bazën e karakteristikave apo përvojave që lidhen drejtpërsëdrejti me fushën e interesit të hulumtuesit dhe pyetjet e tij të hulumtimit i japin mundësi studiuesit ta studiojë temën në thellësi. Rastet e zgjedhura janë ato që mund të zbulojnë dhe të hedhin sa më shumë dritë mbi fushën e studimit. (Matthews&Ross, 1998). Nisur nga këto përcaktime kampioni, studimi është mbështetur edhe në një kampion prej 15 drejtuesish, me të cilët janë realizuar intervistat gjysmë të strukturuara. Të gjithë personat e përfshirë janë drejtues të shkollave jopublike (Drejtor/nëndrejtor) me eksperiencë mbi 4 vjeçare në drejtim, dhe janë 10 femra e 5 meshkuj. Në studim u përfshinë drejtuesit e shkollave Medreseja "Haxhi Sheh Shamia", "Atë Pjetër Mëshkalla" "Teuta" ,"Cor Jezu", "Zemra e Krishtit", "Maria Ndihmëtare", "Dituria", "Miqësia", Kolegji Turk "Hasan Riza Pasha", "Shpresa për të ardhmen", "ABC", "Përparimi", Shkolla austriake "Peter Mahringer", "Zani i Shkodrës" dhe "Scutari" të rrethit të Shkodrës. Në përgjithësi kampioni në kërkimet cilësore është më i vogël se në kërkimet sasiore (Cohen, Manion, et, al., 2007). Një kampion i përshtatshëm për një kërkim cilësor është ai që i përgjigjet në mënyrën e përshtatshme pyetjes kërkimore. Në praktikë, numri i subjekteve të nevojshme bëhet zakonisht i dukshëm gjatë kohës që studimi është në proces dhe nuk shfaqen kategori ose tema të reja nga të dhënat e mbledhura (Marshall, 1996). Pyetjet në intervistat individuale me drejtuesit e shkollave private të rrethit të Shkodrës janë hartuar mbi bazën e treguesve të zhvillimeve kryesore në sistemin parauniversitar jopublik të shprehura përmes indekseve analitikë e sintetikë, të shërbimit arsimor jopublik në rrethin e Shkodrës si: Institucione (kopshte, arsimi 9 vjeçar, arsimi i mesëm); Infrastruktura *(ambientet, klasat, mjetet mësimore dhe didaktike)*; Shërbimet shkollore *(transporti, trajtimi me ushqim, shërbimi mjekësor dhe psikologjik);* Financimi; Mësuesit *(arsimimi, të dhëna demografike, niveli arsimor i mësuesve sipas cikleve të shkollimit, grupmosha e mësuesve, përvoja e mësuesve në*

arsim, përbërja e stafit, përzgjedhja e stafit, kualifikimi stafit, komunikimi me prindërit); Nxënësit *(kontingjenti që ndjek shkollat private, numri i nxënësve, nxënësit e talentuar, uniforma shkollore, kurrikula, veprimtaritë jashtëshkollore)*.

Intervistat janë realizuar të gjitha ballë për ballë. Përpara fillimit të intervistës, pjesëmarrësve iu jepej informacion mbi studimin dhe qëllimin e tij. Ata u informuan se të dhënat e tyre do të shërbenin vetëm për efekt studimi dhe se mund të refuzonin lirisht t'i përgjigjeshin cilësdo pyetje që nuk dëshironin t'i përgjigjeshin. Pjesëmarrësit lexonin formën e miratimit dhe më pas ata jepnin pëlqimin e tyre nëse donin që të ishin pjesë e këtij studimi. Asnjë nga drejtuesit të përfshirë në studim nuk e ka ndërprerë intervistën. Intervistuesja është përpjekur që pyetjet t'i paraqesë sipas një radhe që nuk pengon intervistën. Intervistat me drejtuesit u zhvilluan në mjediset e tyre të punës dhe zgjatën 60-120 minuta. Me qëllim që pjesëmarrësit të shpreheshin lirshëm, intervistuesja nuk ruajti në mënyrë strikte radhën e pyetjeve, me qëllim që intervista të ishte më e natyrshme sipas rrjedhës të përzgjedhur nga i intervistuari, duke u fokusuar në çështjet me interes për studiuesen. Gjatë intervistës u bënë edhe pyetje të tjera më qëllim që të merrej informacioni i synuar nga kërkuesja. Gjatë intervistës u mbajtën shënime të hollësishme për pyetjet e drejtuara.

Në këtë fazë u realizua transkriptimi i intervistave, të cilat u shqyrtuan një nga një. Më pas, krijuam grupimet e përgjigjeve për çdo pyetje. Pas kësaj u bë përmbledhja e të gjitha përgjigjeve të dhëna. Gjetjet e të dhënave të fituara përmes intervistave janë analizuar në mënyrë shpjeguese. Përgjigjet e intervistave janë analizuar në thellësi dhe disa prej tyre janë prezantuar fjalë për fjalë.

Faza përmbyllëse lidhet me diskutimin e analizës së gjetjeve dhe konkludimit të tyre si dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për politikëbërësit, aktorët e shoqërisë, studiuesit e arsimit, shkollës e mendimit pedagogjik dhe mbarë opinionit në lidhje me performancën që kjo alternativë ofron, me qëllim të kuptuarit më mirë të kësaj alternative arsimi, si dhe përmes rekomandimeve të ofruara ta orientojmë këtë alternativë drejt standardeve që të gjithë ne dëshirojmë për një arsimim cilësor për fëmijët tanë.

1.6 Kufizimet e studimit

Për të realizuar studimin janë shfrytëzuar burime të shumëllojshme. U mbështetëm në studimet e mëparshme të autorëve vendas dhe të huaj. Vështirësi ndeshëm jo vetëm në vjeljen e këtij informacioni, por edhe në përzgjedhjen e tij. Shfrytëzuam me rigorozitet burime zyrtare, të dhëna nga organizma qeveritarë, organet e shtypit, interneti, etj. Për një paraqitje sa më me saktësi të zhvillimeve të shkollës e mendimit pedagogjik janë shfrytëzuar koleksione të organeve të shtypit të paraçlirimit, por duhet të theksojmë se pas vitit 1967, shumë materiale të shkollave të ndryshme, si dokumentacioni dhe biblioteka janë dëmtuar rëndë dhe fatkeqësisht nuk kanë përfunduar në arkivat shtetërore, duke i sjellë dëm të pallogaritshëm historisë së shkollës shqiptare. Ekzistenca e materialeve të tilla do ta plotësonte më mirë sfondin historik.

Gjetjet e studimit do të ishin më të plota nëse studimi do të shtrihej edhe në grumbullimin e të dhënave plotësuese nga burime të tjera, si intervistat me nxënës (si përfitues direkt të këtij shërbimi), me mësues (për cilësinë e kësaj alternative, nivelin e kënaqësisë, problematikat me të cilat përballen), me prindër (për cilësinë e shërbimit, arsyet e zgjedhjes, përmbushjen e pritshmërive), punonjës të MAS, DAR /ZA (për standardet, cilësinë, kontrollin, efektivitetin e kësaj alternative). Përfshirja e tyre do ta plotësonte edhe më mirë kuadrin e problemit të studiuar.

Analiza dhe përfundimet e arritura, mbështetur në indikatorët e performancës si dhe intervistat gjysmë të strukturuara, i përkasin vetëm rrethit të Shkodrës, rreth i zgjedhur për studim rasti për arsye se në krahasim me rrethet e tjera të Shqipërisë ka të gjitha institucionet jopublike të arsimit parauniversitar duke filluar nga kopshtet, shkolla vetëm të ciklit të ulët, shkolla të arsimit bazë, gjimnaze klasike, shkollë fetare, shkollë tekniko-profesionale. Kështu përfundimet e nxjerra nuk janë përgjithësuese. Për këtë arsye në të ardhmen mund të ndërmerret një studim në nivel kombëtar për këta tregues të performancës së kësaj alternative.

Një tjetër kufizim është se gjatë paraqitjes së zhvillimeve të arsimit privat mbas viteve ’90 në Shqipëri, analiza e zhvillimeve brenda këtij sistemi ka filluar nga viti 2003, pasi në këtë vit ka filluar botimi i raporteve vjetore statistikore të arsimit nga MASH (sot MAS), raporte mbi të cilat jemi mbështetur për të analizuar zhvillimet në arsimin jopublik parauniversitar në Shqipëri.

Një tjetër kufizim është se në studim mungojnë të dhënat për vitin 2013-2014, pasi për këtë vit nuk është botuar raporti vjetor statistikor i arsimit nga MAS.

Pavarësisht nga këto kufizime, mendojmë se ky studim mbetet një burim i mirë informacioni për të gjithë aktorët e interesuar për përmirësimin e sistemit arsimor, pasi në mënyrë sintetike pasqyron politikat e ndjekura dhe efektet përkatëse në sistemin arsimor jopublik, e veçanërisht në atë parauniversitar.

1.7 Etika e studimit

Integriteti moral i kërkuesve përcaktohet ngushtësisht edhe nga fakti se sa respektojnë në mënyrë korrekte çështjet etike që lidhen me zbatueshmërinë konkrete të studimit të tyre. Ky integritet, veçanërisht i rëndësishëm për studimet shkencore, është një aspekt që siguron se kërkimi është i besueshëm dhe i vlefshëm. Gjatë hartimit të këtij kërkimi studiuesja ka konsideruar çështje etike që lidhen me procedurat e kërkimit, me përgjegjësinë ndaj subjekteve të kërkimit apo çështje që lidhen me deklarimet e konkluduara në këtë studim. Për sa i përket përzgjedhjes së kampionit, janë konsideruar tipet, mënyrat dhe kriteret e realizimit të tij (koha, madhësia, mënyra, etj). Për sa i përket subjekteve pjesëmarrës, fillimisht ata janë prezantuar me studiuesen, me qëllimin e studimit dhe qëllimin e intervistimeve. Të gjithë subjekteve u është kërkuar leja paraprake për tu përfshirë në studim si dhe për respektimin e opinionit të tyre.

Për sa i përket konkluzioneve dhe rekomandimeve të këtij studimi, ato janë trajtuar si një kontribut modest në fushën e arsimit jopublik parauniversitar, duke mbajtur në konsideratë objektivitetin e përgjigjeve dhe mosdeklarimet e rreme mbi çështjet e këtij studimi.

KAPITULLI II

KËNDVËSHTRIM HISTORIK I SHTRIRJES DHE FUNKSIONIMIT TË SHKOLLLAVE PRIVATE NË SHQIPËRI NGA FILLIMET DERI MË 1946

Për historinë e shkollave shqipe është shkruar shumë, por për shkollat private jo posaçërisht. Koncepti për shkollën në përgjithësi dhe për atë private në veçanti është shumë i hershëm, madje më i hershëm se shkolla publike[4]. (Kraja, M. 2008 fq. 48)

Në shkrimet e deritanishme këto shkolla nuk kanë pasur trajtim të plotë. Shpesh ato janë etiketuar si përpjekje arsimore me pak vlera, si shkolla fetare, të huaja midis nesh etj. Për shkak të interpretimit që u është bërë, këtyre shkollave u është minimizuar vlera e tyre atdhetare dhe janë lënë në harresë.

Në periudhën e paraçlirimit këto shkolla janë trajtuar dhe vlerësuar, por me gjithë shkrimet dhe vlerësimet e botuara nuk u arrit të bëhej një studim tërësor i përmbajtjes dhe i veprimtarisë së tyre. Kuptohet se mbas çlirimit këto shkolla u mbyllën për t'u rihapur më 1992.

Në rendin e komunës primitive ilire nuk ka pasur institucione autentike të posaçme arsimore, shkolla. Edukata, si funksion shoqëror, u shfaq që me lindjen e procesit të punës dhe të të folurit, me formimin e gjuhës. Procesi i punës dhe krijimi i veglave të punës shtruan domosdoshmërinë që të rriturit, në mënyrë të qëllimshme, t'u mësonin dhe t'u shpjegonin të vegjëve mënyrën e krijimit të këtyre veglave, si dhe disa elementë primitivë të teknikës së tyre. Fillimisht, fëmijët konsideroheshin si pronë e të gjithë fisit e më pas kur njerëzit filluan të merren me bujqësi e blegtori, edukata fillon të marrë karakter shoqëror. Në komunën primitive edukata dhe mësimi nuk kishin karakter klasor, por ndryshime viheshin re vetëm në edukatë, sipas seksit. Është një periudhë që në trevat shqiptare shkon deri në shekujt VII-VI p.e.s.

Lindja e shkollave është dukuri e rendit skllavopronar, që sipas të dhënave arkeologjike përkon me ngulimet e kolonistëve helenë. Në qytetet ilire bëhet fjalë për shkolla elementare private, palestra, efebë e gjimnaze, të cilat u krijuan nën ndikimin e sistemit të lashtë e arsimor të Greqisë, një sistem mjaft i përparuar ky për kohën. Nuk duhet të harrojmë se problemi i shkollave është i lidhur ngushtë me problemin e gjuhës. Edukata në rendin e komunës primitive është transmetuar gojarisht në gjuhën e ilirëve.

4 Kraja, Musa. *"Pedagogji e zbatuar"*, Tiranë 2008, fq. 48

Kjo traditë ka vazhduar edhe në rendin skllavopronar në sistemin e edukatës popullore, e cila nuk ka ndjekur shkollat e ngulimeve të kolonistëve helenë dhe të pushtuesve romakë e bizantinë.

2.1 Shkollat në sistemin iliro-shqiptar të edukatës

Herodoti në "*Historinë* " e tij pohon se "*pellazgët kanë pasur gjuhë barbare*", pra një gjuhë që nuk ka qenë e shkruar ose e kultivuar, ndërsa Polibi (historiani i madh grek) i cili duke folur për Perseun dhe Gentin na thotë se i pari dërgoi te ky i fundit për bisedime Pleuratin, "*mbasi ky dinte gjuhën ilire*"

Është e rëndësishme të theksohet vijimësia iliro-shqiptare, e dokumentuar dhe e mbështetur në studime gjuhësore dhe arkeologjike prej të cilave është arritur në përfundimin se ilirët patën gjuhën e tyre, të cilën për shkaqe të ndryshme historike nuk mundën ta shkruanin.

Me të drejtë shtrohet pyetja: *A ka pasur shkolla ilire?*

Historiografia jonë, e cila ka trajtuar gjerësisht formacionet ilire në shekujt IV-II p.e.s, jep të dhëna të pasura për artin ilir, gjuhën, besimin si dhe mënyrën e jetesës, por nuk thotë asgjë për shkollat në këto formacione. Edhe gërmimet arkeologjike nuk japin të dhëna, me përjashtim të institucioneve arsimore greke e romake.

Duke hulumtuar në dokumente e biblioteka rezulton se institucione të hershme ka pasur që në shekujt III-II para erës sonë.[5] (MASH, 2003, fq. 40) Gjithashtu, gjatë këtyre shekujve, kemi të bëjmë edhe me mësues që e ushtruan këtë detyrë, sidomos në bashkësitë qytetare ilire.

Kështu Skopa, komandant i etolëve grekë, i cili kur pushtoi qytetin e Dionit në Maqedoni (sipas Polibit), shkatërroi muret, banesat, gjimnazin e çdo gjë tjetër. Në "Panegjyrikët latine", ku u thuren lavde perandorëve romakë, përmenden gjimnazet e Maqedonisë e të Ilirikut, që u mbushën me njerëz të gëzuar, shkarazi ka edhe ndonjë njoftim për gjimnaze të enkelejve e ndonjë të pasur epirot, të dërguar në Romë për të mësuar gjuhë e letërsi romake. Megjithatë të dhënat janë të pakta dhe nuk na japin mundësi për të arritur në përfundime konkrete në lidhje me institucionet arsimore ilire.

Historiografia jonë është e mendimit se kolonitë helene dhe shkollat e tyre të bregdetit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e Ilirisë, duke mundësuar kontaktet me një kulturë të zhvilluar për kohën.

Pas mesit të shekullit I p.e.s, kemi përhapjen e kulturës latine. Fëmijët (djemtë) në moshën 7-12 vjeç vijonin edukimin dhe arsimin në shkolla fillore (gramatikore) të cilat ishin private[6] (Koliqi, H 2012, fq. 33), merreshin me të mësuarit e shkrimit, i cili ishte i huazuar nga grekët. Kjo nuk do të thotë se nuk është mësuar shkrimi në gjuhën ilire, por materiali i paqëndrueshëm ka bërë që të mos arrijë në ditët e sotme. Fëmijët dhe të rinjtë mësonin në gjimnaze, të cilat ngriheshin brenda sheshit qendror ku ndodheshin godinat më të rëndësishme. Një i tillë ishte edhe në Bylis. Ndërsa në Nikoja (Klos i Mallakastrës) dhe në Antigone është provuar se jo vetëm ka pasur njerëz të ngarkuar me detyrën e mësuesit, por ky qëndronte krahas nëpunësve të tjerë të lartë.[7] (Kraja,

5 MASH, *"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*", MASH, ISP, Vëll. I, Tiranë, 2003, fq. 40.
6 Koliqi, H. (2012) *"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar",* Prishtinë.
7 Kraja, M. (1993*) "Mësuesit për kombin shqiptar*", Tiranë, fq. 6.

M 1993, fq. 6) Në shekujt II-I sipas të dhënave nuk është vetëm familja që merret me edukimin e fëmijës, por ata që kanë mundësi paguajnë edhe mësues privatë. Dëshmi për këtë përbëjnë materialet e zbuluara në gurin e varrit të mësuesit Mark Lukari nga Apollonia, i cili ka jetuar në shek. II-I p.e.s. Aty shohim të skalitura mjetet e punës së nxënësit dhe mësuesit. Në brezin e tij varej një mbajtëse lëkure, në vrimat e së cilës futeshin fletët e shkrimit të mbledhura në mënyrë cilindrike. Në fund kishte edhe një kanxhë metalike për kapjen e kallamarit dhe për mbajtjen e një stiloje. Këto dëshmojnë për një proces të organizuar të edukatës dhe të mësimit në këtë periudhë. Zbulimi i një numri të madh stilosh (vegël kockore me të cilën fëmijët gërvishtnin germat në një tabelë të lyer me dyllë), të gjetura në të gjitha qendrat e mëdha qytetare kanë të bëjnë me ushtrimin e shkrimit nga fëmijët e moshës 7-12 vjeç[8] (MASH, 2003, fq.16). Gurskalitësi i varrit ka bërë edhe një tabelë drejtkëndëshe shkrimi, të lyer me dyllë, që quhej deptik. Një i tillë është gjetur edhe në Durrës në një bazament të shek. III p.e.s, i shoqëruar me një strigël dhe një lekit, si pajisje kryesore të një nxënësi. Edukimi i nxënësit vazhdonte në palestër që gjithashtu ishte institucion privat[9] (Koliqi, H 2012, fq. 33)

2.2 Arsimi dhe mendimi pedagogjik në Mesjetë

Me ndarjen e Perandorisë Romake në dy pjesë (fundi i shek. IV), trevat e banuara nga paraardhësit e shqiptarëve bënin pjesë në Perandorinë Bizantine. Pavarësisht masave të marra, vështirë të kalohej kriza që kishte përfshirë në atë kohë sistemin skllavopronar në tërë Perandorinë. Këto marrëdhënie marrin goditjen e fundit me dyndjet e gotëve, visigotëve, hunëve dhe avarëve në shek. V deri VII të erës sonë. Këto dyndje i hapin rrugë lindjes së marrëdhënieve feudale.

Periudha nga shek. VIII- XII u shoqërua me shthurjen e bashkësive fshatare, ku në zonat fushore kemi daljen e familjeve të pasura dhe fshatarëve të varfër dhe në zonat malore kemi krijimin e një shtrese të re feudale. Marrëdhëniet feudale zhvillohen dhe konsolidohen në shek XII-XIII.

Në shekujt V-VII të erës sonë thuhet se në qytetet e Ilirisë nisën të mbizotëronin, nën ndikimin e pushtimeve, kleri dhe kisha e krishterë.

Në shekullin XI, pas ndarjes së kishës ortodokse nga ajo katolike, krijohet Kryepeshkopata e Tivarit, e cila u lidh me Romën, përmes Raguzës që u bë mbështetje për përhapjen e katolicizmit në Shqipërinë e Veriut.

Në shekullin e XIII, në Shqipëri erdhën shumë misionarë katolikë dhe vendi u mbush me kuvende e manastire jo vetëm pranë qyteteve, por edhe në zonat e brendshme malore.

Shkollat dhe arsimi mesjetar shqiptar ishin të lidhura ngushtë me kishën e krishterë, me kishën ortodokse e katolike, më vonë edhe me institucionet fetare islame, përkatësisht me Kostandinopojën, me Vatikanin e Stambollin. Pjesa më e madhe e popullsisë, sikurse edhe në vendet e tjera, nuk dinte shkrim e lexim. Njerëz të shkolluar ishin vetëm klerikët. Pranë institucioneve fetare zënë fill edhe shkollat mesjetare ku mësues ishin klerikët.

Shkollat e huaja në trevat shqiptare i ndeshim që në shekullin e IX. Një kontribut të

8 Po aty, fq 16.
9 Koliqi H. *"Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar"*, Pishtinë, fq. 33.

shquar në këtë drejtim dhanë Klementi dhe Naumi. Klementi ndërtoi krahas kishave e manastireve, edhe shkolla. Ai shkonte fshat më fshat për të përhapur jo vetëm fenë e krishterë dhe shkrimin sllav, por edhe njohuri të dobishme në fushën e bujqësisë. Veprimtarinë e Klementit e vazhdoi shoku i tij Naumi.[10] (Shllaku, L 2002, fq. 24)

Për sa i përket sundimit bizantin, nuk gjejmë gjurmë të përhapjes së tij në trevat tona. Megjithatë, duket se ideja për përhapjen e shkollave fetare greke e ka burimin që në kohën e kësaj perandorie.

Shkrimi i shqipes me alfabet të huaj u përhap në periudhën e mesjetës. Zhvillimi i arsimit shqip me alfabet të huaj u bë realitet në trojet e banuara nga shqiptarët. Nëpërmjet këtij arsimi, populli ynë është mësuar për një kohë të gjatë dhe prej këndej kanë dalë shumë atdhetarë, të cilët kanë punuar një kohë të gjatë për çështjen kombëtare.

Arsimi në gjuhën greke është më i hershmi i dokumentuar, sidomos kur greqishtja u imponua në Shqipëri si gjuhë zyrtare e shkruar. Gjatë viteve 1453-1821 shumica e shkollave greke në Shqipëri ishin shkolla komunare fillestare, që drejtoheshin nga priftërinjtë ose në ndonjë rast edhe nga artizanë (rrobaqepës, këpucarë etj), që zhvillonin mësime brenda në kishë. Në këto shkolla mësohej leximi i veprave kishtare e klasike, aritmetikë e shkrim. Duhet të theksojmë se planet dhe programet në këto shkolla nuk ishin unike, ato vareshin nga shkolla dhe aftësia e mësuesit. Vajzave nuk u jepej ndonjë arsimim i veçantë, por vetëm disa elementë fillestarë të punëve shtëpiake.

Kisha e Romës, me qëllim mbrojtjen e dioqezave katolike në Ballkan, dërgoi misionarë të Urdhrit të Benediktinëve që në shek. IX. Murgjit francezë Benediktinë u vendosën fillimisht në Shirgj (1236), në Durrës (1278), ndërsa në Shkodër më 1345[11] (Qiriazi, Dh. 2000, fq. 68). Ata u shquan në punën e tyre studimore, kulturore e arsimore. Kuvendet e tyre u bënë qendra të rëndësishme të veprimtarisë arsimore, kulturore, letrare dhe shkencore mesjetare. Veprimtaria e tyre në lëmin e arsimit zhvillohej në disa drejtime: ruajtën dorëshkrime të moçme, biblioteka të pasura, ndërtuan shkolla, hospice e orfanotrofe etj.

Në shek. XIII themelohen urdhrat kishtarë domenikanë dhe françeskanë, të cilët u përhapën në trevat shqiptare, në Raguzë (1255), në Ulqin (1258), në Durrës (1278), etj. Domenikanët zhvilluan një veprimtari të pasur arsimore. Pranë kuvendeve të tyre hapin edhe shkolla jo vetëm të ulëta fetare, por edhe studime të larta[12] (Koliqi, H. 2012, fq. 52) Në Ulqin më 1258 noteri ishte edhe mësues në shkollën e qytetit. Nga viti 1261-1406 në Ulqin punuan gjashtë noterë. Veprimtari të tilla kishte në Kotorr (1266), Durrës (1278), Shkodër (1345), Tivar, Drisht, etj. Qyteti i Drishtit kishte traditë të mirë në fushën e arsimit. Atje kishte shumë klerikë të shkolluar, të cilët punonin priftërinj e mësues. Qendra të rëndësishme arsimore dhe kulturore ishin edhe Deja, Hasi, Shurdhahu etj. Françeskanët dhe domenikanët ndërtuan një rrjet të gjerë shkollor në trevat shqiptare, në krye të të cilit qëndronte Universiteti i Durrësit[13] (Koliqi, H. 2012, fq. 53).

Ndikimet e ndryshme fetare në veri e në jug të vendit bënin që mësimi i latinishtes dhe i italishtes në Shqipëri, nga mesi i shekullit XII, të jetë kryer jo vetëm në shkollat

10 Shllaku, L. *Shkollat Klerikale*, Shkodër, 2002, fq. 24.
11 Qiriazi Dh., (2000) "*Krishtërimi në Shqipëri*", Tiranë, fq. 68.
12 Koliqi, H., (2012) *"Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*", Prishtinë, fq. 52.
13 Po aty, fq. 53.

pranë kishave, por edhe me mësues privatë në mënyrë individuale. Kjo praktikë vazhdoi edhe më vonë. Në këtë mënyrë u arsimua edhe Pjetër Budi dhe shumë të tjerë.

Shkollat që u hapën në Shqipëri në shek XIII-XIV, qenë në varësi të institucioneve kishtare, ortodokse e katolike, që kultivonin greqishten dhe latinishten. Në këto shekuj dukjet se filloi edhe përdorimi i shqipes si gjuhë shkrimi. Programet mësimore përfshinin lëndë fetare dhe mbështeteshin kryesisht në ideologjinë kishtare për mbrojtjen e rendit feudal. Gjuha shqipe që kishte nisur të kultivohej nuk mund t'i bënte ballë shkrimit greqisht e latinisht, dy gjuhë të rëndësishme për kohën. Si gjuhë të përditshme, masa e popullit, bujaria feudale dhe kleri vendas përdorën gjuhën shqipe.

Kultura shqiptare ndjek vazhdimësinë e kulturës së lashtë ilire. Ndërkaq shqipja e folur dhe e shkruar dëshmohet që në shek e XIII. Në një dokument të arkivave raguziane (1284) thuhet: "*Ndëgjova një zë që thërriste në mal në gjuhën shqipe*" (Audivi unam vocem clamantem in monte in lingua albanese).

Sipas prof. Musa Krajës thuhet se më 1353, Teodor Nikolla nga Drishti, pati hapur një shkollë për t'u mësuar shkrim e këndim fëmijëve të asaj qendre dalmate.

2.3 Sistemi i edukatës popullore

Sistemi i edukatës popullore ishte mbizotërues. Edukata popullore nuk shteron e nuk konsumohet vetëm me aforizmat pedagogjike, aq më tepër kur ato nuk mund të përmblidhen dot në caqet e një vëllimi, sado solid të jetë ai. Në kuptimin e gjerë të fjalës ajo mishërohet si në mendësinë pedagogjike të popullit ashtu edhe në një sistem të tërë mekanizmash e praktikash edukative.

Pedagogjia popullore dallohet për idealin e saj edukativ, human, përparimtar, demokratik dhe popullor. Do të ishte naive të kërkonim të gjenim këtë ideal të pastër. Është e qartë se në këtë ideal ka e nuk mund të mos ketë ndikime të shumta haptazi kontradiktore. Në mendësinë e popullit këto ndikime kanë qenë disi më të zbehta.

Ndikim të madh në edukatë ka pasur feja dhe institucionet fetare. Ideologjia dhe ritet fetare kanë depërtuar fuqishëm në edukatën familjare, në të gjithë mënyrën e të menduarit e të jetesës në mjediset familjare.

"*Populli nuk është vetëm forca që krijon të gjitha vlerat materiale, ai është i vetmi burim i pashtershëm i vlerave shpirtërore, është filozofi dhe poeti i parë për nga koha, bukuria dhe gjenialiteti, që ka krijuar të gjitha poemat e mëdha…"*. Maksim Gorki

Ideologjia fetare nuk ka vepruar vetëm nëpërmjet dogmave e postulateve të veta teorike. Për arsye të nivelit teorik tepër të ulët të zhvillimit kulturor të popullit e të cektësisë së bindjes fetare dogmatike të tij, ai ka depërtuar në traditat e në zakonet, në ritet më të ndryshme të jetës të lidhura me dukuritë natyrore, punën dhe mënyrën e jetesës, me mënyrën e të menduarit.

Objekti i pedagogjisë popullore ka qenë dhe është edukata, të mësuarit. Thelbi i saj është transmetimi i përvojës njerëzore nga një brez në tjetrin. Nuk kemi të bëjmë me një transmetim mekanik, por me një proces të gjallë, aktiv dhe dypalësh, ku marrin pjesë dhe komunikojnë së bashku ata që e japin dhe ata që e marrin përvojën njerëzore, brezi i rritur dhe brezi i ri.

Thellë në lashtësi, në jetën e komunës primitive, nuk ka pasur jo vetëm shkolla, por asnjë institucion të posaçëm edukativ; nuk ka pasur jo vetëm mësues, por as edukatorë

sado pak të kualifikuar. E megjithatë edhe atje ka pasur një proces edukativ.

Njohuritë, shkathtësitë dhe shprehitë për punë, brezat e rij i kanë marrë në mënyrë empirike nga prindërit, nga të afërmit apo nga mjeshtrit nëpërmjet pjesëmarrjes në punët bujqësore dhe në jetën shtëpiake. Monopolin e atij arsimi të kufizuar që filloi sado pak të zgjerohej e morën fetarët. Hoxhallarët dhe priftërinjtë ishin mësuesit e vetëm.

Në mesjetën e hershme kemi një hap prapa edhe në arsim, në edukatë e në pedagogji. Megjithëse monopolizoi arsimin e dijet, kleri hapi disa shkolla që, për rrethanat që dihen, kishin karakter të theksuar dogmatik.

Pedagogjia dhe edukata popullore kanë lidhje me institucionet e kanunet fisnore. Kjo lidhje i ka rrënjët në faktin që organizimi fisnor patriarkal pasqyrohet i tëri edhe në jetën e familjes patriarkale: i njëjti kanun, të njëjtat zakone, i njëjti stil komunikimi.

Kështu, në qoftë se i pari dhe zoti i bajrakut ishte bajraktari dhe fjala e tij ishte e fundit në çdo gjë, edhe në familjen patriarkale me shumë kurora e me shumë breza fjala e fundit ishte e të "zotit" të shtëpisë, si rregull e më të moshuarit. Fjala e tij gjithnjë shoqërohej nga zbatimi i paapelueshëm. Këtij patriarkalizmi nuk i nënshtroheshim vetëm vajzat, gratë dhe të rinjtë, por edhe burrat.

Në Mesjetën e vonë lindi manifaktura që solli zhvillimin dhe pasurimin e qyteteve. Mbi bazën e formave të reja të jetës shoqërore filloi Epoka e Rilindjes, e cila shënoi përmbysjen e jetës ideologjike të shoqërisë së asaj kohe. Kjo përmbysje ndodhi edhe në fushën e mendimit pedagogjik. Merr fund monopoli i pikëpamjes kishtare skolastike mbi edukatën. Pedagogjia u shkëput nga filozofia. Formimi i pedagogjisë si shkencë lidhet me jetën dhe veprimtarinë titanike të Komenskit (1592-1670). Në kryeveprën e tij "Didaktika e madhe" ai formuloi shkencërisht formën e mësimit në klasë: nxënës dhe mësues, ora e mësimit 45 minuta. Mësimi në gjuhën amtare, i njëjtë për djemtë dhe vajzat, etj.

Më 1332 Atë Brokardi (Guillelmus Adae), kryeipeshkv i Tivarit, jep të dhënat e para mbi shkrimin dhe arsimin në Mesjetë. Në veprën e tij "Directorium ad passagium facienda" (libri I, pjesa 8) ai shkruan: "Lecet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant et diversam, tamen litteram latinam habent in uso et in omnibus suis libris", *"Shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë alfabetin latin në përdorim dhe në tërë librat e tyre"*[14](Shuteriqi, Dh. 1976, fq. 27). Studiuesi prof. Hajrulla Koliqi, mbështetur edhe në burime të tjera (fq. 85), na sjell një dëshmi se "kronikat" që në kohën e Skënderbeut shkruheshin in lingua vernacolo=në gjuhën e popullit. Bëhet fjalë për letrën e Skënderbeut dërguar princit të Tarantit (1460), më pas pastaj Gjon Muzakës (1476). Gjithashtu po ky autor pohon se "Ka prova që dëshmojnë se gjuha shqipe shkruhej edhe në kohën e Skënderbeut. Për këtë dëshmon një letër në gjuhën "*arnaute*", të cilën Skënderbeu ia dërgonte si përgjigje Sulltan Mehmetit të dytë. (fq. 86) Kjo letër sipas autorit gjendet në librin "Le Grand Castriotto d'Albanie Histoire", botuar në gjuhën frënge në Frankfurt më 1779.

Marin Barleti, duke folur për analet e lashta shqipe të shekullit të XV, e përmend shkrimin. Në librin "Rrethimi i Shkodrës" na lë këtë informacion: "*Na patën rënë në dorë disa shkrime, më fort fragmente sesa t'i quash anale, në të cilat flitej më shumë*

14 Shuteriqi,S. Dh "*Shkrimet e para shqipe",* Tiranë, 1976, fq. 27.

për meremetimin, që i bënë atij qyteti stërgjyshët tanë të lashtë, se sa për ndërtimin. Ishte shkruar aty në gjuhën e popullit (vernacolo) se një e quajtur Roza, me një ndër motrat e veta të quajtur Fa, qenë themeluesit e parë të Shkodrës e prandaj fortesa quhet: Rozafa…"[15] (MASH, 2003, fq. 40)

Trajtimi i fillimeve të shkrimit në gjuhën shqipe ka rëndësi për faktin se me shkrimin shqip lidhen edhe fillesat e shkollës shqipe. Dokumentet e para të shqipes së shkruar i përkasin shek. XV. I pari u shkrua nga Pal Engjëlli. Dokumenti i tij përmban formulën e pagëzimit (1462). I dyti ishte Fjalori i Arnold von Harfit (1496) , i cili gjatë një udhëtimi në Shqipëri mblodhi disa fjalë. "*Shqiptarët kanë një gjuhë të tyne, e cila nuk mund të shkruhet mirë, meqenëse nuk kanë shkroja të tyne".,* ndërsa dokumenti i tretë është Ungjilli i Pashkës. Studiuesi i alfabetit shqip, Tomorr Osmani, shkruan për veprën "Perikopeja e ungjillit të pashkës": *"Ky dorëshkrim tregon se në shqipen e shekullit të XV ekzistonin dy dialekte dhe se shqipja shkruhej si në Veri ashtu edhe në Jug"*. Pra është fjala për një traditë të hershme letrare, të shkrimit dhe për një alfabet para Buzukut, të cilin mësuesit e përdornin si mjet.

Për sa u përket veprave të botuara, ato fillojnë në shekullin e XVI pikërisht në kohën e shtrirjes së pushtetit otoman dhe janë një shprehje e atdhetarisë për të ruajtur gjuhën shqipe. Monumenti i shqipes mesjetare, libri që hapi epokën e re të botimit shqip ishte "Meshari" i Buzukut (1555), libër që do pasohet me të tjera vepra si: "E msuama e krishterë" (1592) e Lekë Matrëngës, Doktrinën e Krishterë (1618), "Rituali Roman dhe zhvillimi i meshës latine" (1621), Pasqyra e të rrëfyemit" (1621) e Pjetër Budit. Më 1632 Pjetër Mazreku mblodhi disa fjalë në formën e një fjalorthi (1632), dorëshkrim i botuar më vonë nga Mario Roques. Frang Bardhi boton fjalorin latinisht-shqip në Romë më 1635.

"Meshari" i Buzukut lë të mendohet për një traditë të mëparshme të shkrimit të shqipes në trevat veriore ku përfshihet edhe zona e Shkodrës. Me të drejtë shtrohet pyetja: E ku tjetër të jetë mësuar shqipja, përveçse në shkollat e kohës, apo nëpërmjet të mësuarit individual? Qëllimi i këtij prifti shqiptar ishte sa fetar, po aq pedagogjik, shkruan Hajrulla Koliqi në veprën e tij *"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar"*[16] (Koliqi, H 2012, fq. 86)

Në këtë periudhë kemi shkolla të hapura pranë kishave dhe manastireve. Këto shkolla i kanë ndjekur fëmijët e aristokratëve, kryesisht për nevoja kishtare. Shkollat e manastireve, vetëm aty nga mbarimi i shek. XIV, filluan të ndiqen nga të rinj që nuk dëshironin të bëheshin priftërinj.[17] (Shllaku, L 2002, fq. 27) Kështu në Delvinë, pranë manastireve të Shën Joan Theologut, të Kamenicës, të Navaricës, të Stillos, ka pasur shkolla që më 1275 deri më 1627, shkolla ku krahas mësimeve fetare mësohej filozofia dhe veprat e letërsisë kristiane.[18] (Karafili, Ll. 1938, fq. 292).

Në manastirin e Ardenicës, që nga shek. XIII deri në vitin 1684, është mbajtur një shkollë, ku mësonin gati të gjithë klerikët e Myzeqesë dhe të Beratit. Më vonë ajo u mbyll

15 Grup autorësh, *"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*", MASH, ISP, Vëllimi I, Tiranë, 2003, fq.40

16 Koliqi, H. (2012) "*Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar", Prishtinë.*

17 Shllaku, L. (2002) "*Shkollat Klerikale"*, Shkodër, 2002, fq. 27.

18 Karafili, Ll (Bardhyli), (1938) *"Historia e bibliotekave në Shqipëri"*, Hylli i Dritës, nr. 6, Shkodër, fq. 292.

për t'u rihapur më 1778, si shkollë fillore.[19] (Karafili, Ll. 1938, fq. 169) Përmbajtja e mësimit kishte karakter fetar, ku përveç dogmave fetare mësohej edhe leximi e shkrimi. Në këto shkolla gjejmë elementet e para të një veprimtarie të organizuar kulturore arsimore te shqiptarët.[20] (Rexhepagiq, J. 1970, fq. 11)

Në gjendjen e sotme të burimeve të njohura, nuk mund të flasim për një ekzistencë të shkollave dhe të mësimit të institucionalizuar në trevat e Shqipërisë së Poshtme para shek XIV. Megjithatë, pas shek. XIV nuk mungojnë të dhëna për ekzistencën e shkollave dhe të njerëzve të mësuar edhe në Shqipërinë e Poshtme[21] (Xhufi, P. 2013, fq. 45). Në kohën e tij, Evlija Çelebiu, nuk mungon të numërojë medrese e shkolla të tjera fetare për fëmijët myslimanë në Delvinë, Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Berat, etj. Ndërsa për myslimanët e rinj shqiptarë gjuha turke dhe arabe u bënë gjuhët e lutjes dhe të mësimit nëpër shkolla, për të rinjtë e besimit ortodoks gjuha greke mbeti gjuhë e kishës dhe komunikimit zyrtar[22] (Xhufi, P 2013, fq. 46).

Në Vlorë, pranë manastirit të Svërnecit, deri në vitin 1376 ekzistonte një shkollë.[23] (Karafili, Ll. 1938, fq. 163). Mjaft dokumente dëshmojnë për ekzistencën e shkollave humaniste e provinciale të shkathtësive e filozofisë në Durrës (1278-1498), në Shkodër (1345-1487) dhe në Lezhë (1483-1512).

Është e dokumentuar se në shek. XIV–XV, kleri i famullive merrej me problemet e arsimit dhe si rezultat kemi një shtim të tyre

Shqiptarët kanë qenë nën ndikimin e kulturave të ndryshme (latine, greko-bizantine dhe sllave). Ndikimi i këtyre kulturave manifestohej në të gjithë jetën kulturore dhe arsimore si dhe lidhej me veprimtarinë e urdhrave të ndryshëm fetarë. Për shumë vite vepruan benediktinët, të cilët hapën më shumë se 30 kuvende, si edhe domenikanët, françeskanët, bazilianët, etj. Veprimtaria e tyre në lëmin e shkollimit zhvillohej në disa drejtime: ata ruajtën e përshkruan dorëshkrime të moçme, por edhe vepra klasike, si latine, greke dhe arabe.[24](Malaj, V. fq. 180). Çabej shkruan: "*Këtyre rrethanave u shtohet puna dhe qëndrimi i benediktinëve të domenikanëve në Shqipëri në periudhën paraturke, dy urdhra fetarë që kanë themeluar vatra kulture e shkrim kudo që kanë shkuar".*

Qendra të rëndësishme të administratës e kulturës kanë qenë edhe arqipeshkëvitë e Durrësit, Tivarit, Shkodrës etj, pranë të cilave janë çelur shkolla dhe institucione të tjera humanitare.

Në Lezhë, prej vitit 1483-1512, kemi shkolla pranë kuvendeve. Popullata vazhdon të jetë e interesuar për mësimin ndërkohë që vazhdojnë përpjekjet për hapjen e shkollave. Sipas disa të dhënave të tërthorta mendohet se ka pasur shkolla të artizanëve apo të tregtarëve, e po sipas këtyre të dhënave mësohet se në Stanjo ekzistonte një shkollë e themeluar nga Teodhori i Drishtit, të cilit i paguhet qiraja e shtëpisë, në të cilën duhet

19 Karafili, LL. (Bardhyli), (1938)*"Historia e bibliotekave në Shqipëri*", Hylli i Dritës, 6, Shkodër, fq. 169

20 Rexhepagiq, J. (1970) *"Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918",* Prishtinë, fq. 11.

21 Xhufi, P. (2013) *"Dukuri të shkollës dhe të gjuhës në Shqipërinë e Poshtme (shek. XIV-XVIII)*" Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVII, Tiranë.

22 Po aty.

23 Karafili, Ll (Bardhyli), Hylli i Dritës, 4, Shkodër, 1938, fq. 163.

24 Malaj, V. (1995) *"Meshari"* i Gjon Buzukut-monument i kulturës shqiptare, Ulqin, fq. 180.

të mbajë shkollarët e Stanjos që t'u mësojë lexim e shkrim.[25](MASH, fq. 40) *"...U muar vendim t'i jepen 10 perperë Teodorit, birit të Zotit Nikollë nga Drishti...të mbajë shkollarët e Stanjos që t'u mësojë lexim e shkrim" (1388).* Kuptohet që kjo shkollë ka qenë fillore pasi atje mësohej vetëm lexim e shkrim.

Më 1584, në Letnicë të Shkupit dhe më pas edhe në Stubëll, dy fshatra shqiptare, kanë funksionuar *"kolegjet fetare që njiheshin si shkolla të larta"*[26] (Koliqi, H 2012, fq. 92). Po të njëjtën gjë e pohon edhe studiuesi Dhimitër Shuteriqi: "*Që më 1584, në Letnicë të Shkupit, më pas edhe në Stumbull (bëhet fjalë për vendbanimin e sotëm Stubëll e Epërme, por që nga banorët ruhet në shqiptim në trajtën Stubull (shënimi im E. B) të Gjilanit, dy fshatra shqiptarë kanë funksionuar kolegje fetare. Kolegjet e kohës ishin shkolla të larta. Aty mësohej filozofia e studioheshin klasikët*"[27](Shuteriqi, Dh 1987, fq. 92) Studiuesi Sarë Gjergji sqaron se: "*Letnica nuk i përkiste Shkupit, pasi si famulli i takonte Ipeshkëvisë Shkup –Prizren, ose si famulli njihej me emrin "Mali i Zi i Shupit", në kuadër të së cilës bënte pjesë edhe Stublla , me një popullatë shqiptare të besimit katolik; Letnica vështirë të përcaktohet si vendbanim shqiptar nga e kaluara, aq më tepër kur është kryer vizita apostolike në Komulloviq e Raggi. Raportet kishtare tregojnë për një popullatë joshqiptare, kryesisht dalmate që merrej me argjendari; Studiuesit e ndryshëm flasin për një dhe jo për dy kolegje, duke vënë në dukje Strubllën me popullatë shqiptare, si vend të përshtatshëm për kolegjin; së fundi ka shumë pak të ngarë që brenda së njëjtës famulli të kenë funksionuar dy kolegje".*[28] (Gjergji, S 2013, fq. 68). Në një hartë të shkollave shqipe në (ish) Jugosllavi dhe në Shqipëri në shekullin e XVII, J. Rexhepagiqi paraqet edhe shkollën e Strubllës.

Duke gjykuar nga të dhënat që disponohen deri më sot mendojmë se shkolla e parë shqiptare ka qenë pikërisht kjo e Stubllës në Kosovë, themeluar më 1584. Ka të ngjarë që në atë shkollë të jetë përdorur gjuha shqipe, të paktën për një pjesë të mësimeve. Në studimin e shkurtër të Sarë Gjergjit veçojmë: *"Qysh në shekullin XVI misionarët katolikë provuan të themelojnë një shkollë të lartë në territorin e famullisë katolike të Karadakut të Shkupit, meqë aty nuk banojnë dhe nuk vijnë turqit ... Sidomos Stublla (afër Gjilanit), fshat që flet gjuhën shqipe, ka qenë i përshtatshëm për hapjen e një kolegji të tillë katolik".* Zgjedhja e një fshati albanofon vlerëson tezën se në atë shkollë mësimet duhej të zhvilloheshin edhe në shqip. Natyrisht, si kusht i nevojshëm për hapjen e shkollës ishte njohja dhe përdorimi i mirëfilltë i shqipes. Pak më vonë së tridhjetë vjet mbas botimit të librit të parë shqip takohemi në të parën shkollë shqiptare; një fakt simbolik ky, që tregon lidhjen e ngushtë mes gjuhës, fesë, kulturës dhe shkollës në Shqipëri (Amik Kacaruho). Shkolla në Stubëll, me ndërprerje të kohëpaskohshme, vazhdoi punën edhe në shekujt në vazhdim, dëshmuar kjo nga studiues të ndryshëm apo dokumente arkivore të cilat ruhen në Muzeun e Shkollës së parë shqipe në Kosovë (Stubëll)[29] (Gjergji, S 2013, fq. 70).

Shkolla ku mësohej shqipja gjejmë në Janjevë të Kosovës që në shekullin XVI, pra në kohën kur jetonte Pal Hasi, i cili mendohet të ketë dhënë edhe mësim atje.

25 Grup autorësh, (2003) *"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar"*, MASH, ISP, Vëllimi I, Tiranë, fq. 40.
26 Koliqi, H.(2012) "*Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar"*, Prishtinë, fq. 92.
27 Shuteriqi, Dh. (1987) *"Marin Biçikemi dhe shkrime të tjera",* Tiranë dhe *"Lërimi i shqipes dhe i shkollave shqiptare në Kosovë gjatë shekujve XVI-XVIII",* Rilindja, 12.04.1980, Prishtinë , 1980, fq. 12.
28 Gjergji, S. (2013) Stublla me Kolegjin e Shën Lukës, 1584, *"Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVIII"*, Tiranë, fq. 68.
29 Gjergji, S. (2013) vepër e cituar.

2.4 Arsimi dhe shkollat prevate në Mesjetën e vonë

Pushtimet e huaja penguan përhapjen e ideve përparimtare edhe në fushën e arsimit dhe të shkollës. Megjithatë ndonjë ide pedagogjike përmes veprës letrare të Russoit, Hygosë etj, penetroi nëpërmjet disa vatrave të kulturës, si në Itali, etj, por këto raste ishin tepër të kufizuara. Është koha kur pedagogu i shquar çek Komenski botoi "Didaktikën e Madhe". Ai kishte formuar një sistem shkollor me karakter unik si dhe përpunoi një sërë kriteresh për organizimin e përmbajtjen e shkollës. Por jeta e mbyllur feudale që zhvillohej në Shqipëri, nuk pati mundësi të rrokë mirë këto mendime të tjera të cilat kishin të bënin me organizimin e shkollës dhe punën e mësuesve. Në disa qendra të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, famullitarët ishin mësuesit e parë të zonës, si në Prizren ishte Patër Lorenci, Dom Simon Lumezi, Dom Mazreku, etj; në Gjakovë ishte Dom Top Guziqi, Patër Rrozarja, Patër Guademi, etj; françeskanët Dom Pjetër Zara, Dom Ndue Bytyçi të cilët ia dorëzuan pastaj mësuesve Pashko Logoreci, Mhill Kurti, Engjëll Ndoca.[30] (Kraja, M.1993, fq. 48)

Në fshehtësi të plotë punonin me libra shqip të botuar jashtë mësuesit Patër Deda, Patër Marjani, Dom Bartolomeu etj, deri kur u paraqitën me detyrën e mësuesit Gjergj Xhuxha, Zef Sh. Harapi, Pal Lumezi, etj. Vëllezërit Çelo nëpërmjet alfabetit grek përdorën shkrimin e shqipes në krahinat e Delvinës dhe të Gjirokastrës[31], ndërsa në Veri shkrimet shqipe i ndeshim me formimin e shtetit të arbrit, në shek. XII-XIII. Kjo periudhë është një etapë e vështirë për arsimin, e veçanërisht ballafaqimi me shkollat e huaja. Në Elbasan përveç shkollave "osmane" u hapën edhe dy shkolla qytetëse të huaja, një greke dhe një rumune, por mësuesit atdhetarë si Dhaskal Pina i kthyen në çerdhe të përhapjes dhe mësimit të shqipes.[32](Dedei, S. fq. 129)

Studiuesit vënë në dukje se në trevat e Arbërit shkollat e para lindën që në shekullin e XVI, si rezultat i lulëzimit që kishin arritur qytetet shqiptare në Kosovë, në zonën e Shkodrës, në atë të Krujës, të Himarës, etj. Ato ishin shkolla elementare, ku nxënësit mësonin lexim, shkrim, elemente të historisë etj. Gjuhë mësimi ishte fillimisht italishtja dhe më vonë, aty nga mesi i shek. XVII, filloi të përdorej gjuha shqipe. Numri i nxënësve si dhe kohëzgjatja e mësimit ishte e ndryshme. Shkollat themeloheshin zakonisht në famulli, pranë kishës ose në shtëpinë e famullitarit. Mësues ishin famullitarët, kryesisht shqiptarë që shkolloheshin nëpër kolegje dhe institucione të tjera arsimore në Itali, por edhe të huaj. Veç misionit fetar ata u përpoqën për hapjen e shkollave. *"Në shkollat latine apo greke nisi të përdorej edhe shqipja për nevojat e mësimit të gjuhës së huaj dhe për nevojat e krijimit të klerikëve që të dinin të bënin propagandë fetare në popull në gjuhën e vendit"* [33] (Dedei, S. 1999, fq. 101). Dëshmi për ekzistencën e këtyre shkollave ku mësohej shqip me shkronja latine përbën "Fletëkushtesa" e Lekë Matrëngës shkruar më 20 mars 1592, e cila konsiderohet si vepërza e parë arsimor-pedagogjike për mësimin në gjuhën shqipe, ku ai dëshmon se në vendlindjen e tij ishte një shkollë e tillë[34] (Sylejmani, F, 1979, fq 35-37)

Në shek. XV-XVII, banorë të viseve të ndryshme ishin vendosur në Himarë në

30 Kraja, M. (1993) "*Mësuesit për kombin shqiptar",* Tiranë, 1993, fq. 48
31 AIH *"Gjirokastra në Shekuj"*dhe "*Histori e letërsisë"*
32 Dedei, S. (1978) *"Revista Pedagogjike*" nr.2, fq.129
33 Dedei, S. (1999) *"Zhvillimi i arsimit në Mesjetë në Shqipëri*", "Revista Pedagogjike", nr.2, Tiranë
34 Sylejmani, F. (1979) "*E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës"*, Insituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.

përpjekje për ti shpëtuar pushtuesit por edhe për të emigruar. Krerët e Himarës iu drejtuan Papës së Romës, mbretërve të Napolit, Spanjës, Polonisë e Rusisë, për ndihmë materiale. Në këto kushte Papa dërgon misionarët e vet, kryesisht arbëreshë e me kombësi të tjera që e dinin shqipen.

Kështu, në vitin 1627, në Himarë u hap një shkollë shqipe nga një mision katolik oriental, shkollë që u riorganizua më 1660. Kjo shkollë luajti një rol të rëndësishëm për mësimin e shqipes. Në këtë shkollë një rol të rëndësishëm ka luajtur Neofit Rodino (misionar i dërguar nga Papa, që meshonte në ritin ortodoks. (shënimi im E. B). Ai qëndroi aty nga viti 1627 deri më 1643. "*Sa për popullin e tij të dashur, ishte e kollajshme që të kujtohej ky prift i mirë, nga librat që ky i shkruante dhe i botonte falas…Kjo do të thotë se ky në shkollë kishte përgatitur njerëz që i këndonin librat e tij*"[35] (Marko, P. 1963, fq. 8) Në një letër Neofit Rodino, midis të tjerave thotë: "*Jam kurdoherë midis malësorëve të mi të dashur gjithnjë i zënë për t'i evangjilizuar dhe për të mësuar fëmijët e tyre*"[36]. Në shkollën e Himarës vinin nxënës nga Saranda, Lukova, Nivica, Piqerasi, Shën Vasili, Lëkurasi…etj. Petro Marko shkruan: Sipas Vinçes Rodotas, Rodinoja "*ka qenë i pari mësonjës dhe drejtonjës i misionit në këtë krahinë… Këta banorë nuk shkonin në meshë, nuk dinin as formulën e pagëzimit…Shkonte falas fshat më fshat, punonte e lodhej shumë, e veçanërisht me punën e shkollës…*"[37] Si misionarë të mësimit në shkollë punuan edhe italiani Nilo Katalano (1637-1694) dhe arbëreshi Giuseppe Sqirò (1690-1780). Giuseppe Sqirò punoi në shkollat shqipe të bregdetit për afër një çerek shekulli. Ai u mësonte nxënësve greqisht, latinisht e shqip. *"Ua mësonte doktrinën e krishterë, si dhe shkrimin greqisht e shqip"*[38] (Dedei S, 1999, fq. 106-107). Është për tu theksuar se po të shohim listën e krerëve të misioneve, nga i pari, Neofit Rodinò-së, në vitet 1630, tek i fundit, Giuseppe Sqirò, që u mbyll në vitin 1773, vihet re qartazi një shqiptarizim progresiv i ekipeve të dërguara në Himarë. Duke filluar nga Filloteo Zassi, arbëresh i Sicilisë, njohës i shkëlqyer i gjuhës shqipe, e duke vazhduar me Basilio Matrangën e Giuseppe Sqirònë, krerët e misioneve u përzgjodhën mes arbëreshëve.[39] (Cituar në Xhufi, P 2013, fq. 49 referuar Karalewskij, C 1911, fq. 441)

Më 1724 murgu bazilian Giuseppe Sqirò, i porsakthyer nga një mision i gjatë në Shqipëri, hartoi një relacion, në të cilin tregonte se në trevën e gjerë të Himarës ekzistonin 15 fshatra, prej të cilëve vetëm tre ishin grekë, por që flisnin edhe shqip, kurse të tjerët ishin shqiptarë dhe nuk e njihnin fare gjuhën greke (cituar në Xhufi, P 2013, fq. 56). Pikërisht i nisur nga ky realitet Neofit Rodino, më 1629 i kishte komunikuar kongregacionit nevojën për të shtypur "*një libër mbi mënyrën se si duhen rrëfyer mëkatet"*[40](cituar në Xhufi, 2013, fq. 56). Në një letër tjetër të po asaj kohe Rodini flet për shkollën e hapur në Himarë, "*ku priteshin të vinin për të studiuar shumë klerikë nga manastiret përreth"*, si dhe për nevojën e botimit të një *"libri të hartuar nga ai vetë në gjuhën vulgare, shumë të dobishme e të domosdoshme për ata banorë"* [41](cituar

35 Marko P (1963) *"Shkolla e parë shqipe tre shekuj më parë",* Fletë nga historiku i shkollës, Tiranë, fq. 8.
36 Po aty.
37 Po aty.
38 Sulë Dedei, vepër e cituar.
39 Karalewskij, C (1911) "*La msisione greco-cattolica della Cimarra nell'Epiro nei sec.XVI-XVII"*, në "Bessarione", anno XV, fashik.2, fq. 441.
40 Xhufi, P. (2013) "Në zanafillat historike të arsmit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII", *"Dukuri të shkollës e të gjuhës në Shqipërinë e Poshtme (shek. XIV-XVIII)"*, Tiranë, fq. 56.
41 Xhufi, P. (2013) "Në zanafillat historike të arsmit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII",

në Xhufi, 2013, fq. 56). Se për çfarë gjuhe vulgare bëhej fjalë, këtë e sqaron vetë Neofit Rodino në një letër të datës 2 gusht 1637, ku ai i njoftonte krerët e tij në Romë se kishte vendosur të bënte përkthimin në shqip të librit të katekizmit, duke përdorur për këtë qëllim një prift nga Himara, të quajtur Dhimitër, i cili *"zotëronte një shqipe tepër elegante, duke qenë ai vetë i asaj kombësie (il quale possede elegantissimamente la lingua albanese per essere della nation)* [42] (Cituar në Xhufi, 2013, fq. 57 referuar Karalewskij, C 1912, fq. 196). Ky fakt që nxënësi i Rodinos, që më vonë u bë prift, duke ushtruar edhe mësuesinë, ishte edhe Papa Dhimitri të bën të mendosh se që të dije një shqipe elegante, tradita e shqipes në Bregdet duhet të ketë qenë më e hershme se në vitin 1627. Për sa i përket literaturës së katekizmit, që i drejtohej besimtarëve të thjeshtë, mund të thuhet se misionarët punuan për ta përcjellë atë në gjuhën shqipe. Përkundrazi, lidhur me botimin e librave të dogmës, që i drejtoheshin klerit të lartë ortodoks, misionarët përdorën përgjithësisht greqishten vulgare *(in lingua graeca vulgari)*[43] (Cituar në Xhufi, 2013, fq. 57 referuar Karaleëskij, C 1911, fq. 480-481).

Edhe në Dhërmi, më 1660, u themelua një shkollë nga misionari Kostandin Onofrio, arbëresh nga Piana e Siçlisë *"...Në Dhërmi at Onofrio shkollën e mronte me anë të kavalier Ninas. Këtu merrte pjesë një numër i madh i rinisë…"*[44] (Marko, P 1963, fq. 8). Sipas dokumenteve, më vonë në këtë shkollë arriti De Kamilis Xhovani, i cili jepte mësim në shkollë ku kishte një numër të madh nxënësish. Në një letër, midis të tjerash, shkruan: "*Himarjotët më kanë shkruar lutje… që të shkoj tek ata për të dhënë mësime në shkollë, po unë do të qëndroj këtu në Dhërmi…*"[45] (Marko, P 1963, fq. 9). Sipas dokumenteve të kohës ky klerik më vonë dha mësim edhe në shkollën e Himarës, ndërkohë që kishte fituar një emër të mirë në gjithë zonën. Peshkopi ortodoks kur shkoi në Dhërmi e pa fëmijët të mësonin shqip, se lexonin shqip, se librat që lexonin ishin shqip dhe jo greqisht, se shqip flisnin fshatrat e Himarës, atëherë i mallkoi"[46] (Marko, P 1963, fq. 9). Është për tu theksuar se misionarët lexonin librin e Pjetër Budit në shqip, prandaj do të mësonin në shkollë në gjuhën shqipe. Në këtë shkollë punoi edhe Nilo Katalano, i cili për mësimin shqip në këtë shkollë hartoi një gramatikë dhe një fjalor italisht-shqip. *"Gramatikën shqipe Nilo Katalanua e bëri për 80 nxënësit e tij të shkollës së Dhërmiut*"[47] (Marko, P 1963, fq. 9). Kjo shkollë kishte fituar nam të madh sa vinin nxënës edhe nga Dukati, Tërbaçi, etj.

Më 1632 kemi një shkollë në Kurbin të Krujës, ku mësohej shqip [48](Kastrati, J1964, fq134). Kjo është e para shkollë në territorin e Vilajetit të Shkodrës, guri i sigurt e historik i themelit të shkollës shqipe[49] (Çefa, K. 2013, fq. 102). Shkollën e vijojnë një numër i vogël nxënësish. Shkolla duhet të jetë mbyllur më 1650. Në relacionin e datës 20. XII. 1641 që arqipeshkvi i Durrësit, Mark Skura, i drejton Kongregacionit të Propagandës

"Dukuri të shkollës e të gjuhës në Shqipërinë e Poshtme(shek. XIV-XVIII)", Tiranë, fq. 56

42 Karalewskij, C (1912) La mIsisione greco-cattolica della Cimarra nell'Epiro nei sec.XVI-XVII, në "Bessarione", anno XVI, fashik. 1

43 Karalewskij, C (1911) La msisione greco-cattolica della Cimarra nell'Epiro nei sec.XVI-XVII, në "Bessarione", anno XV, fashik. 2.

44 Marko, P (1963) *"Shkolla e parë shqipe tre shekuj më parë",* Fletë nga historiku i shkollës, Tiranë, fq. 8.

45 Po aty.

46 Po aty.

47 Po aty.

48 Kastrati, J. (1964) Arsimi popullor, nr. 6, "*Tekste të vjetra shkollore…*", fq. 134.

49 Çefa, K.(2013) "Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII", *"Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVIII"*, Tiranë, 2013.

Fide (Congregatio de Propagada Fide, institucion në gjirin e Vatikanit shkruhet *"Ka një shkollë me 12 gjakoj që arqipeshkvi i ushqen me mjetet e veta për të rritë subjekte që të shugurohen meshtarë pastaj kur të jetë koha"* [50], ndërsa në relacionin që prefekti i misioneve françeskane të Shqipërisë më 7. III. 1650 i dërgon Kongregacionit, thuhet: *"...duke u mësuar fëmijëve shkrim e këndim, e disave gramatikë"*[51]. Mbështetur në dokumentet e mësipërme arrijmë në përfundimin që në Kurbin ka ushtruar veprimtarinë e vet një shkollë me 12 nxënës, e cila ka zënë fill më 1632 dhe është mbyllur më 1650. Ajo e ka filluar jetën e vet si shkollë fillore, e më vonë mund të jetë kthyer në kolegj (shkollë e mesme). Shkolla e gramatikës, për të cilën flet dokumenti, në sistemin mesjetar të mësimit, vinte fill pas shkollës fillore[52] (Luka, D 2013, fq. 31). Për programet që zbatonte kjo shkollë në procesin mësimor flet "Fjalori enciklopedik shqiptar" i vitit 1985. Aty shkruhet: "***Shkolla e Kurbinit***. *Një ndër shkollat e para shqipe, e themeluar më 1632 në afërsi të Krujës, që i përkiste vilajetit të Shkodrës. Përveç leximit e shkrimit aty jepej edhe mësimi i gramatikës. Përdoreshin si tekste mësimore edhe veprat e Frang Bardhit, Pjetër Budit, Pjetër Bogdanit, e të ndonjë tjetri, në gjuhën shqipe. Pushtuesit e penguan veprimtarinë e saj deri sa e mbyllën"*[53] (Osmani. Sh, 1985, fq. 1021). Qëllimi i saj nuk ishte vetëm përgatitja e atyre nxënësve, që më vonë do të shuguroheshin meshtarëve, por këta meshtarë të rinj do të kryenin edhe detyrën e mësuesit, pra, do të përhapnin kulturën dhe arsimin në popull[54] (Luka. D, 2013, fq. 37). Kjo shprehet qartë në relacionin që daton vitin 1632, ku shkruhet "*...ata çuna...pasi të nxanë, do të baheshin mësues për të tjerë"*[55] (1965, fq. 371). Në shkollën e Kurbinit krahas leximit, shkrimit e gramatikës mësohej edhe gjuha latine, katekizmi e doktrina e krishterë.

Shkolla të tilla pati edhe në Korçë, e themeluar në vitin 1637[56] (Koliqi, H 2012, fq. 90). Ekziston mendimi se është shkolla më e vjetër. Prindërit paguanin taksa shkollore. Pas kësaj njihen edhe dy shkolla të tilla në Lezhë, të cilat u ngritën nga një ekip misionarësh françeskanë që u vendosën aty në çerekun e dytë të shek. XVII. Më 1638, P. Hiacinti a Sospitello O.F.M italian, pati guximin dhe iu përvesh për të mirë të vendit një pune në vështrim të plotë kultural, duke çelur shkollën fillore në Pllanë, (në atë kohë vend mjaft i banuar afër lumit Mat) e cila frekuentohej nga fëmijë të moshës 8-10 vjeç. Sipas njohësve të kësaj periudhe, kjo shkollë, për vetë sukseset që arriti, tërhoqi nxënës edhe nga viset e tjera, deri edhe nga Zadrima. Numri i nxënësve të jashtëm arriti në 25, fakt ky që na bën të mendojmë se duhet të kishte pasur edhe konvikt. Midis mësuesve të kësaj shkolle përmenden P. Filipi da Locarno O.F.M., Karl Mirandulani, Gjon Shqiptari, P. Sebastjani a Roveta O.F.M dhe P. Bernardni nga Roma[57]. Shkolla u mbyll pas dhjetë vjetësh (1648), por një vit më pas u hap përsëri me kërkesën dhe

50 Relacioni i Mark Skurës drejtuar Kongregacionit të Propagandës Fide mbi vizitën e kryeme nëpër dioçezat e Shqipërisë së mesme, në vëllimin "Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin e XVII", vëllimi II (1634-1650), Tiranë, 1965, fq. 241.

51 Pjesë nga Relacioni i prefektit të misioneve françeskane në Shqipëri drejtuar kongregacionit të propagandës Fide (7 mars 1650), në *"Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë",* vëll. III (1506-1839), Tiranë, 1962, fq. 193

52 Luka, D. (2013) *"Shkolla shqipe e Kurbinit",* Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVII, Tiranë.

53 Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë, 1985.

54 Luka, D (2013) *"Shkolla shqipe e Kurbinit",* "Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVIII", Tiranë.

55 *"Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në Shekullin e XVII*", vëllimi II (1634-1650), Tiranë, 1965.

56 Koliqi, H (2012) *"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*", Prishtinë.

57 Mons Spila, Memorie storiche d. Prov. R. Romana, tom. II, p. 316-317, ss. n. 2.

këmbënguljen e banorëve dhe vazhdoi deri më 1675. Pas një ndërprerje të shkurtër ajo u çel përsëri më 1697 dhe vazhdoi edhe pas mbarimit të shekullit XVII. Themeluesit e kësaj shkolle ngritën edhe një gjimnaz[58] (Kastrati, J. 1964, fq. 49) që filloi të ndiqej nga shumë të rinj që dëshironin të bëheshin klerikë. Sipas një relacioni të P. Hiacinti a Sospitellos dhe Benedikt Travizanus, misioni kishte ndërtuar shtatë hospice. *"Në të gjitha këto vende, misioni ka qenë me shumë fitim…tue u mësue fëmijëve këndim e shkrim dhe disave gramatikë"*[59] (Skura, M 1965, fq. 395) Ata filluan mësimet me ato mjete që kishin d.m.th, me dorëshkrime etj. Nga dokumentet mësojmë se këtu, përveç mësimeve fetare, jepej edhe letërsi, pa përjashtuar gjuhën amtare[60] (Kastrati, J. 1964, fq. 49).

Hapja e shkollave në Pllanë pati jehonë të madhe. Në këto kushte Paria e Blinishtit iu drejtua P. Bonaventurës da Palazzolo (një misionari françeskan i cili erdhi në Shqipëri në krye të një çete françeskanësh, një nga bamirësit më të mëdhenj të kohës, si edhe iniciatori dhe themeluesi i shkollës së Pllanës) që të çelte një kuvend në Blinisht dhe të merrnin ata drejtimin e moshës së re. Në pamundësi për të realizuar kërkesën e banorëve, banorët e Blinishtit iu drejtuan kuvendit të Troshanit, të cilët pas konsultimeve edhe me Ipeshkvin e Sapës, rreth vitit 1639, çelën një kuvend (ospic) e pranë saj edhe një shkollë të mesme "gjymnasiumi" dhe në Blinisht të Zadrimës, nga fretërit e kuvendit të Troshanit dhe me kërkesën e banorëve ngrihet në këtë fshat një shkollë e mesme, po këtë radhë në rangun e një "gjymnasiumi", i cili qysh në fillim kishte 50 nxënës[61] (Dedei, S. 1999, fq. 103) Drejtor i kësaj shkolle u emërua P. Karl Mirandulani O.F.M., i cili kishte aftësi të veçanta për të mësuar moshën e re. Meqë kjo shkollë frekuentohej nga fëmijë dhe të mëdhenj, zhvillimi i lëndëve niste duke u shpjeguar në gjuhën shqipe (lingua vernacula). Mësimi qe bërë me shumë rregullsi, saqë vetë turqit u thoshin banorëve të Blinishtit : "*Shtazët ua patën bre germat e t'ueja veç se këta fretën rishtas ua njallën*"[62]. Në këtë shkollë përveç shkrimit dhe këndimit mësoheshin edhe lëndë të tjera. Në përmbajtjen e lëndëve përfshihej edhe gjuha shqipe, ndërsa gjuha latine mësohej vetëm nga ata që do të bëheshin meshtarë. Si tekste mësimore këtu janë përdorur dorëshkrime dhe vepra të Andrea Bogdanit, Pjetër Budit, Frang Bardhit, Pjetër Bogdanit etj.[63] (Osmani, Sh. 1998, fq. 49). Mendohet se kjo shkollë nuk pati jetëgjatësi për faktin se P. Karli, aty nga mbarimi i vitit 1640, është mësues në shkollën e Pllanës. [64](Kurti, D 1935, fq. 7).

Me vlerë është edhe informacioni i vitit 1641, ku Gjergj Bardhi njofton se gjatë një vizite në Kosovë, në vendin e quajtur Gurrë, ku ishte famullitar Don Andrea Bogdani, kishte takuar dy seminaristë, që ai mbante në shtëpinë e tij dhe i mësonte vetë. Theksoj se ky prijës i Bogdanëve[65] (Koliqi H, 2012, fq. 91), arkipeshkv i Shkupit, shquhet për veprimtarinë e tij arsimore në drejtim të *"shkollimit e kuadrove të reja në vend dhe jashtë Kosovës, funksionimin e shkollave pranë çdo famullie, sigurimin e disa bursave*

58 Kastrati, J. (1964) Vepër e cituar
59 Skura, M (1965*)"Reacion i Mark Skurës drejtue Kongregacionit të Propagandës Fide mbi vizitën e kryeme nëpër dioçezet e Shqipënisë së Mesme"*, vëll. II (1634-1650); Në Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të mesme sh. XVII, V. II, (1634-1650), Tiranë.
60 Po aty.
61 Dedei, S. (1999) *"Zhvillimi i arsimit në mesjetë në Shqipëri",* Revista Pedagogjike , nr 2.
62 Orbis Seraphicus, P. Marcellinus a Civetia et Theophilus Domenichelli O.F.M De Miss, FF. Minorum. Lib. IV, fq. 443, n. 50.
63 Osmani, Sh. (1998) , "*Reflekse etnopedagogjike 1"*, Tiranë, fq. 49
64 P. Donat Kurti, O.F.M. (1935) "*Vepra kulturale e elementit katolik në Shqipëri",* Shkodër, fq. 7.
65 Koliqi H, (2012) *"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik Shqiptar",* Prishtinë, 2012.

për kandidatë shqiptarë në Loreto dhe Propagandën e Romës, hartimin e librave shkollorë dhe homolikë në gjuhën shqipe"[66] (Sedaj E 1999, fq. 275)

Shkolla e Velës (sot në territorin e Mirditës) është hapur pas vitit 1660 nga ipeshkvi i Lezhës, Gjergj Vladanji, i cili rrjedh nga një familje fisnike nga Shiroka e Shkodrës, por me origjinë nga Drishti. Më 1650 Bolica shkruan se: "*Gjergj Vladanji ka veti të virtytshme dhe ka njohuni, njeh gjuhën ilirike dhe gjuhën shqipe, rrjedh nga nji farefisni shumë e mirë, sa edhe turqit e Shqipnisë e çmojnë sadopak"*[67]*(Skura, M 1965, fq. 405)*

Në relacionin e datës 10 korrik 1702 lexojmë:*"Mons. Gjergj Vladani ipeshkv në Lezhë, me vullnetin e tij të fundit, la me testament që nji pjesë të pasunisë së tij, prej tokave që ka, të shkojë për mbajtjen e nji apo dy mësuesve, që t'u mësojë gramatikë e rastet e ndërgjegjes klerikëve dioqeziane. E, në qoftë se shprehet mirë testuesi, me lanë për këtë qëllim nji kapital të madh. Megjithatë, mbas vdekjes së tij, tue qenë të pushtueme pasunitë e tij, nuk ka mbetë tjetër, veç 250 zekina ari, të cilat, nëse nuk janë depozitue pranë Arqipeshkvit, axhës sim dhe pasardhës, do të ndodhë e njajta fatkeqësi si trashigimisë tjetër…Së fundi, që parja të mos rrijë kot, pa u përdorë, me paragjykim të mendjes së përshpirtshme të Prelatit, kam çmue mirë me konsens të Mons. Teodorit, me investue me kohë në këtë pjesë të krishtërimit zekinat e dhanë 250 me interesë gjashtë për qind në vjetë, për me nxjerrë çdo vjetë 15 zekina, shumë të mjaftueshme për mbajtjen e një mësuesi në Lezhë e duhet kerkue subjekti i përshtatshëm për këtë ushtrim detyre…"*Një tjetër burim është relacioni i Ipeshkvit Anton Kryeziut më 1753: "*Në Velë më 1773 gjindet edhe e vetmja shkollë për brezin e ri kishtar në dioqez. Ajo qe ndërtue nga Propaganda Fide dhe kishte 6-8 nxanës dhe nji mësues…"* Më poshtë ai thekson*:"…Përballë padijes së madhe të klerit, që dëshmohej edhe gjatë vizitës, nji shkollë e tillë ishte e domosdoshme, me randsi të veçantë. Sipas lajmeve vjetore, aty studjoshin 6 të rij dioqezanë (Jak Stampaneo, Gjon Cura, Gjerard dhe Anton Xiupa, Zef Trashi, si dhe Gjon Bjanku. Veç këtyne, Ipeshkvi kishte edhe 4 të rij të tjerë në shtëpinë e vet, që ai i përgatiste për karrierën kishtare. Mësimi zhvillohej në shkollë, që me krenari e quejshin gjimnaz. Jepeshin këto landë mësimore: lexim e shkrim, italisht e latinisht…"*

Në një tjetër dokument të datës 23.08.1663 na flet për një mësues të gjuhës shqipe në Lezhë, Don Gjon Csulion. Po në këtë vit prifti Pjetër Mazreku, nxënës i Kolegjit Urban është misionar dhe mësues për gjuhën shqipe në shkollën e Janjevës në Dioqezën e Shkupit. Lëndët që zhvilloheshin në atë shkollë ishin, lexim, shkrim doktrinë kristiane e gramatikë. Librat që përdoreshin ishin: "Ungjilli në gjuhën shqipe", "Pasqyra e të Rrëfyemit", "Rituali Romak", "Doktrina e vogël", të gjitha në gjuhën shqipe.

Në një dokument në Arkipeshkëvinë e Durrësit i cili daton vitin 1675, flitet për një mësues të gjuhës shqipe në Kishën e Kurbinit. Të tjera dokumente na dëshmojnë për Nikollë Vladanjin dhe Pjetër Perlatin si mësues të gjuhës shqipe në Dioqezën e Lezhës.

66 Sedaj E, (1999) *"Ndre Bogdani-prelat e lartë i Kishës dhe mësues i popullit shqiptar*", "Dardania sacra" 1, "Shtufi" Prishtinë.

67 Skura, M (1965*) "Reacion i Mark Skurës drejtue Kongregacionit të Propagandës Fide mbi vizitën e kryeme nëpër dioçezet e Shqipënisë së Mesme"*, vëll.II (1634-1650); Në Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të mesme sh. XVII, V. II, (1634-1650), Tiranë, fq. 405.

2.5 Zhvillimi i arsimit në shek. XVII-XVIII

Në shekullin XVII e sidomos në shekullin e XVIII, vërehet një zhvillim i mbarë kulturor e arsimor. *"Përveç priftërisë, që kanë luajtur rol dhaskali në të gjitha kohësitë, dokumentat arsimore-historike na dëshmojnë se kalamanët e Korçës, fjala vjen, paskan vozitur në shkollë private dhe me dhaskalë laikë, që sot e treqind vjet të shkuara*" dhe më poshtë thuhet se "…"*skolëra" me pagesë pat pasur, punë kjo që fëmijët e të vobektëve i linte pa gramë, apo siç duket dhe për fëmijët e punëtorit të esnafërisë mësimi privat është i shtrenjtë. Kjo e metë e madhe ka ngucur ata korçarë të vjetër, "të shtien aspra isnafërisht" për pagesën e dhaskalit*"[68] (MASH, 2003, fq.58). Një i tillë është akti, me anë të të cilit shtatë ryfetët (esnafët) e Korçës, vendosën t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë pa pagesë *"duke marrë përsipër të paguajnë 200 aspra për mësuesin"*. Në këtë mënyrë këto shkolla nuk i ndiqnin vetëm fëmijët e pasanikëve, por edhe ata nga shtresat e popullit, pra kemi përpjekje për t'i dhënë shkollës karakter demokratik.

Në shekullin e XVII, sipas studiuesit J. Rexhepagiq, në territorin e Kosovës kanë funksionuar shkollat në Janjevë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Suharekë, Gllogjan, Poçest, Papaz e Landovicë. Për shkollat e gjashtë vendbanimeve të fundit ka merita të veçanta Dom Gegë Mazreku. Në shkollën e Janjevës, në vitin 1666, mësues ishte Pjetër Mazreku së këndejmi edhe mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe.[69] (Gjergji, S, 2013, fq. 69). Lëndët mësimore që zhvilloheshin në shkollë ishin: lexim, shkrim, doktrinë kristiane dhe gramatikë. Ndërsa si libra janë përdorur ungjilli në gjuhën shqipe, "Pasqyra e të Rrëfyemit", "Rituali Romak", "Doktrina e vogël", të gjitha në gjuhën shqipe[70](Çefa, K 2013, fq. 124) Raporte të shumta të prelatëve tanë flasin për shkollën shqipe në Kosovë edhe përgjatë shekullit XVIII, siç mësojmë nga raporti i Imzot Gj. N. Kazazit (1747), i cili në banesën e tij po mësonte shtatë fëmijë të moshave nga 7-18 vjeç, ndërkaq Don Zef Berisha, në raportin e 22 majit 1782, falënderon Kongregatën për librat e dërguar në gjuhën shqipe, për shkollën në Gjakovë[71]. (Rexhepagiq, J 1970, fq. 48-52).

Në vitin 1660 fillon hapja në masë e shkollave ortodokse në bregdetin jugor. Më 1663 Jan Krisofidi hapi një shkollë në Palasë.

Rreth vitit 1670 në Tivar janë çelur mejtepe e medrese. Në vitet '70 u çelën dy shkolla në Himarë. Në Berat në çerekun e tretë të shek. XVII kishte 5 medrese. Në Manastirin e Pojanit është mbajtur një shkollë për nevojat e klerikëve të këtij rrethi, shkollë që pas vitit 1684 u kthye në shkollë të mesme.

2.5.1 Kuvendi i Arbrit (15 janar 1703)

Kur u mbajt Kuvendi i Arbrit më 1703, Shqipëria kalonte kohë të vështira. Ishin në rrezik të humbisnin gjuha shqipe, besimi i krishterë, zakonet, traditat dhe virtytet e popullit tonë. Vizitori Apostolik V. Zmajeviç në fjalën e hyrjes në Kuvend do të thoshte: "*Unë dheut rreth e rreth ju solla e gjithë mbarë e kërkova e*

68 MASH, (2003)*"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqIptar",* vëll. I, Tiranë, fq. 58.
69 Gjergji, S (2013) vepër e cituar.
70 Çefa, K (2013) *"Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII"*, Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVII, Tiranë.
71 Rexhepagiq, J (1970) *"Zhvillimi i arsimit dhe sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918",* Prishtinë.

pashë nevojtë e Shqipënisë. Pashë gazepe shumë, Shehrin vu nën haraç ... kalatë e trimave rrenue... Sëmundjen e murtajës që ban kërdinë...Zemra donte me m'u nda përgjysëm, e prandaj thashë: "Populli im u ba rob pse nuk pat dije". Kuvendi vendosi të përhapej letërsia shqipe nëpërmjet veprave të Budit, F. Bardhit, akteve të Kuvendit të Arbrit. Shfrytëzimi i gjerë i shqipes së shkruar ishte detyrë parësore për të rinjtë e shkollave. Nisur nga nevoja e përgatitjes së "*priftërinjve të dijshëm, të urtë e të devotshëm...ku me zyrë e me mësime të mira rritet e mësohet fisnikërisht vegjëlia e Arbnit për lavdi të Hyut e shelbim të dheut të sinë (tonë)"*. Duke pasur parasysh nevojën e meshimit shqip, rivalitetin e klerikëve shqiptarë me ata të dërguar nga Roma, si edhe përvijimin e një kontributi të shquar të disa klerikëve që aso kohe "*kishin udhëhequr popullin në luftë për të drejtat e tij*", mund të vëmë në dukje se ishte lartësuar mendimi dhe ishin rritur pretendimet ndaj përgatitjes së klerikëve vendas, kjo pjesë e detyrës që po kryente shkolla e Velës. Kuvendi porositi: "*Ky mjeshtër që rri në Velë (mësuesi) kujdes të ketë për gjakona* (ndihmësi i priftit; shënimi im E.B.) *e ...të mundohet me gjithë gjoks me i vjejtë kishës e gjithë dheut (atdheut)*". Kuvendi përpiqej të pajtonte detyrat kishtare me ato kombëtare e patriotike për ta vënë klerikun *"në shërbim të dheut sinë"* dhe shkollën*"me i vjejtë kishës dhe gjithë dheut*".

Lidhur me programin, mësuesit porositen që "*shkollarët mbasi të kenë xanë me shkrue e me këndue (shqip), mjeshtri t'ua mësojë gramatikën e t'i bajë me xanë gjuhën latine në mos tepër mirë, bare (të paktën) nevojshëm*". Sistemi shkollor mendohet të ketë qenë më i lartë se një shkollë fillore. Kjo jo vetëm për traditën e shkollave pararendëse të Pllanës e të Blinishtit, por edhe sepse të mësuarit e shkrim-këndimit shqip, të gramatikës e më pas të latinishtes, të veprave shkencore e të manualeve shkollore të hartuara pikërisht për këto shkolla, të mësuarit e katekizmit e të teksteve, të rregullave e të praktikave profesionale, të një literature relativisht të gjerë, me siguri kërkonin një vijimësi të gjatë mësimi. Shkolla e Velës ka qenë në nivelin e një "gymnasiumi". Shkolla e Velës i dha një hov të ri arsimit në trevën e Mirditës. Ajo formoi fizionominë e vet dhe qëndroi e hapur, pavarësisht shkëputjeve deri në vitin 1817. Për shkollën e Velës na flet relacioni i Ipeshkvit Anton Kryeziut më 1753. Ndër të tjera ai thekson: "*Përballë padijes së madhe të klerit, që dëshmohej edhe gjatë vizitës, nji shkollë e tillë ishte e domosdoshme, me randsi të veçantë. Sipas lajmeve vjetore, aty studjoshin 6 të rij dioqezanë (Jak Stampaneo, Jak Cura, Gjerard dhe Anton Xiupa, Zef Trashi, si edhe Gjon Bjanku). Veç këtyne, Ipeshkvi kishte edhe 4 të rij të tjerë në shtëpinë e vet, që ai i përgatiste për karrierën kishtare. Mësimi zhvillohej në shkollë, që, me krenari e quejshin gjimnaz. Jepeshin këto landë mësimore: lexim e shkrim, italisht e latinisht..."*[72] (cituar në Çefa, K 2013, fq. 109)

Një nga njerëzit më të ditur, vullnetmirë, pasionant të cilin nuk mund ta lëmë pa përmendur është Bogdani. Ai më 1671 u vendos në malet e Rrjollit dhe aty themeloi shtëpinë ipeshkvnore, një kishë dhe një shkollë për të rinj. Me rëndësi për studimin tonë janë letrat që u dërgonte eprorëve në Vatikan dhe pikërisht te interesimi i tij për arsimimin e popullit. Ai tregon dëshirë të madhe për hapjen e shkollave. I lutet Kongregacionit të Propagandës Fide t'i dërgojë një mësues shkolle, përveç atij të Rrjollit, edhe një për fshatin Barbullush, si dhe kërkon me këmbëngulje t'u krijoheshin mësuesve kushte të mira, ndërkohë që përpiqet vetë të

72 Çefa, K (2013) *"Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII"*, Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVII, Tiranë, fq. 109

zgjedhë elementin më të vlefshëm, i kërkon edhe libra..."*Se asht gati krejt pa libra në gjuhë të vet*".

"Në vitin 1698 a aty pari gjejmë se P. Filipi prej Shkodret 0.F.M. çilë shi në Shkodër nji shkollë private e mson fmit e tregtarëve e të pasanikve"[73] (Kurti, D & Sirdani, M, 1999, fq. 13). Në revistën "Hylli i Dritës", Patër Anton Gega shkruan "*Një shkollë tjetër, krejt private, na del në shesh në Shkodër nga mbarimi i këtij shekulli*" (bëhet fjalë për fundin e shek. XVII, shënimi im E.B.). "*P. Filip de Locarno kishte marrë me vedi nji djaloç prej Shqipnie, i cili mbaroi këndimin me 19.08.1698, kje shugurue meshtar e i thoshin émnit P. Filipi prej Shkodre. Aso kohe, familja e Kolë Kamsit (Cola Cambesi) tue kenë e dame në shej për bâmirësí ndaj misionarvet, xuer lejen prej ipeshkvit të Tivarit, që P. Filipi t'u shenjonte në Shkodër. Por sa mbrríni, me një herë P. Filipi xûni vend në shpí të familjes Kamsi, çili një shkollë për me msue fmít, ashtu u shërbej edhe katolikvet"*[74]. (Gegaj, A 1932, fq. 138) Në shekullin XVII në shtëpinë e Kamsejve mësimet bëheshin në gjuhën shqipe.

Më 1749 Pal Pemë Kamsi në relacionet dërguar eprorëve të vet në Romë, u përshkruan vështirësitë në hapjet e shkollave dhe i propozon të ngrihet një shkollë e përbashkët për dy dioqezat në Lezhë, e cila shqetësohej më pak nga turqit. Secila dioqezë të çonte nga 6 nxënës. Këta të mësohen nga një mësues. Shkolla duhet të jetë në qelë e mësues një rregulltar. Ndërsa për Shkodrën, Kamsi mendonte se vendi më i përshtatshëm ku mund të hapej një shkollë ishte Pulti, larg zullumeve turke. Më 1785 Imzot Radovani u përpoq të hapte një shkollë në Shkodër po dështoi se popullsia myslimane nuk duronte në lagjet tyre as qelë, as shkollë[75] (Çefa, K 2013, fq. 112)

Në shkollat e bregdetit punoi për afro një çerek shekulli arbëreshi Zef Sqiroi, i cili tërhoqi në shkollën e vet vajza të krishtera e myslimane, të cilave u mësonte greqisht e shqip si dhe shkrim e lexim. Shkolla u frekuentua nga afro 80 nxënës. Popullata i mbështeste këto shkolla pasi krahas marrjes së diturive, fëmijët mësonin në to të shkruanin gjuhën e tyre.

Përdorimi i gjuhës shqipe u vërejt edhe në shkollat turke. Në fundin e shekullit XVI hapen shkollat e para turke, ndërsa në shekullin e XVII numri i tyre rritet me shpejtësi.

Si forma të organizimit të punës së shkollës në vendin tonë ishin mejtepet dhe më vonë medresetë. "Mejtepet"- shkolla fillore - janë ngritur pranë çdo vendbanimi mysliman dhe emërtoheshin me emrin e hoxhallarëve që jepnin mësonim në to, apo të atyre që i kishin hapur. Në vendet ku kishte xhami, besimtarët e pasur i hapnin shkollat në ndërtesa të veçanta, ndërsa në vende ku nuk kishte xhami apo mejtep vinin mualimët (mësuesit) dhe i mësonin fëmijët. Këtu mësohej leximi e recitimi i Kur'anit, lexim e shkrim, bazat e gjuhës arabe, aritmetikë, por filloi edhe përdorimi i gjuhës shqipe. Mësimi zhvillohej në turqisht, duke ia zënë vendin arabishtes. Edukimi i meshkujve dhe femrave ka qenë i ndarë. Përveç mejtepeve për meshkuj dhe për femra, janë hapur edhe disa mejtepe mikste.[76](Shllaku, L. 2002, fq. 36) Vlen për tu theksuar se dënimet e vajzave ishin më të buta se të djemve dhe përmbajtja

73 Kurti, D.,& Sirdani, M(1999) "*Mbi kontributin e elementit katolik në Shqipëri*", Tiranë, f. 13.
74 Gegaj, A (1932)"*Vepra arsimore e françeskajvet në Shqypni në shekullin e XVII* ", Revista "Hylli i Dritës", viti VIII, Nr. 3, fq. 138.
75 Çefa, K (2013), Artikull i cituar.
76 Shllaku, L. (2002) Vepër e cituar fq. 36.

e mësimit në shkollat e vajzave ishte më e varfër se e djemve. Nxënësit mësonin mekanikisht përmendësh. Mësimi ndiqej nga grupmosha të ndryshme nga 5-20 vjeç dhe numri i nxënësve nuk ishte i përcaktuar. Mësuesit e mejtepeve merrnin rrogë nga vakëfi, ndërsa ato të mejtepeve private mbaheshin nga populli.

Medresetë e para në Shqipëri janë shumë të hershme. Ngritja e këtyre institucioneve në qendra të ndryshme, siç ishin Shkupi, Prizreni, Shkodra, Elbasani, Berati, Vlora, Ulqini, Janina, Gjakova, Tetova, etj. faktohet nga të dhëna të shumta. Ato u hapën për nevojat e formimit intelektual të nxënësve të besimit mysliman. Ngritja e tyre bëhej nga fondet e lëna për vakëf nga individë apo grupe individësh.

Një nga më të vjetrat është Medreseja e Mirahorit në Korçë. Medreseja e Mirahorit në Korçë është shkolla e parë shqipe që njohim deri tani, e cila është ndërtuar para vitit 1486, edhe pse nuk është përmendur fakti se në këtë shkollë mësohej shqip. Pra, kemi të bëjmë me një shkollë të çelur para më shumë se 500 vjetëve. Ndërtesa e kësaj shkolle vazhdon të qëndrojë në këmbë edhe sot e kësaj dite.

Mirahori, para se të ndahej nga jeta, la të shkruar në testament amanetin për vijueshmërinë e gjithçkaje që kishte lënë pas, përfshi këtu edhe shkollën, rrogën që do të merrnin mësuesit, shpenzimet për mirëmbajtjen e tyre, rrogën për njerëzit e ditur etj. Dhe që të gjitha këto do të dilnin nga pasuria e Mirahorit. Në këtë testament gjejmë të shkruar se për mësuesin caktonte nga 4 dërhem në ditë, për hasrat e shkollës 500 dërhem në vit, për njerëzit e ditur nga 1 dërhem çdo ditë, për meremetuesin e shkollës 2 dërhem në ditë, ndërsa për studentët dhe fëmijët e studentëve ushqim falas.

Iliaz bej Mirahori mbetet një nga burrat e nderuar që gjithë pasurinë e tij e shkriu për njerëzit dhe nxënësit e shkollës së tij. Ajo çka mbetet e çuditshme ka të bëjë me faktin se deri më sot nuk gjendet qoftë edhe një shkrim i vetëm për Medresenë e themeluesit të Korçës, Iliaz bej Mirahorin. Shumë kush mendon se kjo e vërtetë u fsheh për 50 vjet me radhë nga regjimi komunist.

Nga regjistrat e Sheries së Beratit mësojmë se më 1689, afër 20 persona nga fshati Perondi kanë lënë vakëf 38.500 akçe për ngritjen e medresesë së fshatit të tyre. Pikërisht ekzistenca e kësaj medreseje në fshat më 1689 vërteton se këto lloj shkollash kanë qenë të hapura shumë kohë më përpara në qytete. Kështu më 1679 lihen 100 mijë akçe për një medrese në Berat, që ishte ngritur më parë dhe do të përdorej për studentët që mësonin aty. Po këtë vit lihen 15.000 akçe për ndërtimin e një shkolle fshati. Kështu mund të nxjerrim si përfundim se mejtepet dhe medresetë në Berat dhe në rrethin e tij ngriheshin me ndihmën e popullit[77] (MASH, 2003, fq. 69)

Shtrirjen e shkollave që administrohen nga kleri mysliman në shek. XVII e jep funksionari i Portës së Lartë, Evlia Çelebiu (1611-1684) në librin e tij "Udhëtimet", 1930, përkthyer pjesërisht në gjuhën shqipe nga Sali Vuçiterni[78] (Çelebi, E. 1930) Ndër të tjera ai pohon se gjatë vizitave në qytete dhe qendra të tjera të vogla ka gjetur shkolla që ndiqeshin nga një numër i konsiderueshëm nxënësish. Pranë çdo instituti të kultit në Shqipëri, pohon ai, ka shkolla (mejtepe e medrese). Sipas tij në këto shkolla mbizotëronte të mësuarit përmendësh dhe nxënësit shqiptarë ishin të zgjuar. Gjithashtu, ai na jep këtë panoramë të përhapjes së këtyre shkollave sipas rretheve:

77 Grup autorësh, MASH, (2003) *" Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar",* Tiranë.
78 Çelebi, E (1930) *"Seyahaname"* Shqipëria para dy shekujsh, Tiranë.

QYTETI	MEDRESE	MEJTEPE
Shkodër	10	-
Delvinë	3	3
Gjirokastër	3	5
Berat	5	4
Vlorë	3	5
Kavajë	2	3
Peqin	3	5
Elbasan	3	?
Pogradec	1	2

Tabela 1. *Përhapja e shkollave sipas rretheve.*

Siç shihet edhe nga tabela shkolla të rangut fillor e mbifillor kishte kudo në Shqipëri. Megjithëse ato nuk ishin në gjuhën shqipe, ndjekësit e tyre morën elementin e leximshkrimit dhe të kulturës, në kushtet e mungesës së shkollave në gjuhën amtare. Ata arritën të vazhdojnë shkollat jashtë dhe mbuluan rrjetin e nëpunësve të vendit.

Për Shkodrën, veç të dhënave të tjera si Varoshi që ka 15 lagje, 10 dajlane, banorët e Shkodrës janë kryesisht shqiptarë, që flasin krejt shqip me të dhëna të tjera të rëndësishme me karakter historik dhe etnografik, thekson se: "*ka dhjetë xhami dhe pranë çdo xhamie nga një medrese*"[79] (Çelebi, E. 1930, fq. 154-161). Mendimi ynë është se këtu nuk bëhej fjalë për medrese në kuptimin e një shkolle të mesme, por për një shkollë të ulët (mejtep) për mësim besimi. Është Interesant fakti që sjell udhëtari turk për gjendjen klasore të qytetit, duke theksuar se "*populli i Shkodrës është shumëklasësh: peshkatarë, ushtarë, tregtarë, detarë, industrialët, intelektualët e bujqit e vreshtave"*[80] (Çelebi, E. 1930, fq.160), gjë që na lë të kuptojmë se në Shkodrën e kësaj periudhe kishte njerëz të mësuar në shkolla vendase apo të huaja të cilët ua jepnin këtë kulturë në forma të ndryshme të tjerëve. Fakti që intelektualët veçohen si grupim më vete, forcon mendimin e dhënë edhe nga studiues të tjerë për një arsim dhe kulturë paraturke në Shqipëri dhe se numri i intelektualëve nuk ishte i papërfillshëm.

Gjatë periudhës 1453-1821, shumica e shkollave greke në Shqipëri ishin shkolla komunale fillestare, drejtoheshin nga priftërinjtë ose edhe nga artizanë, zhvillonin mësime brenda në kishë. Në këto shkolla mësohej leximi i veprave kishtare e klasike, aritmetikë e shkrim. Programet në këto shkolla ndryshonin sipas aftësive të mësuesit[81] (Grup autorësh, 2003, fq. 55) . Vajzave nuk u jepej një arsim i veçantë, por vetëm disa elemente të punëve shtëpiake.

Në vitin 1749 është rasti i themelimit të një shkolle në Shqipërinë e poshtme nga privatë. Atë vit, tregtari Spiro Rizo nga Delvina, me banim në Venedik, veç të tjerave, la me testament edhe ndërtimin e një shkolle në vendlindjen e tij, Delvinë[82] (Basileiou, K. Zaride, 1978, fq 260-298). Krahas mësimit të lëndëve të përgjithshme

79 Çelebi, E (1930) *"Seyahaname"* "Shqipëria para dy shekujsh", Tiranë.
80 Çelebi, E (1930) *"Seyahaname"* "Shqipëria para dy shekujsh", Tiranë.
81 Grup autorësh, MASH (2003*) "Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik Shqiptar*",Vëll. I, Tiranë.
82 Basileiou, K . Zaride (1978) Grammata apo to Devino (1753-1792) gia to klerodotema tou Spyrou Rizou, në: "Thesaurismata" 15.

(enciklopedike), në shkollë do të mësohej edhe greqishtja. Mësues i saj përmendet edhe murgu Maksim nga fshati Derviçan i Gjirokastrës. Duhet thënë se si në testament, ashtu edhe në dokumentet vijues të tij, shkruar në italisht dhe në greqisht, jo vetëm emri i financuesit të shkollës, Spiro Rizos, por edhe emrat e shumë prej ekzekutorëve dhe garantëve të testamentit të tij, tingëllojnë shqiptarë: Llambro Buba, Trëndafil Nako, Qiriako Kumbulla, Dhimitër Toli....., Athanas Zholi, Anastas Qëndro e Stefan Xhufa[83] (Basileiou, K. Zaride, 1978, fq. 266, 269, 271, 273, 277, 291). Këta tre të fundit dëshmojnë gjasisht origjinën e tyre nga Progonati, nga ka pasur emigracion të vazhdueshëm në drejtim të Delvinës.[84] (Xhufi, P 2013, fq.52). Po sipas këtij autori, jo vetëm në Delvinë, por edhe në vise të tjera ku funksiononin shkolla greke, si në Himarë, Paramithi, Margëlliç, mjedisi njerëzor ishte shqiptar, ose kryesisht shqiptar. Mes shqiptarëve ekzistonte tashmë një vetëdije, më së paku e gjuhës[85]. (Schimitt, O. J 2012, fq. 116) Në përplasjen mes gjuhës së folur e gjuhës së kishës, mes klerikëve të huaj (grekë), që nuk njihnin gjuhën e vendit dhe që kërkonin të imponoin helenizmin, dhe klerikëve vendas, të mbështetur nga popullsia vendase, ndërfutet edhe përdorimi i gjuhës shqipe në veprimtarinë kishtare në realin e jugut. Dëshmia e parë deri më sot mbetet Perikopeja Ungjillore e meshës së Pashkëve, një tekst shqip për të cilin ne kemi folur më sipër. Botimi i fjalorëve dy, tri e katër 4 gjuhësh i Kostë Beratit, Teodor Kavaljotit e Danil Voskopojarit, përpjekjet e para për përkthimin e Biblës dhe tentativat për sajimin e alfabeteve të gjuhës shqipe janë një provë implicite e institucionalizimit të gjuhës shqipe si gjuhë shkolle, dhe si gjuhë e kishës. Të tilla lëvizje të mëdha kulturore e fetare ofruan hapësira për një "kombëtarizim" të kishës ortodokse shqiptare, gjë që u shpreh në botimet e para në shqip dhe në kultivimin e shqipes në shkollat fetare[86] (Xhufi, P 2013, fq. 53-54).

Një përhapje kanë shkollat greke në Korçë (1728), në Elbasan (1736), në Vlorë (1741) etj.

"*Më 1745, në Shkodër, në lagjen Tophanë funksiononte fshehurazi një shkollë (qendër mësimore) me 30 nxënës, e cila drejtohej nga një mësues laik, Jak Kolë Kamsi*"[87] (Kadiu, A. 1996, 108-109). Shkolla ishte nën ndikimin e klerit, kurse mësimi ishte laik. Për mësuesin dihen pak gjëra, por i rëndësishëm është fakti se ky mësues nuk dinte gjuhë tjetër veç shqipes, e nuk ka dyshim se mësimet zhvilloheshin në këtë gjuhë[88] (Kabineti Pedagogjik,1980, fq. 7).

2.6 Zhvillimi i arsimit në shekullin XVIII deri në shpalljen e Pavarësisë

Shënon një ngritje të veprimtarisë së mësuesve dhe në drejtim të cilësisë së punës së tyre. Voskopoja, një qendër e njohur tregtie, që kishte krijuar lidhje dhe marrëdhënie tregtie me qendra të Evropës perëndimore e qendrore, me shumë esnafë me potencë ekonomike, po kthehej edhe në një qendër të fuqishme arsimore dhe kulturore. Shkollat me alfabet grek nivelin më të lartë kulturor-pedagogjik e arritën pikërisht në Voskopojë. Që në shekullin e XVII jemi ndeshur me dokumente të Voskopojës, që flasin për

83 Po aty.
84 Xhufi, P (2013), artikull i cituar.
85 Schmitt, O.J (2012) *"Shqiptarët, një histori midis Lindjes dhe Perëndimit"*, Tiranë.
86 Xhufi, P (2013)artikull i cituar.
87 Kadiu, A .(1996) *"Dibra e Madhe"*, (monografi), Tiranë, 1996, fq.108-109.
88 Kabineti pedagogjik i Shkodrës, (1980)"*Historiku i arsimit i rrethit Shkodër*" pj. I.

pagesë mësuesish, për mësues privatë, laikë, për interesime të terzinjve, kasapëve, etj. që t'i dërgonin fëmijët në shkollë pa pagesë, nisur nga 200 aspra që kishin siguruar për mësuesin.[89] (MASH, 2003, fq.58) Nga të ardhurat e rufetëve paguheshin mësuesit e shkollave, u jepeshin bursa nxënësve edhe për në akademitë ose universitetet e vendeve të ndryshme të Evropës……, me të cilat voskopojarët kishin lidhje të shpeshta.[90] (Pepo, P. 1967, fq. 169-171.

Më 1710 u ngrit një shkollë në gjuhën greke, të cilën e ndoqën nxënës nga krahina të ndryshme të vendit, nga Maqedonia. Mendohet që edhe më përpara ka pasur shkollë[91] (Kraja, M. 1993, fq. 48) Mësues i parë dhe drejtor ishte Krisanth Shqiptari, me prejardhje nga Zica e Evirit. Ai kishte studiuar në Janinë dhe ishte njeri me kulturë dhe autor i një punimi didaktik "Organ para ushtrimor mësimor", si dhe të një tjetri me titull "Tema të përbashkëta", të botuar në gjuhën greke. Në fillim të shekullit XVIII ai largohet nga Voskopoja. Pas tij ka punuar voskopojari Dhimitër Prokopi, i cili bëri skemën e parë të gramatikës greke. Më pas ka punuar Kol Stingji nga Janina, Jani Gjon Bakërxhiu, voskopojar me studime të kryera në Evropë (Itali). Të dy vinin me koncepte të reja, bashkëkohore për gjuhën dhe arsimin, duke zbatuar metoda të reja didaktike. Shquheshin për kulturë pedagogjike etj. Madje thuhet se Jani pati nën kujdestari Kavaljotin, që e dërgoi për vazhdimin e studimeve në Janinë. Ai njihte mirë helenishten, italishten dhe latinishten. Në shkollat fillestare të Voskopojës mësohej vetëm greqishtja, ndërsa gjuha shqipe mësohej tepër pak. Dy shkollat ekzistuese të Voskopojës u shkrinë në një që në vitin 1732, duke i hapur rrugën krijimit të "Akademisë së Re".

Shkrimi në gjuhën amtare po përhapej, jo vetëm në shkrime me karakter fetar, por edhe didaktik, herë- herë edhe laik, pa munguar edhe elementet realiste. Tashmë shtrohet çështja e zbatimit praktik të shkrimit të gjuhës shqipe jo vetëm në jetën kulturore, arsimore e fetare, por edhe në atë ekonomike.

2.6.1 Kompleksi arsimor-kulturor i Voskopojës

Kompleksi arsimor- kulturor i Voskopojës përbëhej nga pesë institucione: biblioteka, konvikti që kishte dy jetimore, shtypshkronja dhe libraria. Në qendër të tyre qëndronte "Akademia e Re".

Akademia e Voskopojës, e ngritur në vitin 1774, në rangun e një kolegji dhe që mbahej nga esnafët, ishte një institucion privat. Që nga viti 1750 ajo filloi të quhej "Akademia e Re" dhe u bë kështu një qendër mjaft e rëndësishme. Ndërtesa trekatëshe e "Akademisë" kishte afër 40 salla e dhoma leximi. Ajo pati rektor të parë Sevast Leontiadhin (1690-1765) nga Kosturi, i laureuar për filozofi e filologji në Universitetin e Padovës (Itali). Ai u shqua si propagandist i sistemit filozofik të Dekartit e të Malebranshit. Në këtë shkollë të mesme u zbatuan sistemet pedagogjike e metodat didaktike evropiane. Këtu dhanë mësim njerëz të shkolluar në universitetet evropiane, si Grigor Voskopojari, Theodhor Kavalioti, etj. Mësuesit shqiptarë këtu përbënin shumicën, ishin personalitete të arsimit e të shkencës, dhe shumica e tyre qenë autorë të teksteve të Akademisë, të cilat janë vlerësuar si mjaft të dobishme edhe për shkollat e tjera. Shkollat e Voskopojës, sidomos Akademia, i dhanë një shtytje përpara gjithë

89 MASH (2003) *"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar",* Tiranë fq. 58.
90 Pepo, P(1967) Materiale dokumentare mbi veprimtarinë e zanatçinjve të Korçës e të Voskopojës, në "Studime historike"1967, nr. 1, fq. 169-171
91 Kraja, M(1993) "*Mësuesit për kombin shqiptar"*, Tiranë, fq. 48.

zhvillimit të arsimit aty dhe në krahinat rrotull. Me ndihmën e Patriarkanës së Ohrit, e veçanërisht të patrikut Joasaf, që ndihmoi materialisht dhe e përkrahu punën e mësuesve që punonin në këto shkolla, shkolla u frekuentua edhe nga shqiptarë nga Maqedonia, viset e tjera, duke përgatitur jo vetëm tregtarë e nëpunës por edhe mësues e priftërinj[92].

Në këtë shkollë të mesme zhvillohej letërsi helenike, letërsi latine, filozofi, teologji e Lindjes dhe e Perëndimit. Në planin mësimor përfshiheshin gjuha greke, letërsia, matematika, fizika etj. Në këtë "Akademi" bëhen përpjekje për mësimin e helenishtes me anë të shqipes.

Me ardhjen e Kavaliotit në krye të institucionit, u bënë hapa përpara në mendimin didaktik. Mësuesit e kësaj shkolle mësimin e zhvillonin në gjuhën greke. Në këtë shkollë, si rezultat i dëshirave të shumë forcave të interesuara për kulturën kombëtare, u shfaq dukuria e vendosjes së gjuhës shqipe. Kështu Grigor Voskopojari, një figurë e shquar e arsimit në Voskopojë, duke e shkruar shqipen me alfabetin e vet origjinal, shqipëroi Dhjatën e Vjetër dhe Dhjatën e Re, si tekst mësimor. Kavalioti, ky rektor dhe mësues ishte përfaqësues i mendimit filozofik përparimtar për kohën dhe shtron nevojën e edukimit mendor si bazë për zhvillim e përparimin e nxënësit në të gjitha fushat. Ai trajtoi mjaft probleme të teorisë së pedagogjisë, të rolit të edukatës duke i lidhur me shkallën e arsimimit të brezit të ri. Voskopoja bëhet fidanishte [93](Kraja, M. 1993, fq. 52) e atyre që i dhanë emër si: Grigor Voskopojari, përkthyes i një lënde në gjuhën shqipe, Kostë Cekani pedagog e filozof, zotërues i thellë i gjuhës shqipe, hartues i një Historie të Skënderbeut, botuar në greqisht më 1812, Joasaf Gonde, Kostandin Duka, Dhanil Voskopojari, Kostë Berati etj. Daniel Voskopojari botoi tekste që përfshinin gjithë përmbajtjen e shkollës. Më 1802 ai përgatit tekstin "Mësime fillestare…" ku veç shënimeve në formë bisede mes mësuesit e nxënësit, shpjegimeve nga fusha të ndryshme, ka edhe këshilla për nxënësin, vjersha e kallëzime në greqisht, rumanisht, bullgarisht dhe shqip, me afro 1000 fjalë.

Shumë të dhëna flasin se mësuesit në këtë Akademi punuan me shumë pasion dhe këmbëngulje duke përgatitur një plejadë të tërë nxënësish që shërbyen brenda vendit, dhe një pjesë e tyre vazhduan studimet edhe në Evropë.

Kostë Berati e thellon punën si lëvrues i shqipes në pamje të mësimdhënësit dhe të autorit të punimeve. Nga ky ka mbetur dorëshkrim një libër mësimi prej 52 faqesh. Libri ka dy fjalorthë shqip-greqisht, përkthime nga ungjilli, lutje, shqipërimin e një vjershe fetare, etj. Këtu shohim përpjekje për të futur shqipen në shërbesat fetare, sidomos në shkollë. Nxënësit që kryenin studimet në këtë "Akademi" dalloheshin për kulturë të gjerë e aftësi praktike në tregti e zejtari. Këtu u shkollua edhe Teodor Haxhifilipi (Dhaskal Todhri) nga Elbasani.[94] (Dedej, S 2001, fq. 20). Një rol të rëndësishëm ka luajtur shtypshkronja e cila u soll nga Venediku duke u cilësuar "*ndër të parat në Ballkan*"[95] (Adhami, S, 1989, fq. 67). Kompleksi arsimor-kulturor i Voskopojës zë vend të rëndësishëm në historinë e shkollës shqiptare pasi shërbeu si një vatër e rëndësishme në formimin e kuadrove me kulturë të gjerë për kohën, krijoi një traditë kulture që mbijetoi nëpërmjet nxënësve që përgatiti, të cilët kontribuuan si pararendës të Rilindjes sonë kombëtare.

92 Rexhepagiq, J (1970) *"Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918",* Prishtinë, fq. 72.
93 Kraja, M (1993) *"Mësuesit për kombin shqiptar",* Tiranë, 1993, fq. 52.
94 Dedej, S (2001*) "Arsimi dhe mendimi pedagogjik në Mesjetë*", fq. 20.
95 Adhami, S (1989) "Voskopoja në shekullin e lulëzimit të saj", Tiranë.

2.6.2 Kompleksi arsimor-kulturor i pashallëkut të Bushatllinjve në Shkodër

Ardhja në fuqi e Bushatllinjve më 1757 dhe qëndrimi i tyre për gati treçerek shekulli në krye të pashallëkut të Shkodrës, u shoqërua me një varg dukurish të reja shoqërore e kulturore në territoret ku shtrihej pushteti i tyre. Është koha ku mjedisi shqiptar shprehte kërkesa politike që synonin shkëputjen nga varësia e Stambollit. Bushatllinjtë kanë qenë nismëtarë të suksesshëm në disa drejtime, si për ndërtimin e objekteve të kultit, për hapjen e medreseve, për krijimin e bibliotekave, për funksionimin e konvikteve, për gjallërimin e jetës kulturore, për zbatim veprash monumentale e për realizimin e tolerancës ndërfetare. Mehmet Pashë Plaku kishte një vizion modern për ndërtimin e objekteve të kultit, të një xhamie (bëhet fjalë për Xhaminë e Plumbit në lagjen Tabakë, të cilën e ndërtoi më 1773, që krahas të qenit model për ndërtime të tilla në të ardhmen, krahas të qenit ndërtesa më e vjetër dhe më e bukur në qytet dhe njëkohësisht një ndërtesë madhështore nga pikëpamja artistike, krahas tërheqjes së besimtarëve për rritet e të falurit, ajo ka shërbyer si ushtrimore e medresesë e ka impresionuar vizituesit si një tempull vezullues)[96] (Luli, F. 2002, fq. 89-90)

Hapja e medresesë së Qafës në gjysmën e dytë të shekullit XVIII nga Mehmet pashë Plaku dhe më vonë asaj të Pazarit nga Kara Mahmut Pasha janë shprehje e kujdesit të tyre, që krahas synimeve fetare të realizoheshin edhe ato arsimore-kulturore për të përgatitur kuadro që t'u shërbenin proceseve ekonomike e shoqërore, politike e atdhetare. Këto shkolla ishin në rang arsimi të mesëm. Programet e tyre qenë cilësisht të mira, përmbanin lëndë fetare e për shkencat shoqërore dhe natyrore, gjuhë të huaja të lindjes e të perëndimit, përgatitnin hoxhë, mësues e nëpunës për administratën shqiptare të kohës e të mëvonshme dhe studentë për shkollat e larta jashtë vendit. Këto shkolla fituan opinion pozitiv, sepse gradualisht nxënësit u drejtuan dhe u mësuan nga drejtorë e mësues shqiptarë, me programe e tekste në gjuhën shqipe [97] (Luli, F. 2002, 89-90).

Për të rritur lëvizjen e fuqishme kulturore për të krijuar hapësirën e nevojshme për bazat e diturisë, për të mënjanuar errësirën e për të sjellë dritën, Bushatllinjtë ndërmorën një nismë të fuqishme të tipit shtetëror, hapjen e bibliotekës nga fundi i shekullit të XVIII. Ky qe një moment tepër i rëndësishëm, ku anëtarësoheshin nxënësit, mësuesit, hoxhallarët, nëpunësit, studiuesit e krijuesit, duke e kthyer atë në një qendër të fuqishme të shfrytëzimit të literaturës. Ndërtesa ishte e veçantë, ndër më të vjetrat e vendit tonë, me dhoma e anekse të përshtatshme. Ajo përmbante mijëra libra që u sollën nga bota në gjuhë të ndryshme si turqisht, arabisht, persisht, frëngjisht, etj. 3000 libra ishin me karakter teologjik, ndërsa shumë të tjerë shkencorë si për fizikën, matematikën, gjeometrinë, filozofinë, astronominë, historinë, letërsinë, etj.,që ishin të rrallë edhe nga vende të përparuara. Biblioteka kishte vulën e vet e në disa raste edhe atë të Kara Mahmud Pashës, kishte kujdestarë dhe punonte në bazë të një rregulloreje. Në bibliotekë praktikohej kopjimi i librave me dorë dhe shfrytëzimi i tyre në formë të tillë, në mungesë të origjinalit. Ngritja e bibliotekës është e lidhur me emrin e Mustafa pashë Bushatit (sundoi në vitet1812-1831). Ilo Mitkë Qafëzezi shkruan ndër të tjera se Mustafa pasha (zotërues i shumë gjuhëve të huaja), "*ka pasur në sarajet e tij në Shkodër një bibliotekë të madhe*[98] "(Qafëzezi, I.M., 1936, fq. 126-127). Biblioteka përfshinte

96 Luli, L (2002) *"Kontributi shpirtëror e kulturor i Bushatlinjve",* Kumtari 8, Shkodër, fq. 89-90.
97 Po aty.
98 Qafëzezi, I. M.,(1936), *"Daskal Gjoka apo Shkolla Korçare e qëmoçme. Vjetët 1826-1830. Një histori të pedagogjisë dhe të kulturës në Shqipëri, 1637-1902*)", Korçë, fq. 126-127.

libra dhe dorëshkrime kryesisht në gjuhët e lindjes: arabisht, persisht, osmanisht dhe në gjuhë të tjera pa përjashtuar përpjekjet e para në gjuhën shqipe.[99]

D. Erkharti na sjell një pohim me vlerë: "Mustafa pasha kishte hapur në Shkodër bibliotekën publike, shumë të vlefshme, ku çdo njeri mund të huazonte libra, duke lënë kërkesën e tij për to" (Urquhart, 1839)[100].

Për t'iu kundërvënë politikës arsimore të Portës së Lartë, për t'u ardhur në ndihmë nxënësve, për të përfshirë sa më shumë nxënës nga qyteti, fshati, malësia e zona të pashallëkut, u hap konvikti. Ky nuk qe thjesht institucion grumbullimi, por edhe edukimi me personel të veçantë edukativ. Xhamia, medreseja, biblioteka e konvikti, me sheshin në mes e pranë tyre një pus me ujë të pijshëm, përbënin një ansambël harmonik në shërbim të njëri-tjetrit, një provë e interesimit e kujdesit të dinastisë së Bushatllinjve për fenë, arsimin e kulturën. Këto medrese u bënë vatra dijeje, kulture, edukim, progresi e patriotizmi. Ndër këto qenë mësues dhe nxënës si Jusuf Tabaku, Daut Boriçi, Salih Efendia i Madh, Myrteza Efendi Shoshi, Selman Efendi Fakja, Sheh Shamia, Salih Efendi Hylja, Selim Efendi Çoba, Hafiz Halit Bushati, Hafiz Ali Ulqinaku, Hafiz Sabri Beg Bushati, Hafiz Ibrahim Repishti etj. Janë këto personalitete të shquara që hartuan e firmosën memorandume për pavarësinë e vendit, që drejtuan degën e Lidhjes shqiptare të Prizrenit për Shkodrën, që shkruan dhe hartuan abetare, gramatika, mevlude e fjalorë dhe krijuan poezi në gjuhën shqipe, që luftuan jo vetëm me penë, por edhe me armë për mbrojtjen e vendit, që përfaqësuan Shkodrën në kuvende e parlament si deputetë e senatorë, që qenë myftinj të aftë e të nderuar. Bushatllinjtë kanë dhënë një kontribut të çmuar, të gjithanshëm, të vazhdueshëm e cilësor për formimin shpirtëror e kulturor të bashkërenditur me atë atdhetar për traditat dhe lavdinë e meritуar të Shkodrës.

Kompleksi mbahej e administrohej nga fondet e administratës vendase dhe *"nuk vareshin nga administrata e osmane e sulltanit"*[101] (Koliqi, H, 2012, fq. 125). Bushatllinjtë dhe vezirët që e pasuan, menduan të siguronin mbarëvajtjen e tyre përmes vakëfeve të lëna, si: dyqane, troje, prona agrare të përjetshme që me të ardhurat e tyre të jetonin e të ushqeheshin myderrizët, mësuesit dhe studentët konviktorë, të bliheshin libra dhe në rast nevoje edhe të riparoheshin ndërtesat e dëmtuara.

Më 1775 u hap një shkollë fillore në Sheldi, një fshat pranë Shkodrës, me mësues D. Nikollë Kançi, ish mësues i Dajçit. Kançi kishte 4 nxënës dhe ishte i kënaqur me ta. Më 1778 thuhet: *"Shtëpia e famullisë , e ndërtuar ngjitur me shkollën duke shpenzuar ipeshkvi me klerin dhe tregtarët e Shkodrës 14000 aspra, të tjerë bamirës 9000 aspra...shkolla e ndarë përgjysmë me shkollarët që mësojnë "Participus"*. Mësues D. Nikollë Kançi nxanës i Propagandës Fide, si famullitar dhe si mësues tre vjet, vjeç 29 (përmenden edhe orenditë shkollore). Mësuesi kishte provizion 50 skuta, gjysmën për vete, gjysmën për nxënës(ushqim, etj.)[102] (Çefa, K 2013, fq. 113)

Më 1778 për lagjet Palorto e Varosh në Gjirokastër për të mbajtur në këmbë çerdhet e arsimit gjirokastrit, patriotët e mërguar depozituan në bankat e Vjenës shuma të mëdha të hollash, ndërsa Dhimitër Polizoi la në Rumani një shumë të hollash për arsimin.

"Në vitin 1830 filluan të funksiononin shkollat private katolike, që nën presionin e

99 Osmani, Sh. (1994) *"Kompleksi mësimor kulturor i Pashallëkut të Bushatllinjve të Shkodrës"*, Seminari i parë ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", Shkodër, 1994, fq. 337.
100 Urquhart, D. (1839*)"The Spirit of the east"*, vol II, second edition , kap XXI, London, fq. 310.
101 Koliqi, H. (2012)," *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar"*, Prishtinë, fq. 125.
102 Çefa, K (2013) artikull i cituar.

"Kapitolacioneve" turqit detyroheshin t'i lejonin, kështu që elementi katolik i Shkodrës pati mundësi më të mëdha shkollimi dhe të një kontakti më të madh me gjuhën e shkruar shqipe."[103] (Luli, F., et al. 1997, fq. 84-85)

"*Shkollat private shqipe kishin traditë të mirë sidomos në Shkodër si nga numri, ashtu nga llojshmëria dhe kohëzgjatja e tyre*"[104](Koliqi H, 2012, fq. 150) Nga viti 1800 deri më 1861 numëroheshin 12 shkolla të tilla, 8 për djem e katër për vajza[105]. "*Mjetet ishin të vogla e primitive, prandaj nuk asht për t'u shikjue gjith aq përparimi e dobia, qi xirj prej sosh, sa inicjativa, hapi heroik, zelli për të hapun të kulturës. Një mësues përfaqësonte nji shkollë në vedi. Prindt mezi qi pritshin me i çue fmit e vet në shkollë, bile u zotnoshin me pague edhe mësuesin"(*Kurti,D1935, fq.11)[106]

Shkolla e Gegë Kodhelit

Gegë Kodheli (me mbiemër Bushiqi) numërohet si një nga të parët mësues në Shkodër që u jepte mësim fëmijëve në gjuhën shqipe. Ishte shkolluar në Venedik dhe thuhej për të *"se i dinte mësimet ujë"*[107] Ai hapi një shkollë fillore në banesën e Simon Marangonit në lagjen Sarreq, të qytetit të Shkodrës, më 1830. Fëmijët qëndronin në shkollë gjatë gjithë ditës. Fëmijëve u mësonte pak italisht, shkrim, këndim e numëratore dhe ata i paguanin mësuesit 2-4 grosh në muaj dhe dimrit sillnin qymyr për ngrohje. Mësimin e zhvillonte në gjuhën shqipe. Sipas të dhënave kjo shkollë frekuentohej nga 40-50 fëmijë. Fëmijët që shkonin në shkollën e Kodhelit merrnin me vete bukën e drekës, hanin bashkë me mësuesin, në dimër në klasë, pranë vatrës dhe në verë, në oborrin e shkollës. Mësuesi u tregonte fëmijëve përralla, të cilët duke i përsëritur i mësonin ato[108] (Gurakuqi, K. 1928, fq. 90)

Shkolla e Gjon Shkrumit

Nuk dihet me saktësi nëse ai hapi shkollën njëherësh me Geg Kodhelin, apo erdhi pas tij. Ishte bir tregtari. Studioi në Venedik në një shkollë tregtare dhe kur u kthye në atdhe hapi një shkollë fillore në shtëpinë e tij. Si banka shërbenin disa arka të vogla të cilat nxënësit i sillnin nga shtëpitë e tyre, e për tu ulur përdornin copa qilimi, apo shilte të vogla, sipas shtresës. Gjoni u mësonte fëmijëve shkrim dhe këndim në gjuhën shqipe dhe prindërit i paguanin "3 grosh në muaj"[109] (Rev. Përparimi, fq. 115). Abecenë shqipe nxënësve ua mësonte përmes një mjeti – karton të varur në mur.

Shkolla e Zef Kamsit

Zef Kamsi ishte shkodran, nga familja arsimdashëse e njohur e Kamsejve. Nuk dihet se kur e hapi shkollën. Ishte nxënës i Dom Pal Ramadanit, i përmendur si prift popullor.

103 Luli, F. Dizdari. I, Bushati,N.(1997) *"Në kujtim të brezave",* Shkodër, fq. 84-85.
104 Koliqi, H (2012) *"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar"*, Prishtinë.
105 ASHSH, FESH, (Botim i ri) zëri i hartuar nga H. Koliqi dhe Nj. Kazazi, Tiranë, 2009, Vëll. III, fq. 2491
106 Kurti,D. (1935) O.F.M.*"Vepra kulturale e elementit katolik në Shqipëri",* Shkodër, fq. 11
107 *"Do mësuesa t'hershëm në Shkodër*", Revista "Përparimi", 1915, nr 2, fq. 113
108 Gurakuqi, K (1928*),"Françeskanët në Shqypni",* "Dituria", nr. 3 dhe Shejzat (1995), nr 1-2
109 *"Do mësuesa t'hershëm në Shkodër*", Revista "Përparimi", 1915, nr 2, fq. 115

Ishte njeri i ditur sa pleqtë thoshin për të "Paça dijen e tij.."(Rev. Përparimi)[110] dhe zotëronte mjaft mirë italishten. Fëmijëve u mësonte italisht, i mësonte mirë, por ishte i rreptë dhe i ndëshkonte fëmijët duke përdorur të njëjtat ndëshkime që përdornin hoxhallarët e mejtepit. Për një fëmijë merrte 10 grosh në muaj (Kraja,M 1993, fq. 138)[111]. Kur u plak nuk punoi më në shkollë, por filloi një punë tjetër.

Shkolla e Shor Markes

Një mësues me origjinë italiane, ishte edhe Shor Markja, emri i vërtetë i të cilit ishte signor Marko Rrebeskini (shkolla e tij rezulton në të njëjtën kohë me atë të Jak Specit). Në shkollën e tij fëmijët mësonin përralla dhe pak italisht. Kërkonte shumë nga fëmijët, ishte i rreptë me ata që nuk mësonin. Shpesh i ndalonte nxënësit edhe pas mësimit. Në shkollën e tij fëmijët paguanin 10 grosh në muaj, por pa qymyr në dimër. Shkolla e tij qëndroi e hapur për 8-9 vjet.

Shkolla e Jak Specit

Kjo shkollë u hap në lagjen Sarreq të qytetit të Shkodrës, kundrejt oborrit të katedrales, në dhomën e një jerevije, përballë Kishës së Madhe. Mësues i kësaj shkolle qe *Jaku i Tushit të Mark Krajës* ose Jak Speci siç e njihte populli. Kjo nofkë "Speci" i mbeti ngaqë ishte shumë i rreptë dhe i ashpër me fëmijët. Që më 1850-1860, ai kishte grumbulluar më shumë se 30 nxënës, të cilët në një dhomë përdhese mësonin shkrim, këndim e numeratorin në gjuhën shqipe duke përdorur në vend të bankave dërrasa të gjata që shtriheshin në lartësinë e gjurit. Edhe mësuesi përpara vetes kishte një bankë të gjatë 1 metër dhe 40 cm të lartë. Rrinte këmbëkryq mbi një qilim. Sipër "tryezës" së tij kishte një kupë qelqi për bojën, ndonjë letër dhe "abetaren". Si shkolla ashtu dhe mësuesi mbahej nga vetë populli. Çdo nxënës paguante 10 grosh në muaj dhe në stinën e dimrit, kur bënte ftohtë, gjysmë oke qymyr në ditë. Si mjete shkrimi si mësuesi dhe nxënësit përdornin pupla pate dhe bojë[112](Osmani, Sh. 1963, fq. 42) Çdo nxënës kishte një abetare, një kartelë (fletore, shënimi im E. Bilali), një pupël dhe një shishe me bojë, të cilat i përdorte në shkollë e në shtëpi. Mësimet jepeshin në gjuhën shqipe, por fëmijëve u mësonte edhe italisht[113](Osmani, Sh. 1963,fq. 46). Edhe I. M. Qafëzezi na jep këtë informacion: *"Përveç shqipes Jaku u mësonte fëmijëve edhe një gjuhë të dytë, sepse konsullata e Austrisë në Shkodër i jepte 15 napolona në vit"*[114](Qafëzezi, I, M , 1936, fq. 131). *"Në kartelat (fletoret) e nxënësve shkruante emrat "Mark, Mati, Ndokë, Rrok, Gjin e Gjokë e fëmija mandej u shkonin sipër me pupul"*[115](Shtjefni, K 1997, fq. 44) Fëmijët i merrnin me vete çdo ditë librat, fletoret dhe shishet e bojës. Ata qëndronin në shkollë para dhe pasdite, kështu që merrnin me vete edhe ushqimin për drekë. Disiplina në shkollë ishte e rreptë, madje përdoreshin edhe ndëshkimet fizike. Një pjesë e nxënësve që ishin të pasur i çonin mësuesit kush raki, kush verë, kush llokum, pse prindërit quanin mësuesin baba të dytë të fëmijëve të tyre. Shpeshherë

110 Po aty, fq. 130
111 Musa Kraja, *"Mësuesit për kombin shqiptar",* Tiranë, 1993, fq. 138
112 Osmani, Sh (1963*)"Mësuesit dhe shkollat e para në Shkodër për gjuhën dhe lirinë kombëtare"* ,"Arsimi Popullor", Nr. 3
113 Po aty fq. 46
114 Qafëzezi I. M .(1936) *"Dhaskal Gjoka apo shkolla korçare e qëmoçme (me një histori të pedagogjisë e të kulturës në Shqipëri (1637-1902)",* Korçë
115 Shtjefni, K (1997) *"Shkodra në shënimet e mia"*, Bot impekx, Shkodër, fq. 44

organizonte shëtitje për fëmijët jashtë qytetit, zakonisht te çinari i Zef Zorbës. Aty u shpjegonte në natyrë kodrat, malet e fushat e Shkodrës. Këto i quante mësime të hapura gjeografie. Nxënësit dilnin nga "shkolla" duke kënduar këngë shkodrane.

Shkolla e Gjergj Benussit

Jetën më të gjatë, më të rregullt, me një përmbajtje didaktike, e pati shkolla që hapi Gjergj Benusi më 1836, fillimisht në gjuhën italiane e më pas në gjuhën shqipe. Gjergji ka qenë nënshtetas i huaj, nga Rivognio d'Istrias që ndodhet pranë qytetit të Triestes në Itali. E përkohshmja "Përparimi", në qershor të vitit 1915, duke shkruar mbi "Do mësues të hershëm në Shkodër", në mes të tjerash shkruan: *"Deri atëherë s'ishte kenë asnji shkollë ma e rregullueme e me nji farë metode didaktike si jo qi kje çilë prej Gjergj Benusit"*.

Më pas shkollën e vijoi i biri, Gaspri (1850-1931): " *...vijon zejën e tet, tue mbajtë për 12 vjet rresht një shkollë private shqipe në shtëpinë e vet..."*[116]. Në këtë shkollë mësonin fëmijë të moshave të ndryshme, por të ndarë në klasa të veçanta. Për nxënësit nuk kishte libra, por ata punonin me fletore. Njihej si mësues të mirë. Gaspri ka dhënë një kontribut të çmuar në botimin e dy abetareve dhe " Sccibptari i msuem n'ghiuh t'vet"(1890) me alfabetin e shkodranishtes së vjetër. Në vitin 1897 e riboton me disa përmirësime. Në këtë vepër lartëson bukurinë e gjuhës shqipe dhe cilësohet si një libër i nevojshëm për shkolla e popull.

Këto qendra mësimore të ngritura në lagje të ndryshme të qytetit, zhvilluan një veprimtari të kufizuar, si për shkak të ndjekjeve të autoriteteve osmane të pushtimit[117] (Prendushi, M. 1974, fq. 66-67) ashtu dhe për shkak të kushteve jo të mira materiale e nivelit të ulët të tyre. Ato i zhvillonin mësimet më tepër fshehurazi, kishin programe të ngushta mësimore dhe frekuentoheshin nga një numër i kufizuar nxënësish. Megjithatë, rëndësia e këtyre qendrave mësimore është e madhe, sepse ato shprehnin dëshirën e përpjekjet e popullit e të patriotëve për arsim dhe kulturë, dhe u bënë vatrat e para për përhapjen e shkrimit e të leximit, sidomos në gjuhën amtare, si dhe të njohurive elementare.

Këto "qendra mësimore" qëndruan të hapura privatisht deri në vitin 1855, vit në të cilin tregtarët shkodranë dhe kleri i lartë, duke parë që mësuesit nuk plotësonin kërkesat e kohës, me ndërmjetësinë e konsullit thirrën nga jashtë mësues të huaj, që filluan nga puna në vitin shkollor 1855-1856. Më 1855, Ipeshkvi mbante në qytet një shkollë fillore me mësues civilë. Mësuesit i zgjidhte vetë Ipeshkvi, i paguante me 1200 fjorinta, që i jepte Austria[118]. . *"...Tue qenë se nxanësit e shkollës së Gjergj Benusit u shtuen tepër...u pa nevoja, në vitin 1856, më thirrë dhe mësues të tjerë nga jashtë... Shkodranët çuen e muerën këta tre mësues Mark Rebeskinin, Gjuriqin, Luigj Katraniqin dhe, bashkë me Gjergj Benussin që gjendej në Shkodër, hapën një shkollë me katër klasë...Disa shkodranë dhanë 40 napolona, por meqenëse kjo shumë nuk mjaftonte, është qeveria austriake që mori përsipër pagesën e rrogave të mësuesve. Kjo shkollë nuk pat jetë të gjatë, pse tre mësuesit e parë u mërzitën dhe shkuen ndër vendet e veta, tue mbetë prap vetëm Gjergj Benussi, i cili kishte nxanë shqip dhe ishte ba gjymës shkodran, mbasi emni i tij ishte lidhë me fatin e qytetasve"*[119].

116 Dituria: "*Gjergj Benussi*", vol.III-Janar 1928, Nr.3, fq. 90
117 Prendushi, M. (1974) *"Vështrim historik mbi zhvillimin e arsimit në Shkodrën e shekullit XIX"*, "Studime historike", Nr. 3, fq. 66-67
118 Kurti, D.(1993) "*Shkolla françeskane"*, Kumbona e së diellës, Shkodër, 7 (13), fq. 18
119 Dituria: "Gjergj Benussi", vol. III-Janar 1928, Nr. 3, fq. 90

Duke parë gjendjen e këtyre shkollave të hershme, Emzot Topiç *(peshkop i Shkodrës, shënimi im E.B)* si dhe nga dëshira për të sjellë françeskanët në Shkodër, më 1857 në letrën që i dërgon Kryetarit të përgjithshëm të françeskanëve në Romë krahas të tjerave ai do ti shkruante"...*Për sa u përket mjeteve për përmbajtjen e kësaj mungadje, përveç ndihmës që do të kishin françeskanët nga banorët katholikë, do të mujshin me marrë përsipër edhe mësimin e kalamajvet. Për këtë qëllim kam nxjerrë nji ndihmë të përvitshme prej 1200 florintash nga Madhnija Apostolike mbretnore dhe rregjinore*".[120]

Po mësimi ku do të zhvillohej?

Më 1855 françeskanët përdorën 2 dhoma të një ndërtese që populli i Shkodrës u kishte falur françeskanëve, në lagjen Gjuhadol ndërtesë që ata e përdornin për banesë kur zbritnin nga malet në qytet[121]. Kështu u çel shkolla e drejtuar nga etërit françeskanë. Përparimet ishin të mëdha. Në raportin që Konsullata Austriake në Shkodër i dërgonte Ministrisë së saj më 4 korrik 1863, e informonte pikërisht për shkollën që populli i quajti "Shkolla Fretnore". Në të shkruhej: "*Ç' prej vjetit 1855 gjindet në Shkodër një shkollë fillore. Kjo mâ përpara drejtohej prej mësuesvet civilë, por pastaj u pá nevoja e mësuesvet prej Misionarvet Françeskanë. Mësimi në këtë shkollë âsht ndam në katër klasë dhe mësohen këto lândë: Besim, Aritmetikë, Kaligrafi dhe Elementet e para të gramatikës italishte. Ky insitut âsht i ndihmuem prej misis së qeverisë s'onë auguste me 1260 florinta të vakutës austriake, ashtu edhe prej Shoqnis bâmirse fetare. "Të Zânunt të pafajshëm të Zojës". Prej këtyre ndihmavet dalin shpenzimet për shpenzimet e banesën e mësuesvet. Përpara dy muejvet, i nënshkruemi qe grishë në provimet e nxânsvet, ashtu edhe në dhânjen e çmimevet, që u ndan nga Emzot Çuçija, episkopi i Shkodrës"*[122]. Provimet bëheshin publikisht dhe provimi i besimit (katekizmi) jepej në gjuhën shqipe. Më 1867, si rezultat i ecurisë së mbarë të kësaj shkolle Emzot Pooten *(Kryepeshkop, në vend të Emzot Çurçisë, shënimi im E.B),* e pa të nevojshme shtimin e mësuesve, prandaj kërkoi që ndihma me 1260 florinta të shtohej deri 1560 florinta në vit me qëllim që të sigurohej rroga për edhe një mësues të katërt, pasi nxënësit shtoheshin çdo ditë. Kjo kërkesë u pranua sidomos sepse u mbështet nga ana e konsullatës austriake në Shkodër. Duhet të theksojmë se "*... nga shuma e mësipërme 600 florinta i mbanin fretnit, ndërsa pjesa tjetër i jepej shkollës së Gjergj Benusit e dy zojushat shkodrane, të cilat mbanin një shkollë për punë dore për vajzat e qytetit"*[123].

Sa më shumë koha kalonte, aq më shumë rritej numri i nxënësve. Për këtë qëllim doli nevoja e shtimit të personelit mësimdhënës si dhe e zhvendosjes së shkollës në një ndërtesë më të përshtatshme. Përsëri qeveria Austriake iu përgjigj kërkesës për ndihmë. Ajo dha 3000 florinta[124] në vitin 1876. Si rezultat i ndihmave të siguruara, pa harruar kontributin e shkodranëve, shkolla u ndërtua e më 1877 françeskanët u shpërngulën në ndërtesën e re. Shkolla shënoi përparime si për sa i përket zhvillimit të mësimit, në ndjekjen me rregull të saj nga nxënësit, po ashtu edhe për shtimin e numrit të tyre. Si rezultat i këtyre arritjeve përsëri ka kërkesa për zgjerim të ndërtesës. Gjithçka u realizua në një kohë të shkurtër, madje u ndërtua edhe një sallon që do përdorej si teatër ku nxënësit do të paraqitnin shfaqje të ndryshme. Më 1899, u përpiluan programe të thjeshta, lëndë të reja, mjetet mësimore, u shtuan klasat, salloni u zgjerua e në oborrin e shkollës më 1901 u ndërtua një strehë ku nxënësit të dëfreheshin në ditët me shi.

120 Dituria: *"Françeskanët në Shqipëri"*,vëll. 3, nr. 3, Tiranë, 1927, fq. 90
121 Arkivi i Françeskan në Shkodër
122 Arkivi Françeskan në Shkodër
123 Artikull i cituar, Dituria, fq. 93.
124 Arkivi Ipeshkvor i Shkodrës

Kështu punoi kjo shkollë deri më 1902 kur në krye të këtij institucioni do të vinte At Gjergj Fishta. Me ardhjen e Fishtës kjo shkollë përdori gjuhën shqipe si gjuhë mësimi në të gjitha lëndët. Ai do ti jepte një frymë tjetër shkollës, atë kombëtare. Një bashkëkohës për këtë ngjarje shkruan: *"At Gjergji jo vetëm shkroi, por edhe punoi për edukatën kombëtare. Më madhja vepër e tija në këtë pikëpamje asht kur...shtje gjuhën shqipe si gjuhë mësimi...Do ditë se ky hap n'at kohë faqe qeverisë ishte guxim, faqe zotnive shkodranë-ishte utopi për mos me thën tjetër; e faqe rretheve të tjera ma të nalta e ma të ulta shikohej jo vetëm me një farë skepticizmi e me sy të shtrembtë, por gadi gadi si i rrezikshëm*"[125]Nën drejtimin e tij shkolla mori një drejtim ndryshe. U hoq gjuha italiane. Përveç klasave fillore u shtuan klasat qytetëse, sipas programit të shkollave austriake. Një gjallëri të veçantë iu dha shfaqjeve teatrore, në të cilat merrte pjesë edhe popullsia me qëllim ngjalljen e ndjenjave kombëtare. Numri i nxënësve arriti deri në 300. Në vitin 1909, Porta e Lartë, me një shkresë të veçantë, e njohu zyrtarisht shkollën shqipe françeskane. U afruan edhe mësues civilë, ndër të cilët edhe Mati Logoreci e Gaspër Beltoja. Më vonë u aktivizuan edhe mësues të tjerë si Gaspër Mikeli, Ndue Paluca, Kolë Margjini etj., të cilët kishin marrë përgatitjen e duhur në shkollat e larta austriake. Si rezultat i veprimtarisë së tyre të gjithanshme, shkolla, për kohën, barazohej me shkollat më të mira të Austrisë. (Shllaku, L. 2002, fq. 102).

Më 1902 shkolla punoi me një plan mësimor për 6 klasat si vijon[126]:

Nr.	LËNDËT	KLASA/ORË					
		I	II	III	IV	V	VI
1.	Besim	2	2	2	2	2	2
2.	Lexim e shkrim	6	6	6	5	4	3
3.	Gjuhë mësimi	6	7	5	5	6	5
4.	Aritmetikë e gjeometri	5	4	4	4	4	4
5.	Histori e natyrës e fizikë	-	-	1	2	2	3
6.	Gjeografi e histori	-	-	1	2	2	2
7.	Vizatim	1	1	1	1	1	1
8.	Këngë e gjimnastikë	4/2	4/2	4/2	4/2	4/2	4/2
	Shuma	22	22	23	24	24	24

Tabela 2. *Plani mësimor për 6 klasa me të cilat punonte shkolla në vitin 1902.*

Në vitin 1909 Fishta u shton tre klasave fillore dhe tri plotoreve edhe tri qytetëse.

Më 24 mars 1912, këtë shkollë e viziton Ministri i Punëve të Brendshme të Turqisë, i cili lavdëroi për punën e mirë si mësuesit dhe nxënësit. Valiu i qytetit dhe komandanti i ushtrisë shpesh dhanë edhe të holla për të ndihmuar nxënësit e varfër të kësaj shkolle.[127](Gurakuqi, K 1928, fq. 95)

Një rol të rëndësishëm ka luajtur biblioteka e themeluar më 15 shkurt 1907 nga At

125 MPSH, D.1/5, dok.742
126 Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, dosje 1/15, dok. 752
127 Gurakuqi, K (1928) "*Françeskanët në Shqipëri",* Diturija, nr. 3, vëll 3, fq. 95

Gjergj Fishta dhe At Shtjefen Gjeçovi me bibliotekar Serafin Mazrekun, duke pasur dhuratë edhe nga konsulli i Austro-Hungarisë 58 vepra shqip dhe 16 gjermanisht.[128] (Kola, Gj. 1941, fq. 133)

Numri i vëllimeve në vitin 1942, arrinte në 15 mijë. Ajo ndahej në dy seksione, në atë të albanologjisë dhe në të dytin me shumë vepra të rëndësishme për kohën. Kjo e bënte bibliotekën françeskane pa dyshim, një ndër bibliotekat më të mira të Shqipërisë.[129] (Shllaku, L. 2002, fq. 153) Fishta luajti një rol të rëndësishëm jo vetëm në krijimin por edhe pasurimin e bibliotekës duke nxitur kërkimet dhe zbulimet në bibliotekat e kuvendeve, komunave e sidomos në arkivat e Propaganda Fide-s dhe të Vatikanit për zbulimin e qindra dorëshkrimeve, veprave dhe relacioneve që kanë lënë jo vetëm misionarët, por edhe vetë misionarët që shërbyen në Shqipëri. Fryt i këtij gjurmimi ishte sjellja në Shqipëri e fotokopjuar e veprës "Meshari" të Buzukut nga ana e Justin Rrotës, më 1929.[130] (Shllaku, L 2002, fq. 154)

2.6.3 Kolegji Saverian

Një grup prej 22 qytetarësh të parisë katolike të Shkodrës, më 1877, në një takim me drejtorin e financave të Vilajetit të Shkodrës, shtroi nevojën e hapjes së një shkolle të mesme në këtë qytet, por edhe shqetësimin për mungesën e mjeteve. Me ndihmën e disa qytetarëve shkodranë fillimisht u mblodhën 500 napolona. Edhe At Luigj Mazza, S.J., në atë kohë mësues i ri, dhuroi nga pasuria e tij për këtë shkollë 1100 napolona ar. Kështu, më 17 tetor 1877 në kishën e vogël të jezuitëve u mblodhën qytetarë shkodranë, familjet e 30 nxënësve të parë të kësaj shkolle dhe At Zef Lombardini, u paraqiti pjesëmarrësve institutin e ri *"...i cili shpresohej se do të delte për nder e dobi të qytetit"*[131]*(1928, fq. 9)*. Shkolla u quajt Kolegja Saveriane e Jezuitëve që rreth vitit 1888 mund të quhej një gjimnaz i vërtetë.[132] (Kamsi, V. 2008, fq. 1208). Gjatë jetës së tij ka pasur profile të ndryshme reale, teknike, normale, tregtare dhe gjithnjë duke ruajtur deri diku profilin e gjimnazit klasik.

Në vitet e para (1878-1881) zv/rektor i parë i kësaj shkolle ishte At Luigj Mazza. Për mbarëvajtjen e punës në shkollë u formua gjithashtu një komision përgjegjës me 7 anëtarë, njerëz të njohur të qytetit. Në vitet 1889-1893 rektor i saj ishte At Luigj Mazza. Një kontribut të shquar për mbarëvajtjen e kësaj shkolle e ka dhënë edhe Austro-Hungaria, e cila më 1888 i akordoi një subvencion prej 4000 frangash në vit, që më vonë u shtuan. Mësimet jepeshin falas, ndërkohë që vetëm në fillimet e saj nxënësit ishin të detyruar të paguanin një taksë shkollore. Pas vitit 1919 u subvencionua nga Italia. Sa ishte fondi nuk kemi pasur rast ta gjejmë.

Stema e Kolegjit përmbante një shqiponjë, e cila në mes kishte simbolet fetare, emblemën e Shkodrës dhe synimin "Për Zot, Për Atme e Përparim". Mësimet filluan me seriozitet jezuit: arsim i vërtetë, i plotë, i rregullt, kulturë e përgjithshme perëndimore,

128 Kola, Gj (1941) "*Shkolla shqipe françeskane e Gjergj Fishta"*, në "Gjergj Fishta", Tiranë
129 Shllaku, L (2002), "*Shkollat klerikale"(Vështrim historik nga fillimet deri më 1924)*, Shkodër, fq. 153
130 Po aty, fq. 154
131 Kolegja Saveriane ndër 50-vetët e para, Shkodër, 1928
132 ASHSH, FESH-2 Botim i ri(Grup autorësh), (2008)Tiranë, Vëll. II, Zëri është punuar nga Villy Kamsi

qytetërim i zgjedhur evropian, me programe të studiuara e të zgjedhura, me metoda të përparuara e efikase, me mjete moderne e të reja, pra një formim i gjithanshëm perëndimor. Pavarësisht drejtimeve herë tregtar, e herë klasik, gjithmonë qe e barasvlershme me shkollat më të mira të mesme të Evropës perëndimore.

Nga fillimet deri më 1914 shkolla kishte 6 klasë (tri klasë teknike dhe tri klasë tregtare, ose të larta), më 1914-1916 kishte 4 klasë (reale apo sendesh praktike) dhe 2 klasë tregtare me programet e mëparshme. Në vitet 1919- 1925 përbëhej nga 4 ose 6 klasë tregtare e normale me mësime pedagogjie. Në vitin 1926 ajo kishte kaluar në një gjimnaz modern, pra në një shkollë gjimnaziale-klasike.[133] Krahas *"trajtimit besimtar të nxënësve shkolla synonte formimin e gjithanshëm të nxënësve, edukimin mendor, moral, estetik e fizik"*[134](Shllaku, L. 2002, fq. 75)

Për të nxitur nxënësit në mësime dhe në arritjen e rezultateve në klasat e shkollës praktikohej ndarja e nxënësve në grupe, bëheshin provime publike e zhvilloheshin konkurse, fituesit e të cilëve nderoheshin para prindërve, nxënësve e qytetarëve, por edhe shoqëroheshin me dhurata të ndryshme[135]. (Kazazi, Nj. 2014, fq. 45)

Procesin mësimor e ndihmonin edhe ambientet shkollore, si kabinetet e fizikës e kimisë etj. si dhe biblioteka shumë e pasur e jezuitëve. Këtu gjendeshin veprat e autorëve tanë të vjetër, si Bardhit, Bogdanit, Budit dhe Gramatika e parë shqipe e F. M. Da Leçes, 1716, si thoshte Mjeda, e para gramatikë në Ballkan, pastaj letra të albanologëve të shquar si Hanit, Majerit, Joklit, Kamardes, etj si dhe dorëshkrime të mësuesve të gjuhës shqipe të kolegjit, si të Jungut, Xanonit, Mjedës, etj e dokumente me rëndësi, të cilat më vonë do të grabiten, do të digjen, do të zhduken. Në dispozicion të shkollës ishte edhe një shtypshkronjë, ndër më të vjetrat, ndoshta më e para në Shkodër, e themeluar më 1870, e cila botonte libra për nxënësit, revista e libra të ndryshëm, jo vetëm fetare, por edhe shkencore e letrare, ku librat shqip zinin vend të rëndësishëm. Sipas të dhënave të studiuesve që kemi mundur të sigurojmë, mësojmë se deri më 1928 në këtë shtypshkronjë u botuan rreth 412 libra shkollorë (mesatarisht 7-8 libra në vit), ndër të cilët mbi 16 gramatika, 1 fjalor, 5 libra literature, 19 libra shkencorë (kryesisht matematike), 6 libra historie e gjeografie, 34 libra këndimi e edukate, etj.[136] (1928, fq.43). Biblioteka kishte edhe 10 revista të huaja që vinin periodikisht. Pjesë e kësaj biblioteke ishte edhe ajo që quhej "biblioteka argëtimore" me rreth 300 vëllime.[137] (1928, fq. 27)

Në edukimin e nxënësve ka luajtur një rol të rëndësishëm muzeu shumë i pasur i shkollës. Muzeu kishte seksionet e etnografisë, të historisë së natyrës apo seksionin merceologjik. Interesant ishte seksioni numizmatik që përmblidhte rreth 1000 monedha të vjetra, të të gjitha kohërave dhe nga shumë vende. Monedhat shqiptare që përbënin një koleksion prej 33 copësh (epirote, të Durrësit, Drishtit, Shkodrës, Tivarit, Pojanit, etj, ishin krenaria e muzeut. Këto padyshim krijonin mundësinë që nxënësit të kuptonin lashtësinë e popullit, kulturën e tij, marrëdhëniet tregtare, luftërat me pushtuesit, përpjekjet për liri dhe për rrjedhojë ngjallnin krenari kombëtare. Veprimtaritë kulturore që zhvilloheshin në Kolegj, si dramat apo shfaqje të ndryshme kanë ndikuar në

133 " Kolegja Saveriane ndër 50-vjetët e para", Shkodër, 1928, fq. 11
134 Shllaku, L (2002) "*Shkollat klerikale. Vështrim historik nga fillimet deri më 1924"*, Shkodër, fq. 75
135 Kazazi, Nj (2014) *"Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër"* (Nga fillimet e tij deri në vitet '20 të shek. XX) Monografi, Shkodër, fq.45
136 "Kolegja Saveriane ndër 50-vjetët e para", (1928), Shkodër.
137 "Kolegja Saveriane ndër 50-vjetët e para", (1928), Shkodër.

edukimin estetik e veçanërisht atdhetar të nxënësve. Një inspektor i arsimit pas vizitës në këtë shkollë u shpreh se: *"...shkolla dhe muzeu janë ngritur për me kulturue filizat e shqiptarëve"*.[138]

Vend të veçantë zinin ushtrimet gjimnastikore, të cilat shoqëroheshin me piano, me shkopinj gjimnastikorë, me shirita shumëngjyrësh, me kurora lulesh e gjithmonë me flamurin kuq e zi të Skënderbeut.

Më poshtë po prezantojmë planin mësimor të kësaj shkolle[139]:

Nr.	LËNDËT	KLASA I	KLASA II	KLASA III	KLASA IV
		Tregtare	Tregtare	Tregtare	Tregtare
1.	Shqyp	5	5	5	5
2.	Italisht	3	3	3	3
3.	Frençezisht	2	2	2	2
4.	Histori dhe shkronjë	3	3	3	3
5.	Matematikë	3	3	3	3
6.	Shk. Natyrake	-	2	1	1
7.	Llogarim (kompusteri)	-	-	3	3
8.	Ravizë	2	2	2	2
9.	Bukurshkronjë	2	2	2	2
10.	Besim	2	2	2	2
11.	Edukatë qytetore	Të diel për të gjithë			
	Gjithsej orë	22	24	26	26

Tabela 3. *Plani mësimor i Kolegjit Saverian, Shkodër.*

Siç shihet edhe nga pasqyra shohim se lëndët shoqërore zënë një vend të konsiderueshëm (46-86%) , pastaj vijnë shkencat natyrore (8-30%), e pas tyre lëndët artistike (15-18%) të shumës totale të orëve që ishin në planin e tyre mësimor. Lënda e besimit zinte vetëm 4.1-9%, ose përqindjen më të ulët të orëve javore që shkonin nga 22-26.

Shkolla kishte edhe rregulloren e saj të veçantë ku përcaktoheshin puna mësimore dhe edukative me nxënësit, organizimi i jetës së brendshme të shkollës, masat disiplinore, provimet, etj. Mësimi zhvillohej paradreke dhe pasdreke. Shkolla ishte e hapur për të gjithë, pa dallime fetare.

Nga pikëpamja organizative, shkolla drejtohej nga rektori e zv/rektorët. Trupa mësimore përbëhej nga jezuitë dhe laikë, ndër të cilët Gaspër Bennusi, Gaspër Mikeli e të tjerë të cilët kishin qenë edhe nxënës të kësaj shkolle.[140] Mësuesit që dhanë mësim në këtë shkollë ishin me shkollë të lartë të kryer jashtë shtetit, të gjithë autorë tekstesh a veprash me karakter letrar, gjuhësor, historik, filozofik etj, të gjithë me një botë të

138 Kolegja Saveriane në 50 –vjetët. fq. 14
139 Programi i shkollave tregtare në Kolegjë të Sh. F. Saverit, Shkodër, 1921, fq. 5
140 "Kolegja Saveriane ndër 50-vjetët e para" (1928), Shkodër, fq. 77.

pasur shpirtërore e intelektuale, të gatshëm për të zhvilluar fuqitë mendore të nxënësve për një formim intelektual të shëndoshë, por edhe për emancipimin e jetës shoqërore e kulturore, si edhe për integrimin e shoqërisë shqiptare në Evropë.

Në këtë shkollë u shkolluan: Lazer Mjeda, fetar e atdhetar i flaktë, themelues i shoqërive letrare e botuese, mecenat e lëvrues i letrave shqipe; Bumçi, anëtar e pastaj kryetar i Dërgates shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris, senator i Shqipnisë; Doçi, luftëtar i idealeve të binomit Fe e Atdhe, politikan e diplomat, themelues i shoqërisë Bashkimi e autor krijimesh artistike; Konica, aristokrati elegant i letrave shqipe, stilisti i madh e djaloshi i jashtëzakonshëm, Gurakuqi, përfaqësuesi i politikës kombëtare, pionieri i qytetërimit evropian, pastaj nxënës të tjerë të shumtë që u bënë drejtues të administratës shqiptare. Kolegji Saverian mori një rëndësi të veçantë pasi aty u arsimuan nxënës jo vetëm të besimit katolik, por edhe nxënës të besimit mysliman dhe ortodoks. Deri në vitin 1928, në këtë shkollë u arsimuan edhe 159 nxënës të besimit mysliman dhe 99 nxënës të besimit ortodoks. Gjithashtu në kolegj mbajtën mësim edhe arsimtarë të besimit mysliman, jo vetëm mësime feje (islame), por edhe lëndë të tjera mësimore.[141] (Lika, Q 1998, fq. 242). Kujdesi që iu kushtua zhvillimit dhe përvetësimit të gjuhës shqipe, shfaqjet muzikore e teatrale të dhëna në rastin e ngjarjeve të rëndësishme kombëtare të atdheut, si shpallja e Pavarësisë, pjesët e ekzekutuar nga banda e shkollës ndër ceremoni e raste solemne, i shërbyen rritjes së patriotizmit në radhët e nxënësve.

Ndonëse në shumë studime për historinë e kësaj shkolle ka mbizotëruar mendimi se ajo *"ishte një shkollë fetare", "me horizont të kufizuar ngritur mbi parimet e një shkolle fetare"* etj., etj, arrijmë në përfundimin se Kolegji Saverian ishte shkollë me tradita, mbështetur në përvojën evropiane të kohës. Ajo qe shkollë e fortë që jepte kulturë të përgjithshme, u hapte mundësi nxënësve për të vazhduar shkolla evropiane, i kushtonte kujdes të veçantë përvetësimit të gjuhëve të huaja, por duke pasur në qendër të vëmendjes zhvillimin dhe përvetësimin e gjuhës shqipe. Ajo mund të vlerësohet si modeli dhe krenaria e shkollës shqiptare[142](Shllaku, L. 2002, fq. 83).

Për këtë shkollë janë dhënë vlerësime të shumta. Faik Konica si një ish- nxënës i kësaj shkolle në shkrimet e tij do të shprehej *"Kolegji Saverian mbahet në një shkallë të lartë dhe të gjithë ata që kanë parë shkollat e Francës e të Europës munden me dëshmue se ajo e Shkodrës është e zonja për shumë punë, me u vue në një me to*[143]"(Pepa, S. 1993, fq. 12).

"Shkolla e jezuitëve me traditat më të mira të mësimeve humaniste, ... dallohej nga shkollat e tjera edhe nga fakti se në të mësoheshin gjuhët klasike me një program më të dendur, kështu që edhe nxënësit ishin më të zgjedhur"[144](Sedaj, E. 1991)

Në vitin 1921 me rastin e ndarjes së çmimeve në fund të mësimeve, Xhafer Ypi në atë kohë prefekt i qytetit, u shpreh *"...prandaj gëzohem m'u gjetë sot në këtë vend ku si po më bie me kontatue e botnisht po ma kande me dishmue, jepet nji edukatë letrarishte, shkencore e morale vortetë fort e mirë. I kjoftë lavdi eprorëve e profesorëvetë ksaj kolegje. Këtu jepet trajtimi i shëndoshë asaj djelmnije që ka me kenë si me thanë kurrizi i Shqypnisë sonë të njoftun si komb dhe shtet i pamvarshëm".*

141 Lika, Q (1998) Tradita të tolerancës ndërfetare në qytetin e Shkodrës, "Shkodra në shekuj", vëll I, Seminari i Dytë Ndërkombëtar, Shkodër

142 Shllaku, L(2002) *"Shkollat klerikale, vështrim historik nga fillimet deri më 1924",* Shkodër, fq. 83

143 Pepa, S. (1993), "Kumbona e së Diellës", Nr. 6

144 Sedaj, E. *"Henrik Lacaj",*(prill 1991), në gazetën "Drita"

Kjo shkollë është vlerësuar si shkolla më e organizuar dhe më e kompletuar që kishte Shqipëria e asaj kohe.[145] (Hoti, V 2002, fq. 45).

U mbyll më 1946, pas një periudhe gati 70 vjeçare veprimtarie.

Në vitin 1885-1886 Xhaçino Simini, me origjinë italiane hapi një shkollë private me emrin "Instituto Hamidije". Në këtë shkollë mësonin 30 nxënës. Ai u mësonte italisht. Nxënësit paguanin 6 grosh në muaj.

Në Shqipëri në këtë periudhë ishin përhapur mjaft shkolla në gjuhët greke dhe turke. Më 1878 në krahinat e Gjirokastrës, Beratit e Vlorës kishte 80 shkolla turqisht, 163 shkolla greqisht dhe asnjë shkollë shqip. Në vitin 1879 në krahinat Berat, Durrës e Korçë kishte 125 shkolla greqisht, nga të cilat 6 shkolla qytetëse, dhe 1 shkollë e mesme në Korçë[146](Shapllo, S. 1963, fq. 57). Sipas të dhënave të konsullatës franceze të Janinës në vitin 1882 vetëm në vilajetin e Janinës (që përfshinte gjithë Shqipërinë e Jugut përveç rretheve të Kolonjës, Korçës e Pogradecit dhe që shumicën dërrmuese të popullsisë e kishte shqiptare) kishte 643 shkolla për djem dhe mikse me 736 mësues, dhe 22 shkolla për vajza me 40 mësuese.[147]Në vitin 1894 arriti që në sanxhakun e atëhershëm të Gjirokastrës të kishte 84 shkolla fillore greke[148] dhe po aq në krahinën e Beratit[149]. Gjithë organizimi, plani e programi mësimor i shkollave në gjuhën greke të Shqipërisë ishin identike me ato të shkollave në Greqi.

Pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, shkrimi i gjuhës shqipe vazhdoi të mësohej fshehurazi në vise të ndryshme të Shqipërisë. Elementë të shtresave të ndryshme, çirakë, zanatçinj, të pasur, të varfër, të rinj e të moshuar, në bodrume, nëpër shtëpi, nëpër shkolla në gjuhë të huaj, në qytete e në malësi, me libra e pa libra filluan të mësojnë shkrimin e gjuhës shqipe. Koto Hoxhi largohet nga Stambolli, vjen në vendlindjen e tij, në Qestorat dhe punon për të përhapur mësimin shqip në të rinj e në të moshuar[150] (Papapano, Th. 1963, fq. 69). Koto Hoxhi tërhoqi rreth vetes nxënës shqiptarë të shkollës normale greke të Qestoratit, u dha mësim në orët e lira.

Shembullin e tij e ndoqën edhe nxënësit e tij. Një nga ata ishte edhe Petro Nini Luarasi, në atë kohë 17 vjeçar. Ndonëse punonte mësues i greqishtes në fshatrat Bezhan të Kolonjës, Katund, Luaras, gjatë viteve 1882-1887 u bë një përhapës energjik dhe i guximshëm i gjuhës Shqipe dhe " e ktheu shkollën greqishte, pothuajse krejt shqip".

Thimi Mitko (1820-1890) u përpoq të hapë një shkollë shqipe në Korçë, në fund të viteve '50, por u ndalua nga Porta e Lartë dhe Patriarkana. Anastas Byku , i cili veproi në vitet 1859-1878, punoi për krijimin e një rrjeti shkollash në gjuhën shqipe dhe botoi një abetare "Gramë për shqiptarët", në të cilin përdorej alfabeti greqisht për shkrimin e shqipes.

Më 1851 Panajot Dhimua nga Gjirokastra, me të hollat e veta, që kish te fituar me djersë duke punuar në Stamboll , ngriti në lagjen Varosh shkollën e vajzave[151]

145 Hoti, V (2002) "*Luigj Gurakuqi për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar"*, Shkodër, fq. 45
146 Shapllo, S (1963) *"Rrugët kryesore të shkollës shqipe gjer në çlirimin e vendit",* Arsimi Popullor, Nr. 4.
147 Archives du Ministére des Affaires Etrangéres, Janina1882 (dokumente të mikrofilmuara, pranë Arkivit të Institutit të Historisë, Tiranë)
148 Haus-Hof-und Staatsarchiv-Politisches Archiv-Albanien (më tej HHStAPAA). Informacion i konsullit austro-hungarez të Janinës Nr. 40/res, datë 17 tetor 1894
149 Po aty, Informacion i konsullit austro-hungarez të Janinës, Nr. 45/res, datë 25 dhjetor 1894.
150 Papapano, TH. (1963) *"Shkollat e para shqipe në rrethin e Gjirokastrës",*Arsimi Popullor, Nr. 3.
151 Thoma Papapano *"Shkollat e para shqipe në rrethin e Gjirokastrës",*"Arsimi Popullor", Nr. 3,1963, fq. 68

(Papapano, Th. 1963, fq. 68). Në këtë shkollë ai dëshironte arsimimin e vajzave " pa dallim feje".

Në kushtet që po kalonte vendi ynë, problemi i arsimimit të femrës ishte bërë një nevojë e domosdoshme e kohës. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim kanë luajtur shkollat femërore të hapura në Shkodër, Korçë, Pogradec etj.[152](Shllaku, L. 2002, fq. 82)

Shkolla e Kushë (Marie) Mici

Shkolla qe një qendër mësimore private për vajza. Në maketin e historisë së arsimit shqiptar, thuhet: *"Kjo shkollë qe një qendër mësimore shqipe (private) për vajza, që u hap nga mësueset Kushë Micja me shoqen e saj Tereza Berdica. Kjo qe një vatër e rëndësishme e edukimit dhe qëndroi e hapur deri në vitin 1897"*[153]*(MASH,2003, fq.97)*

Kushë Micja e fillon karrierën në një moshë shumë të re, e frymëzuar nga dashuria e madhe për gjuhën e popullin, nën moton *"Kurrgja për vete dhe gjithçka për të tjerët"*. Në një ceremoni të thjeshtë më 1859 hapi të parën shkollë shqipe femërore e cila e mori emrin "Shkolla e Kushë Mices". Kjo shkollë për 45 vjet u bë qendra e përhapjes së arsimit për femra. Si lokal shkollor ajo përdori njërën nga dhomat dhe një pjesë të çardakut të shtëpisë së saj, ndërtesë të cilën e përdorte edhe për banim. Në shkollë ajo mbante mbi 50 nxënës me mosha të ndryshme nga 9-14 vjeç[154](Gjyshja, T. 1961, fq. 195) me shkallë diturie të ndryshme. Ajo funksionoi në formën e një shkolle me klasa kolektive. Lëndët që mësoheshin në këtë shkollë ishin: *këndim, shkrim, numëratore, vizatim, këngë dhe punëdore.* Orenditë ishin të thjeshta e të pakta. Mësimi zhvillohej nga ora 8-12 paradite, ndërsa pasdreke bëheshin mësimet e këngës dhe të punës së dorës.

Studiuesi Musa Kraja për këtë shkollë shkruan:*"Kushe Mici punoi në një shkollë të rregullt, në gjuhën shqipe, duke pasë ndihmëse Terezina Berdicën"*[155](Kraja, M. 1993, fq. 132) Për ta vërtetuar këtë si dhe për të mësuar për numrin e atyre që e frekuentonin këtë shkollë, format që përdornin këto mësuese informohemi nga një listë emërore që mban datën *"prill 1865",* listë e shkruar dhe e firmosur nga të dyja mësueset e kësaj shkolle. Lista përmban 86 emra, por nuk është e ndarë në dy grupe apo klasa, siç mund të mendohet meqenëse dy ishin mësueset që punuan në këtë shkollë. Bashkë me listën emërore është një tjetër dokument i cili mban datën 28.8.1865. "*Shkolla femnore e këtij qyteti" "Vajza të drejtueme nga Maria Mici që janë dallue si për pjekuni në mësime, ashtu dhe për sjellje janë këto...(Përmenden tetë nxënëse, në mes të tyre edhe Tina Nika. Këtu përmenden edhe nëntë vajza të dalluara nga Tereze Berdica, të dalluara për studim e sjellje*[156]*)(AMSH,dosja NR. 1, fondi i arsimit).*

Shkolla vazhdoi deri në vitin 1897, vit në të cilin mësuesja u largua nga nxënësit e saj për arsye të moshës.[157] (Kazazi, Nj. 2014. fq. 67)

152 Shllaku, L. vepër e cituar
153 Grup autorësh, MASH,ISP,(2003) *"Historia e Arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar",* Vëllimi i I, Tiranë.
154 Gjyshja, T (1961) *"Qendra mësimore e Kushë Mices në Shkodër gusht 1859",* "Shkodra 1961", Nr. 13, fq. 195
155 Kraja, M (1993) "*Mësuesit për kombin shqiptar",* Tiranë, fq. 132
156 Arkivi i Muzeut të Shkodrës, dosja nr.1, fondi i arsimit
157 Kazazi, Nj (2014) *"Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër"*, Shkodër, fq. 67

Shkolla e Tereze Bërdicës

Tereze Bërdica, më 1862, në shtëpinë e saj në rrugën Daullej, çeli shkollën për vajza të cilën e thirrën "Shkolla e Tereze Berdicës". Tereza merrej me arsimin e vajzave që nga mosha 7 vjeç deri në moshën 14 vjeç, kryesisht të familjeve të varfra, ndërkohë që shpesh ajo nuk kërkonte as pagesën mujore. Mësimin e zhvillonte në një dhomë të shtëpisë. Gjatë punës së saj ajo u ndihmua nga Kusha, tek e cila gjeti drejtuesen e aftë për çështjet shkollore. Në këtë shkollë punoi për 33 vjet. Krahas punës së dorës, ajo u mësonte nxënëseve shkrim e këndim shqip. Në vitin 1895 u mor në shërbim në shkollën italiane si kujdestare fëmijësh të foshnjores dhe nxënëset e saj u shpërndanë në shkollën e Kushes, të Tinës dhe në shkollën italiane[158](Gjyshja, T. 1963, fq. 62)

> Një tjetër shkollë femërore ishte **"Shkolla e Tinës së Nikës"** e cila u hap në vitin shkollor 1873-74.[159] (Koliqi, H&Kazazi, Nj. 2009, fq. 2492) Ajo do t'i shkruante Guerinit (Pashko Guerini, arqipeshkv i Shkodrës në periudhën nga 1886 deri më 1909, i cili me të drejtë është quajtur arqipeshkv i shkollave shqipe) për këtë ngjarje: "*Tashti u mbushën më se 7 vjet që unë…pata hapë një shkollë për vajzat, një pjesë të të cilave i pranova pa shpërblim dhe një pjesë kundrejt një shpërblimi të vogël. Megjithë fuqitë e mia nuk pushova, një herë tue i mësue…*"[160](AMSH, fondi i arsimit)

Tina kishte qenë për tetë vjet nxënëse e Kushe Mices (shkollë që e filloi që në moshën 8 vjeç). Që në fillim Kusha do të vërente te ajo zgjuarsinë, vullnetin, shpirtin e organizimit, cilësi që bënin që ajo ta mbante shumë pranë vetes duke e pajisur me një arsimim të veçantë. Këtë shkollë më pas e ndoqi edhe e motra Gjystja, e cila kishte prirje të veçantë për punën e dorës.[161](Gjyshja, T. 1959, fq. 79) Të dyja motrat, si nxënëse, qenë krahu i djathtë i Kushes në mësim dhe punë dore.

Tina, si ndërtesa shkollore, përdori lokale të ndryshme. Ajo punoi si mësuese për 50 vjet, ndërsa me të motrën për 15 vjet. Në shkollën e saj u arsimuan së bashku vajza dhe djem. Djemtë nga mosha 7-10 vjeç mbasi merrnin mësimet në këtë shkollë vazhdonin mësimet me ndonjë mësues privat, ose fillonin punën e shegertit në Pazar. Vajzat mund të vazhdonin më tej shkollën. Shkolla drejtohej nga të dy motrat dhe mbahej me kontributin e prindërve të fëmijëve. Nga ana mësimore Tina zbatoi të njëjtin program të mësueses së saj Kushë Micës.[162] (Gjyshja, T. 1959, fq. 81) Çdo vit arkipeshkvi i Shkodrës, emzot Pashko Guerrini, së bashku me sekretarin Dom Pjetër Gjo-Lalën, në mbarim të korrikut vinte të dëgjonte provimet dhe të lavdëronte punën e bërë nga fëmijët, madje për më të mirët në këndim e punë dore jepte edhe çmime .

E rënduar nga shëndeti dhe gjendja ekonomike më 1920 iu drejtua Ministrisë së Arsimit për ndihmë për vazhdimin e shkollës, por përgjigjja qe negative pasi shkolla ishte private dhe kjo ministri nuk mund ta mbështeste.[163] (Gjyshja, T. fq. 63)

Më 9 prill 1923 kjo shkollë merr emrin "Shkolla Fillore Serreq" dhe u mbajt nga

158 Gjyshja, T (1963)" Shkollat e para femërore në Shkodër deri në vitin 1912", Arsimi Popullor, Nr. 3,Tiranë, fq .62
159 Koliqi, H& Kazazi, NJ "Fjalori Enciklopedik", Tiranë.
160 Letër drejtuar Guerinit më 9 mars 1881, Arkivi i Muzeut të Shkodrës, fondi i arsimit
161 Gjyshja, T (1959) "Me rastin e 90- vjetorit të shkollës së Tinës së Nikës", Arsimi Popullor, Nr. 6, fq. 79
162 Po aty, fq. 81
163 Tom Gjyshja, artikull i cituar, fq 63

shteti me personel e mjete mësimore të dërguara nga drejtoria e arsimit të Shkodrës. Ndërsa lokali u përdor si shkollë deri në majin e vitin 1933 kur u shtetëzuan shkollat private.[164] (Gjyshja, T. fq. 63)

Për regjimin e brendshëm dhe punën që zhvillohej në këto shkolla po citojmë një pjesë të letrës që Topich (Giovani Topich, Arqipeshkv i Shkodrës), në formë urdhri, u dërgon mësueseve më 30 shtator 1859 . *"Në ditët shkollore do të bahen 5 orë mësim, 3 orë paradreke dhe 2 orë mbasdreke simbas kalendarit dhe orarit që bashkangjitet. Në dhetuer, kallnuer e fruer fëmijtë nuk do të shkojnë në shtëpija, por do të marrin dreken me vehte. Të ejtet mbasdreke dhe ditët e diela janë ditë pushimi. Po qe se festat bien në ditët e javës, në të ejten mbasdreke do të bahet mësim. Ndalohen ndëshkimit e fëmijve me rrahje; nxanesit dënohen në gjuj para klasës, pa hangër. Nxanësit që nuk do të binden përjashtohen nga shkolla..."*[165]*(Topich, 1856)*

Për sa i përket numrit të nxënëseve sipas një relacioni të vitit 1883[166]*(Guerrini, P.1883)*, numri i nxënësve në të tria shkollat është 115 dhe më 1896 vetëm në shkollën e Kushe Micës e Tina Nikës ishte 114[167]. (Guerrini, P, 1897) Siç edhe shihet, numri i nxënëseve qe i qëndrueshëm, por *"...më 1889 kur u hapën shkollat italiane, në shkollën e Kushe Micës dhe Tinë Nikës pati një rënie të numrit të nxënëseve të regjistruara dhe frekuentuese*[168](Prendushi, M. fq. 74) Pikërisht në këtë kohë mësuesja Tina Nik Gjergji e përshkruan kështu gjendjen e këtyre shkollave "*Gjendja e mjerueshme e vendit dhe hapja falas e shkollave të murgeshave (1879), tronditën shumë shkollën teme e me të edhe jetën teme. Për këtë arsye dhe mbasi u bë hapja e shkollave italiane (1889) mbajtja e shkollës seme u ba diçka e dyshimtë"*[169]*(*AMSH, Dosja e arsimit, 1889*)*

Tina luftoi që në shkollën e saj të rriste përpjekjet për të rritur numrin e nxënëseve dhe të përmirësonte frekuentimin. Ajo e mbajti shkollën e saj deri në vitet 20-të të shek. XX-të. Në këtë shkollë më 1906 mësonin 51 vajza të varfra të qytetit. Më 1907 ajo kërkoi që edhe motra e saj, Gjystja, të njihet si mësuese, sepse vetëm nuk e përballonte numrin e vajzave që vinte duke u rritur. Më 1907 kërkoi gjithashtu që shkolla të ndihmohej financiarisht[170](Prendushi, M. 1974, fq. 75)

Kontributi i këtyre shkollave ka qenë i madh saqë mund të themi*"... se gratë në Shkodër edhe para njiqind e mâ vjetve (bëhet fjalë për shekullin e XIX, shënimi im E.B) shkruejshin shqip"* [171](Koliqi, H 1972, fq. 62). Krahas dëshmive të njohura deri tani, një tjetër dëshmi që na ka rënë në dorë janë disa shënime, në një tefter (bllok, shënimi im E.B) me faqe të zverdhura në të cilin përshkruhet shqip mënyra se si duhet të gatuheshin gjellët e ëmbëlsirat. Nuk është qëllimi për të dhënë mënyrën e gatimit, por aty në rreshta të shkruar me grafinë e dikurshme të shqipes, nëna bashkë me pajën i vendoste në arkë së bijës, që shkonte nuse, edhe shënime, mësime si të sillej në shtëpinë

164 Po aty, fq 63
165 Topich, letër datë 30 shtator 1856, që u dërgon mësueseve të shkollave në Shkodër. Po për rregulloren e shkollave dhe sistemin e punës në to shih dhe "Instruksion për një inspektor krahinor shkollash" (dok. Nr. 820, 283, Kotorr, 22.8.1846"
166 Guerini (Aktet e vizitës kanonike në Arkidioçezin e Shkodrës", 1883, Fondi i Austro-Hungarisë.
167 Guerini, P (Aktet e vizitës kanonike në Arkidioçezin e Shkodrës", 1897 (po këtu flet për vitin 1896)
168 Prenushi, M artikull i cituar, fq. 74
169 AMSH Dosja e arsimit e shek.XIX. Letër e Tina Nik Gjergjit, datë 28 prill 1889
170 Mikel Prenushi *"Vështrim historik mbi zhvillimin e arsimit në Shkodrën e shek.XIX*", Studime historike, nr. 3, 1974, fq. 75
171 Ernest Koliqi "Gjellë e ämbëlsina të vendit tonë", "Shejzat" ,I, Nr 1-4, viti 1972, fq. 62

e burrit. Kuptohet se gatimet kanë një rëndësi të madhe në jetën familjare, prandaj i është kushtuar një rëndësi të madhe mënyrës së përgatitjes së tyre. Ortografia është ajo e librave të moçëm, botuar në Shkodër gjatë shekullit të XIX.



Fragment nga artikulli i Ernest Koliqi "Gjellë e ämbëlsina të vendit tonë"

Shkollat e Kushe Mices, Tina Nikës dhe Tereze Berdicës nuk qenë shkolla fetare. Ato mbaheshin me të ardhurat që siguronin me ndihmat ekonomike të disa familjeve të kamura, të cilat ishin të interesuara dhe nuk kursenin asgjë për arsimin dhe edukimin e vajzave të tyre. Mësueset dhe shkollat që drejtonin ato, përfituan edhe një shumë të vogël në lekë nga fondi austriak pas lutjeve të herëpashershme që u bënë[172] (Kazazi, Nj. 2014, fq. 67)

Përveç këtyre shkollave, pati edhe të tjera shkolla femërore në gjuhën shqipe, si shkolla e Stigmatineve (1878), e Kallmetit (1896), azili i motrave servite apo streha foshnjore në qytet (1898), shkolla plotore për vajza (1906). Po kështu më 1907 u hap në Shirokë një shkollë fillore femërore, kurse me 1911, në Kallmet një shkollë fillore jo e plotë për vajza. Si rezultat i këtyre shkollave një pjesë e mirë e grave dhe vajzave të qytetit tonë dinin të shkruanin e të lexonin. Më 2 prill 1881, treqind nxënëse të shkollave të qytetit të Shkodrës i dërguan Dora d'Istries (princeshës Elena Gjika) një penë të argjendtë dhe një letër me 300 nënshkrimet e tyre. [173](Kastrati, J. 1963, fq. 72)

Studiuesi Jup Kastrati në një shkrim të tij na njeh me një fakt interesant: *Ai thekson "se deri në shpalljen e Pavarësisë , në rrethin e Shkodrës, kishte 47 shkolla shqipe, nga të cilat 10 për vajza"*[174] *(*Kastrati, J. 1963, fq. 72)

172 Kazazi, Nj (2014*) "Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër",* Shkodër
173 Kastrati, J (1963) "*Kontribut për historinë e arsimit në rrethin e Shkodrës deri në vitin 1912",* Arsimi Popullor, Tiranë
174 Po aty fq. 72

Për arsimin në Shkodër, Dom Ndoc Nikaj në librin e tij "Kujtime të nji jetës së kalueme" ndër të tjera shkruan*:"Para se të vinin në Shkodër Jezuitët , Fretnit e Stimatinet patne kenë dy msojtore varzash nën drejtimin e dy murgeshave shtëpiake: Kush Micja e Treze Berdicia qi nepshin nji nduer mësimi sa me dijt me këndue e me shkrue, në mos tjetër se e cilla e varzave emnin e vet edhe per djelmt pat kenë nji i quejtun Ndoc Speci e ma vonë Benushi"* (Nikaj, N , 2003, fq. 36)

Një tjetër shkollë është shkolla fillore e Stigmatineve, e cila u hap më 1879, nën kujdesin e motrave Stigmatine, të sjella në Shkodër nga françeskanët, shkollë që arriti deri në nivelin e shkollës së mesme Shkolla ishte private. Fillimisht u hap me 200 vajza dhe me tri mësuese. Shkolla ka qenë një godinë e rregullt, e përshtatur mjaft mirë për zhvillimin normal të mësimeve.

Veprimtarinë e nisi si shkollë fillore, me dy klasa të ulëta dhe ku si gjuhë mësimi ishte shqipja. Në vitin 1888 sipas një statistike numri i nxënësve ishte 428, mes të cilave janë 7 vajza jetime, 12 murgesha motra e tre probada. Disa prej tyre arritën të punojnë mësuese në këtë shkollë. Ndonëse shkolla e atëhershme nuk mund të krahasohet me shkollat e mëvonshme për nga metoda e programi, megjithatë duhet theksuar se është punuar shumë. Atyre u mësohej shkrim e këndim e punë dore si dhe njohuri për jetën dhe ekonominë shtëpiake. Në letërsinë e asaj kohe për to u shkrua kështu:*"Ato'i herë e pikë ma e para/Në gjuhë shqipe e me fjalë të mbara/Ne na mësojnë se n'shekull nieri/ Nuk ka ndollë aj, jo pa hiri/"*

Dhe në vazhdim tregohej se: *Prap aty mësohej algjebra/ msohet mrenda matematika/ gjimnastika e muzika/ Me histori e gjeografi/edhe na me ra vizë/ me ra vizë e me qendis/ me xanë e me mat e me pre/n'trajt të vjetër e n'trajt të re/me la petka, me harnue/buk e shujt me na gatue/gjithshka hije ka p'r'i grue/Qi me xanë e me punue/Zot e Atdhe pa i harrue/.*

Dhe përfundon: *Eni pra varza shkodrane/Cilësdo fe, cilësdo stinë/E të brohorasim n'der t'ksaj vatre/Rrofshin shkollat Stigmatine/*[175](Fishta, At. Gj. 1924, fq. 84-87)

Në vitin shkollor 1896-1897, *shkolla stigmatine* ka pasur katër klasa e kishte një përgatitje që përfshinte dy rende fëmijësh. Numri i nxënëseve ka qenë deri në 400, të ndarë siç e tregon tabela e mëposhtme:

	Azili	Përgatitorja	Klasa I	Klasa II	Klasa III	Klasa IV
Nr. i nx.	215	58	38	35	27	10

Tabela 4. *Organizimi i shkollës stigmatine.*

Provimet u zhvilluan më 8.06.1897, me këtë program:

Azili- *doktrinë e krishterë, histori e shenjtë, shkrim i zanoreve e i numrave deri në dhjetë, ushtrime përmendësh.*

Përgatitorja- *diktat, mbledhje e zbritje me numra të thjeshtë, katekizëm, histori e shenjtë, fjalë italisht-shqip, ushtrime përmendësh.*

175 Fishta, At Gj. (1924), "Mrizi i Zanave", Shkodër.

Klasa I-II *diktat fjalësh italisht me përkthim shqip, mbledhje e zbritje me tre numra, katekizëm, histori e shenjtë, ushtrime përmendësh.*

Klasa III- *përkthim me gojë e me shkrim prej shqipes në italisht, shumëzime me grosh e me pare, pjesët e ligjëratës e analizë gramatikore, njohsimet e para të dheshkronjës, katekizëm, histori e shenjtë, ushtrime përmendësh.*

Klasa IV- *hartime italisht, analizë logjike e gramatikë, problem mbi katër veprime, të kthyemit e lirave në grosh, dhe shkronja e Evropës.*

Në vitin 1910 shkolla ka gjashtë klasa dhe një "Informa". Drejtoreshë ishte Santeoreca, 43 vjeçe.

Mësueset e shkollës ishin: Mr. Asunta (shqiptare), Mr. Jezuina, Mr. Luigjina (shqiptare), Mr. Filiciana, Mr. Kraja, Mr. Anjeza (shqiptare), Mr. Gjyzepina, Mr. Magdalena (shqiptare), Mr. Kondita (shqiptare), Mr. Kolombiana (shqiptare), Mr. Modesta shqiptare), Mr. Ugolina (shqiptare). Por jo të gjitha mësueset ishin murgesha. Në vitet 1918-1920, ndër mësueset jo murgesha njihen Anji Çurçija, Pavlina Mirdita, Modesta Naraçi, Roza Ndrekaj, Gizeta Gjinaj, Adelajde Dragusha, Xhorxhia Garxhiolia[176](Bushati, H 1998, fq. 47)

Shkolla e Stigmatineve shkoi duke përparuar gjithnjë e më tepër. Sipas të dhënave gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, në këtë shkollë mësonin 304 vajza, të ndara në 6 klasë, me 10 mësuese, 5 klerikale e dy shekullare. Mësimi jepej në gjuhën shqipe dhe mësohej edhe gjermanishtja në vend të italishtes që jepej më parë.

Më 1920 hyri në veprim programi i Ministrisë së Arsimit, duke e mbajtur dhe duke e njohur si shkollë private, ndërsa dëftesat ishin të njëjta me ato të shkollave shtetërore.

Në vitin 1922, shkolla do të rritet duke synuar që të shndërrohet në një shkollë normale femërore dhe me kërkesën e P. Pal Dodajt, Provincial i Françeskanëve të Shkodrës, drejtuar Ministrisë së Arsimit shkolla do të kishte edhe konvikt. Në këtë periudhë shkolla kishte pesë klasa fillestare dhe tri klasa qytetëse. Në vitin shkollor 1927-1928, kjo shkollë nxori maturantet e para, të cilat u emëruan mësuese në shkollat fillore të vendit. Kemi pasur fatin të konsultojmë një vendim të tillë për emërimin e një prej ish-maturanteve të para të kësaj shkolle, të cilin po e sjellim të plotë më poshtë:

Dekret nr. 242 i Ministrisë së Arsimit të Mbretnisë Shqiptare, Tiranë më 20.10. 1928: "Në themel të proponimit tonë nr - 3493, datë 10.10.1928 e pëlqim të Këshillit Ministruer, nr. 1542 me 13-10.1928 po emnoheni mësuese në shkollën femnore Shijakë."[177] (Dekret, 1906). Në dekret shënohet me bojë: Filloi punën me 25.10.1928. Pranë vulës së Shkollës Plotore –Shijakë, firma Bekteshi.

Nga dokumentacioni që ruhet në Arkivin e shtetit, Tiranë, kemi marrë këtë informacion mbi përfundimin e shkollës nga nxënëset maturante sipas viteve:

176 Bushati, H. (1998) "*Shkodra dhe motet",* vëll. lI, Shkodër

177 Dekret i kësaj ministrie, dërguar mësuese N. Zeka. e datëlindjes 1906 nga e cila kemi marrë mjaft të dhëna interesante për këtë shkollë.

Viti shkollor	Nxënëse maturante
1927-1928	9
1928-1929	8
1930-1931	9
1931-1932	5
1932-1933	8+1[175]

Tabela 5. *Të dhëna mbi përfundimin e shkollës nga nxënëset maturante.*

Në këtë vit provimet u dhanë kur kjo shkollë ishte mbyllur dhe nxënësit ishin transferuar në degën Normale të Gjimnazit të Shtetit. Shkolla normale e motrave Stigmatine nxori disa breza maturantesh për 5 vite, ku morën dëftesën e pjekurisë gjithsej 40 vajza, shumica nga Shkodra dhe rrethet e saj.[179] (Dizdari, I. 1988, fq.7) Në planin e shkollës përfshiheshin lëndë të tilla si: gjuhë shqipe, pedagogji, histori, gjeografi, gjuhë frënge, matematikë, histori natyre, dituri natyre, bujqësi teorike, bukurshkrim, vizatim, punë dore, besim, ravizë, këngë, italisht, ekonomi shtëpiake, gjimnastikë, punë dore. Në këtë shkollë iu kushtua kujdes edhe shfaqjeve teatrore. Shumica e pjesëve ishin me temë nga ngjarjet kombëtare dhe shfaqeshin në data dhe përvjetorë si shpallja e Pavarësisë, përfundimi i vitit shkollor, etj. Ja si përshkruhet në gazetën "Besa shqyptare" pjesëmarrja e këtyre nxënëseve në ditën e ngritjes së flamurit në Shkodër: *"rresht mas rreshtit pritshin varzat e shkollave me flamj t'vet e tubë e varzave t'vogla që rrethoninflamurin e msojtores t'Stigmatineve , t'veshuna si engjëj, me krahë fletësh e duke hedhë lule jepnin paraqitje nt,kandshme"*[180] Kjo shkollë u mbyll më 1933, në bazë të reformës Ivanaj, për t'u rihapur në vitin shkollor 1936-1937, tani si degë normale e Gjimnazit të Shtetit. Kjo shkollë luajti një rol të rëndësishëm arsimor, pedagogjik dhe atdhetar, për mësimin e përhapjen e gjuhës shqipe edhe në elementin femëror të Shkodrës.

2.6.4 Mësonjëtorja shqipe e Korçës

Shënoi një hap të madh përpara, një ngritje cilësore në zhvillimin e arsimit tonë kombëtar. Kjo shkollë, e licencuar në emër të Pandeli Sotirit, u miratua nga Ministria e Arsimit në Stamboll pikërisht në kohën kur Naim Frashëri ishte funksionar i lartë i "Pleqësisë së Arsimit". Përmes tij u nxor edhe leja *"Për të çelur një shkollë private në gjuhën shqipe në Korçë" me emrin e Pandeli Sotirit. Shkolla u hap më 7 mars 1887, fillimisht me 35 nxënës, duke u zgjeruar më tej me 60 nxënës. Kjo shkollë arriti të kishte deri në 200 nxënës në vitet e para, ortodoksë dhe myslimanë, djem dhe vajza*[181] (Koci, K 196, fq. 14) Shkolla zgjati herë e hapur dhe herë e mbyllur deri në vitin 1903.

Vlen për tu theksuar se në literaturën pedagogjike, vazhdon të shënohet "Mësonjëtorja e parë shqipe", duke shkelur në mënyrë flagrante të vërtetën, pasi shkolla shqipe ka

178 AQSH, Fondi 251, viti 1932, Dok. 241 dhe Fondi 699, viti 1935, Dok. 30
179 Dizdari, I. (1988), *"Historiku i shkollës Pedagogjike",* Pjesa III, dorëshkrim, Shkodër
180 "Besa Shqyptare", Shkodër, 27 maj 1913, nr. 6, kryeartikull: Dita e djeshme
181 Koci, K (1961) " Mësonjëtorja shqipe e Korçës", Arsimi popullor, nr. 3, Mars

pasur shumë më herët. Për "Mësonjëtoren shqipe të Korçës", përveçse duhet nënvizuar "kombëtare", mirë është t'i shtohet edhe "laike" e "demokratike", madje edhe të qartësohet, siç është në licencën e saj, "private", sepse kështu është licencuar.

Kjo mësonjëtore kishte këto tipare:

- Mësimi në këtë shkollë zhvillohej tërësisht në gjuhën shqipe.
- Mësuesit e saj ishin të gjithë shqiptarë. Tekstet që u përdorën në këtë shkollë ishin hartuar nga rilindës të shquar si Naim e Sami Frashëri dhe dalloheshin për përmbajtjen e shëndoshë kombëtare dhe përparimtare për kohën, gjë që i shërbente edukimit patriotik të nxënësve.
- Shkolla dallohej për karakterin e saj laik. Për të kontribuuan shqiptarët e të gjitha besimeve. Ishte shkollë e përbashkët për nxënës të besimeve të ndryshme fetare.
- Mësuesit e saj ishin të gjithë laikë.
- Shkolla dallohej për karakterin e saj demokratik. Ajo frekuentohej nga djem e vajza të shtresave e të klasave të ndryshme të popullsisë të qytetit dhe fshatit.
- Ajo u bë qendër për përhapjen e mësimit të shkrimit e leximit tek të rriturit.
- Mësimi jepej falas dhe tekstet shpërndaheshin falas.
- Në këtë Mësonjëtore jepeshin lëndë të tilla, si: gjuha shqipe, gramatika shqipe, aritmetika, historia e Shqipërisë, shkrim-këndimi, gjeografia, dituri-natyre. Asnjëherë, deri në atë kohë nuk kishte pasur një shkollë të tillë që të përfshinte në planin e saj mësimor "Historinë e Shqipërisë", me një tendenciozitet të theksuar patriotik.

Viti shkollor 1888-1889 filloi duke pasur drejtor Thanas Sinën, dhe si mësues Koto Sotirin e Thoma Avramin. Ndërsa në vitin shkollor 1889-1890, drejtimin e Mësonjëtores e mori mësuesi Petro Nini Luarasi.

Të tjera shkolla private vijuan të hapen pas saj, si në Pogradec më 14 mars 1887[182], sipas modelit të Mësonjëtores shqipe të Korçës[183] (Kraja, M 2002, fq. 110), në Ersekë po atë vit dhe në Dibër. Çelja dhe mbajtja e shkollës shqipe të Pogradecit u bë në sajë të bashkëveprimit të popullsisë të dy besimeve. Mësues i parë ka qenë Koto Sotiri, i vëllai i Pandeli Sotirit. Ky punonte për përhapjen e mësimit të shqipes dhe të librave në gjuhën shqipe, prandaj edhe i kishin vënë epitetin "Koto Shqiptari".

Shkolla shqipe u çelën në Ohër, Rekë, Treskë dhe u bënë përgatitje edhe në Elbasan, Leskovik, Ersekë etj. Në një letër që i dërgohej nga Shqipëria "Fiamurit të Arbrit"[184], në korrik 1887, duke bërë fjalë për shkollat shqipe të çelura në Shqipëri, thuhej ndër të tjera :"*deri sot janë gjithsej gjashtë. Pse nuk vjen edhe ndonjë mësues prej jush për të filluar shkollën mundësisht në Berat dhe në Kavajë…Po le të kemi durim të mbajmë ato që kemi*"[185].

182 Gazeta"Shqiptari" e Bukureshtit, viti I, nr.4, datë 11 vjeshtë e I, 1888.
183 Kraja, M (2002) *"Bij të Lunxhërisë për arsimin shqip",* Tiranë, fq. 110
184 "Fiamuri i Arbërit" u botua nga arbëreshët e Italisë nën drejtimin e De Radës
185 "Fiamuri i Arbërit", Viti III, Nr. 6, datë 15 gusht 1887, fq. 1

Patriotët shqiptarë në çdo krahinë punonin e kujdeseshin për përhapjen e gjuhës shqipe. Petro Nini Luarasi, në Kolonjë shpërndante pa shpërblim libra shqip dhe me hapjen e Mësonjëtores, hoqi dorë nga puna si mësues në shkollën greke dhe iu kushtua punës që tu mësonte bashkëfshatarëve të tij shkrimin në gjuhën amtare. Me iniciativën e tij u çel në Ersekë në vitin 1887 një shkollë private shqipe e cila vazhdoi gati dy vjet. "*Përsëshpejti-shkruan Petro Nini-nisnë të këndojnë dhe të shkruajnë shqip më të shumët e shtëpiakëve (banorëve) të Kolonjës dhe të fshatrave të Vakëfeve, dhe secili përkujdesej fort çkathëtë, t'i jepte mendimet e tij, mikut, duke u bërë, në këtë mënyrë, secili mëmëdhetar edhe nxënës i tij edhe mësonjës i të afërmit të tij*"[186] (Grameno, M 1905, fq. 230). Në këtë shkollë mësuan jo vetëm të vegjlit, por edhe të rriturit[187](MASH. 2003, fq. 135).

"*Shkolla e parë shqipe në Dibër, e vitit 1888, e udhëhequr nga Said Najdeni ishte mjaft modeste në brendinë e saj. Aty përveç elementeve të para të shkrim-këndimit me alfabetin e Stambollit, mësohet edhe diçka nga matematika, nga shkencat natyrore, bëhej mësim fetar, bisedohej për tema nga historia e kultura kombëtare, bisedohej për veprimtarët e Stambollit, si edhe për ngjarjet më aktuale*"[188](Vishko, A 1995).

Për mbajtjen e shkollave e të mësuesve dhe çeljen e shkollave të reja, me iniciativën e shqiptarëve myslimanë e ortodoksë u formua në Korçë më 1888 "Shoqëria e Mësimit Shqip", e cila numëronte rreth 160 anëtarë[189]. Kryetar i saj ishte Alo Dishnica. Çdo anëtar paguante një kuotë mujore. Arka e saj do të përdorej për mbajtjen e shkollave ekzistuese dhe mësuesve të tyre dhe për çeljen e shkollave të reja shqipe. Kjo shoqëri u bë qendra kryesore brenda vendit, që merrej me drejtimin dhe organizimin e arsimit.

Më 1889 u hap *Mësonjëtorja Kombëtare e Prizrenit* (shkollë private). Emri i kësaj shkolle është i lidhur me atë të Mati Logorecit. Shkolla subvencionohej nga Austro-Hungaria. Futja e shqipes si gjuhë mësimi dhe puna e palodhur e mësuesit patriot Mati Logorecit bëri që shkolla të ndiqej edhe nga fëmijët myslimanë. Numri i nxënësve erdhi duke u rritur dhe në këtë shkollë bashkë më Matinë fillon punën edhe Lazër Lumezi.

Një ngjarje e rëndësishme për arsimin në Shqipëri ishte edhe hapja në qytetin e Korçës e shkollës shqipe e vashave, më 23 tetor 1891, nga Gjerasim Qiriazi. Leja në formën e një dekreti perandorak u lehtësua nga fakti se ishte në shërbim të një shoqërie të huaj dhe se, sulltanit iu paraqit si një shkollë në gjuhën angleze. Fillimisht pati vetëm 3 nxënëse, numër ky që erdhi duke u rritur. Në fund të vitit të parë shkollor ajo arriti të kishte 27 nxënëse, *"një numër jo tepër i vogël, - shprehej Sevasti Qiriazi, -për të filluar lëvrimin e një toke kaq të fortë"*. Në vitin e parë shkollor mësuese e vetme e shkollës ishte Sevasti Qiriazi, një grua që në bankat e shkollës kishte ëndërruar që tu jepte mësim motrave shqiptare me qëllim që t'i shkëpuste nga fanatizmi i shekujve të kaluar. Pavarësisht se shkolla fillimisht ishte në shërbim të "Shoqërisë biblike" shumë shpejt ajo u shndërrua në një shkollë kombëtare, duke u kthyer në një vatër të rëndësishme mësimi dhe edukimi për vajzat e besimeve të ndryshme. Plani mësimor i kësaj shkolle parashikonte arsimimin në gjuhën amtare dhe edukimin atdhetar. Në vitin e parë shkollor rëndësi iu kushtua leximit dhe shkrimit në gjuhën shqipe dhe aritmetikës. Gjithashtu plani mësimor përmbante njohuri elementare në gramatikë, histori, gjeografi, zoologji,

186 Grameno, M (1905*) "Mallkimi i gjuhës shqipe",* Bukuresht, fq. 230
187 Grup autorësh, MASH, ISP,(2003)"*Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar",* Tiranë
188 Vishko, A (1995) "Rrethanat arsimore në Dibër e rrethinë në gjysmën e dytë të shekullit XIX", "*Dibra dhe etnokultura e saj*", Vëll. II, Tetovë.
189 Gazeta "Shqiptari", 9 tetor 1888

si dhe në punë dore. Në vitin e dytë shkollor numri i nxënëseve arriti mbi 50. Në këtë vit u shtua edhe një tjetër mësuese, Fanka Efthimi, e cila u bë një ndihmëse e aftë dhe besnike e Sevastisë. Përveç lëndëve në gjuhën shqipe, si lëndë të veçanta zhvilloheshin gjuha angleze e greke. Shkolla me kalimin e kohës pati edhe bibliotekën me mbi 200 libra si dhe muzeun, i cili do të shërbente edhe si kabinet për dituritë e natyrës. Në këtë shkollë shërbeu edhe misionari amerikan në Shqipëri, Ph. Kennedy.[190](Pipa, F 1962, fq. 6)

Në shumë qytete e fshatra të Shqipërisë si në Berat, Vlorë, Fier, Elbasan, Dibër, Çamëri, Skrapar, Kolonjë, Luaras, Treskë, Selenicë, etj ishin çelur shkolla ilegale shqipe të cilat funksiononin pa lejen e qeverisë osmane dhe në kundërshtim me politikën e saj. Shumë nga këto shkolla e patën jetën e shkurtër për shkak të vështirësive të mëdha. Atdhetarët rilindas vazhduan më tej dhe në përmasa të reja sistemin e mësimit klandestin, të filluar prej kohësh në Shqipëri. Sa më shumë shtoheshin ndjekjet kundër pishtarëve të dritës së arsimit shqiptar, aq më shumë rritej lëvizja për përhapjen ilegalisht të shkrimit shqip, aq më shumë qarkullonin librat e gazetat shqipe.

Në vitin 1898, me ndihmën e Naim Frashërit, u bënë përpjekje për të hapur një shkollë private shqipe në Përmet[191](MASH, 2003, fq. 151). Nuk ka të dhëna që kjo shkollë të jetë hapur.

Në Tiranë, që më 1886, ishte hapur një shkollë ”katolike” për vajza dhe më 1897 u hap një shkollë e tillë për djem, në të cilën Murat Toptani kërkoi që të mësohej edhe gjuha shqipe.

Hapja e shkollave shqipe, sidomos private, nuk ishte e lehtë. Duheshin përballuar, përveç presioneve të pushtuesit dhe reaksionit fqinj, edhe vështirësi të tjera të mëdha, të cilat, jo të gjithë i kalonin me sukses. Në Grabovë të Oparit pati përpjekje për të hapur një shkollë shqipe, pasi një grabovare, e martuar në Vjenë, premtoi të ndihmonte shkollën me 25 lira turke në vit, por për mungesë mësuesish dhe pengesave të tjera nuk ia arriti qëllimit.[192](MASH, 2003, fq. 163)

2.7 Shkollat private pas shpalljes së Pavarësisë

Gjatë periudhës së Pavarësisë 1912-1939 nga shteti shqiptar janë bërë përpjekje serioze për të kodifikuar sistemin dhe strukturën e arsimit tonë. Kuptohet që është një periudhë ku forcat përparimtare i rritën kërkesat dhe përpjekjet e tyre për shkollën dhe gjuhën shqipe. Për herë të parë shkolla e arsimi ynë drejtohej nga një qeveri kombëtare[193](Kanini, I,2001, fq. 11). Janë marrë vendime, janë miratuar programe dhe rregullore, janë dekretuar ligje ku kanë kontributet e tyre personalitete të shquara të arsimit shqiptar, si L. Gurakuqi, S. Peci, R. Mitrovica, A. Dibra, H. Mosi. Pas shpalljes së Pavarësisë, në sajë të veprimtarisë së qeverisë së Vlorës, u krijua për të parën herë në historinë e arsimit shqiptar rrjeti i shkollave në territorin e administruar prej saj.

Vendimi i parë shtetëror për shkollat private është ai i datës 13 shtator 1913, i marrë nga Ministria e Arsimit e Qeverisë së Vlorës. Është për t’u theksuar se vetëm disa muaj pas shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, kjo Ministri lejonte shkollat e veçanta (të huaja)

190 Pipa, F (1962) ”Një shekull shkollë shqipe, 1861-1961”, Romë, fq. 6
191 Grup autorësh, MASH, ISP, (2003) *”Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*”, Tiranë, fq. 151
192 MASH, ISP,(2003*)”Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar”*, Tiranë, fq. 163
193 Kanini, I (2001), “*Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës I Botërore”,* Tiranë, fq. 11

"vetëm nëse do t'i nënshtroheshin kontrollit shtetëror"[194] (Rev. Shkolla kombëtare, 1918, fq. 60)

Për këtë duhet të plotësonin disa kushte: Të merrnin leje zyrtare nga Qeveria, të përdornin gjuhën shqipe si gjuhë mësimi, të kishin programet, librat e diplomat e mësuesve, të kontrolluara dhe të vërtetuara nga Ministria e Arsimit, si dhe t'u nënshtroheshin në çdo pikëpamje ligjeve të shtetit shqiptar. Shkolla të tjera, të çdo lloji që të ishin, nuk do të hapeshin, në qoftë se drejtorët e tyre nuk do të plotësonin detyrimet sipas ligjit të qeverisë. Ky vendim provonte se qeveria e Vlorës po merrte masa për zhvillimin e arsimit kombëtar, si dhe mbylljen e shkollave të huaja që nuk respektonin vendimin e saj. Vendimi qe kundër hapjes së shkollave në gjuhë të huaj. Kështu shkollat në gjuhën greke ose nuk u rihapën, ose u mbyllën. Në Vlorë, Berat, Elbasan etj, shkollat në gjuhën greke u mbyllën. Në tetorin e vitit 1913, në Shqipëri erdhi Komisioni Kombëtar i Kontrollit. Ky komision shqyrtoi disa herë problemin e shkollave të huaja. Ndonëse ky komision bëri presion mbi qeverinë e Vlorës për rihapjen e shkollave greke, qeveria e I. Qemalit nuk u tërhoq. Më 22 janar 1914, qeveria e Vlorës dha dorëheqjen. Në këtë periudhë e në vazhdim nga njëra anë kemi kërkesat e vazhdueshme për rihapjen e shkollave greke nga Patriarkana dhe nga ana tjetër kemi lëvizje popullore në mbarë vendin kundër rihapjes së shkollave të huaja.

Periudha 1912-1920 është faza e parë e përpjekjeve për shkollë laike, të cilat vazhduan dhe u thelluan gjatë vitit 1924. Rilindasit projektuan shkollën kombëtare, demokratike dhe laike shqipe.

Në vitin 1916 miratohet *"Programi për pesë rendet e shkollës fillore" si dhe plani mësimor për shkollat fillore. Luigj Gurakuqi ishte ndër hartuesit kryesorë të këtyre dokumenteve me rëndësi për shkollën dhe krijimin e traditave shqiptare në këtë fushë*"[195](Hoti, V 2002, fq. 199-214).

2.7.1 Gjimnazi "Illyricum"

Në vitin 1921, mbi bazën e shkollës françeskane të hapur në vitin 1861, u hap në Shkodër nga Urdhri Franceskan gjimnazi "Illyricum".

Gjimnazi françeskan i hapi dyert në shtator të vitit 1921. Ideja e themelimit lindi nga një grup profesorësh të shkollës fillore françeskane, të cilët për këtë i drejtuan një kërkesë P. Pal Dodajt (në atë kohë provincial i Shkodrës). Kërkesa u pranua dhe u siguruan fonde për blerjen e një shtëpie trekatëshe pranë kuvendit të fretërve, që do të përdorej si shkollë. Kjo ndërtesë u përshtat më së miri për mësim. Edhe shkolla fillore u zhvendos prej lokalit të vet dhe u përfshi pjesërisht në gjimnaz dhe pjesërisht në kuvendin e fretërve. Drejtor i parë ishte P. Gjergj Fishta i cili kryente njëkohësisht edhe detyrën e drejtorit të shkollës françeskane. Deri në vitin 1928, duke qenë gjimnaz klasik ai përbëhej prej shtatë klasash. Pas këtij viti u pranua program i Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë dhe ndahej në katër klasa të ulëta dhe katër të larta. Gjimnazi në fillim nuk kishte tekste të botuara, por punonte vetëm me materiale në dorëshkrim, të përshtatura sipas programit klasik të gjimnazit austriak. Me kalimin e viteve materialet në dorëshkrim u botuan si tekste shkollore. Mësuesit përgjithësisht ishin klerikë françeskanë, por kishte edhe civilë. Lëndën e gjuhës shqipe e jepnin P. A.

194 Revista "Shkolla kombëtare", (1918), Viti I, nr. 17-18. Tiranë, 1 Qershor
195 Hoti V (2002)"*Luigj Gurakuqi-për shkollën e arsimin kombëtar",* Camaj-Pipaj, Shkodër, fq. 199-214

Marlaskaj dhe P. Justin Rrota, i cili botoi edhe "Sintaksën e gjuhës shqipe"[196] (Kurti, D 1993, fq. 18). Në vitin 1924 doli matura e parë. Në këtë kohë në shkollë funksiononte "Lidhja e mësuesve", shoqatë me një statut të përcaktuar, që kishte për qëllim ngritjen pedagogjike të mësuesve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre[197] (Shllaku, L , 2002, fq. 106) Në përfundim të vitin shkollor 1927-1928 doli matura e dytë, provimet e së cilës u zhvilluan nën kryesinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Arsimit, zotit Jani Minga (në fakt e para maturë zyrtare, shënimi im E. B). Këtë vit maturën e morën 18 vetë (9 civilë e 9 françeskanë). Shumë prej tyre vazhduan studimet e larta jashtë shtetit, për inxhinieri, kimi, filozofi, arte të bukura, etj. Në vitin 1929 doli matura e dytë zyrtare (4 maturantë), në vitin 1932 doli matura e tretë (6 maturantë).

Më 25.4.1933, sipas një vendimi të Qeverisë së A. Zogut, për mbylljen e shkollave private (Reforma Ivanaj), gjimnazi e ndërpreu punën e tij, ndërsa shkolla fillore vazhdoi mësimet deri në fund të vitit shkollor. Pas tri vjet ndërprerjesh, rifilloi jetën shkolla fillore e gjimnazi. Vetëm në vitin e parë u regjistruan 72 nxënës, pa dallim besimi. Drejtor u caktua P. Frano Kiri, meqë P. Gj. Fishta u ngarkua me një detyrë tjetër. Edhe kjo fazë e dytë e jetës së shkollës u shoqërua me një punë të palodhur nga profesorët. Periudhën 3 vjeçare të shkëputjes profesorët e kishin shfrytëzuar për përgatitjen e teksteve mësimore si: "Sintaksa e gjuhës shqipe" nga P. Frano Kiri, "Histori e Ilirisë" nga P. Marin Sirdari, etj. Ky gjimnaz u ndoq edhe nga nxënës të krahinave të Jugut.

Në vitin shkollor 1938-1939 numri i nxënësve të regjistruar në shkollën fillore ishte 230-250, ndërsa në gjimnaz ky numër arrinte në 215-220 vetë.[198](Kurti, D 1993, fq. 21)

Shkolla është subvencionuar nga Ministria e Arsimit me një fond prej 15.000 franga ari. Më vonë subvencionimi u ul në 10.000 derisa u ndërpre nga kjo ministri. Presioni për ndërprerje në veprimtarisë së saj ka qenë i vazhdueshëm dhe u mor vendimi për ta mbyllur atë. Por me ndërhyrjen e Fishtës dhe mbështetjen e Vatikanit, një gjë e tillë u ndërpre dhe shkolla vijoi punën me programin e Ministrisë së Arsimit, duke ruajtur të drejtat si shkollë private[199](Shllaku, L (2002, fq. 108). Që nga kjo kohë gjimnazi françeskan filloi të quhej "Liceu Illyricum" dhe arriti të ketë 40 nxënës për çdo klasë. Nxënësit ishin të besimeve të ndryshme, kishte katolikë, por edhe muhamedanë e ortodoksë.

Në vitin 1940 doli matura e dytë. Nxënësit që e mbaruan (5 gjithsej) ishin françeskanë. Kështu vazhdoi deri në vitin 1945, vit në të cilin morën maturën 4 nxënës.

Në këtë shkollë zhvillohej gjashtë ditë në javë mësim me përjashtim të së shtunës pasdite, katër orë paradite e dy orë pasdreke. Kishte raste edhe pesë orë. Pa dashur të ndërtojmë një plan mësimor të plotë, theksojmë se lëndët që zhvilloheshin në këtë shkollë ishin: gjuhë shqipe, letërsi, gjuhë latine, matematikë, gjeometri, fizikë, kimi, histori, filozofi, botanikë, zoologji, anatomi, frëngjisht, italisht, katekizëm, muzikë, fizkulturë, vizatim, histori arti.

Më 1946, gjimnazi u mbyll. U sekuestruan lokalet e këtij institucioni, shtypshkronja, biblioteka muzeu, baza materiale e shkollës, etj. Në këtë kohë shkollën e vijonin 180 nxënës. Nga kjo shkollë kanë dalë intelektualë të shquar, të cilët kanë kontribuar në fusha të ndryshme të jetës.

196 Kurti, D. (1993), "Shkolla françeskane", Kumbona e së dielës, Shkodër, 7(13),
197 Shllaku, L(2002), "Shkollat klerikale"*(Vështrim historik nga fillimet deri më 1924)*, Shkodër, fq. 106
198 Kurti, D (1993) Artikull i cituar, fq. 21
199 Shllahu, L (2002), vepër e cituar, fq. 108

Gjimnaz i shtetit në Shkodër u hap në vitin1922. Në vite të ndryshme pati kohëzgjatje që shkon nga gjashtë, shtatë deri tetë vjet. Vitet e fundit ishte 8 vjet me bazën 5 klasë fillore. Maturantët e parë dolën në vitin 1928-1929. Në klasën e katërt të shkollës, pra bëhet fjalë për vitin shkollor 1925-1926, filloi edhe dega normale. Në një lajmërim të drejtorisë së shkollës, me firmë të dr. Mirash Ivanajt theksohet se Drejtoria e Përgjithshme e arsimit me tel. nr. 1860, dt. 26.10.1925, lajmëron se pëlqen propozimin e kësaj drejtorie për çeljen e degës normale në të cilën vetëm për këtë vit do të pranoheshin nxënës të klasës së katërt. Mësimet fillojnë më 2.11.1925[200] (AQSH, 1925, fl. 29).

Në një raport të Ministrisë së Arsimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme me nr. 1752, dt. 21.1.1923, flitet për shkollat shtetërore dhe private në Shqipëri: *"Në Shkodër gjindet nji gjimnaz klasik me dy klasat e para tuj qenë se ka fillue me motin e ri shkollor të tanishëm*"dhe vazhdon më poshtë "*Posë shkollave shtetërore……që përmendëm gjenden në Shkodër edhe dy gjymnaze të mbajtuna nga kleri katolik*"[201] (AQSH, 1923, Fl. L-3).

Nga një raport i Ministrisë së Arsimit (firmosur nga A. Dibra) "Mbi statistikën e përgjithshme të arsimit nga viti shkollor 1924-1925 e deri në vitin 1928-1929" kemi arritur të ndërtojmë këtë pasqyrë për numrin e shkollave private:

Vitet shkollore	Institute të ndr. private		Shkolla të mesme private			
	Gjithsej	Mesme	Nxënës		Mësues	
			Gj	F	GJ	F
1924-1925	44	5	361	73	49	13
1925-1926	46	5	396	73	64	6
1926-1927	54	4	503	-	33	-
1927-1928	Nuk ka ndryshim nga viti i kaluar					
1928-1929	51	6	382	142	62	30
1929-1930	-	5	-	-	-	-[199]

Tabela 6. *Pasqyrë përmbledhëse për numrin e shkollave private 1924-1930.*

Ndërsa në prefekturën e Shkodrës, nga një pasqyrë përmbledhëse statistikore për vitin shkollor 1925-1926, jepen këto të dhëna:

200 AQSH, F. 669, D. 47, V. 1925, Fl. 29
201 AQSH, F. 251, D. 300, V. 1923, Fl. L-3
202 AQSH, F. 295, V. 1924, D. 112, Fq. 1-12

Lloji	Shkolla të mesme			Personeli mësimor			Nxënës		
	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ
Shtetërore	1	-	1	9	-	9	37	-	37
Private	3	-	3	24	7	31	194	60	254[200]
	2	1	3						

Tabela 7. *Pasqyrë përmbledhëse statistikore për vitin shkollor 1925-1926, në Shkodër.*

Ndërsa për shkollat e mesme të Shkodrës në vitet 1924-1925 deri më 1928-1929 kemi këtë tabelë:

Shkollat Shtetërore (1) Shkollat private (2)	Vitet shkollore	Kur është çelë	Numri i klasave	Numri i mësuesve	Numri i nxënësve		
					Të jashtëm	Bursistë	GJ
Gjimnazi i shtetit(1)	1924-25	1922	4	10	58	11	69
	1928-29		7	15	162	46	208
Normalja femërore Stigmatine(2)	1924-25	1878	4	4	21	10	31
	1928-29		5	7	60	20	80
Gjimn. Françeskanëve (2)	1924-25	1921	6	6	76	-	76
	1928-29		7	11	83	-	83
Kolegji Jezuitëve(2)	1924-25	1878	8	12	84	-	84
	1928-29		8	13	112	-	112[201]

Tabela 8. *Shkollat e mesme në Shkodër 1924-1925 deri më 1928-1929.*

203 AQSH, F. 295, V. 1925, D. 156. Fl.10
204 AQSH, D. 156, F. 295, V. 1924, fl. 5.

Të dhëna me interes për gjendjen e arsimit në Shkodër jep edhe Teki Selenica në librin "Shqipëria më 1927" (Tiranë 1928), nga ku po nxjerrim statistikën e mëposhtme për shkollat e mesme të prefekturës Shkodër.

Shkollat	Shkolla të mesme			Shkolla Gjithsej	Nr. i nx. në shkollat e Mesme			Për të gjitha shkollat
	M	F	GJ		M	F	GJ	
Shtetërore Nr. nxënësve	1	1	2	87	9	8	17	129
	128	23	151					
Private Nr. i nxënësve	2	-	2	7	13	-	13	31[201]
	373	-	373					

Tabela 9. *Shkollat e mesme në prefekturën e Shkodrës*

Në fund të viteve '20, me çeljen e shkollave të huaja dhe prirjen për shtimin e tyre, lëvizja për kombëtarizimin e arsimit, mori një vrull të dukshëm. Shumë autorë argumentonin se Shqipërisë i duhej një shkollë ku të drejtonte shteti, sepse shkolla e shtetit ishte e vetmja vatër e formimit të njëtrajtshëm kombëtar të brezave, ku përmblidheshin fëmijë të të gjitha besimeve fetare. Nën moton se arsimi fillor ishte gjëja më delikate dhe më e shenjtë për një komb, ata argumentonin se shkollat fillore private përgatisnin breza heterogjenë duke kërkuar që kalamajtë t'i mësonte shteti në mënyrë uniforme, me kulturë kombëtare pa gardhe fetare e ndarje besimesh.

Sipas deklaratës shqiptare të 2 tetorit 1921, në Lidhjen e Kombeve, shteti shqiptar u garantonte pakicave kombëtare të gjitha të drejtat e parashikuara në normat ndërkombëtare. Në rrafshin e arsimit, popullsisë minoritare greke i ishte njohur e drejta për kultivimin e gjuhës dhe kulturës së saj kombëtare, me anë të shkollave shtetërore dhe private, të drejta që i ishin siguruar edhe pakicës serbe e vllahe. Nga 50 shkolla greke, që kishte prefektura e Gjirokastrës, 30 prej tyre ishin private. Të gjitha shkollat minoritare të Konispolit ishin private, pra 9 shkolla (MASH, 2003, fq. 431). Në shkollat private të fshatrave Sopik, Çatistë, Terihat, Grapsh, në vitin 1925, gjuha shqipe nuk mësohej fare, pavarësisht se në këto shkolla kishte mësues që dinin të shkruanin e të flisnin shqip. Gjithashtu në këto shkolla punonin edhe mësues pa marrë miratimin dhe emërimin nga Ministria e Arsimit. Duke shfrytëzuar mungesën e kontrollit të rregullt nga organet kompetente shqiptare, shumë ose të gjitha lëndët që duheshin të zhvilloheshin në gjuhën shqipe sipas programit shtetëror zhvilloheshin në greqisht. Po kështu edhe librat dhe dëftesat ishin vetëm në greqisht. Në mungesë të kuadrit dhe për shkak të dobësive organizative, shkollat minoritare nuk kontrolloheshin nga organet eprore përkatëse, madje shkollat e Delvinës e Konispolit, deri në vitin 1925, nuk ishin kontrolluar asnjëherë (MASH, 2003, fq. 432). Vetëm me ardhjen si inspektor arsimi të Jani Mingës në mars të 1925, ato shkolla nisën të kontrollohen rregullisht dhe tashmë Ministria e Arsimit kishte një tablo të qartë e të plotë të gjendjes së shkollave të minoritetit grek. Ndonëse vështirësitë ishin të madha e të shumanshme, ai arriti të bënte diçka për përmirësimin e gjendjes. Ai do të dëshmonte *"gjendja e shkollave grekofone private, prej*

205 Selenica, T (1928) "Shqypnia më 1927", Tiranë , fq. LXVII dhe 387.

pikëpamjes kombëtare, me përjashtim prej disa fare të pakta, ishte e vajtueshme". Kështu , në vitin 1931, ai arriti në përfundimin se shkollat e minoritetit grek vepronin si në kohën e sundimit osman. Më 1932 ai do shprehej se shkollat minoritare janë kazerma me ushtarë aktivë pa uniformë. Prandaj ai në këtë vit i kërkoi Ministrisë së Arsimit mbylljen e shkollave private të minoritetit grek dhe kalimin e tyre në drejtimin e shtetit shqiptar. Më 11 janar 1933 ministër i arsimit është Mirash Ivanaj.

Edhe gjatë viteve 1925-1933 çështja e ruajtjes së frymës kombëtare të shkollës dhe e laicizmit të saj, mbeti një problem mjaft i rëndësishëm. Ardhja e Hil Mosit në krye të Dikasterit të Arsimit shënoi një hap të rëndësishëm për shkollën, e sidomos për arsimin fillor. Në raportin që do t'i paraqiste qeverisë më 24 korrik 1930 ndër të tjera do të kërkonte për t'i shtetëzuar ato, ku nga shuma prej 62 shkollash, 36 prej tyre ishin private. Gjithashtu, shkallë-shkallë, duheshin kombëtarizuar shkollat profesionale italiane dhe amerikane, duke përgatitur më parë personelin shqiptar për ato institucione. (MASH, 2003, fq. 437) Ministri Hilë Mosi në bashkëpunim me A. Xhuvanin (në këtë kohë ishte sekretar i përgjithshëm Dikasterit të Arsimit, shënimi E.B) në gushtin e vitit 1932 i paraqiti mbretit një parashtesë analitike, ku çështja themelore ishte kombëtarizimi i arsimit. Duke vështruar se në 30 shkolla fillore dhe private "*grekofone, rumanofone, serbofone, italiane dhe të komuniteteve të ndryshme fetare, një sasi e madhe fëmijësh shqiptarë, rriteshin me një kulturë dhe me ndjenja të ndryshme prej atyre që jepeshin në shkollat shtetërore"*. Kështu duke parë se numri i tyre sa vinte dhe rritej, kërkohej që në ligjin e ri të arsimit, duke iu përmbajtur edhe statutit themeltar të Shtetit, të futeshin dispozita të veçanta, në mënyrë që vetëm shteti shqiptar të kishte të drejtë të hapte dhe të mbante shkolla fillore. Në janarin e vitit 1933 Hil Mosi vdiq dhe vendin e tij do ta zinte Mirash Ivanaj. Me idenë e reformimit të arsimit shqiptar, ai iu fut punës fillimisht për të njohur gjendjen si domosdoshmëri për reformën. Ai i paraqiti mbretit nevojën urdhëruese të shtetëzimit të shkollave private, sepse ekzistenca e tyre, sipas tij mund të kompromentonte pa shpresë shpëtimi formimin e një brezi të shëndoshë të domosdoshëm për afirmimin e popullit tonë si popull dhe si shtet. Duke analizuar rrezikun e shkollave të huaja, Ivanaj përfundonte se edhe sikur të huajt të vinin në Shqipëri me qëllime të vërteta mirëbërësie, nuk mund ta kryenin misionin për shkak se problemi i edukimit moral, patriotik e shoqëror, që ishte shumë më i rëndësishëm se ai diturak në Shqipëri, ishte i veçantë, dhe për t'u zgjidhur, ishte e nevojë e domosdoshme të ndiqej një rrugë tjetër e njëllojtë për të gjithë nxënësit shqiptarë larg ndryshimeve shoqërore, fetare e krahinore. Sipas Ivanajt, edhe sikur të bëheshin ligje për rregullimin dhe kontrollimin e shkollave private (vendase ose të huaja), do të ishte tepër e vështirë të zbatohej me një përfundim të mirë. E para sepse ato shkolla ishin veshur me një autoritet të tillë, saqë do të ishte shumë e vështirë t'i nënshtroheshin ligjeve kufizuese dhe, asisoj, do të shkaktoheshin keqkuptime, mosmarrëveshje e grindje me dëm të madh. E dyta, edhe sikur të krijoheshin ligje, ato do të kërkonin mbikëqyrje e kontrolle të imta dhe të shpeshta me një personel të veçantë, të aftë dhe të shpërblyer mirë, gjëra që shteti shqiptar me gjasë nuk mund t'i bënte. Ai mbronte idenë se shkolla duhet të ishte gjithëshqiptare, e në radhë të parë do të edukonte atdhetarë, në tërë komponentët e punës së saj. Në këtë mes, shteti nuk mund të hiqte dorë nga përgatitja totale, absolute e tërë dhe e pandarë e qytetarëve të ardhshëm, duke mos u dhënë një shpirt, një mendim, një ndjesi, një të vetmin moral, pa ortakë e pa ndihmësa. Vetëm me këtë edukim shkollor mund të sigurohej e tashmja dhe të ndërtohej e ardhmja. Çështjen ai do ta shtronte edhe në rrafshin teorik, duke theksuar se sa kohë shkolla kishte të bënte me formimin e njeriut, ajo ishte një veprimtari mjaft komplekse pedagogjike, psikologjike e shoqërore. Kështu si e tillë, duhet herë pas here të modifikohej dhe t'i përgjigjej kërkesave të së ardhmes. Kështu Shqipërisë i duhej një institucion arsimor i veçantë, që t'i përshtatej gjithçkaje shqiptare, detyrë që mund ta realizonte vetëm një

shkollë mbarëshqiptare në përmbajtje e metodë. (MASH, 2003, fq. 443)

Në këto kushte ai i kërkoi parlamentit ndryshimin e neneve 206-207, të Statutit të Shtetit Shqiptar, të cilët lejonin çeljen e shkollave private. Falë argumenteve bindëse të Ivanajt, më 11 prill 1933 Parlamenti miratoi ndryshimet e statutit dhe me 22 prill 1933 u sanksionua nga Mbreti. Ligji shkollor

Neni 206 i Statutit themeltar ndryshohet kështu:

"Mësimi dhe edukimi i shtetasve shqiptarë, janë një e drejtë ekskluzive e shtetit. Jepen vetëm ndër shkolla dhe institute shtetërore shkallësh të ndryshme sipas ligjit."

"Arsimi fillor për të gjithë shtetasit shqiptarë është i detyrueshëm dhe jepet falas."

"Shkollat private të çdo kategorie qofshin, që kanë veprue deri më sot, mbyllen."

Neni 207: Shkollat fetare për përgatitjen e klerit, të mbajtura prej komuniteteve fetare shqiptare, janë të lira dhe rregullohen me ligj.

ZOGU I PARË
Mbreti i shqiptarëve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e ndryshimit të neneve 197,206,207 të Statutit themeltar të Mbretërisë të votuar nga Parlamenti sipas shkresës nr. 229 datë 11.04.1933 të kryesisë së tij.

Tiranë, 22 prill 1933

Zog d. v. Kryeministri

Pandeli Evangjeli d. v.

Ministri i Drejtësisë

V. Avrami d. v.

Ministri i Punëve të Jashtme

Xhafer Vila d. v.

Ministri i Punëve të Brendshme e Zv. Ministër i Ekonomisë Kombëtare

Musa Juka d. v.

Ministri i Financave

A. Dibra d. v.

`Ministri i Arsimit

Dr. Mirash Ivanaj d. v.

Ministri i Punëve Botore

S. Saraçi d. v.[206]

206 "Fletore Zyrtare", viti XII, Nr. 21, fq. 2

Teksti i Mocionit me nënshkrime

Ne të nënshkruarit, në bazë të neneve 224 e 225 të Statutit Themelor të Mbretërisë për arsyet e treguara në raportin e bashkangjitur propozojmë këto ndryshime të neneve 197, 206 dhe 207 të Statutit Themeltar, me lutje që t'i parashtrohen Mbledhjes së Përgjithshme për bisedim e aprovim me ngutësi.

(Teksti i ndryshimit si nalt në nëntitullin Ligja Shkollore, veç me datë 10 prill 1933)

Raporti justifikues i disa modifikimeve në Statutin Themeltar

Eksperienca e arritur deri më sot me mësimin e lënë privatëve tregon se shkolla private sado e kontrolluar nga shteti nuk i është përgjigjur nevojave për të cilën ka marrë njohjen zyrtare dhe nuk ka dhënë ato fryte që, për të mirën e popullit tonë kanë pritur prej saj.

Dihet që një shkollë private për të qenë e pranuar nga shteti duhet të jetë bashkëpunëtore e tij në edukimin e brezit të ri. Porse ky bashkëpunim vetëm duhet të vërtetohet kur ekzistenca e shkollave private bazohet mbi qëllimin që ndjek vetë shteti për shkollat e veta duke plotësuar ato të meta në arsim të cilat shteti për shkaqe të ndryshme nuk mundet me ndjek.

Por, për të bërë të mundur ndjekjen e tyre, pavarësisht nga shkollat private qëllimi i shtetit duhet medoemos:

1. Burimi i mjeteve të tyre të jetë i siguruar dhe i pajtueshëm me qëllimin e shkollës shtetërore.
2. Personeli edukues i tyre të jetë i zhveshur nga çdo ndjesi që është në kundërshtim me përshkrime të Statutit tonë dhe me parimet që në dhënien e edukatës së brezit të ri.
3. Të ndihmojë shtetin, duke çelur n'ato vende në të cilat shteti nuk mund të hapë shkolla të tijat.

Dihet se shkollat tona private nuk kanë përmbushur asnjërin nga kushtet e mësipërme. Kështu vërtetohet se qëllimi i tyre kryesor nuk mund të jetë ai i shtetit.

Më 26 prill 1933, u zbatua me mbylljen e të gjitha shkollave private në Shqipëri. Më poshtë po japim një statistikë të shkollave private dhe akatolike të mbyllura.

Shkolla Katolike	Numri i nxënësve
Shkolla fillore e Jezuitëve (Shkodër)	219
Shkolla tregtare e Jezuitëve (Shkodër) dhe Gjimnazi i Jezuitëve (Shkodër)	117
Shkolla fillore e Jezuitëve (Tiranë) dhe Gjimnazi i Jezuitëve (Tiranë)	130
Shkolla fillore e Françeskanëve (Shkodër)	279
Gjimnazi i Françeskanëve (Shkodër)	159
Shkolla fillore e Stigmatineve (Shkodër)	480
Shkolla normale e Stigmatineve (Shkodër)	98
Konvikti i Stigmatineve (Shkodër)	65
Shkolla e Azili i Stigmatineve (Rus) (Shkodër)	157
Shkolla fillore dhe Azili i Stigmatineve (Shirokë) (Shkodër)	62
Shkolla fillore dhe Azili i Stigmatineve (Dajç) (Shkodër)	114
Shkolla fillore e Stigmatineve (Tiranë)	182
Azili i Serviteve (Shkodër)	355
Azili i Serviteve (Tiranë)	187
Shkolla fillore e Salezjaneve	21
SHUMA	**2560**

Shkolla Akatolike	Numri i nxënësve
Shkolla muslimane (Tiranë)	20
Shkolla rumune (Korçë)	194
Shkolla rumune Shipkë	60
Shkolla e Dokos (Tiranë)	150
Shkolla serbe fillore e Azili (Shkodër)	110
Shkolla serbe fillore Vrakë (Shkodër)	70
SHUMA	784

Tabela 10. *Statistika të shkollave private dhe akatolike të mbyllura*

Shkollat që u mbyllën sipas reformës arsimore ishin 85, të ndara sipas tabelës së mëposhtme:

Shkolla shqiptare private jofetare	**21**
Shkolla shqiptare klerikale myslimane	14
Shkolla shqiptare klerikale katolike	17
Shkolla shqiptare klerikale ortodokse	4
Shkolla të huaja për shqiptarë	19
Shkolla private të minoritetit grek	10

Tabela 11. *Shkollat që u mbyllën sipas reformës arsimore.*

Ndryshimet në arsimin e mesëm

1. Suprimimi i shkollës Normale Femërore të Korçës
2. Suprimimi i Institutit privat Femëror "Naim Frashëri"
3. Suprimimi i Institutit privat Femëror "Kyrias"
4. Suprimimi i shkollës Normale femërore katolike të Stigmatineve
5. Me largimin e personelit Italian, shkollat profesionale italiane në Berat, Korçë e Durrës u suprimuan
6. U suprimua dega normale e Shkollës Teknike të Tiranës.
7. Shkolla Teknike e Tiranës, që u shtetëzua, u plotësua me personel të zgjedhur dhe u bënë ndryshime në strukturën dhe programin e saj.
8. U suprimua gjimnazi ushtarak i Tiranës dhe shkolla bujqësore e Lushnjës.

Reforma nuk preku Institutin shqiptaro-amerikan të Kavajës, sepse ai në bashkëpunim me shtetin shqiptar, sipas një ligji të caktuar, i nënshtrohej kontrollit të shtetit dhe i jepte llogari shtetit. Po ashtu reforma nuk preku as Liceun Kombëtar të Korçës, i cili edhe pse punonte në gjuhë të huaj, Ivanaj nuk e konsideronte shkollë të huaj.

Sipas këtyre ndryshimeve, shkolla shqiptare hynte në një fazë të re të zhvillimit të saj. Viti shkollor 1933-1934, fillonte vetëm me shkolla shtetërore. Reforma e Ivanajt qe radikale. Ajo rroku të gjitha dukuritë e punës së shkollës. Edhe pse reforma të tilla në perëndim ishin bërë afro dy shekuj më parë, mendimi dhe nisma e Ivanajt pati edhe kundërshtarë. Reforma preku dhe alarmoi qarqet drejtuese të shkollave private dhe të huaja brenda dhe jashtë vendit. Kleri katolik në Shkodër, me përkrahësit e tij dhe përfaqësues të minoritetit grek në Gjirokastër, iu kundërvunë ashpër reformës. Kleri mysliman dhe ai ortodoks nuk bënë asnjë reagim. Kleri katolik me tërë mjetet propagandistike doli fuqishëm në mbrojtje të shkollave të tij, me argumente historike, për ndihmesën e meshtarëve katolikë në lëmin e arsimit shqip e të gjuhës shqipe. Ndërsa në Shkodër, u krijua një tension i madh, në Prefekturën e Gjirokastrës u krijua një shqetësim edhe më i madh. Autoritetet shtetërore greke, të cilave iu mbyll porta e ndërhyrjes në Shqipëri, e paraqitën shtetëzimin e shkollave minoritare greke, si masë për të ndaluar mësimin e greqishtes në ato shkolla. Me anë të konsullatave të tyre në Shqipëri dhe të disa klerikëve ortodoksë, organizuan një fushatë sistematike

me propagandë shpifëse kundër shtetit shqiptar. Për ta bërë çështjen shqetësim ndërkombëtar, u vu në lëvizje shtypi grek dhe në disa qendra të Greqisë së Veriut u bënë mitingje e protesta në mbrojtje të shkollave private minoritare, sikur minoriteti grek në Shqipëri persekutohej. Qeveria Italiane nuk doli hapur në mbrojtje të shkollave të saj në Shqipëri, kurse në kanale diplomatike ka një mori dokumentesh që tregojnë fare haptas, shqetësimin e shtetit Italian për shkollat e saj në Shqipëri. Qeveria italiane shfaqte shqetësim jo të vogël edhe për shkollat e klerit katolik, ku gjuha italiane, letërsia italiane dhe kultura italiane në përgjithësi, zinin vend të rëndësishëm në programet dhe praktikat e atyre shkollave. Për sa i përket shkollave profesionale italiane, në të vërtetë ligji nuk parashikonte mbylljen e tyre. Mësuesit duhet të lidhnin një kontratë pune me Ministrinë e Arsimit dhe se ato shkolla do të vareshin këtej e tutje nga një seksion i kësaj ministrie. Dhe krahas drejtorit teknik italian do të vendosej një drejtor administrativ shqiptar. Mirëpo, shteti italian, që donte dorë të lirë, e tërhoqi shpejt personelin. Pas dy vjetësh, çështja e shkollave private, mori karakter ndërkombëtar, sepse në një anë kleri katolik, me përkrahjen e heshtur nga diplomacia italiane dhe qeveria greke në anën tjetër, iu drejtuan Lidhjes së Kombeve në Gjenevë. Sipas reformës, minoritetit i siguroheshin po ato të drejta, si për të gjithë shtetasit shqiptarë. Mbyllja e shkollave private nuk vinte në masa shtrënguese pakicën greke në Shqipëri, që të hiqte dorë nga ajo që formon thelbin e jetës së saj si etni më vete. Megjithatë, çështja kishte karakter juridik dhe Komiteti i Lidhjes ia drejtoi Gjyqit Ndërkombëtar të Hagës, i cili e zgjidhi në të mirë të kërkesës greke, me 8 vota pro dhe 3 kundër. E manipuluar sipas interesash të caktuara ndërkombëtare, të cilat shkonin në dëm të Shqipërisë, Lidhja e Kombeve plotësoi kërkesën greke për minoritetin e saj në Shqipëri dhe nuk pyeti për çështjen e shkollimit shqip.

Qeveria shqiptare iu nënshtrua vendimit të Gjyqit Ndërkombëtar dhe shkollat private minoritare greke u rihapën. Prandaj Ivanaj i cili kishte deklaruar se nuk do të pranonte asnjë ndërhyrje në punën e tij, më 16 gusht 1935, dha dorëheqjen me argumentin: *"Vetëm shkollat e shtetit, pa as më të voglin cënim të të drejtave individuale ose kolektive, djelmënia jonë mund të edukohet si e tillë e të fitojë ndjesinë dhe ndërgjegjen ndërkombëtare, moralin dhe disiplinën shtetërore. Në kuptimin e sakrificës për atdheun e për mbretin, nuk mund të bashkohem me mendimin e shumicës së Këshillit Ministror e të pranoj çfarëdo ndryshimi në zbatimin e nenit 207 të Statutit të Mbretërisë".*

Një tentativë e tillë radikale në fushën arsimore ishte i destinuar të dështonte, sepse shteti shqiptar ishte shumë i dobët ekonomikisht e politikisht, kështu që mbreti u detyrua të kthehej në partneritetin e mëparshëm italo-shqiptar. Reforma e Ivanajt forcoi e shkollën kombëtare, por nga ana tjetër ngadalësoi ritmin e përparimit të saj. Me mbylljen e shkollave fetare një numër mësuesish mbetën të paaktivizuar. Mbyllja e shkollave private solli në disa qytete, si në Shkodër, një grumbullim të tepruar nxënësish, dhe si rrjedhojë klasat u mbipopulluan. Largimi nga Shqipëria e një pjese të instruktorëve- mësuesve të huaj të aftë profesionalisht e varfëroi cilësinë e arsimit. Kjo qe shumë e ndjeshme sidomos në Shkollën Teknike të Tiranës, e cila mbasi u shtetëzua humbi shumë nga efikasiteti i mëparshëm.

Pas Ivanajt, në qeverinë e Mehdi Frashërit, ministër arsimi erdhi Nush Bushati. Periudhës së Bushatit në Ministri i përket riçelja e shkollave private të klerit katolik, të vendosur në parim nga Gjyqi Ndërkombëtar i Hagës dhe të sanksionuar ligjërisht pas marrëveshjes Italo-shqiptare, të marsit të atij viti, me dekret mbretëror të 9 majit 1936.

Pas N. Bushatit në krye të Ministrisë së Arsimit u emërua Faik Shatku, të cilit i takoi të çojë deri në fund procesin e riçeljes së shkollave të klerit katolik.

Në periudhën 1925-1939 arsimi parashkollor nuk pati një shtrirje të kënaqshme, të marrë fizionomi të njehsuar si sistem. Në vitin 1925, Shqipëria kishte 11 kopshte për fëmijë, ndërsa në 1939 nuk e kaluan shifrën 23, me 2434 fëmijë dhe me 40 edukatore. Kopshtet më shumë ishin si klasa përgatitore të fillores sesa si njësi të plotësuara më vete në sistemin arsimor.

Më të organizuara, ishin kopshtet në Tiranë, Korçë, Shkodër e Durrës. Institucioni arsimor më i rregullt, me program laik dhe me kushte materiale shumë të mira ishte kolegji privat "Teuta" në kryeqytet, që u hap më 7 prill 1930. Themeluesi, mbajtësi dhe drejtuesi i tij Rexhep Dizdari, i shkolluar për pedagogji në Itali, e bëri kolegjin model shembullor jo vetëm për mësim, por edhe për ngrënie, fjetje e higjienë. (MASH, 2003, FQ. 458)

Ndonëse Reforma e vitit 1933 parashikonte masa për rimëkëmbjen e arsimit parashkollor, nuk u bë ndonjë hap i rëndësishëm për arsye të buxhetit të varfër, si dhe jetëshkurtësisë së Reformës. Institucionet parashkollore me programe të qarta pedagogjike, personel të kualifikuar dhe me bazë materiale shumë të mirë, ishin kopshtet private të mbajtura dhe të drejtuara nga kleri katolik, të quajtura azile. Aty pranoheshin fëmijë me pagesë të shtresave të kamura të besimit katolik. Përveç Shkodrës, azile të tilla u hapën në Tiranë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan. Pranë azilit të Serviteve në Shkodër, kishte edhe një jetimore, ku nuk kishte asnjë kufizim për pranim fëmijësh, fetar apo shoqëror. Në Shkodër numri i fëmijëve në këto kopshte, arriti 500 me 8 edukatore.

Në vitin shkollor 1924-1925, vendi ynë kishte 447 shkolla fillore, me 25187 nxënës dhe 757 mësues. Edhe ai numër i kufizuar shkollash ishte i shpërndarë në mënyrë të shpërpjesëtuar midis prefekturave të vendit. Shpërpjesëtimi më i madh vërehej në raportin fshat-qytet dhe midis zonave të një krahine, me një tjetër. Me përjashtim të fshatrave të Prefekturave të Gjirokastrës dhe të Korçës, në pjesën e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, numri i shkollave ishte tepër i vogël. Përhapja e kulturës në popull ndikohej edhe nga faktorët ekonomikë dhe traditat e shkollimit të përgjithshëm. Pas vitit 1933 numri i shkollave rritet. Sistemi shkollor shqiptar është i bazuar në reformën e Ivanajt. Ky sistem ka vazhduar të ndiqet nga viti 1934-1944, me disa ndryshime të diktuara herë pas here nga rrethanat shoqërore dhe politike. Në vitin 1938-1939 në Shqipëri kishte 23 foshnjore, 643 fillore, dhe 22 të mesme, me 60763 nxënës të mësuar nga 1660 mësues dhe instruktorë.[207] Në tabelën e mëposhtme vërehen ndryshimet statistikore sa i përket gjendjes së arsimit shqiptar në vitet 1938-1939, ashtu siç reflektohen nga burimet shqiptare, britanike dhe italiane.

207 Annuari Statistikor i Republikës Populllore të Shqipërisë, kap. 12, Tiranë 1959, fq. 263+23. Këto shifra janë të afërta me burimet britanike, ndërsa burimet italiane janë më të largëta. Tabela italiane jep një numër më të madh shkollash fillore, por më të pakët për sa i përket shkollave të mesme se tabelat shqiptare dhe britanike. Edhe numri i nxënësve është përgjithësisht më i madh . Në anën tjetër, tabela nuk jep numra nxënësish në shkolla të mesme të disa qyteteve si Elbasani, Korça, Durrësi ku ka pasur edhe femra, pavarësisht nga numri i tyre i kufizuar.

NUMËR	BURIME		
	Shqiptare	Britanike	Italiane
Shkolla foshnjore	23	13	21
Fëmijë	2434	2000	2453
Mësues	40		40
Shkolla fillore	643	642	663
Nxënës	52024	54526	56936
Djem	35067		38988
Vajza	16597		17948
Mësues	1349	1351	1302
Shkolla të mesme	22	18	19
Nxënës	6315	5677	6235
Djem	4547		4810
Vajza	1768		1425
Mësues	271	261	293
Gjithsej, fillore dhe të mesme	665	660	682
Nxënës	58339	60203	63171
Mësues	1620	1612	1595

Tabela 12. *Ndryshimet statistikore mbi gjendjen së arsimit shqiptar në vitet 1938-1939.*

Në vitin shkollor 1939-1940, kemi 663 shkolla fillore, me 54558 nxënës dhe 1388 mësues. Pra, rezulton se gjatë periudhës 1925-1939 kemi një shtim prej 200 shkollash fillore, me një rritje mesatare vjetore prej 14 shkollash në vit, me 400 nxënës. Po kështu kemi edhe një shtim në numrit të mësuesve, me rreth 600 mësues. Jashtë statistikave të shkollave fillore të mbajtura nga shteti, në Shqipëri kishte edhe disa shkolla fillore private, të mbajtura nga institucione klerikale ose me personel të huaj të mbajtura nga fonde të huaja. Sipas ligjeve në fuqi, shkollat private duhet të punonin sipas programeve të shkollave fillore shtetërore.

Përveç shkollës fillore me konvikt, të mbajtur nga familja amerikane Kenedi në Korçë, që dallohej për kushte shumë të mira të gjithanshme, u dalluan edhe shkollat e klerit katolik në Shkodër, si ato të urdhrit jezuit dhe françeskan, të cilat u dalluan për tekste, mjete mësimore, pajisje për mësim dhe veprimtari të shumta e të pasura artistike, kulturore e sportive. Mësuesi i shkollave jezuite ishte shumë autoritar dhe krejt i pavarur në punën e tij. Në shkollë mbizotëronte një disiplinë rigoroze.

Gjatë kësaj periudhe në Shqipëri ekzistonin edhe shkolla fillore italiane, të çelura ligjërisht për fëmijët e shtetasve italianë që punonin në Shqipëri, si në Shkodër, Vlorë, Durrës e Tiranë. Me punën e mirë që bënin ato tërhoqën edhe nxënës shqiptarë nga kategori të ndryshme shoqërore.

Pas vitit 1929 të huajt lejoheshin të hapnin vetëm shkolla profesionale. Gjithashtu, edhe inspektimi i të gjitha shkollave, sipas shkallës, bëhej nga inspektorët përkatës,

gjë që u mbajt parasysh edhe më pas. Në një nga ligjet e arsimit në kreun IV "Administrata e qarkut dhe inspektimi i shkollave", në artikullin 123 shkruhet: "*Kontrollimi dhe inspektimi i shkollave fillore, internateve fillore të shtetit, ashtu edhe i të gjithë institucioneve private të kësaj kategorie, u ngarkohen inspektorëve të arsimit fillor"*[208]

Shkollat profesionale italiane u çelën gjatë vitit 1929 në Gjirokastër, Berat, Korçë e Shkodër. Qëllimi i këtyre shkollave ishte të nxirrnin teknikë dhe artizanë për nevojat aktuale të Shqipërisë. Në bazë të burimeve financiare që rridhnin nga huaja SVEA, Shkollat u vendosën në ndërtesa të mira, u pajisën me mjete mësimore moderne, të ardhura nga Italia, me biblioteka me fond të pasur, si me tekste mësimore, ashtu edhe me literaturë profesionale dhe të kulturës së përgjithshme. Gjuha, letërsia, historia e gjeografia u zhvilluan nga mësues shqiptarë. Shkollat e Beratit u quajtën thjesht profesionale dhe ishin me program 4 -vjeçar. Ato të Korçës e Shkodrës, të quajtura industriale, ishin me program 8- vjeçar me dy cikle 4- vjeçare. Nxënësit mund të ndiqnin kurset e plota ose kurset e mbrëmjes. Duke ruajtur një kuotë të caktuar të numrit të nxënësve, ata pranoheshin pa detyrim financiar, përveç pesë franga ari në vit si garanci shëndetësore në rast të ndonjë aksidenti të vogël në punë. Të gjithë nxënësit, pajiseshin nga shkolla me libra dhe tërë mjetet mësimore, si dhe me rroba pune për praktikën në ofiçinë.

Në fillim të vitit 1932, autoritetet italiane planifikuan shtimin e kapaciteteve dhe riorganizimin e shkollave profesionale, por Reforma e vitit 1933 ua preu udhën duke i shtetëzuar. Si pasojë e kësaj këto shkolla u mbyllën përfundimisht.

Në shkollat private, të huaja ose vendëse, falë angazhimit të madh të nxënësve dhe të vetë drejtorive të shkollave, veprimtaritë jashtëmësimore ishin më të shumta, më të larmishme dhe me nivel të lartë të zhvillimit. Për nga programi i pasur dhe serioziteti i zbatimit tyre, veprimtaritë jashtëmësimore nuk dalloheshin nga vetë procesi mësimor, pra konsideroheshin si shkollë e dytë për nxënësin. Vendin e parë e zinin shkollat e klerit katolik në Shkodër, kryesisht të Urdhrit Jezuit. Në shkollën teknike të Tiranës veprimtaritë jashtëmësimore arritën një nivel të lartë, të paparë në Shqipëri deri në fund të Luftës së II Botërore.

Me interes është: "Rregullore për shkollat private të minoriteteve" e Ministrisë së Arsimit të Mbretërisë Shqiptare. Në bazë të nenit 5 të Deklaratës të lëshuar në Lidhjen e Kombeve më 2 tetor 1921, shkollat private të minoriteteve u lanë të veprojnë të lira, me mësues të zgjedhur prej minoriteteve e të pëlqyeshme prej Ministrisë së Arsimit.[209]

Më 1 tetor 1921 u hap në Tiranë e para shkollë profesionale, e quajtur *Shkolla Teknike*, (e njohur me emrin Shkolla Teknike e Tiranës, shënimi im E. B). Harry Fultzi asokohe 34 vjeç, profesor i "Arteve Mekanike" në Universitetin e Çikagos, profesor i mësimeve pasuniversitare në "Kolegjin e Arsimit", i diplomuar gjithashtu për shkenca edhe nga instituti i teknologjisë "Armour", pedagog i shquar amerikan "një njeri entuziast, me gjykim të shëndoshë, personalitet të përkryer dhe iniciator", do ta drejtonte Shkollën Teknike deri në vitin 1933. Talenti si pedagog dhe administrator, optimizmi i pashtershëm, ishin vendimtare për ekzistencën, gjallërimin dhe rritjen e shkollës. Fultz-i së bashku me Carls A. Hollingshead (nëndrejtor i shkollës dhe një ndër anëtarët e parë të personelit mësimor) si dhe

208 Mbretëria Shqiptare (1933) "Ligjet e Arsimit", Tiranë.

209 Mbretërija Shqiptare. Minisria e Arsimit (1935): *"Rregullore mbi shkollat private të minoriteteve"*, Tiranë.

pedagogë e instruktorë të tjerë amerikanë e shqiptarë, me vetëdije të plotë ju përkushtuan nxënësve dhe çështjes së arsimit në Shqipëri.

Shkolla financohej plotësisht nga shoqata "Kryqi i kuq Amerikan", kurse programi shkollor ishte i njëjtë me programin e shkollave teknike të qytetit industrial amerikan, Pitzburg. Shkolla Teknike u jepte nxënësve njohuri të posaçme teorike dhe praktike me një gamë të gjerë programesh profesionale. Ajo kishte një central elektrik që i jepte dritë qytetit si dhe shtypshkronjën e vet. Ajo ndërmerre projekte ndërtimi, zhvillonte veprimtari të shumta sportive e kulturore dhe publikonte gazetën e njohur "Laboremus", mulli drithi, kombinat druri, fabrikë akulli, ofiçinë, automjete dhe makineri të ndryshme, shërbim postar, qendër sinoptike, bankë monetare për nxënësit, etj. Cilësia e programeve ishte e tillë që të diplomuarit e shkollës pranoheshin në universitetet më të njohura të SHBA-së dhe Evropës. Si rezultat i veprimtarisë së saj të suksesshme, nga viti në vit, rritet numri i nxënësve, të cilët do të pajiseshin me kulturë teorike e praktike si mjeshtra punimi. Kështu në vitin shkollor 1921-1922, shkolla kishte 64 nxënës e 7 mësues, dhjetë vjet më vonë, më vitin shkollor 1931-1932, shkolla kishte 410 nxënës dhe 30 mësues. Në vitin 1933, vit në të cilin u mbyll shkolla, arriti të ketë 522 nxënës dhe 34 mësues. Qeveria shqiptare i dha këtij institucioni 60 mijë franga ari, nga 150 mijë që kishte buxheti për gjithë arsimin shqip[210] (Kraja, M 2008, fq. 66)

Shkolla Teknike e Tiranës luajti një rol të rëndësishëm për edukimin e të rinjve me ndjenjën e patriotizmit, të disiplinës, me dashurinë dhe respektin për punën. *"Përpiqu ta bësh Shqipërinë një vend për të cilin ia vlen të jetosh"* thoshte Harry Fultz.

"Dhënia e anglishtes nga z. Hollingshed ishte diçka më tepër se thjesht mësim gjuhe. Qysh në fillim ai i përqendronte nxënësit të përshkruanin botën natyrore përqark, njëkohësisht përdorte muzikën duke u mësuar fëmijëve këngë, disa nga të cilat i kompozonte vetë. Studimi i historisë së natyrës dhe muzikës shërbente si mjet aktiv në metodën e tij për të lehtësuar mësimin e anglishtes. Baza e metodës së tij ishte veprimi. Nga kjo të rinjtë në çdo rast, ngulitnin në mendje trajtat e ndryshme të foljes.[211] (Fulz-Kantos, J 1994, fq.52)

Hollingshed përdorte metoda krejt personale e shumë të frytshme, sajonte përherë materiale që i përshtateshin nivelit, aftësive, interesit dhe rrethanave të djemve, u mësonte atyre si duhet të vërenin me kujdes të bënin pyetje me vend, të përshkruanin dhe të mbanin shënimet si duhet[212] (Fulz-Kantos, J 1994, fq. 59)

Ja çfarë na tregon Q. D një nga ish-nxënësit e kësaj shkolle*:"... Atë ditë mësuesi plak, hyri me një sëpatë me bisht të gjatë, të cilën e kishte mbështetur në shpatullën e djathtë si druvarët. Një cung druri ishte i ngulur në të. Duke e vendosur mbi tavolinë ai na përshëndeti të gjithëve duke na thënë: "Good morning boys". Të gjithë qeshëm. Ishte rasti i parë që një mësues, për më tepër me një sëpatë në krah, na fliste në një gjuhë të huaj, ne fëmijëve të mbledhur aty nga e gjithë Shqipëria. "Good morning" tha ai dhe ne përsëritëm lehtë, fill mbas tij, "Good morning". Ishim gjithsej 12 fëmijë, të gjithë të ulur në nga një karrige të gjerë, që kishte një krah në anën e djathtë, sa për të vendosur një fletore. Të gjithë kishim shpinën nga muri dhe mësuesi mund të na shikonte edhe këpucët. Duke ulur sëpatën për tokë, mbasi ia hoqi asaj bishtin nga hekuri filloi të shqiptonte më ngadalë, "This is*

210 Kraja , M (2008) *" Pedagogji e zbatuar"*, Tiranë, fq. 66
211 Fulz- Kantos, J (1994), Kryqi i Kuq Shqiponja e Zezë, fq. 52
212 Fulz- Kantos, J (1994), Kryqi i Kuq Shqiponja e Zezë, fq. 59

the wood", pastaj me radhë "This is the axe" "This is the wood" përsëri, po këtë radhë për copën e drurit që qëndronte në tokë. Pastaj duke e goditur fort atë me sëpatë tha: "I chop , I am chopping". Kaq ishte mësimi i parë në një shkollë pune, ku do të flitej për gjithë kohën vetëm anglisht dhe ku për herë të parë këta të rinj po bënin mësimin e pedagogjisë. Së bashku dhe të gjithë ishin nga trevat e tokave tona shqiptare…" (Dita e parë e mësimit)

Si çdo shkollë tjetër, *Shkolla Teknike amerikane*, kishte të përcaktuar qartë qëllimin e saj: dhënie mësimi dhe stërvitje në lëndët themelore teorike e praktike. Shkolla kishte vendosur për nxënësit disa detyrime që ata duhet t'i plotësonin, si mbarimin e klasës V të shkollës, vërtetimin mjekësor se nuk vuan nga asnjë lloj sëmundjeje, të ketë sjellje të mirë, të mos jetë më i vogël se 13 vjeç e jo më i madh se 16 vjeç, të jetë i vendosur t'u bindet rregullave të shkollës[213].

Dukuri e veçantë në strukturën e shkollës teknike, ishte prania e një dege pedagogjike, nisma e çeljes të së cilës i përkiste Ministrit të Arsimit, Rexhep Mitrovica. Duhet të theksojmë se dukuria më origjinale e punës pedagogjike, ishte fleksibiliteti i programit, që u kurorëzua me programet vetjake. Ajo ishte risia më joshëse pedagogjike, që dha fryte shumë të mira në institucion. Programet vetjake i jepnin mundësi çdo nxënësi të vendosej në kushte të barabarta, për të arritur shkallën më të lartë të zhvillimit të prirjeve dhe të aftësive. Në shkollën teknike u arrit një formim i shëndoshë i edukatës së punës, me përqasje, si detyrë, si veprimtari e përballueshme, si kënaqësi. Në sajë të punës në praktika u arrit që shkolla të mbulonte disa nga shpenzimet e saj, deri një ditë duke e mbajtur krejt veten.

Edhe veprimtaritë jashtëshkollore qenë risi për arsimin shqiptar. Ato ishin të organizuara sipas sistemit amerikan të klubeve: klubi bujqësor, klubi industrial, klubi pedagogjik, klubi letrar, klubi dramatik, klubi koral-muzikor, klubi atletik dhe kryqi i kuq i shkollës. Në këto klube u zhvilluan tërë prirjet e kërshëritë e nxënësve.

Në vitin 1933, si pasojë e reformës Ivanaj, shkolla teknike u shtetëzua. Mësuesit amerikanë u larguan dhe programi pësoi ndryshime rrënjësore. U lagua edhe bërthame e mësuesve shqiptarë të përgatitur në shkollat amerikane. Me këtë reformë shkolla do të quhej "Instituti Teknik".

Shkolla Teknike e themeluar prej të rinjve të Kryqit të Kuq Amerikan shfrytëzonte disa lloj burimesh financiare nga qeveria shqiptare, kryqi i kuq amerikan i të rinjve, veprat e ndryshme të shkollës, punëtoria e shkollës dhe bursat private[214] (Kadiu, 2002, fq. 68) Për vitin shkollor 1929-1930, pagesa e shkollës nga prindërit ishte 25 napolona në vit. Gjysma paguhej në tetor dhe gjysma në shkurt. Një numër i caktuar bursash dhe gjysmë bursash u jepeshin nxënësve të vobektë.

Çështja e arsimimit të femrës zuri vend edhe në Parlamentin shqiptar të viteve 1921-1924. Në një nga seancat parlamentare të vitit 1921, u kërkua çelja në shkallë vendi e shkollave të reja fillore femërore, si edhe çelja e një shkolle normale femërore për përgatitjen e mësueseve; u shtrua si domosdoshmëri ngritja metodike e kuadrit arsimor në shkollat ekzistuese, u miratua çelja e shkollës normale femërore private "Kyrias"[215]. Më 2 tetor 1922, u hap në Tiranë shkolla normale femërore private me emrin "Instituti Kyrias". Protagoniste të hapjes së këtij instituti kanë qenë pedagoget e shquara shqiptare

213 Shkolla Teknike (1928) "Libri i rregullave", Tiranë.
214 Kadiu, A (2002) "Shkolla private-jopublike", Tiranë
215 *AQSH*, Fondi 259, viti 1921, dos. 46, f. 3.

Parashqevi Qiriazi dhe Sevasti Qiriazi, që kishin mbajtur shkollën shqipe të vashave në Korçë. Në këtë nismë pjesëtar ishte dhe Kristo Dako. Në këtë shkollë të mesme private e tipit të kolegjit amerikan[216](MASH, 2003, fq. 479), përveç mësueseve shqiptare dhanë mësim edhe mbi dhjetë mësuese të huaja: zvicerane, amerikane, franceze dhe italiane. Shkolla përbëhej nga tre departamente: plotësues, përgatitor dhe specializues. Ky i fundit që zgjaste tre vite, degëzohej në këto profile: dega normale, që përgatiste mësues, dega shkencore- shtëpiake; dega leteriale (humaniste). Për sa i përket strukturës dhe programit, ajo ishte baras me një akademi femrash, e ngjashme me shkollat e huaja evropiane bashkëkohore. Sipas marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit, me pak ndryshime aty u zbatua programi shtetëror, në përputhje me programet e institucioneve analoge të kohës. Gjuhë mësimi aty ishte shqipja megjithëse disa lëndë, si edukimi estetik, vizatimi, muzika, ekonomia shtëpiake dhe higjiena zhvilloheshin në gjuhën frënge; ndërsa kimia, fizika, botanika e ndonjë tjetër në gjuhën angleze. Megjithëse me tekste anglisht, pedagogjia dhe psikologjia jepeshin shqip. Vend të rëndësishëm në program e zinin historia e gjeografia e Shqipërisë dhe letërsia shqipe, që zhvilloheshin në gjuhën amtare.

Pranë internatit ishte edhe kopshti i ekonomisë ndihmëse, i mbjellë me elb dhe misër, si dhe me ngrehina, ku mbaheshin dhentë e pulat, nga të cilat konvikti siguronte qumështin, gjalpin, djathin, mishin, vezët, etj. Si shkollë elite, deri në vitin 1930, ky Institut arriti të ketë 136 nxënëse dhe 12 mësuese, ndërsa nga viti 1925 deri në vitin 1933 kur u mbyll, nxori 40 kandidate, të cilat më së shumti shërbyen në arsim.

Në Institutin Kyrias, për vitin shkollor 1931-1932, pagesa nga prindërit për nxënësit e kursit fillor (mosha 7-11 vjeç) 700 franga ari, ndërsa për nxënësit e kursit të mesëm (mosha 11-15 vjeç) dhe atij superior (mosha 15-17, 18,19 vjeç) 650 franga ari"[217].

Normalja Femërore "Naim Frashëri"në Tiranë u themelua në Tiranë në vitin 1930. Ishte shkollë private me emrin Liceu dhe Normalja "Naim Frashëri". Falë punës këmbëngulëse të drejtorit Qamil Bala, shkolla arriti të ketë në fund të vitit të dytë, 100 nxënëse. Themeluesi i shkollës Q. Bala, synonte të ngrinte një institucion arsimor me konvikt të tipit të kolegjit, nga shkolla fillore deri në mbarim të shkollës së mesme, me 2-3 degë specializimi. Por koha nuk i premtoi, sepse vdiq shumë herët, më 1933 në moshën 55 vjeçare. Ai i dha shumë rëndësi konkretizimit duke i kushtuar një rëndësi të madhe emancipimit të femrës.

Në vitin 1937 (kur ministër arsimi ishte Dr. Mirash Ivanaj) kemi publikimin e disa ligjeve të tjera për arsimin. Në kaptinën V "Ndërrimi i degëve ose i shkollave" në nenin 330 të Ligjit shkruhet: "Nxënësit e shkollave të mesme të huaja dhe, ata, që kalojnë nga një shkollë e mesme në një tjetër me qëllime e programe të ndryshme ose prej një dege në një degë tjetër, do t'u nënshtrohen provimeve plotësuese në ato lëndë të detyrueshme, të cilat nuk i kanë mësuar në shkollën e mëparshme ose i kanë mësuar mbi një tjetër bazë e me kufij më të ngushtë".[218](MA, 1937)

Për hapjen, funksionimin dhe vazhdimin e shkollave private ka disa rregulla shtetërore, dispozita të veçanta, etj. Dokumentet historike e arsimore flasin rreth krijimit të një përvoje të re e të panjohur. Në "Rregulloren për shkollat private të minoriteteve "e Ministrisë së Arsimit të Mbretërisë Shqiptare (1935) dalin në pah disa veçori që duhet të kishin shkollat private të minoritetit. Sipas kësaj rregulloreje përcaktohej se

216 MASH (2003) "Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar", Vëll. 1, Tiranë
217 Instituti Kyrias, kolegj për vajza, (themeluar më 1891), Kamëz– Tiranë, 1931
218 Mbretërija Shqiptare. Ministria e Arsimit: (1937)"Dekret Ligja organike e Arsimit", Tiranë.

numri i fëmijëve të përfshijë të dy sekset që kanë mbushur moshën ligjore të detyrimit shkollor. Për mësuesit që do të punonin në këto shkolla merrej miratimi nga Ministria e Arsimit, të cilës i dërgohej emri dhe jetëshkrimi i shkurtër i tyre. Edhe në nenet e tjera theksohet se kërkohet zbatimi i dispozitave ligjore të Ministrisë së Arsimit. Kjo rregullore tregon sesa rëndësi i jepej figurës së mësuesit dhe rolit të tij, si realizues i procesit të mësimit dhe të edukimit të nxënësit. Mësuesit duhet të kishin figurë të pastër dhe të mos ishin implikuar në organizata të huaja, në dëm të interesave dhe të integritetit kombëtar. Ata duhet të paguhen vetëm nga popullsia e vendit që e ka hapur shkollën minoritare. Kjo rregullore shprehte edhe kujdesin për arsimimin e të gjithë fëmijëve dhe suksesin e tyre.

Është me interes të ndalemi te "Ligji mbi ndërtesat shkollore dhe orendive të tyre", në nenin 1 në të cilin shkruhet: "Ndërtesat e shkollave fillore ngrihen të reja ose meremetohen e përmbahen (mirëmbahen E.B) me shpenzimet e popullsisë së lagjeve të qyteteve dhe të katundeve"[219].

Për sa i përket kuadrit arsimor që do të punonte në këto shkolla, pavarësisht nga theksimet e ndryshme, kujdesi ishte i përhershëm. Kërkesa për një mësues të përgatitur lidhej edhe me synimin që niveli i nxënësve të rritej sa më shumë. Kështu, sipas dokumenteve, në një shkresë të Luigj Gurakuqit theksohet: *"Mësuesit e shkollave fillore përveç njohurive të plota që duhet të kenë si në gjuhë e në çdo degë tjetër të ditunisë, duhet të njohin edhe mjeshtrinë e mësimit, në theori e në praktikë. Ata që nuk e ndjekin fare apo të paaftët në provimet e lëndëve të shpejta do të pushohen nga puna, ata që do të kalojnë me notën 4 do të mbahen përkohësisht. Për këtë arsye t'i vini kujdes të madh këtij rendi, sa më tepër të shtrënguet në provimet që do të jepen në javën e tretë të shtatorit.*

Siç do ta shihni programa asht mjaft e përmbledhtë e ka vetëm për qëllim t'u zgjanohen njohuritë mësuesve tue u dhanë të kuptojnë se si lypet t'sillen në shkollë, se si duhet të zhvillohen landët e mësimet gjer në të tretin rend të shkollës fillore…".

2.7.2 Medreseja e vitit 1925 në Shkodër

Kjo medrese u quajt "Medreseja e Re" dhe u hap në vitin shkollor 1925-1926. Drejtor i parë i saj qe Hafiz Ibrahim Kaduku. Fillimisht kjo medrese u hap në një shtëpi në rrugën "Naim Gjylbegu" dhe më vonë u vendos në ndërtesën e rindërtuar në Mejtepin e Molla Medos te Xhamia Plakë.

Medreseja e Re u konceptua, u organizua, u administrua dhe u drejtua si shkollë moderne, me programe, me tekste e mësues shqiptarë. Dokumentacioni i kësaj shkolle qe tepër i rregullt, me amzë, regjistra, orar, dëftesa e karakteristika nxënësish. Shkolla pati lokal të përshtatshëm e me orenditë e nevojshme. Kuadri qe i plotë, me drejtor, me mësues të lëndëve të kulturës së përgjithshme e fetare e me mësues kujdestarë. Struktura e vitit shkollor ishte me tremujorë. Kjo shkollë punonte me një plan mësimor të studiuar, që përmbante mbi 20 lëndë. Nga analiza e këtij plani rezulton se lëndët e kulturës së përgjithshme përfshinin shkenca shoqërore, si: këndim, gramatikë, hartim, drejtshkrim, bukurshkrim, histori-gjeografi e logjikë, ndërsa shkencat natyrore, lëndë si: aritmetikë, gjeometri, botanikë, shkencë (kimi, fizikë). Përveç këtyre, në planin mësimor si lëndë fetare mësoheshin: Kuran, besim e moral dhe si gjuhë të huaja mësoheshin arabishtja e frëngjishtja. Së bashku me

219 Ministria e Arsimit: "Ligja mbi ndërtesat shkollore dhe orendive të tyre"

këto lëndë në këtë shkollë mësoheshin edhe lëndë të tilla, si: gjimnastika, vizatimi, puna e dorës, muzika e higjiena. Në dëftesat e nxënësve ishte nota edhe për sjellje e zell. Për sa më sipër jemi bazuar në dëftesat që disponojmë të nxënësve Hafiz Xhevdet Zylja e Hafiz Murat Piraniqi. Prej këtyre lëndëve, 15 jepeshin para një komisioni provues midis të cilave: Besim, Ku'rani qerim, gjuhët e huaja arabishtja e frëngjishtja, këndimi, gramatika, hartim, drejtshkrim, bukurshkrim, histori, gjeografi etj. Nga dëftesat kuptohet se gjuha arabe mësohej me nënndarje, si lexim e gramatikë. Në aspektin fetar gërshetohej ana teorike me atë praktike në shkollë e në faltore dhe në veprimtari të ndryshme me karakter përkujtimor e festiv.

Ky parashtrim i planit mësimor na lejon të vëmë në dukje se raportet e gruplëndëve ishin të arsyeshme e të rregullta, se nxënësit formoheshin mirë e drejt, merrnin kulturë të gjerë të përgjithshme e të mjaftueshme fetare, mësoheshin e edukoheshin dhe përgatiteshin edhe shpirtërisht.

Puna krijuese e reformuese drejtuese e Hafiz Ibrahim Kadukut synonte për ta bërë medresenë një shkollë me objektiva të emancipuara, me bashkërendim të menduar të drejtimit kulturor e fetar, me rregullsi e disiplinë të një institucioni arsimor bashkëkohor e me kërkesa rigoroze për nxënësit.

Medreseja e Re e Shkodrës e të gjitha medresetë e qarqeve të Shqipërisë u mbyllën në bazë të vendimit të Kongresit III Mysliman të Shqipërisë.

2.7.3 Medreseja e Xhamisë Plakë, viti 1944

Ndonëse medresetë në qarqet e Shqipërisë u mbyllën në vitin 1929, me kalimin e kohës lindi sërish domosdoshmëria e hapjes së tyre. Shkodra ishte ndër të parat qytete që i rihapi ato në vitin 1944, e cila mori emrin "Medreseja e viteve 1944-1947". E mori këtë emër sepse qëndroi e hapur gjatë këtyre viteve. Medreseja e Xhamisë Plakë është e lidhur ngushtë me ngritjen dhe ndihmesën e Komunitetit Bamirës Mysliman në Shkodër. Ky Komitet i krijuar më 26.12.1943, si detyrë parësore përcaktoi hapjen e një Medreseje në Shkodër. Me rastin e inaugurimit të lokalit të ri të ish-mejtepit të Molla Medos, të rikonstruktuar, Hafiz Esat Myftia ndër të tjera shtroi problemin e hapjes së medresesë. Mes të tjerash ai theksoi: "*... Me formue medrese d.m.th. me mbajtë në këmbë Ligjin e Zotit, at Ligj që bota sado të marrë prej tij s'pushon së buruemi. Medreseja qe ajo që i çeli sytë botës. Për ne mjafton me shpresue se ky institut ka me kenë vend-burimi i Fesë, i moralit, i ndërgjegjes së pastër dhe vend-edukativ për Rininë Myslimane.*"

Komiteti Bamirës mori masat e duhura organizative, ekonomike e pedagogjike, e rregulloi lokalin, e pajisi me orendi, siguroi kuadrin, tërhoqi nxënësit, krijoi konviktin, plotësoi të gjitha kushtet për hapjen e saj.

Mësimi filloi me 27.12.1944 në një atmosferë feste mes të ftuarve të shumtë, të popullit dhe nxënësve. Hapja e medresesë u miratua nga Kryemyftinia e Shkodrës dhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.

Si për Komitetin Bamirës ashtu edhe për medresenë hapjen dhe mbarëvajtjen e saj një rol me rëndësi ka luajtur kryemyftiu i Shkodrës, Hafiz Sabri Beg Bushati. Për propagandimin e tyre në organet e shtypit, si revistat "Kultura Islame", "Njeriu" dhe në gazetën "Bashkimi i Kombit", shquhet medresisti Ismail Muçej.

Arsyet e hapjes së medresesë janë të shumta. Mes tyre përmendim:

- mungesa e kuadrove të reja dhe nevojën për to në të ardhmen,
- përgatitja e kuadrove kryhej vetëm në Tiranë dhe përmes studimit pranë myderrizëve që kishin të drejtën e lëshimit të diplomave (ixhazeteve).
- Me vendim të Kongresit të tretë të Komunitetit Mysliman ishin mbyllur të gjitha medresetë e rretheve.
- Për shkak të Luftës së Dytë Botërore ishte ndërprerë studimi jashtë shtetit në universitetet e huaja të kuadrit të lartë fetar.
- Ideologjia ateiste komuniste ishte hedhur në sulm kundër fesë për të marrë pushtetin, gjë që shtronte me forcë rolin e shkollës dhe të kuadrove të reja fetare në këtë fushë.

Pranë konviktit kanë punuar me angazhim të madh Hafiz Riza Bebeziqi e Musa Kastrati, të cilët kanë treguar një kujdes të vazhdueshëm për ushqimin, veshmbathjen, regjimin e studimit, veprimtaritë jashtëshkollore e argëtimin e nxënësve.

Struktura e vitit ishte e ndarë në tremujorë, mësimet zhvilloheshin 5 ditë në javë, dita e premte dhe e diele ishin pushim. Çdo ditë kishte pesë orë mësimi, 3 paradreke e 2 pasdreke. Ngarkesa mësimore ishte normale dhe e përballueshme nga nxënësit.

Medreseja e vitit 1944 zgjati vetëm 3 vite mësimore.

VITI SHKOLLOR	KLASAT
1944-1945	vetëm klasë përgatitore
1945-1946	klasën përgatitore dhe klasën e parë
1946-1947	një klasë përgatitore, një klasë të parë dhe një klasë të dytë.

Tabela 13. *Të dhëna mbi Medresenë.*

Në vitin 1944-45 klasa përgatitore ka pasur 48 nxënës, 22 ishin konviktorë, 6 kishin ½ burse dhe 20 ishin të jashtëm. Shumica e nxënësve ishin nga qyteti, por ka pasur edhe nga fshatrat e Oblikës, të Barbullushit, të Shtojit të Vjetër, të Vrakës, të Gruemirës, të Grudës së Re e të Zogajve nga rrethi i Shkodrës dhe ai i Koplikut, i Lezhës, Pukës, e Kukësit, pra nga të gjitha krahinat veriore si dhe nga Ulqini i Malit të Zi. Numri i përgjithshëm i nxënësve ka qenë mbi 60.

Pranë kësaj medreseje kanë ndjekur mësimet si klasë më vete, grupi i telebejve të rritur, mbi 10 vetë, duke ndjekur vetëm lëndët e kulturës së përgjithshme, mbasi mësimet fetare i merrnin tek myderrizi i njohur Haxhi Hafiz Muhamet Bekteshi.

Programi për klasën përgatitore përmbante të gjitha lëndët e shkollës fillore shtetërore. Ai zhvillohej për një vit për të siguruar nivelin e barabartë të nxënësve të rinj. Ata përgatiteshin për të filluar klasën e parë të medresesë, mbasi disa prej tyre kishin formim dhe moshë të ndryshme.

Për të paraqitur planin mësimor të kësaj shkolle, nuk kemi gjetur planet e kohës, por jemi mbështetur tek dëftesa e nxënësit Sami Muçej. Sipas kësaj dëftese

zhvilloheshin këto lëndë të kulturës së përgjithshme: gjuhë shqipe, histori, gjeografi, matematikë, histori natyre, fizikë, kimi, edukatë morale-qytetare, higjienë, vizatim, bukurshkrim e edukatë fizike.

Lëndët fetare ishin këto: Kuran, tefsir, besim, hytbe, gjuhë arabe, etimologji e gramatikë, histori e shenjtë, ilahi e praktikë fetare. Formimit fetar të nxënësve i kanë shërbyer falja e përditshme, mbajtja e hytbeve në ditën e xhuma, praktikimi i detyrës së imamit e të myezinit, këndimi i Mevludit, festimi i festave fetare, dhënia e programeve fetare nga grupi artistik i shkollës me pjesë kuranore, ilahi, salavate e tema të ndryshme, etj.

Për edukimin e përgjithshëm të nxënësve kanë ndihmuar edhe veprimtaritë e shumta e të larmishme jashtëshkollore, si: bisedat, ekskursionet, puna me librin në bibliotekën e shkollës, kremtimi i festave fetare e kombëtare, shfaqjet e grupit artistik, ndeshjet sportive, vizitat në familjet e nxënësve fshatarë tek nxënësit qytetarë, ceremonitë e mbylljes së vitit shkollor etj.

Të gjithë nxënësit vishnin uniformën shkollore, ishin të pajisur me kartën e studentit me fotografi e të dhëna tjera të shumta, dalloheshin për rregull, disiplinë, studim, përparim e pastërti. Ceremonitë e fundit të vitit ishin tepër festive, prekëse e mbresëlënëse me pjesëmarrjen e mësuesve, nxënësve, prindërve, qytetarëve, Komunitetit Bamirës, të autoriteteve fetare lokale e qendrore. Në vitin 1944-45 nxënësve të dalluar iu dhanë dhurata me rastin e mbylljes së vitit shkollor. Çmimi i parë iu dha nxënësit Enver Barbullushi (një orë dore), i dyti iu dha nxënësit Shefqet Kraja (një penë ari), i treti iu dha Izet Hoxhës (një çantë lëkure), ndërsa të tjerëve iu dhuruan libra.

Me këtë rast një nxënës i dalluar tha: "*Të gjithë neve një ditë do t'i shtijmë shpatullat e do t'i japim gjoksin Fesë Islame. Medreseja na shton zellin e përpjekjet tona drejt së mirës që na pret e na ban të përqafojmë fjalën e dhanun: Duam të jemi shërbëtorë të denjë e prijësa të drejtë të Fesë Islame*". Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Hirësia e tij Hafiz Musa Aliu me përmallim u shpreh: "Na urojmë që ju, o nxënës, të bëheni të mirë e të na ndiqni që të gëzojmë edhe ne". Kryemyftiu i Tiranës, Hafiz Muharrem Mollahi shtoi: *"Ju lumtë, ju o djema, që dhatë shembull të një këtë vepre, ju meritoni uratë të panumërta". Ky zotëri në darkën e shtruar theksoi edhe këtë: "Instituti që keni formuar asht konform me qytetërimi e kulturën e sotme dhe në përpikëri me edukimin e naltë islam. Medreseja juaj ka plotësisht pamjen e një shkolle me karakteristika moderne, këtu mësohet dituni fetare dhe dijeni moderne, shkencë. Atu ku ngrihet një shkollë fetare don të thotë të zgjedhësh tendencat, të zgjanosh rrethin e arsyetimit, sipas nevojës, të suprimosh një gjygj e të mbyllësh një burg. Sot ky institut, kjo shkollë kulturore, ka ngul themelet në vend dhe ndihma e Zotit Fuqiplotë garanton mbarëvajtjen e saj. Ai që ka për të guxue të cënojë integritetin e saj fetar, do të jetë mëkatar i pafalun, armik i islamit dhe i gjithë neve".*

Funksionimi i kësaj shkolle edhe në kushtet e rënda e të rrezikshme të luftës, vetë me kontributin e popullit të Shkodrës, është një shembull i shkëlqyer për të sotmen dhe të ardhmen. Mirëmbajtja e ndërtesës, sigurimi i pajisjeve, shpërblimi i kuadrit, furnizimi i konviktit me të gjitha kërkesat, plotësimi i nevojave administrative e zhvillimi i veprimtarive jashtëshkollore vetëm me ndihmën e popullit, të bamirësve shkodranë, është një vepër e bukur qytetarie e veprim i lavdërueshëm islam që duhet pasur parasysh e praktikuar edhe në ditët e sotme.

Këto arritje nuk vazhduan gjatë, sepse një korrespondencë e gjatë mes Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Drejtësisë, Komunitetit Mysliman, Kryemyftinisë e Komitetit Bamirës, ishte tregues i mbylljes së shpejtë të kësaj shkolle, tregonte qartë, synimin e organeve shtetërore për të mos lejuar më shkollat private e fetare, për të zhdukur mundësinë e përgatitjes së kuadrove të reja fetare.

Viti shkollor 1946-47 qe viti i fundit të kësaj medreseje. Kryesia e Komitetit Ekzekutiv të KP të Nënprefekturës njoftonte drejtorinë e medresesë se në mbështetje të vendimit Nr.293/94 datë 22.09.1947 të Komitetit Ekzekutiv të K.P. të Prefekturës, drejtoria e Foshnjores Nr. 4 urdhërohej të merrte në dorëzim lokalin e asaj medreseje me gjithë materialin që dispononte përkundrejt një procesverbali dhe të inventarit të shkollës. Nxënësit u shpërndanë në shkollat shtetërore .

2.7.4 Medreseja e Përgjithshme, Tiranë

Të gjitha medresetë e qarqeve të Shqipërisë u mbyllën në bazë të vendimit të Kongresit III Mysliman të Shqipërisë .Statuti i miratuar në këtë kongres në vitin 1929, në kreun X, në nenet 55-57 nënvizonte se "Do të ketë një institut në qendrën e komunitetit me më emër "Medrese e Përgjithshme", e cila përfshin kategoritë e mësimeve filluer e të mesme… Medresetë e qarqeve syprimohen dhe vakëfet e tyne bahen t'ardhuna të Komunitetit"(Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar, 1929)[220]

Më 1924, në nivelin e gjimnazit klasik e teologjik, me personel tërësisht shqiptar u themelua "Medreseja e Përgjithshme e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Tiranë". U hap në bazë të vendimit Nr. 1051 dhe Nr. 1252 të Qeverisë Shqiptare dhe u organizua në përputhje me nenin 60 të Statutit të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Hapat e parë kjo medrese i hodhi në rrethana te veçanta historike që po kalonte shoqëria shqiptare në atë kohë.

Në përparimin e medresesë patën rëndësi edhe vendimet e Kongresit të Komunitetit Mysliman Shqiptar, e në mënyre të veçantë pikëpamjet përparimtare të kryetarit të këtij Komuniteti Haxhi Vehbi Dibra.

Më 1931 përfunduan punimet e ndërtesës. Ky qe një sihariq për tërë botën shqiptare. Mehdi Frashëri, një nga politikanët dhe sociologët e shquar shqiptarë, në fjalën e përshëndetjes tha: *"Përparimi i vrullshëm për ne shqiptarët është një nevojë e jetës, se për të mjeruarit në këtë botë s'ka mëshirë. Mëshira mund të jetë personale, por jo midis popujve, d.m.th. se s'është internacionale.*

Ai popull që rrëzohet me këmbët e veta, s'ka të drejtë të ankohet. Medresetë që do të jenë foleja e prijsave të fesë islame në Shqipëri duhet të konformohen me frymën e shekullit brenda të cilit jetojmë."

Medreseja e Përgjithshme e Tiranës brenda pak viteve e fitoi fizionominë e vet si një institucion serioz, ku merrej një formim i shëndoshë fetar dhe kombëtar. Kjo u arrit në sajë të trupit mësimor të pedagogeve, të cilët ishin shquar në lëvizjen kombëtare për çlirimin e Shqipërisë dhe njëkohësisht mbeten të respektuar dhe në periudhën kur vendi hyri në rrugën e emancipimit shoqëror. H. V .Dibra, që drejtoi për shumë vjet medresenë, Qamil Bala, drejtori i saj i parë, Ismet Dibra,

220 Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar(1929), Tiranë, fq. 13

Haki Sharofi, Isa Domni, Esat Myftia e të tjerë që qenë në krye të saj, kishin një përgatitje të lartë teologjike, filozofike, etike e sociologjike. Shkrimet e tyre janë dëshmi e kulturës së gjerë që zotëronin.

Medreseja punonte mbi bazën e një rregulloreje të përbërë prej 92 nenesh, ku përcaktohej çdo gjë që kishte të bënte me këtë institut. Medreseja e Përgjithshme vazhdonte 10 vjet, 3 prej të cilëve i përkisnin arsimit fillor, kurse 7 të tjerët përbënin arsimin e mesëm, të ndarë në kursin e ulët (4-vjeçar) dhe kursin e lartë (3-vjeçar). Viti mësimor fillonte më 1 tetor dhe mbaronte më 30 qershor. Nxënësit ishin kryesisht konviktorë dhe të seksit mashkull. Në fund të çdo viti mësimor, sidomos në fund të çdo cikli, nxënësit maturantë jepnin 4 provime me shkrim e me gojë: besim, arabisht, gjuhë shqipe dhe histori e shenjtë. Në lëndën e besimit maturantët bënin një provim praktik, si dhe një predikim në një xhami faqe popullit. Në fund nxënësit pajiseshin me diplomë. Sistemi i vlerësimit ishte me 10 nota.

Që në themelimin e saj u pajis me plan dhe program mësimor të nivelit bashkëkohor. Plani mësimor i gruplëndëve profesionale fetare u gërshetua me gruplëndët që karakterizonin shkollat e mesme shtetërore, licetë klasikë. Ajo nxori dijetarë dhe shkencëtarë të aftë si Vexhi Buharaja, Shaban Demiraj, Vehbi Ismaili e të tjerë, punimet e të cilëve kanë zënë vend në fondet e shkencës sonë shqiptare.

Medresistët zhvillonin një veprimtari të gjerë jashtëshkollore, shkencore e artistike. Ata shfrytëzonin për këto qëllime festat fetare e ato kombëtare. Përgatisnin këndimin e Mevludit shqip, ilahive etj., të cilat i zhvillonin para publikut. Në harkun kohor 1931-1941, trupi mësimor i medresesë ishte mjaft i ngritur nga ana intelektuale.

Pas Luftës së Dytë Botërore mbijetesa e saj u bë shumë e vështirë. Pushteti komunist i imponoi me vendim të veçantë një plan-program mësimor, që prekte thellë fizionominë dhe përmbajtjen e saj. Në mes lëndëve që iu imponuan ishte edhe gjuha ruse. Jo shumë kohë më vonë, gjuhës ruse iu shtua lënda e darvinizmit. Ndaj këtyre masave personeli mësimor reagoi ashpër. Esat Myftia, ish-drejtor i Medresesë së Përgjithshme, dha dorëheqjen.

Më 1967, kjo medrese, fole e mendimit islam shqiptar, u mbyll. Mësuesit dhe nxënësit u shpërndanë, u morën me punë të tjera dhe një pjesë u internuan ose u futën nëpër burgje.

Me rikrijimin e Komunitetit Mysliman dhe kërkesat e popullit për të vazhduar traditën e edukimit fetar përmes medresesë, kjo shkollë u rihap më 1991. Ajo mori emrin e dijetarit të njohur në fushën e drejtësisë islame "Haxhi Mahmud Dashi".

Për këto lloje shkollash, do të paraqesin interes disa shënime për Medresenë e Tiranës, nisur nga ideja e madhe kombëtare se edhe në shkollat e tjera private fetare mësojnë fëmijët tanë shqiptarë, pjesë e brezit të ri, qytetarë të vendit tonë, përmes kujtimeve të ish mësuesit patriot H. Sharofi, nga një analizë që i bëhet figurës së tij. *"Në atë institucion shumë autoritar, me nxënës të zgjedhur në filtër moral familjar, shoqëror, rigoroz, me një trupë pedagogjike mjaft serioze, me rregull e disiplinë...kanë dalë nxënës të shkëlqyer që më vonë u bënë personalitete të shquara si gjuhëtari i mirënjohur Shaban Demiraj, poligloti dhe përkthyesi i madh Vexhi Buharaja,etj., pasi ajo nuk jepte vetëm kulturë fetare, por edhe shkencat që*

jepeshin në shkollat e atëhershme".[221] Medreseja e Tiranës ishte një gjimnaz me programe klasike shumë të ngjeshura. Këto përbëjnë një traditë të shkëlqyer duke mbetur një mesazh aktual dhe i përhershëm që u drejtohet mësuesve që japin e do të japin gjuhën, letërsinë, historinë dhe gjeografinë e Shqipërisë në shkollat private fetare. Aty nxënësit përveç arabishtes mësonin edhe anglisht, lëndë të cilat i jepnin edhe provim.

Reforma arsimore e vitit 1946, në kuadër të afirmimit të karakterit laik dhe shtetëror të shkollës, i hapi rrugën mbylljes së shkollave fetare e private.

221 Gogaj, I (14 prill 1995): "Mësuesi atdhetar veteran i shkollës shqipe", Gaz."Rilindja".

KAPITULLI III

ZHVILLIMET E ARSIMIT JOPUBLIK PAS VITEVE '90

Në këtë kapitull do paraqesim zhvillimet që ky arsim ka pasur pas viteve ’90, sipas indikatorëve të performancës së shërbimit arsimor jopublik, tregues që do të na mundësojnë vlerësimin e arritjeve në krahasim me vendet e rajonit dhe vendet e BE-së.

3.1 Zhvillimi i arsimit jopublik pas viteve ‘90

Ndryshimet demokratike të viteve ’90-të sollën në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës kërkesën për rivendosjen e arsimit jopublik, me paraqitjen edhe të kërkesave të para për krijimin e një alternative të re arsimimi, përveç atij publik. Në mungesë të një legjislacioni që rregullonte raportet ndërmjet organeve drejtuese të arsimit dhe subjekteve private (komunitete fetare, shoqata, fondacione, persona fizikë apo juridikë), në këto vite është operuar mbi bazën e marrëveshjeve ndërmjet palëve. Rregullimi i parë ligjor u bë me ligjin e datës 21.06.1995, “Për sistemin arsimor parauniversitar”. Ndërsa në Kushtetutën e Shqipërisë shkruhet: *“Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit.”*[222]

Fillimisht, në vitet 1990-1995, alternativën e re të arsimimit e përkrahën komunitetet fetare si; shoqata dhe fondacione të ndryshme, persona juridikë të huaj, të cilët themeluan Medresenë. Gradualisht, pas viteve 1998-1999, kjo alternativë filloi të shihej si interesante edhe për personat juridikë ose fizikë vendas, prirje e cila u zhvillua edhe më shumë pas vitit 2000. Ky zhvillim lidhet me vetë zhvillimin e politikave arsimore, që pasqyrohen nëpërmjet kuadrit ligjor për arsimin privat parauniversitar, i cili ka ndryshuar gradualisht dhe është përforcuar me aktet nënligjore përkatëse.

3.1.1 Organet përgjegjëse dhe roli i tyre për arsimin jopublik

Organet përgjegjëse për institucionet arsimore private parauniversitare janë Këshilli i Ministrave, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale e Rinisë dhe institucionet në varësi të ministrive, ku mund të përmendim Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore dhe Zyrat e Punës.

Këshilli i Ministrave. Roli i tij konsiston në dhënien e lejes së funksionimit të institucioneve arsimore private parauniversitare dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj.[223]

222 Kushtetuta e Shqipërisë, neni 57, pika 6.
223 Ligji nr. 8387, datë 30.07.1998, “Për sistemin arsimor parauniversitar”, Neni 44, pika 1.

Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ky institucion është organi kompetent për hapjen e institucioneve arsimore private laike, në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Ky organ përcakton kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes për shkollat private laike, në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, me anë të akteve nënligjore përkatëse, si dhe i propozon Këshillit të Ministrave akte nënligjore për kriteret ose procedurat për hapjen e shkollave të tjera private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare ose në të cilat mësimi bëhet në gjuhë të huaj[224].

Roli i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit lidhet edhe me përcaktimin e njëvlershmërisë për njohjen e dokumenteve të përfundimit të një klase a një shkolle private. Ky institucion nxjerr akte nënligjore të veçanta për kalimin e nxënësve nga një shkollë private në një shkollë publike[225]. Funksion tjetër i kësaj ministrie është kontrolli periodik i procesit mësimor laik, për të verifikuar realizimin e kërkesave të planit e të programeve mësimore të miratuara nga ministria. Ky funksion realizohet në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore[226].

Për arsimin profesional privat, Ministria e Arsimit dhe Sportit përgjigjet për miratimin e krijimit ose riorganizimit të institucioneve private, që realizojnë arsimin profesional e teknik, si dhe propozon tek organet përgjegjëse për mbylljen e tyre, kur provohet që veprimtaria e tyre nuk përputhet me aktet përkatëse nënligjore.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka të drejtën e dhënies së licencave për kryerjen e veprimtarive të formimit profesional dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së licencuar të formimit profesional si dhe të drejtën e mbylljes së kësaj veprimtarie, kur nuk është në përputhje me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore.

Njësitë arsimore vendore. Ministria përfaqësohet në nivelin vendor nga njësitë arsimore vendore, të cilat krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Njësitë arsimore vendore janë drejtoritë arsimore, në nivel qarku, dhe zyrat arsimore, në nivel rrethi. Njësia arsimore vendore është përgjegjëse për funksionimin e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të saj[227].

Këto janë organe të specializuara që, së bashku me Drejtorinë e Inspektimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, kryejnë inspektime në procesin mësimor në institucionet arsimore private të licencuara, duke realizuar në këtë mënyrë vlerësimin real të cilësisë së shërbimit të ofruar. Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe njësisë arsimore vendore shfaqet edhe në rastet e heqjes së licencës së shkollave private të arsimit të detyruar. Në këtë rast Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe njësia arsimore vendore përkatëse i vendos nxënësit në institucione të tjera arsimore, publike ose private. Shpenzimet për përfundimin e një viti shkollor, për të gjithë nxënësit e regjistruar në atë shkollë private, përballohen nga garancia bankare e institucionit arsimor privat të mbyllur. Modalitetet e transferimit të nxënësve përcaktohen me udhëzim të ministrit[228].

224 Po aty, neni 44, pika 4
225 Po aty , neni 45, pika 2
226 Po aty, neni 47
227 Neni 30,"*Njësitë arsimore vendore*" *pika 1,2,3* , ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"
228 Neni 70, *"Shkelja e kërkesave ligjore nga institucionet arsimore private", pika 5* , ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"

3.1.2 Kuadri ligjor i përgjithshëm për hapjen dhe funksionimin e institucioneve parauniversitare jo publike

Kuadri ligjor në fuqi, në fushën e arsimit privat përfshin:

1. Nenin 57, pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995, "Për sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar me anë të Ligjit nr. 8387, datë 30.07.1998, "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995, "Për sistemin arsimor parauniversitar" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 358, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar.

   Licencimi i tij bëhet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".
3. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 28.05.1999, "Për kriteret e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore private parauniversitare dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj".
4. Udhëzimin nr. 33, datë 1.11.2010 "Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare".
5. Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".
6. Udhëzimin nr. 6, datë 14.03.2003, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale "Për regjistrimin e institucioneve të AFP".
7. Udhëzimin nr. 1590, datë 04.08.2008, të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale "Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional".

3.1.2.1 Kriteret për dhënien e licencës[229]

1. Drejtoria për Zhvillimin e Arsimit Privat (DZHAP), shqyrton paraprakisht dokumentacionin e subjektit (person juridik) që aplikon për licencë, të dërguar në mënyrë elektronike (*on line*) nëpërmjet regjistrit aplikativ nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL). Në rast se gjatë shqyrtimit paraprak, DZHAP vë re se ka mangësi në dokumentacion, i propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës refuzimin e kërkesës[230].
2. Shqyrtimi i dokumentacionit bëhet në përputhje me kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese shoqëruese përkatëse, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar.[231]

229 Udhëzim, nr. 33 datë 1.11.2010, kreu I, *Kriteret për dhënien e licencës*
230 Po aty, pika 1.
231 Po aty, pika 2.

3.1.2.2 Kushtet për të hapur një shkollë private

Subjekti, i cili kërkon të hapë një shkollë private, aplikon pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Leja për hapjen e shkollës private jepet kur planet, programet mësimorë dhe kushtet e realizimit të tyre nuk bien në kundërshtim me interesat kombëtare, me legjislacionin shqiptar, me rendin publik, me normat morale dhe higjienën, si dhe kur sigurohen kushtet materiale të domosdoshme së bashku me personelin e nevojshëm mësimor[232].

Kur kërkohet leje për hapjen e një shkolle private ku do të zhvillohen lëndë fetare, ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, gjuha dhe letërsia shqipe, historia e kombit shqiptar dhe gjeografia e Shqipërisë zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe[233].

Subjekti aplikues duhet të jetë i regjistruar në gjykatë si person juridik dhe të ketë të përcaktuar në objektin e tij të aktivitetit hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar. Ai duhet të plotësojë kushtet fizike, duke siguruar një godinë të përshtatshme për shkollë, si dhe të pajisur me bazë materiale dhe didaktike, të ketë kurrikula të përshtatshme për nivelin përkatës si dhe stafin e duhur mësimdhënës[234].

Subjekti aplikues duhet të plotësojë kriteret dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

Formularin e vetëdeklarimit i cili përmban[235]:

a) numrin dhe datën e ekstraktit historik të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) për regjistrimin si person juridik, me aktivitet në fushën e arsimit privat, të lëshuar jo më parë se tre muaj që nga data e depozitimit të kërkesës;

b) numrin dhe datën e lejes higjieno-sanitare, të lëshuar jo më parë se tre muaj që nga data e depozitimit të kërkesës;

c) numrin dhe datën e vërtetimit nga njësia e pushtetit vendor për mbrojtjen kundër zjarrit, të lëshuar jo më parë se tre muaj që nga data e depozitimit të kërkesës;

d) datën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe kohëzgjatjen e saj (jo më pak se 5 (pesë) vjet) dhe/ose datën e dokumentit të pronësisë (kopje të njësuar me origjinalin), të nxjerrë jo më herët se tre muaj nga data e depozitimit të kërkesës. Deklarata të shoqërohet me dokumentet përkatëse;

e) datën e nxjerrjes dhe kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit dhe lejes së punës për shtetasit e huaj, të lëshuar jo më parë se tre muaj që nga data e depozitimit të kërkesës;

f) deklaratën e subjektit që nuk është në ndjekje penale nga organi i prokurorisë, proces gjyqësor, proces hetimi;

g) deklaratën e subjektit që ka të ardhura të mjaftueshme për të ushtruar aktivitetin, për të cilin kërkon të licencohet;

h) numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT);

232 Ligji nr. 8387, datë 30.07.1998, Për sistemin arsimor parauniversitar, neni 44, pika 2.
233 Ligji nr. 8387, datë 30.07.1998, Për sistemin arsimor parauniversitar, neni 44, pika 3.
234 Ligji nr. 8387, datë 30.07.1998, Për sistemin arsimor parauniversitar, neni 46.
235 Udhëzim, nr. 33 datë 1.11.2010, kreu I, *Kriteret për dhënien e licencës*, pika 3, i.

Dokumentacioni teknik.[236]

Kërkesa e subjektit duhet të jetë e shoqëruar me:

a) Deklaratën për emërtimin e institucionit, numrin e telefonit personal dhe të institucionit, adresën e postës elektronike, nivelin e arsimimit që do të ofrojë, numrin e grupeve apo të klasave që do të formohen, numrin e fëmijëve/nxënësve për grup/klasë dhe për shkollat, titullin e dokumentit që do të lëshohet në përfundim të çdo viti shkollor, apo kursi;

b) Deklaratën për shërbimet që do të ofrohen në këtë institucion dhe për tarifën përkundrejt së cilës ofrohen shërbimet e deklaruara;

c) Planin mësimor dhe programet lëndore që do të zbatojë institucioni;

d) Listën e teksteve që do të përdoren: në lëndët mësimore të detyruara sipas altertekstit (për vitin shkollor përkatës), apo në lëndët mësimore shtesë, me zgjedhje apo fakultative;

e) Listën e plotë e stafit drejtues, mësimdhënies dhe ndihmës, ku duhet të përfshihet edhe administratori, e shoqëruar me deklaratën e subjektit për arsimimin përkatës të stafit si dhe për ngarkesën mësimore të tij;

f) Deklaratën për inventarin faktik të bazës materiale dhe asaj didaktike që mendohet të vihet në dispozicion dhe që është në funksion të arsimimit, edukimit dhe realizimit të kërkesave të programeve lëndore, për të provuar se mjetet mësimore janë të mjaftueshme për realizimin e kërkesave të planit mësimor dhe të programeve lëndore.

Verifikimi i përmbushjes së standardeve normative të infrastrukturës të objektit shkollor realizohet nga një person juridik apo fizik i licencuar pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari në ndërtim". Subjekti i licencuar kontrollon, nëse aplikuesi disponon lejen higjieno-sanitare dhe vërtetimin nga njësia e pushtetit vendor për mbrojtjen kundër zjarrit. Personi fizik ose juridik i licencuar përgatit një relacion, i cili i bashkëlidhet dokumentacionit të aplikimit.[237]

3.1.3 Standardet normative që duhet të përmbushë/in objekti/et që do të funksionojnë si institucione arsimore[238]

a) Klasë e zakonshme konsiderohet ai mjedis mësimor që ka një normativë sipërfaqeje shfrytëzimi prej 1.3-1.6 m2/nxënës;

b) Nyjet hidrosanitare përfshijnë 1 boks për 40 djem, 1 boks për 30 vajza, si dhe 1 boks për administratën.

c) Për kopshtet, shërbimet higjienike vendosen pranë çdo grupi dhe pozicionohen në mënyrë të tillë që të jenë sa më afër për secilin grup. Numri i bokseve duhet të jetë 3 (tre) për një grup, duke i ndarë me mure nga njëri-tjetri që ndërkohë duhet të ketë dhe katër lavamanë me ujë të pijshëm. Banjat duhet të kenë porta

236 Po aty, pika 3, ii.
237 Udhëzim, nr. 33 datë 1.11.2010, kreu I, pika 4 *Kriteret për dhënien e licencës.*
238 Po aty, pika 5.

të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja. Të përjashtohet hapja e dyerve nga brenda për lehtësimin e daljes në raste emergjence. Pajisjet e banjave duhet të jenë të përshtatshme për moshën e fëmijëve.

d) Për edukimin fizik, subjekti që kërkon licencë duhet të ketë në dispozicion një palestër (për shkollat nën 100 nxënës shfrytëzohet një klasë në katin përdhes me përmasa 60 m^2) dhe një kënd sportiv jo më të vogël se 100 m^2.

e) Objektet arsimore që vihen në dispozicion për nivele të ndryshme arsimimi (kopsht, shkollë 9-vjeçare dhe shkollë të mesme) të kenë mjedise që nuk komunikojnë me njëri-tjetrin.

f) Lidhur me normativën e ndriçimit natyral duhet që sipërfaqja e dritareve të mbulojë minimalisht 15% të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi duhet të jetë në krahun e majtë të nxënësit, mundësisht i orientuar nga juglindja. Ndriçimi të realizohet me dritare me xham të tejdukshëm. Dritaret nuk lejohet të vendosen në murin ku është vendosur dërrasa e zezë.

g) Për shkollat e arsimit bazë (sistemi 9-vjeçar) duhet të jenë në dispozicion, minimumi, 9 klasa për ciklin e ulët dhe të lartë dhe dy dhoma mësuesish. Për shkollat e ciklit të ulët (5-vjeçar) duhet të jenë në dispozicion, minimumi, 5 klasa dhe një dhomë mësuesish. Për shkollat e mesme të përgjithshme/profesionale duhet të jenë në dispozicion, minimumi, 5 dhoma mësimore. Për kopshtet të ketë minimalisht 3 dhoma mësimore.

h) Objektet arsimore me mbi 200 nxënës duhet të jenë të pajisura me dalje dhe shkallë emergjence.

i) Objektet arsimore duhet të jenë të pajisura me pikën e ndihmës së shpejtë dhe pajisjet e nevojshme në të.

j) Objektet arsimore duhet të kenë sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit.

k) Objektet arsimore të jenë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore dhe të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për nxënësit duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. Materialet e përdorura për ndërtimin e tyre nuk duhet të kenë elemente përbërëse të dëmshme për shëndetin e nxënësve. Këto materiale duhet të sigurojnë akustikë të mirë në mjedisin e mësimit dhe të jenë izoluese ndaj zhurmave dhe luhatjeve të temperaturës.

l) Objektet arsimore duhet të jenë larg zonave industriale, varrezave apo zonave me ndotës mbi normat e lejuara.

m) Objektet arsimore të jenë të pajisura me gjenerator dhe depozitë uji.

n) Objektet arsimore të kenë sistem ngrohjeje.

Të drejtën e mbylljes apo pezullimit të përkohshëm të aktivitetit, deri në 1 vit kalendarik, të institucionit arsimor privat parauniversitar, e ka QKL-ja me kërkesë të vetë subjektit ose me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në rast shkeljeje të kritereve të përcaktuara në dokumentacionin përkatës ligjor e nënligjor[239].

Në rast pezullimi të përkohshëm të veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar, sistemimi i nxënësve do të bëhet në bazë të nenit 48, të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar.[240]

239 Po aty, pika 9
240 Po aty, pika 10

Në rast mbylljeje të aktivitetit të institucionit arsimor privat parauniversitar, sistemimi i nxënësve do të bëhet në bazë të nenit 48, të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar.[241]

3.1.4 Kërkesat që duhet të plotësojë stafi mësimdhënës

Në bazë të ligjit "*Për sistemin arsimor parauniversitar",* subjektet që kërkojnë të marrin leje për hapjen e institucioneve arsimore private duhet të provojnë se kanë personel pedagogjik me arsimin përkatës e me kualifikimin e duhur si dhe duhet të sigurojnë personelin e nevojshëm mësimor. Kjo do të thotë që mësuesit duhet minimalisht të kenë arsimimin përkatës për lëndën që do të mbulojnë si dhe preferohet staf i kualifikuar në fushat e mësimdhënies. Stafi që do të angazhohet në mësimdhënie bëhet evident në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës si dhe në Drejtorinë Arsimore Rajonale përkatëse apo Zyrën Arsimore, ku gjithashtu raportohen edhe ndryshimet që bëhen në stafin mësimor.

Për shkollat private, programet e të cilave janë të njëjta me ato të shkollave publike, mësuesit duhet t'u nënshtrohen dhe të zotërojnë kualifikime të njëjta si edhe mësuesit e shkollave publike. Jo më pak se 60% e stafit mësimdhënës duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë.

3.1.5 Kontrolli i shtetit mbi arsimin privat

Ministria e Arsimit dhe e Sportit, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit dhe organeve të saj arsimore në rrethe, kontrollon periodikisht procesin mësimor laik në shkollat private, për të verifikuar realizimin e kërkesave të planit e të programeve mësimore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Organet kontrolluese kompetente kontrollojnë gjithashtu dokumentacionin që duhet të jetë në ruajtje, si[242]:

a) Dokumentacionin përkatës me ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, statistika të numrit të nxënësve dhe të mësuesve.

b) Regjistra të veçantë dhe të përkohshëm, si: regjistra klase, evidencë për lëvizjen e nxënësve (i detyrueshëm për institucionin arsimor privat para-universitar), planet mësimore dhe programet lëndore të zbatuara çdo vit shkollor.

c) Rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit.

d) Kriteret për pranimin e nxënësve dhe të mësuesve.

e) Kontratat me prindërit për shërbimet arsimore apo shërbime të tjera jashtëshkollore që ofron.

f) Kontratat e punës me mësuesit me kohë të plotë apo të pjesshme.

Po kështu, drejtoria e tatimeve kontrollon subjektin për respektimin e shlyerjeve të detyrimeve tatimore.

241 Po aty , pika 11

242 Udhëzim, nr. 33 datë 1.11.2010, kreu II, pika 2, *"Detyrimet e institucionit arsimor privat parauniversitar dhe institucionit arsimor plotësues privat parauniversitar ndaj ministrisë së Arsimit dhe Shkencës".*

3.1.6 Financimi publik dhe i grandeve

Ligjërisht, shteti nuk ka asnjë detyrim ose politikë për të mbështetur financiarisht institucionet arsimore private të licencuara. Duke qenë se është konsideruar si aktivitet privat, që në momentin e marrjes së lejes së funksionimit, nuk ka asnjë fond publik që të derdhet për arsimin privat.

E gjithë barra e financimit për institucionet arsimore private parauniversitare u takon tërësisht subjekteve të cilët e krijojnë aktivitetin. Financimi mbështetet nga prindërit e nxënësve ose nga donatorë të ndryshëm. Sipas ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", neni 39 "Mbështetja financiare për arsimin parauniversitar Privat" , ministria mbështet financiarisht, sipas mundësive dhe programeve të miratuara, institucionet arsimore private vendase, të cilat janë jofitimprurëse dhe kanë të paktën pesë vjet që funksionojnë si institucione private. Sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, mbështetja financiare për shkollat private diferencohet sipas renditjes së tyre në provimet kombëtare të arsimit bazë ose të maturës shtetërore, si dhe në testimet ose konkurset ndërkombëtare. Gjithashtu po sipas këtij neni, pika 2, shkollat private e përdorin mbështetjen financiare vetëm për nxënësit e shkëlqyer në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nga viti 2009, një fond modest është dhënë edhe nga Shteti Shqiptar për institucionet parauniversitare të ngritura nga bashkësitë fetare për të ndihmuar në pagesën e mësuesve, që parashikohet në Ligjin nr. 10 140 datë 15.05.2009, Neni 4[243].

3.1.7 Tarifat në shkollat private

Institucionet arsimore private parauniversitare dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare licencohen përkundrejt tarifave të përcaktuara si më poshtë:

Nr.	Institucionet	Tarifa në lekë
1	Për kopsht	35 000 (tridhjetë e pesë mijë)
2	Për shkollë të ciklit të ulët fillor	45 000 (dyzet e pesë mijë)
3	Për shkollë të ciklit të lartë 9-vjeçar	45 000 (dyzet e pesë mijë)
4	Për shkollë 9-vjeçare	55 000 (pesëdhjetë e pesë mijë)
5	Për shkollë të mesme të përgjithshme	70 000 (shtatëdhjetë mijë)
6	Për shkollë të mesme teknike-profesionale e social-kulturore	60 000 (gjashtëdhjetë mijë)
7	Për kurs plotësues (IAPPRP)	70 000 (shtatëdhjetë mijë)[241]

Tabela 14. *Tarifat e institucioneve arsimore.*

243 *Ligji Nr. 10 140 datë, 15.05.2009,* Neni 4: "Shteti financon bashkësitë fetare për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, para-universitar dhe universitar, që zotërohen drejtpërdrejt ose përmes organizata jo fitimprurëse të krijuara dhe të administruara nga bashkësitë fetare, dhe që janë të miratuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose nga Këshilli i Ministrave". Ky kontribut përgjithësisht mbulon rreth 5% të shpenzimeve.

244 Po aty, kreu II, pika 1, Tarifat e shërbimit.

Tarifat e regjistrimit në shkollat private shqiptare ndryshojnë sipas niveleve arsimore që ofrojnë, kushteve fizike, cilësisë së arsimit të ofruar, kushteve shtesë të ofruara dhe vendndodhjes.

3.1.8 Mbështetja për familjet në nevojë

Për mbështetjen e familjeve në nevojë nuk ka ndonjë program të veçantë, përjashtuar rastin e teksteve mësimorë për arsimin e detyruar. Sipas kësaj skeme librat janë falas. Nuk ka ndonjë skemë tjetër të çfarëdo forme për të mbështetur familjet më të ardhura të pakta për shkollimin e fëmijëve të tyre në shkollat private.

3.1.9 Ekuivalentimi i kurrikulave dhe kualifikimit

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, kurrikula e përdorur në shkollat private në shumicën e rasteve është e njëjtë me atë te shkollave publike. Përjashtim bëjnë shkollat që ofrojnë lëndë fetare dhe disa shkolla të huaja në kurrikulën e të cilave ka edhe lëndë në gjuhë të huaj, por edhe në këto raste, ato janë të kontrolluara dhe miratuara nga organet përkatëse shtetërore. Për tipe të njëjta shkollash zakonisht ka ekuivalencë programesh dhe module të njëjta kualifikimi. Në rastet kur ka lëndë të ndryshme, ekuivalenca bëhet me anë të provimeve plotësuese.

3.1.10 Organizimi i provimeve dhe certifikatat/dëftesat e lëshuara për nxënësit

Organizimi i provimeve në shkollat private përkon me provimet e shtetit dhe sistemi i vlerësimit ndjek të njëjtat kritere dhe modele si në shkollat publike.

Lidhur me certifikatat dhe dëftesat, çdo shkollë private lëshon Certifikatat dhe Dëftesat përkatëse bazuar në një model të unifikuar dhe miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Certifikatat e formimit profesional gjithashtu lëshohen në bazë të modelit të përcaktuar nga vetë institucioni. Në të dy rastet, certifikatat dhe dëftesat e lëshuara nga shkollat private kanë të njëjtën vlerë si ato të lëshuara nga shkollat publike.

3.1.11 Statusi i mësuesit

Statusi i mësuesit ka ngjashmëri me shkollat publike për sa i përket kërkesave profesionale, kodit të etikës, të drejtave sipas kodit të punës, por ka edhe një sërë ndryshimesh në varësi te profilit, standardeve dhe mundësive të veçanta për çdo shkollë private.

3.1.11.1 Lëvizja e mësuesve nga sektori publik në atë privat

Bazuar në legjislacionin ekzistues është e mundur që mësuesit të lëvizin nga sektori publik në atë privat dhe anasjellas, ose të punojnë njëkohësisht në të dy sistemet. Në rastin kur mësuesit punojnë njëkohësisht në të dy sistemet, ata duhet të deklarohen dhe të paguajnë kuotën shtesë të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për pagën e deklaruar në sektorin privat.

Grafikët e mëposhtëm dhe interpretimi i tyre përkatës paraqesin një panoramë

të ecurisë së institucioneve të arsimit jopublik parauniversitar pas viteve ’90, sipas treguesve të shtrirjes, funksionimit dhe zhvillimit të tyre.



Grafiku 1. *Numri i institucioneve të licencuara.*

Siç shihet edhe nga grafiku, ka një rritje të numrit të institucioneve të arsimit parauniversitar të hapura nga viti 1995 deri në vitin 2012.



Grafiku 2. *Numri i institucioneve të licencuara sipas llojit (1995-2012).*

Në vitin 1995 janë hapur 12 institucione private, 4 shkolla 8 vjeçare, 6 gjimnaze, 2 shkolla fetare.

Në vitin 1996 nuk kemi rritje të numrit të institucioneve private, por në këtë vit u jepet leja për ushtrimin e aktivitetit 1 kopshti dhe 1 shkolle 8-vjeçare.

Në vitin 1997 në Republikën e Shqipërisë hapen edhe 6 institucione të reja nga të cilat 3 kopshte dhe 3 shkolla 8-vjeçare.

Në vitin 1998, siç edhe shihet nga grafiku, u hapën 10 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 6 kopshte, 2 shkolla 8-vjeçare dhe 2 gjimnaze.

Në vitin 1999 ka një rritje të numrit të institucioneve private të arsimit parauniversitar. Në këtë vit u hapën 22 institucione private, nga të cilat 12 kopshte, 5 shkolla 8-vjeçare, 2 gjimnaze dhe 3 shkolla fetare.

Në vitin 2000 numri i institucioneve të licencuara pëson rritje. Janë 27 institucione, nga të cilat 11 kopshte, 1 shkollë e ciklit të ulët, 9 shkolla 8-vjeçare, 5 gjimnaze dhe 1 shkollë profesionale.

Në vitin 2001 vazhdon rritja e kërkesave për hapje të institucioneve private. Në këtë vit hapen gjithsej 46 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 22 kopshte, 2 shkolla të ciklit të ulët, 14 shkolla 8-vjeçare, 7 gjimnaze dhe 1 shkollë profesionale.

Në vitin 2002 vazhdon rritja e kërkesave për hapje të institucioneve private. Në këtë vit hapen gjithsej 50 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 20 kopshte, 2 shkolla të ciklit të ulët, 18 shkolla 8-vjeçare, 6 gjimnaze, 1 shkollë profesionale dhe 3 shkolla social-kulturore.

Viti 2003 shënon një ulje të kërkesave për hapje të institucioneve private krahasuar me vitet paraardhëse. Në këtë vit hapen gjithsej 27 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 10 kopshte, 7 shkolla 8-vjeçare, 7 gjimnaze dhe 3 shkolla social-kulturore.

Viti 2004 shënon përsëri një ulje të kërkesave për hapje të institucioneve private krahasuar me vitet paraardhëse. Në këtë vit hapen gjithsej 21 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 6 kopshte, 8 shkolla 8-vjeçare, 6 gjimnaze dhe 1 shkollë profesionale.

Viti 2005 shënon një rritje të kërkesave për hapje të institucioneve private. Në këtë vit hapen gjithsej 26 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 8 kopshte, 10 shkolla 8-vjeçare, 7 gjimnaze dhe 1 shkollë social-kulturore.

Viti 2006 shënon një rritje të kërkesave për hapje të institucioneve private. Në këtë vit hapen gjithsej 31 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 13 kopshte, 1 shkollë e ciklit të ulët, 6 shkolla 8-vjeçare, 9 gjimnaze, 1 shkollë profesionale dhe 1 shkollë social-kulturore.

Viti 2007 shënon një rritje të kërkesave për hapje të institucioneve private. Në këtë vit hapen gjithsej 52 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 15 kopshte, 16 shkolla 8-vjeçare, 16 gjimnaze, 4 shkolla profesionale dhe 1 shkollë social-kulturore.

Viti 2008 shënon një ulje të kërkesave për hapje të institucioneve private, krahasuar me në vit më parë. Në këtë vit hapen gjithsej 39 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 13 kopshte, 14 shkolla 8-vjeçare, 11 gjimnaze dhe 1 shkollë social-kulturore.

Viti 2009 shënon një ulje të kërkesave për hapje të institucioneve private, krahasuar me në vit më parë. Në këtë vit hapen gjithsej 19 institucione të arsimit parauniversitar,

nga të cilat 4 kopshte, 7 shkolla 9-vjeçare, 5 gjimnaze, 3 gjimnaze me kohë të pjesshme.

Viti 2010 shënon një rritje të kërkesave për hapje të institucioneve private krahasuar me një vit më parë. Në këtë vit hapen gjithsej 29 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 9 kopshte, 6 shkolla 9-vjeçare, 7 gjimnaze, 1 gjimnaz sportiv, 5 shkolla profesionale dhe 1 institucion plotësues.

Viti 2011 shënon një ulje të kërkesave për hapje të institucioneve private krahasuar me një vit më parë. Në këtë vit hapen gjithsej 15 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 5 kopshte, 1 shkollë 9-vjeçare, 6 gjimnaze, 3 gjimnaze me kohë të pjesshme.

Viti 2012 shënon një rritje të kërkesave për hapje të institucioneve private krahasuar me një vit më parë. Në këtë vit hapen gjithsej 24 institucione të arsimit parauniversitar, nga të cilat 6 kopshte, 1 shkollë e ciklit të ulët, 6 shkolla 9-vjeçare, 6 gjimnaze, 3 gjimnaze me kohë të pjesshme, 1 shkollë profesionale dhe 1 institucion plotësues.



	2004 - 2005	2005 - 2006	2006 - 2007	2007 - 2008	2008 - 2009	2009 - 2010	2010 - 2011	2011 - 2012	2012 - 2013	2013- 2014	2014- 2015
Publik GJITHSEJ	1539	1573	1589	1666	1685	1686	1719	1761	1778		1751
Publik FSHAT	1241	1260	1274	1385	1370	1369	1417	1446	1478		1420
jopublik GJITHSEJ	85	76	78	86	89	92	80	146	133		106
jopublik FSHAT	14	11	11	15	13	15	18	25	18		16

Grafiku 3. *Numri i institucioneve të arsimit parashkollor në shkallë Republike sipas vendndodhjes (2004-2015).*

Siç shihet edhe nga grafiku ka një rritje të interesimit për institucionet e arsimit parashkollor jo vetëm në qytet, por edhe në fshat. Gjithashtu, ka një interesim edhe për arsimin jopublik. Ka një rritje të numrit të institucioneve jopublike parashkollore duke arritur në 146 në vitin shkollor 2011-2012, nga të cilat 25 në fshat. Në vitin shkollor 2014-2015 numri i këtyre institucioneve pëson rënie, 106 nga të cilat 16 në fshat.



Grafiku 4. *Numri i institucioneve të arsimit bazë në shkallë Republike (2004-2015).*

Sa i përket edhe institucioneve të arsimit bazë, në shkallë Republike, ka një rritje të numrit të institucioneve nga viti 2004-2005 deri më 2012-2013. Viti 2009-2010 është viti ku kemi numrin më të lartë të institucioneve jopublike të arsimit bazë në gjuhën e shifrave 141, shifër kjo që tregon se krahasuar me vitin shkollor 2004-2005 numri i tyre pothuajse është dyfishuar. Ndërsa në vitin 2010-2011 numri i këtyre institucioneve fillon të bjerë duke arritur në vitin 2014-2015 në 121, rënie që vërehet edhe në arsimin publik.



Grafiku 5. *Institucionet e arsimit të mesëm sipas llojit publik/privat dhe sipas profilit (2004-2015).*

Në këtë grafik është paraqitur numri i institucioneve publike dhe jopublike në arsimin e mesëm, sipas profilit. Ajo që vihet re është një rritje në vite e numrit të institucioneve jopublike nga viti në vit. Madje po të krahasojmë vitin 2004-2005 me 2014-2015 kemi pothuajse dyfishim të numrit të gjimnazeve private. Po kështu ka edhe një rritje të numrit të shkollave të mesme profesionale private deri në vitin shkollor 2012-2013, gjë që tregon rritjen e interesit edhe për shkollat profesionale. Në vitin shkollor 2014-2015 ka një rënie të numrit të shkollave të mesme profesionale.



Grafiku 6. *Numri i institucioneve sipas tipit dhe niveleve/arsimi parashkollor (2004-2015).*

Në arsimin parashkollor, përqindja që zënë institucionet parashkollore publike luhatet nga 44% (viti shkollor20 03-2004) deri në 50% (viti shkollor 2014-2015), ndërsa përqindja e institucioneve jopublike luhatet nga 23% (viti shkollor 2010-2011) deri në 38% në vitin shkollor 2003-2004. Theksojmë se në vitin shkollor 2014-2015 kjo shifër bie në kuotat e 28%.



Grafiku 7. *Numri i institucioneve sipas tipit dhe niveleve/arsimi 8/9-vjeçar (2004-2015).*

Në arsimin bazë, përqindja që zënë institucionet publike luhatet nga 38% (viti shkollor 2014-2015) deri në 46% (viti shkollor 2003-2004), ndërsa përqindja e institucioneve jopublike luhatet nga 32% (viti shkollor 2014-2015) deri në 40% në vitin shkollor 2003-2004 dhe 2009-2010.



Grafiku 8. *Numri i institucioneve sipas tipit dhe niveleve/arsimi i mesëm (2004-2015)*

Në arsimin e mesëm, përqindja që zënë institucionet publike luhatet nga 10 % (viti shkollor 2003-2004) deri 11%, pothuajse të njëjtë në të gjitha vitet nga 2004 deri në vitin 2014, ndërsa përqindja e institucioneve jopublike luhatet nga 22% (viti shkollor 2003-2004) deri në 36% në vitin shkollor 2008-2009 dhe 2010-2011. Nga sa tregon

edhe tabela, ka një interesim në rritje për hapjen dhe frekuentimin e shkollave të arsimit të mesëm jopublik. Të para në raportin publik /jopublik, ka më shumë interesim për institucionet jopublike.



Grafiku 9. *Përqindja e institucioneve arsimore publike dhe jopublike për arsimin parauniversitar për periudhën 2003-2015.*

Siç edhe shihet nga tabela, ka një rritje të numrit të institucioneve jopublike nga viti në vit. Në gjuhën e shifrave, ky tregues përfaqëson 6% deri 10% për periudhën e marrë në studim.



Grafiku 10. *Numri i mësuesve në arsimin bazë në vite sipas gjinisë e vendndodhjes së shkollës (Republika, 2004-2015)*

Pjesëmarrja e mësueseve femra në arsimin bazë është shumë e lartë dhe pothuajse e njëjtë si në arsimin publik, ashtu edhe në atë jopublik, 65% në vitin 2004-2005 dhe 73% në vitin 2014-2015 për arsimin publik, ndërsa në atë jopublik 82% në vitin 2004-

2005 dhe 83% në vitin 2014-2015, në qytet. Në fshat 57% në vitin 2004-2005 dhe 65% në vitin 2014-2015 në arsimin publik, ndërsa në atë jopublik 82% në vitin 2004-2005 dhe 84% në vitin 2014-2015. Gjithashtu ka një numër pothuajse të njëjtë të femrave në arsimin jopublik si në fshat, ashtu edhe në qytet.



Grafiku 11. *Numri i mësuesve në arsimin e mesëm në vite sipas gjinisë e vendndodhjes së shkollës (Republika, 2004-2015)*

Pjesëmarrja e mësueseve femra në arsimin e mesëm është e lartë dhe pothuajse e njëjtë si në arsimin publik, ashtu edhe në atë jopublik, 57% në vitin 2004-2005 dhe 65% në vitin 2014-2015 për arsimin publik, ndërsa në atë jopublik 58% në vitin 2004-

2005 dhe 66% në vitin 2014-2015, në qytet. Në fshat 43% në vitin 2004-2005 dhe 56% në vitin 2014-2015 në arsimin publik, ndërsa në atë jopublik 51% në vitin 2004-2005 dhe 63% në vitin 2014-2015. Gjithashtu ka një numër pothuajse të njëjtë të femrave në arsimin jopublik si në fshat, ashtu edhe në qytet.



Grafiku 12. *Niveli arsimor i mësueseve në kopshtet publike e jopublike.(Republika 2004-2015).*

Niveli arsimor i mësuesve në arsimin parashkollor paraqitet në një situatë të tillë: Ajo që vihet re është fakti se si në arsimin publik, ashtu edhe në atë jopublik mësueset janë si me arsim të mesëm edhe të lartë. Në të dy sistemet, publik dhe jopublik, mësuesit janë

në një përqindje më të lartë me arsim të lartë krahasuar me atë të mesëm. Për periudhën e marrë në studim, ajo që vihet re është fakti se nga viti në vit në kopshtet jopublike ka një rënie të përqindjes së mësueseve me arsim të mesëm nga 59% në vitin 2004-2005 në 17 % në vitin shkollor 2014-2015 dhe rritje të përqindjes së mësuesve me arsim të lartë nga 41% në vitin shkollor 2004-2005 deri më 82% në vitin 2014-2015.



Grafiku 13. *Niveli i arsimit të mësuesve në arsimin bazë (Republika 2004-2015)*

Niveli arsimor i mësuesve në arsimin bazë paraqitet në një situatë të tillë: në arsimin publik, po ashtu edhe në atë jopublik, mësuesit janë me arsim të mesëm dhe të lartë. Ajo që vihet re është fakti se në arsimin bazë ka një përqindje më të ulët të mësueseve me arsim të mesëm, si në atë publik ashtu edhe në atë jopublik. Për periudhën e marrë

në studim vihet re se nga viti në vit në shkollat jopublike të arsimit bazë ka një rënie të përqindjes së mësueseve me arsim të mesëm, nga 14% në vitin 2014-2015 në 7 % në vitin shkollor 2010-2011 dhe rritje të përqindjes së mësuesve me arsim të lartë, nga 86% në vitin shkollor 2004-2005 deri më 93% në vitin 2014-2015.



Grafiku 14. *Niveli i arsimit të mësuesve në arsimin e mesëm, Republika 2004-2015.*

Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm paraqitet në një situatë të tillë: në arsimin publik, ashtu si edhe në atë jopublik, mësuesit janë me arsim të mesëm dhe të lartë, por përqindja e mësuesve me shkollë të mesme si në sektorin publik ashtu edhe në atë jopublik është mjaft e ulët, ulje që ka ardhur duke pësuar rënie nga viti në vit, që në gjuhën e shifrave nga 4% në vitin 2004-2005 në 2 % në vitin 2014-2015 për arsimin publik, dhe 1% në vitin 2004-2005 në 2% në vitin 2014-2015.

	Numri i fëmijëve/nxënësve, institucioneve dhe mësuesve për periudhën 1997-2015 ISCED 0-5								
	Arsimi jopublik								
	Numri i fëmijëve/ nxënësve			Numri i institucioneve			Numri i mësuesve		
Vitet	Kopshte	8/9-vjeçare	Të mesme	Kopshte	8/9-vjeçare	Të mesme	Kopshte	8/9-vjeçare	Të mesme
1997 - 1998	395	288	628	5	6	1	89	41	26
2000 - 2001	1847	5935	2823	29	36	19	113	376	330
2001 - 2002	3250	7729	3878	53	54	32	188	620	443
2002 - 2003	3581	9649	4830	61	65	38	206	825	539
2003 - 2004	4150	13620	7700	85	89	51	230	1040	740
2004 - 2005	4150	14608	9104	85	78	68	230	1248	1047
2005 - 2006	3841	16108	11166	76	91	77	230	1487	1244
2006 - 2007	3921	17369	12610	78	105	93	227	1597	1311
2007 - 2008	3678	18358	13989	86	120	106	232	1684	1356
2008 - 2009[2]	3464	20452	11139	89	128	121	210	1940	1397
2009 - 2010	3641	21241	11741	92	141	118	225	1998	1392
2010 - 2011	3512	21180	13212	80	140	124	222	1910	1477
2011 - 2012	5728	20834	14265	146	132	124	266	1924	1566
2012 - 2013	5130	20599	15497	133	126	125	362	1811	1639
2013-2014[242]									
2014-2015	5340	20643	13867	106	121	116	345	1872	1533

Tabela 15. *Numri i fëmijëve/nxënësve, institucioneve dhe mësuesve për periudhën 1997-2015 ISCED 0-5*

Në këtë tabelë të dhënat tregojnë se numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet jopublike është rritur ndjeshëm, nga 395 në vitin 1997-1998, në 5340 në vitin 2014-2015; po kështu numri i nxënësve në arsimin bazë, nga 288 në vitin 1997-1998, në 20643 në vitin 2014-2015; në arsimin e mesëm, nga 628 në vitin 1997-1998, në 13867 në vitin 2014-2015.

Sa i përket numrit të institucioneve jopublike të arsimit parashkollor, numri i tyre ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Kështu nga 5 institucione parashkollore vitin 1997-1998 arritën në 106 në vitin 2014-2015. Në arsimin bazë, nga 6 institucione në vitin 1997-1998 arritën në 121 në vitin 2014-2015. Në arsimin e mesëm, nga 1 institucion në vitin 1997-1998 arritën në 116 në vitin 2014-2015.

245 Të dhënat janë marrë nga Raporti paraprak "Reforma e sistemit arsimor parauniversitar", Tiranë, Maj 2014, fq. 11

Rritje nga viti në vit ka edhe për sa i përket edhe numrit të mësuesve. Kështu në arsimin parashkollor, nga 89 në vitin 1997-1998 arritën në 345 në vitin 2014-2015. Në arsimin bazë, nga 41 mësues në vitin 1997-1998 arritën në 1872 në vitin 2014-2015. Në arsimin e mesëm, nga 26 mësues në vitin 1997-1998 arritën në 1533 në vitin 2014-2015.



Grafiku 15. *Nxënës të regjistruar (në përqindje, në të gjithë Republikën, 2004-2015) sipas viteve në arsimin bazë AF, AMU.*

Të dhënat tregojnë se ka një rritje të numrit të nxënësve që frekuentojnë institucionet jopublike të arsimit bazë. Ka një përqindje shumë të lartë të nxënësve që frekuentojnë arsimin publik, 49% ciklin fillor dhe 46% arsimin e mesëm të ulët, ndërsa arsimin jopublik bazë e ndjekin 3% e nxënësve.

3. 2. Zhvillimet e arsimit privat në vendet e Bashkimit Evropian

Sipas raportit të Eurydice, pas viteve 2000, arsimi i administruar nga sektori privat, ose jo-shtetëror, brenda Bashkimit Evropian ka pësuar ndryshime të shumta në reforma, po në të njëjtën mënyrë si sistemet arsimore në përgjithësi.

3.2.1 Shpërndarja e nxënësve

Në të gjitha vendet e BE-së, më shumë se 90% e nxënësve të shkollave fillore dhe tetëvjeçare ndjekin sektorin e institucioneve publike. Autoritetet publike financojnë shkollimin e detyrueshëm të shumicës së nxënësve. Sektori i arsimit publik mbizotëron në të gjitha vendet, përveç Belgjikës dhe Holandës. Ndërsa në Greqi, Spanjë, Francë, Irlandë, Itali dhe Britani krahas nxënësve që ndjekin sektorin publik ose institucionet private që marrin fonde publike, ekziston një përqindje e vogël e nxënësve që ndjekin institucionet private që nuk marrin fonde publike. Në Greqi, Itali dhe Britani kjo përqindje është më e lartë se 5-6%.

Ndër institucionet arsimore private mund të dallohen ato të cilat marrin ose jo ndihmë financiare nga shteti. *Një institucion arsimor privat konsiderohet që merr ndihmë financiare, në qoftë se ai merr më shumë se 50% të fondeve të nevojshme nga autoritetet publike. Një institucion privat konsiderohet që nuk merr fonde nga shteti, kur ai merr më pak se 50% të ndihmës së tij nga autoritetet publike.*

Në 15 shtete të Bashkimit Evropian ligji e lejon ngritjen e shkollave private. Kjo jo gjithmonë është e përcaktuar qartë, por është e nënkuptuar në kushtetutë pasi ajo shprehet për afirmimin e të drejtës së zgjedhjes dhe lirisë së arsimimit.

Në Spanjë, Francë, Irlandë dhe Holandë është detyrimi i shteteve që të sigurojnë fonde për institucionet e arsimit privat, duke u ofruar shkollim nxënësve të arsimit të detyruar.

Në vendet e tjera, mundësitë për fonde publike, në sektorin e shkollave private nuk janë të përcaktuara në ligjin kushtetues, por janë të ligjëruara në dispozita të ndryshme ligjore. Në Greqi, Austri dhe Portugali struktura bazë legjislative është e drejtuar nga legjislacioni specifik i sektorit privat. Në Gjermani është shteti ai që rregullon arsimin privat, falë ligjeve specifike ose ligjeve të zakonshme të shkollave publike dhe private.

3.2.2 Kushtet për ngritjen e shkollave private

Pothuajse në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, shteti kontrollon themelimin e të gjithë institucioneve private, duke iu ofruar shkollim nxënësve në arsimin e detyruar, përmes legjislacionit dhe kushteve të përcaktuara lidhur me garantimin e standardeve të dispozitave arsimore. Në shumicën e vendeve evropiane, krijimi i shkollave private 9-vjeçare dhe të mesme private bëhet me miratimin e dekretit të shkollave. Ndërsa pranohet një minimum bazë i kushteve që duhet të plotësojnë të gjitha shkollat private që ofrojnë shkollim për nxënësit në arsimin e detyruar, për ato shkolla private që marrin

fonde publike, këto kushte forcohen me shumë dhe duhet të përputhen ose të jenë më të larta se ato që plotësojnë shkollat publike.

Aprovimi, ose autorizimi zyrtar, në varësi të kërkesave rregullatore, bëhet i njohur publikisht. Kur autorizimi ose aprovimi miratohet, ai duhet të bëhet përpara hapjes së shkollës. Aprovimi mund të jetë i përkohshëm, ose përfundimtar, në pritje të kontrollit, ose kontrolleve gjithëpërfshirëse të shkollës si në rastin e Portugalisë dhe Britanisë. Ky autorizim, mund të anulohet kur shkolla ndërpret së plotësuari një ose më shumë nga kushtet, të cilat në mënyrë origjinale justifikojnë dekretimin e tij (praktika të tilla aplikohen në shtete si Danimarka, Spanja, Italia, Luksemburgu).

3.2.2.1 Kushtet fizike për hapjen e shkollave private

Grupi i dytë i kërkesave për hapjen e një shkolle private, u përmbahet kushteve fizike në të cilat zhvillohet mësimi. Këto kërkesa lidhen me:

- Ndërtesat, pajisjet, shëndetin dhe sigurinë.
- Numrin e nxënësve në klasë.

Ndërtesat. Në pjesën më të madhe të vendeve evropiane, standardet për ndërtesat, pajisjet, shëndetin dhe sigurinë janë themelore kur hapet një shkollë private që ofron shkollim për arsimin e detyruar.

3.2.3 Numri i nxënësve në klasë

Nga ana tjetër, numri i nxënësve merret gjithashtu ne konsideratë. Në disa vende një kusht për krijimin e një shkolle private, që merr financim nga shteti, është kontingjenti minimal i nxënësve. Ky rast është në Danimarkë, Irlandë, Holandë dhe Suedi.

3.2.4 Kërkesat për stafin e mësuesve

Në të gjitha vendet dallohen dy kërkesa bazë: a) profesionalizmi i duhur ose kualifikimet akademike dhe b) karakteri i mirë moral dhe bindës ndaj ligjit.

Kategoria e parë e kërkesave lidhet me stafin e mësimdhënies si dhe atë menaxhues të shkollave, si për individët ashtu edhe organizatat që ngrenë shkollën. Brenda kësaj kategorie, fusha më e zakonshme në të cilin standardet rregullatore shtrihen përgjatë shteteve të Bashkimit Evropian lidhen me trupën e mësimdhënies. Pjesa më e madhe e shteteve specifikon se mësuesit duhet të kenë kualifikim mësimdhënieje dhe akademik të përshtatshëm me nivelin e arsimimit dhe lëndën. Këto janë ekuivalente ose të ngjashme me ato të sektorit publik.

3.2.5 Kërkesat lidhur me përmbajtjen

Kërkesa më e rëndësishme që duhet të plotësohet për të hapur një shkollë private lidhet me përmbajtjen e dispozitave arsimore. Edhe pse në shume vende te Bashkimit Evropian liria për edukim është vendosur dhe zbatuar në parimet kushtetuese, në pak vende është shteti që vendos qëllimet dhe objektivat bazë të edukimit për shkollimin e nxënësve që ndjekin arsimin e detyruar.

Vendet që bëjnë me shumë marrëveshje specifike që kanë të bëjnë me planin mësimor janë Belgjika, Greqia, Spanja dhe Irlanda.

Në Belgjikë, Spanjë dhe Luksemburg minimumi i planit mësimor përcaktohet nga shteti. Ky faktor përbën edhe fokusin kryesor të shqyrtimit të kërkesës nga ana e qeverisë lidhur me aprovimin e krijimit të shkollës dhe veprimtarinë e saj në vazhdimësi.

3.2.6 Kontrolli i shtetit

Në shumicën e vendeve ku përgjegjësia për kontroll është e vendosur në nivelin e qeverisë qendrore ekziston një marrëveshje praktike për monitorimin dhe mbikëqyrjen e të dy sektorëve arsimorë, atij publik dhe privat, e cila merr formën e një inspektorati kombëtar. Në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, veprimtaria e institucioneve arsimore private, në nivelin e arsimit të detyruar, kontrollohet nga shteti përmes legjislacionit dhe inspektimit. Përgjegjësia për kontrollin e arsimit privat i takon ministrive ose departamenteve qeveritare. Praktikisht, në të gjitha vendet dhe në të gjitha llojet e shkollave kontrolli ushtrohet mbi standardet e stafit të mësuesve dhe mësimdhënies. Danimarka është i vetmi shtet që ndryshon në këtë aspekt. Kontrolli mbi ndërtesat, pajisjet, shëndetin dhe sigurinë është gjithashtu shumë i përhapur. Shkollat private që kanë ngjashmëri më të madhe me shkollat publike, ose që gëzojnë nivelin me të madh të mbështetjes financiare shtetërore, në krahasim me të tjerat, janë subjekt i kontrollit, i cili ka një fushë të gjerë. Në shumë vende administrimi financiar kontrollohet vetëm aty ku shteti jep subvencionim si: Belgjika, Spanja, Franca, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Britania dhe Anglia. Ndërsa limiti i numrit të nxënësve, maksimumi ose minimumi, është i përcaktuar në shumë vende, si kusht për krijimin e një shkolle të re e cila monitorohet rregullisht. Megjithatë, në vendet ku inspektimi është kryer nga trupa qeveritare ka dy devijime nga rregulli. Kështu, në Holandë, inspektorati është gjysmë-autonom me statusin e vetëqeverisjes, duke i dhënë autonomi në maksimum dhe pa ndikuar në përgjegjësinë në tërësi të Ministrisë së Arsimit. Nga ana tjetër, në Britani (për shkollat që nuk marrin fonde nga shteti) funksioni monitorues realizohet nga një agjenci autonome joqeveritare.

3.2.7 Ekuivalenca e kurrikulës dhe kualifikimit

Në Greqi, Spanjë, Irlandë, Luksemburg, Holandë, Finlandë, Suedi dhe Britani kurrikulat e arsimit fillor dhe tetëvjeçar janë të njëjta si në sektorin e shkollave publike dhe në ato private. Në raste të veçanta detyrimet lidhur me planin mësimor privat janë të limituara. Kështu, në Spanjë kjo nënkupton vetëm minimumin e planit mësimor. Në Gjermani shkollat private duhet të ndjekin të njëjtat objektiva dhe të kenë një nivel arsimimi të ngjashëm me atë të sektorit të shkollave publike, por nuk janë të kufizuara në të njëjtin plan mësimor. Në shumicën e vendeve, pavarësisht sektorit se ku punojnë mësuesit, ata marrin një rrogë e cila është e njëjtë ose e krahasueshme. Në disa vende niveli i pagës së mësuesve varet nga sektori në të cilin ata japin mësim. Kështu, në Spanje dhe zakonisht në Itali mësuesit në sektorin privat kanë një pagë më të ulët se ata të sektorit publik. Në Greqi paga minimale e mësuesve në sektorin privat është e njëjtë me ata të sektorit publik, por ndonjëherë mund të jetë dhe më e lartë se ajo e mësuesve në sektorin publik.

3.2.8 Financimi publik i granteve

Vendet e Bashkimit Evropian mund të ndahen në tre grupe në bazë të marrëdhënies që ka arsimi privat me autoritetet publike.

Në kategorinë e parë përfshihen shtete si Britania e Madhe dhe Greqia ku shkollat private nuk marrin fonde publike. Gjithsesi, kjo nuk është pengesë për shtetin për të pasur të drejtën e kontrollit mbi institucionet arsimore private. Në Britaninë e Madhe disa institucione private përfitojnë fonde nga kishat.

Në kategorinë e dytë përfshihen shtete si Franca, Italia dhe Portugalia ku ekzistojnë lloje të ndryshme kontratash, të cilat krijojnë një lidhje ndërmjet shkollave private dhe autoriteteve publike. Në varësi nga lloji i kontratës, shkolla përfiton ndihmë financiare të një vlere pak a shumë domethënëse dhe është më e lirë për sa i përket kushteve të mësimdhënies dhe rekrutimit të mësuesve të përcaktuar nga autoritetet publike.

Në kategorinë e tretë përfshihen shumica e vendeve të BE-se, ku ndihma financiare e shkollave private ka shumë të përbashkëta me sektorët e shkollave publike. Në Belgjikë, Danimarkë, Gjermani, Spanjë, Irlandë, Luksemburg, Austri, Finlandë dhe Suedi arsimi privat nuk është i financuar as pjesërisht as plotësisht, por operon pak a shumë nën të njëjtat kushte si sektori i arsimit publik. *Në Holandë barazia financiare ndërmjet institucioneve publike dhe private është një e drejtë kushtetuese.*

Në Evropë (sipas Eurydice, 2005), shpenzimet arsimore financohen nga dy burime të ndryshme, publike dhe private. Shpenzimet publike përfshijnë të gjitha blerjet e drejtpërdrejta të shërbimeve arsimore nga sektori publik (pavarësisht nga niveli administrativ në fjalë), ndërsa shpenzimet private përfshijnë pagesën e tarifave të shkollimit (dhe të gjitha pagesat e tjera), kryesisht nga familjet, sektori i biznesit dhe organizatat jofitimprurëse.

Shpenzimet në arsim janë të financuara kryesisht nga burimet publike. Në të vërtetë, në pothuajse të gjitha vendet, të paktën 80% e shpenzimeve arsimore (të gjitha nivelet e arsimit të kombinuar) përballohen nga buxheti publik. Në institucionet private, të cilat marrin pak, ose asnjë fond nga autoritetet publike, tarifa e pagesës është e përgjithshme dhe shuma që prindërit duhet të paguajnë ndonjëherë është shumë e lartë.

Zakonisht në vendet ku institucionet private të mbështetura financiarisht, marrin ekuivalente fondesh, ose thuajse ekuivalente me ato që i janë dhënë shkollave të sektorit publik, arsimi privat është falas. Megjithëkëtë, në shumicën e vendeve prindërit kontribuojnë vullnetarisht për koston e arsimit. Në të kundërt, në disa vende institucionet private vendosin tarifa edhe në qoftë se financohen nga shteti, por nivelet e tarifës janë të kufizuara. Në Greqi, Itali dhe Britani nuk ka shkolla private në nivelin e arsimit të detyruar të cilat marrin mbështetje financiare nga autoritetet publike. Shumica e sekteve dhe shkollave të tjera, në zotërim të kishave ose trusteve (Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut) financohen nga fondet publike si pjesë e sektorit publik të arsimit.

Në shumë vende të Bashkimit Evropian, fondi i dhënë si ndihmë financiare për institucionet private, shpesh është i shpërndarë në kategori të ndryshme shpenzimi, por në disa vende autoritet lokale ose shkollat marrin një ndihmë financiare të përgjithshme e cila mbulon kategoritë e ndryshme.

Në Danimarkë shkollat private marrin ndihmë financiare në përputhje me numrin e nxënësve të regjistruar. Kjo ndihmë mbulon 80-85% të shpenzimeve. Ata janë të lirë të përcaktojnë shpërndarjen e kësaj ndihme në kategori të ndryshme shpenzimesh.

Në Itali shkollat fillore, të cilat janë në të njëjtin plan (parificate), marrin një ndihmë financiare vjetore e cila mbulon më pak se 50% të tre kategorive të shpenzimeve. Ato janë të lira të përcaktojnë shpërndarjen e kësaj ndihme.

Në gjysmat e vendeve të Bashkimit Evropian (Belgjikë, Spanjë, Irlandë, Holandë, Austri, Portugali dhe Finlandë) në shumicën e rasteve autoritetet publike mbulojnë rrogat e stafit. Shpenzimet operative në shkollat private, gjithashtu në shumicën e rasteve mbulohen nga autoritetet publike ashtu si edhe për sektorin e shkollave publike (Belgjike, Gjermani, Spanje, Holande dhe Portugali.

Pjesa e financimit publik të shpenzimeve në arsim është pak më e ulët se mesatarja e BE-së (89.2%) në Gjermani, Spanjë, Qipro, Letoni, Hungari, Britaninë e Madhe dhe Bullgari. Situata është ndoshta e ngjashme në vende të tjera, ku jo të gjitha të dhënat që lidhen me burime private janë në dispozicion dhe pjesa e fondeve private është e nënvlerësuar. Në këto vende, pra, pjesa e financimit privat është më e madhe.

Diferencimi mes publikes dhe privates është ndërlikuar më tej nga shkollat me autonomi publike, sidomos në çështjet financiare. Shkollat që kanë autonomi të plotë për të kërkuar burimet private të financimit ndodhen në shumicën dërrmuese të vendeve. Vetëm shkollat në Greqi, Francë, Luksemburg, Finlandë, Islandë dhe Norvegji nuk kanë autonomi të plotë në këtë fushë. Megjithatë, shkollat në përgjithësi nuk mund të marrin kredi private: ato kanë autonomi të plotë për të vepruar kështu vetëm në komunitetin flamand të Belgjikës, në Itali, Holandë (në nivelin e mesëm), Bullgari dhe Rumani.

Kur është fjala për përdorimin e fondeve private, shkollat kanë liri të konsiderueshme për të marrë mallrat operative dhe shërbime të luajtshme dhe, në një masë disi më të vogël, të punësojnë personel jo-mësimor (brenda kufijve të fondeve private në dispozicion të tyre). Shumë sisteme arsimore, megjithatë, nuk u lejojnë shkollave lirinë për të përdorur fonde private dhe për të punësuar personelin mësimor.

Asistenca ndaj familjeve në nevojë

Në vendet e Bashkimit Evropian asistenca financiare e drejtpërdrejtë (kesh) u jepet prindërve të fëmijëve në arsimin e detyruar, pavarësisht nëse mësojnë në shkollë publike apo private. Në varësi të vendit, asistenca financiare mund të marrë formën e lehtësimit të taksave ose ndihmës financiare që u paguhet familjeve nga autoritetet publike (në nivelin lokal ose qendror). Në vende të veçanta, ndihmat dhe huatë u jepen nxënësve; në këtë rast familjeve të tyre. Ndihma financiare u paguhet familjeve në të gjitha vendet. Ato janë me shuma të caktuara që kur fëmija lind deri kur mbaron arsimin e detyruar.

Zakonisht shuma e ndihmës financiare është e pavarur nga të ardhurat e prindërve. Megjithatë, ne Itali dhe Portugali është në përpjesëtim të kundërt me këtë të ardhur. Në Spanjë jepet ndihmë financiare vetëm për familjet me të ardhura shumë të limituara, ndërsa në Austri është proporcionalisht anasjelltas me të.

Përveç ndihmës familjare, në më shumë se gjysmat e vendeve evropiane, prindërit përfitojnë edhe nga lehtësimi i taksave. Kjo në përgjithësi do të thotë mbulimin e një pjese të shpenzimeve që ka një fëmijë për arsim, e cila jepet të paktën derisa të mbarojë arsimi i detyruar.

Në disa vende ekziston një sistem për caktimin e ndihmës financiare, e cila i referohet të ardhurave familjare. Kështu, për shembull, në Belgjikë, Francë, Luksemburg dhe

Holandë ndihmat u caktohen vetëm nxënësve të shkollës së mesme, ndërsa në Irlande ndihmat jepen vetëm për nxënësit e shkollës tetëvjeçare.

Organizimi i provimeve dhe certifikatat/dëftesat

Në përfundim të arsimit 8-vjeçar (ose gjashtë viteve të para në sistemin me një strukturë) në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian nxënësit nuk marrin dëftesë; arsimi i detyruar vazhdon si arsim i dytë (tre vitet e fundit të arsimit të mesëm në sistemin me një strukturë). Vetëm në Belgjike, Greqi dhe Itali nxënësit marrin dëftese në fund të arsimit 8-vjeçar. Në këto vende dëftesa është përgjegjësia e vetme e institucionit. Organizimi dhe vlerësimi që çon drejt dëftesës i takon secilit institucion, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat.

KAPITULLI IV

STUDIM RASTI - ARSIMI PRIVAT NË RRETHIN E SHKODRËS NË PERIUDHËN 2010-2014

Në këtë kapitull do të fokusohemi në përshkrimin e arsimit jopublik në rrethin e Shkodrës. Një nga arsyet pse u zgjodh Shkodra për studim rasti është fakti se në rrethin e Shkodrës, në krahasim me rrethet e tjera të Shqipërisë, kemi të gjitha institucionet jopublike të arsimit parauniversitar duke filluar nga kopshtet, shkollat vetëm të ciklit të ulët, shkollat e arsimit bazë, gjimnazet klasike, shkollat fetare dhe shkollat tekniko-profesionale.

Në një shoqëri demokratike dhe në një ekonomi tregu, informimi për arsimin publik, dhe jopublik të të gjitha niveleve do të thotë të njohësh shkallën e përfshirjes së çdo grupmoshe, frekuentimin e shkollës, nivelin e përgatitjes së nxënësve, nivelin e stafit të mësimdhënies, infrastrukturës, shërbimet që ky arsimi jopublik ofron.

Përmes një procedure që harmonizon të dhënat e marra nga baza e të dhënave e Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër dhe mbështetur në intervistat gjysmë të strukturuara të realizuara me drejtuesit e shkollave private të rrethit të Shkodrës, u ndërtua tabloja e organizimit dhe funksionimit të institucioneve private të arsimit parauniversitar, e cila përbën një tregues të zhvillimeve kryesore në sistemin parauniversitar jopublik të shprehura përmes indekseve analitikë e sintetikë si:

Institucione *(kopshte, arsimi 9 vjeçar, arsimi i mesëm)*

Infrastruktura *(ambientet, klasat, mjetet mësimore dhe didaktike)*

Shërbimet shkollore *(transporti, trajtimi me ushqim, shërbimi mjekësor dhe psikologjik)*

Financimi

Drejtuesit *(niveli arsimor, të dhëna demografike)*

Mësuesit *(arsimimi, të dhëna demografike, niveli arsimor i mësuesve sipas cikleve të shkollimit, grupmosha e mësuesve, përvoja e mësuesve në arsim, përbërja e stafit, përzgjedhja e stafit, kualifikimi i stafit, komunikimi me prindërit)*

Nxënësit *(kontingjenti që ndjek shkollat private, numri i nxënësve, nxënësit e talentuar, uniforma shkollore, kurrikula, veprimtaritë jashtëshkollore)*

Pak fjalë për rrethin e Shkodrës

Rrethi i Shkodrës është pjesë e Qarkut të Shkodrës, së bashku me Malësinë e Madhe dhe Pukën. Si ka një sipërfaqe prej 1.302,96 km^2 si dhe ka në administrim 2 bashki:

Shkodrën dhe Vaun e Dejës si dhe 15 komuna (Ana e Malit, Berdicë, Bushat, Dajç, Gur i Zi, Hajmel, Vig-Mnelë, Postribë, Pult, Rrethina, Shllak, Shalë, Shosh, Temal, e Velipojë).

Në vitin 2013, Qarku Shkodër shënoi 211.000 banorë. Popullata urbane në Shkodër është 93.000 banorë (44.1% e popullsisë), ndërsa ajo rurale është 118.000 banorë (55.9% e popullsisë)[246]

Një aspekt i rëndësishëm është edhe arsimi në Shkodër ku sipas bazës së të dhënave të Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, në vitin shkollor 2013-2014 konstatohet se në Qarkun Shkodër zhvillojnë aktivitetin e tyre arsimor 91 kopshte nga të cilat (82 publike, 63 në fshat dhe 9 jopublike, nga të cilat 2 në fshat); 190 shkolla publike e jopublike[247], të ndara sipas cikleve dhe llojit të arsimit (165 publike dhe 25 jopublike) nga të cilat: 138 shkolla 9-vjeçare (123 publike, 100 në fshat dhe 15 jopublike); 39 shkolla të mesme gjimnaze, nga të cilat: 30 publike, 21 në fshat dhe 9 jopublike; 9 shkolla të mesme profesionale, nga të cilat: 8 janë publike, 2 në fshat dhe 1është jopublike, ndërsa 4 shkolla publike janë me kohë të shkurtuar dhe vetëm një e tillë ndodhet në fshat (jopublike të tilla nuk ka në rrethin e Shkodrës). (DAR Shkodër, tetor 2013)[248]

Meqenëse studimi ynë do të përqendrohet në arsimin privat parauniversitar të rrethit të Shkodrës, në tabelat në vijim po japim një informacion të shkurtër për secilin institucion.

4.1 Institucione

Kopshte private

Kopshti	Bashki/ Komunë	Viti i hapjes	Kapaciteti
Frano Ilia	Komunë	24/12/1999	80
Nënë Françiska	Komunë	05/10/2000	70
Cor Jesu	Bashki	1/06/1999	120
Fryma e dashurisë	Bashki	2/08/2002	50
Hasan Riza Pasha	Bashki	20/06/2006	30
Maria Ndihmëtare	Bashki	1/06/2000	60
Miqësia	Bashki	17/01/2008	30
Teuta	Bashki	29/03/2011	25
Zemra e Krishtit	Bashki	17/06/1998	100

Tabela 16. *Lista e kopshteve private të rrethit Shkodër.*

246 Census 2013

247 Shënim: Në arsimin publik e privat kemi shkolla të bashkuara, të cilat përfshihen edhe në numrin e shkollave të arsimit bazë edhe në numrin e shkollave të mesme. Në total numërohen vetëm një herë.

248 Shënim: Të dhënat i përkasin vitit 2013-2014, kohë kur ende nuk kishte hyrë në fuqi ligji nr. 115/2014 për ndarjen administrativo territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, miratuar me 31.07.2014. Ky ligj është botuar në fletoren zyrtare, viti 2014, nr 137, fq. 4365. Për më shumë shih www. reformaterritoriale.al

Të dhënat tregojnë se në Shkodër nga 9 kopshte private, 2 prej tyre janë në fshat dhe 7 në qytet. Pjesa më e madhe e këtyre institucioneve janë hapur pas vitit 1998. Kështu më 1998 hapet kopshti *"Zemra e Krishtit"*, më 1999 *"Cor Jezu"*dhe *"Frano Illia"*, më 2000 *"Maria ndihmëtare"dhe "Nënë Françiska"*, më 2002 *"Fryma e dashurisë"*, më 2006 "*Hasan Riza Pasha*", më 2008 *"Miqësia", më 2011 "Teuta"*.

Arsimi 9-vjeçar

Shkolla	Qytet/Fshat	Viti i hapjes	Lloji sipas ciklit
Dituria	Shkodër	13/09/2001 9/02/2005	9-vjeçare
Maria Ndihmëtare	Shkodër	1/06/2000	E bashkuar me të Mesmen
Cor Jesu	Shkodër	22/09/1999	9-vjeçare
Zemra e Krishtit	Shkodër	1/06/2000	9-vjeçare
Shpresa për të ardhmen	Shkodër	31/07/2003	9-vjeçare
Haxhi Sheh Shamia	Shkodër	29/11/1995	E bashkuar me të Mesmen
Hasan Riza Pasha	Shkodër	21.01.2002	E bashkuar me të Mesmen
Teuta	Shkodër	10/01/1999 23/09/2004	9-vjeçare
Miqësia	Shkodër	18/06/2002	9-vjeçare
ABC	Shkodër	15/03/2004 17/01/2008	9-vjeçare
Përparimi	Shkodër	6/07/2005 20/06/2006	E bashkuar me të Mesmen
Peter Mahringer	Shkodër	13/06/2008	E bashkuar me të Mesmen
Zani i Shkodrës	Shkodër	2009	E Bashkuar me të Mesmen
Dom Alfons Tracki	Velipojë	10.09.2012	Shkollë e Ciklit të Ulët

Tabela 17. *Lista e shkollave private të arsimit 9 vjeçar në rrethin Shkodër.*

Në arsimin 9-vjeçar në Shkodër ushtrojnë aktivitetin e tyre 15 shkolla private nga të cilat vetëm njëra në fshat dhe vetëm si shkollë e ciklit fillor, 6 shkolla janë shkolla të bashkuara me të mesmen. Të dhënat tregojnë se më 1995 u licencua shkolla fetare *"Haxhi Sheh Shamia"*, më 1999 "*Teuta"* e *"Cor Jezu"*, më 2000 *"Zemra e Krishtit"* dhe *"Maria Ndihmëtare"*, më 2001 *"Dituria"* si shkollë e ciklit të ulët dhe më pas më 2005 si shkollë 9-vjeçare, më 2002 *"Miqësia" e "Hasan Riza Pasha"*, më 2003 *"Shpresa për të ardhmen"*, më 2004 ABC në fillim si shkollë e ciklit të ulët më pas më 2008 si shkollë 9-vjeçare, më 2005 *"Përparimi"* si shkollë e ciklit të ulët e më pas më 2006 si shkollë e 9-vjeçare, më 2008 shkolla *"Peter Mahringer"*, më 2009 "Zani i Shkodrës" si shkollë 9 vjeçare, më 2012 hapet si shkollë e ciklit të ulët shkolla Dom Alfons Tracki".

Arsimi i mesëm

Shkolla	Viti i hapjes	Lloji sipas programit	Specifikimi në varësi të llojit	E bashkuar ose jo
Haxhi Sheh Shamia	29/11/1995	Gjimnaz	Fetare	E bashkuar me 9-vjeçare
Atë Pjetër Meshkalla	29/11/1995	Gjimnaz	Klasike	E veçantë
Hasan Riza Pasha	22/06/1995	Gjimnaz	Klasike	E bashkuar me 9-vjeçare
Maria Ndihmëtare	3/07/2005	Gjimnaz	Klasike	E bashkuar me 9-vjeçare
Scutari	29/10/2004	Gjimnaz	Klasike	E veçantë
Përparimi	13/06/2008	Gjimnaz	Klasike	E bashkuar me 9-vjeçare
Zani i Shkodrës	13/06/2008	Gjimnaz	Klasike	E bashkuar me 9-vjeçare
Peter Mahringer	13/06/2007	Tekniko-profesionale	5 vjeçare	E bashkuar me 9-vjeçare
Dituria	21/12/2012	Gjimnaz	Klasike	E bashkuar me 9-vjeçare
Përparimi[246]	2009, me kohë të shkurtuar			

Tabela 18. *Lista e shkollave private të arsimit të mesëm në rrethin Shkodër.*

Të dhënat e tabelës tregojnë se shkollat e mesme private në Shkodër janë licencuar dhe kanë filluar aktivitetin e tyre më 1995. Kështu më 1995 fillon aktivitetin kolegji turk "*Hasan Riza Pasha",* shkolla fetare *"Haxhi Sheh Shamia"* dhe gjimnazi *"Atë Pjetër Meshkalla"*, më 2004 gjimnazi *"Scutari"*, më 2005 gjimnazi *"Maria Ndihmëtare"*, më 2007 fillon aktivitetin shkolla tekniko-profesionale 5-vjeçare *"Peter Mahringer"*, më 2008 gjimnazet *"Përparimi"* dhe *"Zani i Shkodrës",* më 2012 gjimnazi *"Dituria"*.

4.2 Infrastruktura

Infrastruktura përbën një pikë të rëndësishme të shkollave private. Objektet shkollore në qytetin e Shkodrës janë tërësisht të reja dhe vazhdimisht janë objekt zgjerimi dhe përmirësimi. Ndërtesat shkollore janë të standardeve bashkëkohore duke ofruar mjedise të brendshme e të jashtme në funksion të mësimdhënies dhe të edukimit të nxënësve.

"*Institucioni ynë ofron mjedise të përshtatshme, mjaft komode për zhvillimin normal të procesit mësimor. Klasat me hapësirën e përshtatshme për çdo nxënës, (m^2/ për çdo nxënës), bankat në cilësinë dhe parametrat e kërkuar, Smart board-et në 4 klasa, 2 sallat e multimedias (e pajisur me laptop e projektor ku zhvillohen aktivitete të ndryshme si dhe përdoret për të parë filma në gjuhën angleze, gjermane dhe turke, me qëllim që nxënësit të përmirësojnë këto gjuhë), rafte për çdo nxënës, mjete mësimore të përshtatshme për zhvillim normal të procesit mësimor. Laboratorët me pajisjet*

249 Shënim. Ndonëse është marrë licenca, ajo nuk është tërhequr asnjëherë.

moderne e bashkëkohore, sallat e kompjuterave ku çdo nxënës ka një kompjuter në dispozicion. Gjendja fizike e godinave, pasurimi i tyre çdo vit, mirëmbajta janë tregues të standardeve që ky institucion ofron."

(A.B, drejtues, "Kolegji Turk")

"Nxënësit e shkollës sonë zhvillojnë mësim në dy godina të standardeve bashkëkohore. Në njërën godinë janë vendosur nxënësit e arsimit bazë dhe në tjetrën nxënësit e gjimnazit. Shkolla ka një numër të mjaftueshëm klasash, palestër, sallë informatike, laboratorë me gjithë mjetet e përshtatshme për një zhvillim normal të orëve të punëve të laboratorit, numri i klasave është i mjaftueshëm, po ashtu edhe hapësira (m^2) për nxënës është e mjaftueshme. Një bibliotekë me mjedise e literaturën e nevojshme sipas grupmoshave është në dispozicion të nxënësve. Shkolla është e pajisur me sistem ngrohjeje qendrore, e cila është mjaft funksionale."

(T.Z, drejtuese, shkolla "Dituria")

"*Në drejtim të infrastrukturës, shkolla është e pajisur mirë me laboratorët dhe mjetet e nevojshme didaktike, mundësi të gjëra të përdorimit të kompjuterit dhe të internetit për të gjithë nxënësit, klasa të mjaftueshme dhe të pajisura me sistem kondincionimi, etj."*

(M.B, drejtuese, shkolla "Teuta")

"*Shkolla jonë përcjell dije, mirësjellje e qytetari. Kjo shkollë prezanton standarde evropiane, mësues të kualifikuar, mjedise të përshtatshme dhe komode me sistem kondicionimi, bazë materiale bashkëkohore, laborator të mësimit të gjuhëve të huaja (italisht, anglisht), kabinet informatike të pajisur me kompjutera të viteve të fundit. Në dispozicion të orës janë aparatet e projeksionit. Një element shumë i rëndësishëm është siguria, e për këtë qëllim ambientet janë të siguruara dhe të monitoruara me aparatet përkatëse". (M.D, drejtues, shkolla "Zani i Shkodrës")* "*Pikë e fortë e shkollës është baza mësimore didaktike e plotësuar me bibliotekën e shkollës, me materiale për nxënësit si dhe me literaturë pedagogjike për mësuesit. Kabinetet e informatikës, kabineti i biologji-kimisë, i teknologjisë, i fizikës, i edukimit fizik me dy palestra, njëra prej të cilave e kompletuar për gjimnastikë, kabineti i punës dhe i edukimit muzikor me një nivel bashkëkohor dhe me sallë për veprimtari ekstrakurrikulare*, etj.*"*

(L.R, drejtuese, shkolla "Përparimi")

"Shkolla private që unë drejtoj ofron kushte shumë të mira të ambienteve. Ajo ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme për zhvillim normal të procesit mësimor".

(P. M, drejtuese, shkolla "Shpresa për të ardhmen")

"*Në shkollën tonë ofrohet një infrastrukturë e standardeve bashkëkohore, me godina të përshtatshme, klasa funksionale, laboratorë, terrene sportive, bibliotekë e sallë mediateke mjaft funksionale. Ambientet e shkollës shfrytëzohen gjatë gjithë verës. Mbi të gjitha ne ofrojmë një ambient të denjë që flet për respekt e mikpritje, një mbështetje të sinqertë në rrugën e jetës, një derë që mbetet hapur edhe pasi nxënësit tanë kanë përfunduar studimet dhe të cilën e trokasin shumë shpesh pasi aty kanë thithur "erën e mirë" njerëzie"*

(T. B, drejtuese, shkolla Maria Ndihmëtare.)

"Shkolla jonë ofron një ndërtesë shkollore me ngrohje gjeo-termike, ambient arsimor dhe edukues, ambiente të standardeve bashkëkohore, një mobilim shumë të mirë sipas standardeve austriake. Ajo ofron mjedise të përshtatshme duke filluar nga mjaftueshmëria e klasave, ambiente të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Palestra u ofron nxënësve një fushë të madhe futbolli dhe 2 fusha basketbolli, 2 fusha volejbolli. Palestra shfrytëzohet për zhvillimin e orëve të edukimit fizik, aktivitetet sportive, aktivitete të kohës së lirë dhe festën e mbylljes së vitit shkollor, apo aktivitetet e tjera shkollore. Ajo ka edhe dhoma zhveshjeje. Në shkollë nuk mungojnë këndet sportive e tualete të përshtatshme. Shkolla ka një sistem sigurimi. Si rezultat i rritjes së numrit të nxënësve u ndërtuan 4 salla projektesh, dy salla Software, një laborator CISCO si dhe një laborator elektronik. Një sallë e madhe të pajisur me kompjutera, ku nxënësit mund të ulen gjatë orëve të pushimit. Laboratori i elektronikës dhe laboratori CISCO janë pajisur me mjete nga më modernet. Çdo nxënës ka në laboratorin elektronik oshiloskopin dhe software të tjera për matjen e tensionit të rrymës. Përveç këtyre pajisjeve, çdo nxënës ka në dispozicion dhe kompjuter ku janë të instaluar software testues dhe simulues. Një platformë mësimore Moodle online u vjen në ndihmë mësuesve dhe nxënësve. Falë saj, materialet mësimore disponohen online, detyrat e shtëpisë dhe projektet dorëzohen përmes internetit, si edhe njoftimet etj."

(S.B drejtuese, shkolla austriake "Peter Mahringer)

"Me fillimet e demokracisë, menjëherë në dhjetor të vitit 1991, u hap medreseja si shkollë e mesme e përgjithshme me profil fetar, në fillim me një klasë, që në vite erdhi duke u forcuar dhe zgjeruar sa sot është bërë një nga shkollat më serioze të mesme në Shkodër. Kushtet në ndërtesën e vjetër ishin të vështira, baza materiale jo në lartësinë e duhur. Si rezultat i rritjes së numrit të nxënësve, ndërtesa po bëhej gjithnjë dhe më e ngushtë, prandaj edhe filluan përpjekjet për të ndërtuar medresenë e re. Me subvencionet e Shoqatës V.H.K. "Istanbul" u ngrit medreseja e vajzave dhe me ndihmën financiare të Bankës së Zhvillimit në Xhida të Arabisë Saudite dhe me subvencionet e Shoqatës "Islamic Reliev" u bë e mundur ngritja e medresesë së djemve. Sot mbas shumë vite përpjekjesh kemi dy ndërtesa moderne, njëra për djemtë dhe tjetra për vajzat që i plotësojnë më së miri nevojat për punë mësimore edukative. Shkollat janë pajisur në bazë të standardeve më të larta pedagogjike, me mjedise komode pune për nxënësit, për mësuesit dhe për administratën. Të gjitha orenditë dhe pajisjet janë të reja, të përzgjedhura në bazë të kërkesave të higjienës shkollore që plotësojnë më së miri nevojat mësimore të nxënëseve. Ka pajisje të shumta didaktike për të gjitha lëndët, ku bëjnë pjesë laboratori i kimisë, i biologjisë, i fizikës dhe i informatikës. Shkolla ka edhe palestrën e vet. Biblioteka e shkollës e cila po pajiset çdo ditë gjithnjë e më mirë me literaturë shkencore, letrare artistike dhe fetare.

(K.D drejtues, Medreseja Haxhi Sheh Shamia"

"Mjedisi i shkollës është i ri. Në shkollë ka 1 sallë multimediale ku nxënësit prezantojnë projekte të ndryshme, 1 klasë laborator informatike, 1 laborator biologjie, një laborator fizike, një laborator kimie, një sallë testesh dhe 1 auditor. Auditori përdoret për të dhënë njoftime të rëndësishme për nxënës apo prindër. Ndërtesa ka standarde bashkëkohore dhe është e përshtatshme për një shkollë moderne dhe efektive. Shkolla ka sallën e pritjes ku rijnë nxënësit që vijnë me vonesë, ka terrene sportive të hapura, palestrën e mbyllur me dy dhoma zhveshjeje për djem dhe dy për vajza si dhe farmacinë. Çdo klasë ka nga një ngjyrë dhe mban emrin e një figure të shquar që ka qenë edhe nxënës i kësaj shkolle, p.sh, Martin Camaj. Shkolla ka bibliotekën shumë

funksionale e njëkohësisht shumë të pasur me libra. Në të ndodhen edhe kompjutera ku shërbimi që ofrohet është pa pagesë. Gjithashtu edhe një fotokopje është në dispozicion të nxënësve brenda ndërtesës së shkollës"

(R.L, drejtues, gjimnazi privat "Atë Pjetër Meshkalla").

Numri i klasave

Klasat janë njësi bazë në të cilat zhvillohet mësimi, dhe për këtë arsye numri i mjaftueshëm i klasave është gjithmonë në vëmendjen e drejtuesve të shkollave. Të gjithë drejtorët e shkollave private konfirmojnë numrin e mjaftueshëm të klasave në shkollat e tyre. Në tabelën e mëposhtme jepet një informacion për numrin e klasave në arsimin bazë sipas shkollave dhe sipas viteve për periudhën e marrë në studim (2010-2014).

Shkolla	2010-2011	2011-2012	2012-2013	2013-2014
DITURIA	19	18	18	18
MARIA NDIMËTARE	9	9	9	9
COR JESU	13	13	13	12
ZEMRA E KRISHTIT	25	22	22	21
SHPRESA PËR TË ARDHMEN	9	9	9	9
HAXHI SHEH SHAMIA	20	20	20	20
HASAN RIZA PASHA	14	15	16	15
TEUTA	9	9	9	9
MIQËSIA	9	9	9	9
ABC	8	9	10	10
PËRPARIMI	9	9	9	9
PETER MAHRINGER	2	2	4	4
ZANI I SHKODRËS	9	5	2	1
DOM ALFONS TRACKI				3

Tabela 19. *Numri i klasave në shkollat private të Shkodrës në arsimin e detyruar.*

Nga tabela vërehet se ka një ruajtje të numrit të klasave nga viti në vit. Ajo që të tërheq vëmendjen është fakti se ka një numër relativisht të madh të nxënësve që ndjekin institucionet private si "Zemra e Krishtit", kolegjin turk "Hasan Riza Pasha" dhe me drejtim fetar si: "Haxhi Sheh Shamia". Po kështu vërehet një rënie e numrit të klasave në shkollën 9-vjeçare "Zani i Shkodrës". Në vitin shkollor 2013-2014 hapet shkolla 9-vjeçare e ciklit fillor me 3 klasa, e vetmja shkollë e arsimit bazë në fshat.

Drejtorët e shkollave raportojnë mjaftueshmërinë e klasave edhe në shkollat e mesme. Tabela në vijim na jep një informacion për numrin e klasave në arsimin e mesëm, për periudhën (2011-2014)

Shkolla	2010-2011	2011-2012	2012-2013	2013-2014
HAXHI SH. SHAMIA		17	17	18
ATË PJETËR MESHKALLA		18	19	20
HASAN RIZA PASHA		10	10	11
MARIA NDIHMËTARE		8	8	7
SCUTARI		6	6	6
PËRPARIMI		3	3	3
ZANI I SHKODRËS		3	5	4
PETER MAHRINGER		8	10	10
DITURIA			2	3

Tabela 19. *Numri klasave në arsimin jopublik të mesëm sipas viteve.*

Duhet të theksojmë se për vitin shkollor 2010-2011 nuk ka të dhëna. Siç edhe shihet nga tabela, në vitet e marra në studim vërehet se numri i klasave në arsimin e mesëm ka ruajtur një stabilitet në vite. Ka një rritje të numrit të klasave në shkollën tekniko-profesionale "Peter Mahringer" dhe "Atë Pjetër Meshkalla"

4.3 Shërbimet në shkolla

Më poshtë është dhënë perceptimi i drejtorëve të shkollave për shërbimet të cilat ofrohen në shkollat private si: ushqimi, transporti, shërbimi psikologjik, kujdesi shëndetësor.

Trajtimi me ushqim

Lidhur me shërbimin e mëngjesit dhe të drekës, ndonëse të gjithë drejtorët bien dakord se ai është i domosdoshëm në shkollë, vetëm në tre shkolla private të rrethit të Shkodrës ofrohet ky shërbim.

"Nxënësit trajtohen me ushqim, i cili cilësisht është mjaft i mirë"

(A.B, drejtues,"Kolegji Turk H.R Pasha")

"Në shkollë funksionon mensa ku nxënësit mund të marrin çfarë të dëshirojnë kundrejt pagesës, e cila nuk përfshihet në tarifën e shkollimit"

(R.L, drejtues, gjimnazi privat "Atë Pjetër Meshkalla").

"Në shkollë funksionon një mensë dhe një sallë e madhe ngrënie, ku nxënësit përfitojnë shërbimin e mëngjesit dhe të drekës"

(S. Bazhdari, drejtuese, shkolla austriake "Peter Mahringer")

"Në shkollën tonë nuk ofrohet ushqim"

(T.Z drejtore , shkolla "Dituria")

Transporti

Shkollat jopublike e ofrojnë shërbimin e transportit. Pothuajse në të gjitha shkollat 9- vjeçare ky shërbim ofrohet dhe konsiderohet i domosdoshëm me përjashtim të shkollave të mesme ku vetëm një përqindje e ulët e ofrojnë këtë shërbim. Tarifat e këtij shërbimi në asnjë rast nuk përfshihen në tarifën e shkollimit.

"Ky shërbim në shkollën tonë ekziston. Transporti bëhet me mikrobusë. Për këtë shërbim prindërit duhet të paguajnë mbi tarifën e shkollimit. Që në momentin e regjistrimit, nxënësit duhet të japin adresën e saktë, në të kundërt nuk e përfitojnë këtë shërbim. Për nxënësit që vijnë nga rrethinat apo qytetet e tjera akomodimi i tyre bëhet në shtëpinë-konvikt ku pranohen vetëm nxënësit e shkollave të mesme".

(A.B, drejtues, kolegji turk)

"Shkolla nuk merr përsipër as strehimin, as transportin"

(R.L, drejtues, gjimnazi privat "Atë Pjetër Meshkalla").

Shërbimi psikologjik

Në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar ofrohet shërbimi psikologjik ndërkohë që në shkollat e mesme psikologu jep edhe lëndën e psikologjisë. Të gjithë drejtorët bien dakord për domosdoshmërinë e këtij shërbimi dhe nga të gjithë vlerësohet si shumë i rëndësishëm, ndërsa kur bëhet fjalë për problematikat me të cilat përballet një psikolog ata ndajnë pikëpamje të ndryshme.

"Në shkollë ka një kabinet të shërbimit psikologjik i cili u vjen në ndihmë jo vetëm mësuesve për trajtimin e nxënësve të vështirë problematikë, por ofron edhe shërbim të specializuar për nxënësit për çdo problem që ato paraqesin."

(T.Z, drejtuese, shkolla "Dituria")

"Në shkollën tonë ofrohet shërbim psikologjik. Punohet shumë veçanërisht me vitet e para, ushtrime për qetësimin e konflikteve për përforcimin e identitetit të grupit, lojëra workshope, etj me qëllim interesimin dhe angazhimin e nxënësve"

(S. Bazhdari, drejtuese, shkolla austriake "Peter Mahringer")

"Shërbimi psikologjik fokusohet në nxitjen dhe zhvillimin mendor e fizik të nxënësve, si dhe në ndihmesën dhe mbështetjen që jep për rritjen e cilësisë së procesit të mësimnxënies dhe mësimdhënies. Njëkohësisht ky shërbim u vjen në

ndihmë nxënësve të viteve të para të ardhur nga rrethinat, fshatra apo zona malore. Këta nxënës kanë shumë probleme me përshtatjen qoftë me mjedisin, qoftë me shoqërinë."

(R.L, drejtues, gjimnazi privat "Atë Pjetër Meshkalla").

Kujdesi shëndetësor

Edhe kujdesi shëndetësor ofrohet si shërbim në të gjitha shkollat private të Shkodrës. Në çdo shkollë ka një dhomë të ndihmës së parë, ku ofron shërbim një mjek/infermier. Gjithashtu në çdo klasë ekziston kutia e ndihmës së parë.

"Shkolla ka siguruar asistencë mjekësore për nxënësit. Në dispozicion është një mjeke e përgjithshme e cila u vjen në ndihmë nxënësve sa herë kanë nevojë."

(A.B, drejtues, kolegji turk H. R. Pasha)

"Kujdesi mjekësor realizohet përmes një mjeku dhe infermieri si dhe të një dhome të ndihmës së parë në shkollë. Kutia e ndihmës së parë është e pranishme në të gjitha klasat."

(T.Z, drejtuese, shkolla "Dituria")

"Në çdo klasë kemi kutinë e ndihmës së parë"

(M.B, drejtuese, shkolla "Teuta")

4.4 Financimi

Të gjitha shkollat kanë një buxhet që mbulon shërbime të caktuara. Ligjërisht shteti nuk ka asnjë detyrim të mbështetë shkollat private të licencuara. Nuk ka asnjë fond publik që të derdhet në arsimin privat. Në këto kushte e gjithë barra e financimit për institucionet arsimore private parauniversitare është tërësisht e subjekteve të cilët e krijojnë aktivitetin. Financimi mbështetet nga prindërit e nxënësve ose nga donatorë të ndryshëm. Prindërit për shërbimin që u ofrohet paguajnë shuma të caktuara të cilat ndryshojnë nga shkolla në shkollë, varen nga hallka e sistemit dhe nga tarifa që cakton shkolla. Shpesh tarifat që paguajnë prindërit janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe për këtë arsye drejtuesit vazhdimisht janë në kërkim të donatorëve.

"Nxënësit paguajnë kuota mujore, edhe pse të moderuara, të cilat në shumë raste kanë qëllimin për të ndërgjegjësuar prindërit dhe familjet për shërbimin që u ofrohet (kjo sidomos për kopshtet). Në raste të tjera kuotat shërbejnë për të mbuluar shërbimet bazë që ofrohen dhe kryesisht pagat e personelit mësimdhënës dhe ndihmës. Atëherë ku i marrin fondet këto institucione, si ia dalin? Siç e thashë më lart puna e palodhur e rregulltarëve është një prej burimeve, jo vetëm njerëzore të menaxhimit të shkollave, pasi e përkthyer kjo punë në vlerë monetare është patjetër një kontribut jo i vogël për ekonominë e tyre. Pikërisht të bindura për vlerat që transmetojnë, stafet drejtuese të shkollave katolike nxitin vazhdimisht bamirës të ndryshëm privatë apo OJF të tjera, për të kontribuar sado pak në mbulimin e shpenzimeve të pashmangshme për të mbajtur lart cilësinë e shkollës, formimin e mësuesve, bazën materiale, mirëmbajtjen, etj. Burim tjetër është subvencioni i shtetit. Që më 2009, me miratimin e ligjit nr. 10 140 datë 15.05.2009, një fond modest është dhënë edhe nga Shteti Shqiptar për të ndihmuar në pagesën e mësuesve të këtyre institucioneve arsimore, konkretisht 4000 lekë të reja për person. Është në dëshirën e të gjitha shkollave të menaxhuara nga ente të Kishës

Katolike të përqafojnë sa më shumë nxënës, që këto shkolla të jenë sa më të arritshme edhe për shtresat e varfra ekonomikisht. Me përpjekjet personale të mbështesin disa prej tyre, pasi jo gjithmonë është e mundur të gjenden mbështetje financiare për këto familje.

(Motër T, drejtuese "Maria Ndihmëtare")

"Nxënësit paguajnë kuota mujore, të cilat ndryshojnë sipas hallkave të sistemit"

(T.Z, drejtuese, shkolla "Dituria")

"Nxënësit paguajnë shuma modeste, duke i dhënë mundësinë të gjithë të interesuarve që pavarësisht nga niveli i tyre ekonomik të ndjekin këto shkolla"

(K.D, medreseja Haxhi Sheh Shamia").

"Në momentin e regjistrimit, nxënësit marrin rregulloren e shkollës dhe dorëzojnë mandat arkëtimin e bankës për pagesën e bërë: taksën e regjistrimit dhe (2.300 lekë) dhe tarifën e muajit (7800 lekë). Tarifa vjetore përfshin ngrohjen dimërore dhe regjistrin elektronik me vlerë 78000 lekë. Pagesa duhet bërë përmes bankës. Tarifa që paguhet nuk mbulon të gjitha shpenzimet e shkollës: çdo vit duhet të aktivizohemi për të gjetur ndihma nga donatorë privatë, të cilët i falënderojmë për ndihmën e tyre"

(R.L, drejtues, gjimnazi privat "Atë Pjetër Meshkalla").

4.5 Drejtimi i shkollës

Drejtimi i shkollës është një tjetër aspekt i rëndësishëm i shkollave private që duhet vlerësuar. Ecuria e shkollës varet shumë nga niveli arsimor i drejtuesve, profili i shkollës, përvoja, aftësitë menaxheriale, etj. Mbështetur në pohimet e vetë drejtuesve rezulton se 100% e tyre kanë mbaruar fakultet mësuesie dhe kanë përvojë mbi 15 vjeçare si mësues dhe drejtues.

Arsimimi i drejtuesve

Lidhur me nivelin e arsimit të drejtuesve të shkollave private, bazuar në vetë pohimet e vetë drejtorëve si dhe në bazën e të dhënave të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Shkodrës, del se 100% e tyre kanë arsim të lartë pedagogjik. Një pjesë e tyre pohojnë se kanë studiuar dhe janë specializuar në shtete të rajonit si Austria, Turqia apo Italia. Po sipas bazës së të dhënave të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Shkodrës, drejtuesit e shkollave janë 40% të huaj dhe 60% shqiptarë.

Përqindja e femrave në drejtim



Grafiku 16. *Përqindja e drejtueseve femra në arsim.*

Në arsimin parauniversitar publik dhe privat ka një përqindje të mirë të përfshirjes së femrës në drejtim. Të dhënat tregojnë se në shkollat private ka një përqindje më të lartë të femrave në drejtim, shifër që ka ardhur duke u rritur nga viti në vit, përkatësisht nga 52.6% deri në 81%.

4.6 Mësuesi

Studimet e shumta në fushën e arsimit dhe mësimdhënies tregojnë lidhjen ndërmjet arritjeve të nxënësve dhe shkallës së profesionalizmit të mësuesit, shkallës së njohurive në fushën lëndore, përvojës së tij në zbatimin e tyre, etj.

Arsimimi i mësuesve

Përqindja e mësueseve femra në arsimin bazë

Grafikët në vijim japin një panoramë të përqindjes së mësueseve femra në arsimin bazë të mesëm.



Grafiku 17. *Numri i mësueseve femra në arsimin bazë.*

Si në shkollat publike dhe në ato private në arsimin 9-vjeçar ka një numër të lartë të mësueseve femra. Një përqindje më e lartë e femrave vërehet në shkollat jopublike, përkatësisht 78%-83.1%. Numri më i madh i femrave është regjistruar në vitin shkollor 2011-2012 në arsimin jopublik, përkatësisht 83.1%.



Grafiku 18. *Përqindja e mësueseve femra në arsimin e mesëm të lartë.*

Siç edhe shihet nga grafiku ka një përqindje të lartë të femrave në të dy sektorët, në atë publik e jopublik. Në vitet e marra në studim në arsimin privat, viti 2013-2014 ka përqindjen më të lartë të femrave 75%, ndërsa në vitet e tjera luhatet nga 61.3% në 69.7%. Në arsimin publik në vitet 2010-2013 numri i femrave ruan një stabilitet. Po ashtu edhe në këtë sektor në vitin 2013-2014 ka një numër të lartë të mësueseve, përkatësisht 68% të përfshira në këtë sektor.

Niveli arsimor i edukatoreve ndër vite



Grafiku 19. *Kopshtet private - Niveli arsimor i edukatoreve ndër vite.*

Në arsimin parashkollor jopublik ka një përqindje të lartë të mësueseve me arsim të lartë, përkatësisht 81.8% - 96%. Përqindja e mësueseve me arsim të mesëm pedagogjik ka pësuar herë ngritje e herë ulje. Kështu nga 8.3%, në vitin 2011-2012, në 13.6% në vitin 2012-2013 dhe pëson ulje në 4% në vitin 2013-2014. Përqindja e mësueseve me arsim të mesëm jo pedagogjik luhatet nga 4.2% në vitin shkollor 2011-2012 në 4.6% në vitin shkollor 2012-2013. Është me rëndësi të evidentohet fakti se në vitin shkollor 2013-2014 në arsimin parashkollor privat nuk ka asnjë edukatore me arsim të mesëm jopedagogjik.

Niveli arsimor i mësuesve në ciklin fillor

Grafikët në vijim na japim informacion mbi nivelin arsimor të mësuesve në Ciklin fillor sipas viteve të marra në studim.



Grafiku 20. *Niveli arsimor i mësuesve në ciklin fillor të arsimit të detyruar, 2010-2011.*

Të dhënat tregojnë se në arsimin fillor, si në publik ashtu edhe në privat, ka një përqindje të lartë të mësuesve me arsim të lartë, përkatësisht në shkollat publike 76.5% dhe shkollat private 94.7%. Në shkollat private ka një përqindje shumë të vogël të mësuesve me arsim të mesëm pedagogjik, përkatësisht 5.3%. Mësues me shkollë të mesme jo pedagogjike në arsimin jopublik nuk ka, ndërsa në atë publik janë vetëm 3%.



Grafiku 21. *Niveli arsimor i mësuesve në ciklin fillor të arsimit të detyruar, 2011-2012.*

Në vitin 2011-2012 vazhdon rritja e numrit të mësuesve me arsim të lartë që punojnë në të dy sektorët, publik e privat. Në shkollat private në ciklin fillor rreth 3.4% janë mësues me arsim të mesëm pedagogjik. Kjo shifër ka pësuar një ulje prej 1.9 % krahasuar me një vit më parë, ndërsa në shkollën publike ka një rënie prej 2.5 % të mësuesve me arsim të mesëm pedagogjik krahasuar me vitin 2010-2011. Ashtu si edhe një vit më parë, në shkollat private nuk ka asnjë mësues me shkollë të mesme jo pedagogjike, ndërsa në arsimin publik ata përbëjnë rreth 3.6% të mësuesve.



Grafiku 22. *Niveli arsimor i mësuesve në ciklin fillor të arsimit të detyruar, 2012-2013.*

Në vitin shkollor 2012-2013 shifrat flasin për një përqindje të lartë të mësuesve me arsim të lartë si në arsimin publik dhe në atë jo publik. Gjatë këtij viti ka një rënie me 2% të numrit të mësuesve me arsim të mesëm pedagogjik në arsimin publik. Në arsimin jopublik këtë vit ka një rritje të numrit të mësuesve me arsim pedagogjik prej rreth 1.8%.



Grafiku 23. *Niveli arsimor i mësuesve në ciklin fillor të arsimit të detyruar, 2013-2014.*

Në vitin shkollor 2013-2014 shifrat flasin për një përqindje të lartë të mësuesve me arsim të lartë si në arsimin publik dhe atë jo publik, respektivisht 81% dhe 96%. Gjatë këtij viti pati një rënie të numrit të mësuesve me arsim të mesëm pedagogjik në të dy sistemet publik e jopublik, krahasuar me vitin 2012-2013.



Grafiku 24. *Arsimi privat - Niveli arsimor i mësueseve në Ciklin e Ulët sipas viteve.*

Të dhënat tregojnë se në arsimin privat në ciklin e ulët, gjatë periudhës së marrë në studim, ka një përqindje të lartë të mësueseve me arsim të lartë, shifër që luhatet nga 95% deri në 97%. Numri i mësuesve me arsim të mesëm pedagogjik është i ulët dhe nga viti në vit ky numër është gjithmonë e më i ulët.

Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të ulët

Grafikët në vijim na japin informacion për nivelin arsimor të mësuesve në arsimin e mesëm të ulët sipas viteve të marra në studim.



Grafiku 25. *Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të ulët, 2010-2011.*

Në arsimin e mesëm të ulët, gjatë vitit 2010-2011, të dhënat tregojnë se si në sistemin publik ashtu edhe në atë privat ka një përqindje të lartë të mësuesve me arsim të lartë. Në sistemin privat të dhënat tregojnë se 100 % e mësuesve janë me arsim të lartë. Po kështu në sistemin privat nuk ka asnjë mësues me arsim të mesëm pedagogjik dhe jopedagogjik, ndërsa në sistemin publik vërehet prania e mësuesve me arsim të mesëm pedagogjik rreth 4.5% dhe jo pedagogjik 4.2%.



Grafiku 26. *Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të ulët, 2011-2012.*

Në arsimin e mesëm të ulët, gjatë vitit 2011-2012, të dhënat tregojnë se si në sistemin publik ashtu edhe në atë privat ka një përqindje të lartë të mësuesve me arsim të lartë. Në sistemin privat të dhënat tregojnë se 100 % e mësuesve janë me arsim të lartë. Ajo që vihet re është fakti se në arsimin publik ka një rritje prej 0.9 % të mësuesve me shkollë të lartë krahasuar me një vit më parë. Po kështu në sistemin privat nuk ka asnjë mësues me arsim të mesëm pedagogjik dhe jopedagogjik, ndërsa në sistemin publik vërehet një rënie 0.7% e mësuesve me arsim të mesëm pedagogjik dhe 0.2 % e mësuesve me arsim jopedagogjik krahasuar me një vit më parë.



Grafiku 27. *Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të ulët, 2012-2013.*

Të dhënat për vitin 2012-2013 na japin një panoramë tjetër për sa i përket zhvillimeve në arsimin e mesëm të ulët. Në të dy sistemet si në atë publik e atë jo publik ka një rënie të numrit të mësuesve me shkollë të lartë, përkatësisht 0.6% në arsimin privat dhe 1.4% në arsimin publik. Po kështu në shkollat private ka një përqindje të ulët, përkatësisht 0.6% të mësuesve me arsim jo pedagogjik. Gjithashtu ka një rritje prej 1.2%, krahasuar me një vit më parë të mësuesve me arsim të mesëm pedagogjik.



Grafiku 28. *Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të ulët, 2013-2014.*

Në arsimin e mesëm të ulët gjatë vitit 2013-2014 të dhënat tregojnë se si në sistemin publik ashtu edhe në atë privat ka një përqindje të lartë të mësuesve me arsim të lartë. Në sistemin privat të dhënat tregojnë se 91 % e mësuesve janë me arsim të lartë. Ajo që vihet re është fakti se në arsimin publik ka një rritje prej 0.2 % të mësuesve me shkollë të lartë në arsimin publik krahasuar me një vit më parë. Po kështu në sistemin privat ka vetëm 1% të mësuesve me arsim të mesëm jo pedagogjik , ndërsa në sistemin publik vërehet se 5% e mësuesve janë me arsim të mesëm pedagogjik dhe 4 % e mësuesve me arsim jopedagogjik.



Grafiku 29. *Arsimi privat- Niveli arsimor i mësueseve në arsimin e mesëm të ulët sipas viteve.*

Të dhënat tregojnë se në arsimin privat në arsimin e mesëm të ulët, në periudhën e marrë në studim ka një përqindje pothuajse 100% të mësuesve me arsim të lartë. Përqindja e mësuesve me arsim të mesëm jo pedagogjik është pothuajse e pakonsiderueshme.

Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë

Grafikët në vijim na japin informacion për nivelin arsimor të mësuesve në arsimin e mesëm të lartë sipas viteve të marra në studim.



Grafiku 30. *Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2010-2011.*

Të dhënat tregojnë se në vitin shkollor 2010-2011 në të dy sistemet, si në atë publik edhe në atë jopublik, ka një përqindje të lartë të mësuesve me arsim të lartë. Vetëm në atë publik vërehet një përqindje më e lartë e mësuesve me arsim të mesëm (1.7%), krahasuar me atë privat (0.7%).



Grafiku 31. *Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2011-2012.*

Të dhënat tregojnë se në të dy sistemet, si në atë publik edhe në atë jopublik, ka një përqindje të lartë të mësuesve me arsim të lartë. Vetëm në atë publik vërehet një përqindje më e lartë e mësuesve me arsim të mesëm (4.8%), krahasuar me atë privat (0.5%). Në krahasim me një vit më parë në arsimin publik ka një rritje të lehtë të mësuesve me arsim të mesëm, nga 0.7% në 4.8%.



Grafiku 32. *Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2012-2013.*

Edhe në vitin shkollor 2012-2013 të dhënat tregojnë se në të dy sistemet, si në atë publik edhe në atë jopublik, ka një përqindje të lartë të mësuesve me arsim të lartë. Vetëm në atë publik vërehet një përqindje më e lartë e mësuesve me arsim të mesëm (2.4%), krahasuar me atë privat (0.5%). Në krahasim me një vit më parë në arsimin publik ka një ulje të lehtë të mësuesve me arsim të mesëm, nga 4.8% në 2.4%. Ndërsa në arsimin jopublik shifrat janë të njëjta.



Grafiku 33. *Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2013-2014.*

Në vitin shkollor 2013-2014 të dhënat tregojnë se në të dy sistemet, si në atë publik edhe në atë jopublik, ka një përqindje të lartë të mësuesve me arsim të lartë. Vetëm në atë publik vërehet një përqindje më e lartë e mësuesve me arsim të mesëm (2.4%), krahasuar me atë privat (0.5%). Krahasuar me një vit më parë, shifrat ato janë të njëjta si në arsimin publik edhe në atë jopublik.



Grafiku 34. *Niveli arsimor i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë.*

Në arsimin e mesëm të lartë ka një numër të lartë të mësuesve me arsim të lartë (99.5 %) Mësues me arsim të mesëm ka një përqindje shumë të ulët, përkatësisht shifrat flasin për një luhatje nga 0.7% në vitin 2010-2011 deri në 0.5% në vitin 2013-2014.

Drejtuesit pohojnë se mësuesit i kanë kryer studimet në Shqipëri. Megjithatë nuk mungojnë rastet kur mësues të caktuar kanë kryer studimet jashtë shtetit në Kanada, Austri, Itali, Siri, Turqi, Arabi Saudite, Azerbajxhan, etj.

Grupmosha e mësuesve

Grupmosha e edukatoreve

Grafikët në vijim na japin një pasqyrë të grupmoshës së edukatoreve sipas viteve të marra në studim.



Grafiku 35. *Kopshtet Private - Grupmosha e edukatoreve në vitin 2010-2011.*

Në vitin shkollor 2010-2011, përqindja më e madhe e edukatoreve i përket grupmoshës 30-34 dhe 40-44 vjeç, përkatësisht 29.1%. Grupmoshat e tjera luhaten nga 4.2% deri në 8.3%. Një përqindje të konsiderueshme zë edhe grupmosha mbi 60 vjeç, përkatësisht 16.7%.



Grafiku 36. *Kopshtet private - Grupmosha e edukatoreve në vitin 2011-2012.*

Në vitin 2011-2012, përqindja më e madhe e edukatoreve i përket grupmoshës 30-34 vjeç (33.3%) dhe 45-49 vjeç (20.8%). Grupmoshat e tjera luhaten nga 4.2% deri në 8.3%. Ka një rënie prej 8.4% të përfshirjes së grupmoshës mbi 60 vjeç në arsimin privat, krahasuar me vitin 2010-2011.



Grafiku 37. *Kopshtet private - Grupmosha e edukatoreve në vitin 2012-2013.*

Në arsimin parashkollor në vitin 2012-2013 përqindjen më të madhe të edukatoreve e përbën grupmosha 30-34 vjeç, përkatësisht 40.9%. Në këtë vit grupmoshat më të preferuara janë ato 35-39, 40-44 dhe 45-49 vjeç. Nuk ka asnjë edukatore të grupmoshës mbi 60 vjeç të aktivizuar në kopshtet private.



Grafiku 38. *Kopshtet private - Grupmosha e edukatoreve në vitin 2013-2014.*

Në vitin 2013-2014 përqindjen më të madhe të edukatoreve e përbën grupmosha 35-39 vjeç, përkatësisht 36 %. Në këtë vit grupmoshat më të preferuara janë ato 30-34, 40-44 dhe 45-49 vjeç. Nuk ka asnjë edukatore të grupmoshës mbi 60 vjeç të aktivizuar në kopshtet private.

Grupmosha e mësuesve në arsimin fillor

Grafikët në vijim na japin një pasqyrë të grupmoshës së mësueseve në arsimin fillor privat sipas viteve të marra në studim.



Grafiku 39. *Grupmosha e mësuesve në arsimin fillor privat, 2010-2011.*

Në vitin shkollor 2010-2011 në arsimin fillor privat përqindja më e madhe e mësuesve i përket grupmoshës 25-29 dhe 30-34 vjeç. Po kështu edhe për grupmoshat e tjera përqindja luhatet nga 2.6% në 17.1%



Grafiku 40. *Grupmosha e mësuesve në arsimin fillor privat, 2011-2012.*

Në vitin shkollor 2011-2012 në arsimin fillor privat përqindja më e madhe e mësuesve i përket grupmoshës 30-34 dhe 35-39 vjeç. Ka një përqindje të ulët të mësuesve të grupmoshës nën 25 vjeç, po ashtu ka rënie edhe të numrit të mësuesve mbi 60 vjeç krahasuar me vitin 2010-2011.



Grafiku 41. *Grupmosha e mësuesve në arsimin fillor privat, 2012-2013.*

Edhe në vitin shkollor 2012-2013 në arsimin fillor privat përqindja më e madhe e mësuesve i përket grupmoshës 30-34 dhe 35-39 vjeç. Edhe në këtë vit ka një përfshirje të vogël të grupmoshës nën 25 vjeç. Po ashtu ka një rënie të numrit të mësuesve të grupmoshës 40-45 vjeç. Po kështu rënie e numrit të mësuesve vërehet edhe në grupmoshën 50-54 vjeç e 55-59 vjeç. Në këtë vit ka një rritje të përfshirjes së grupmoshës mbi 60 vjeç krahasuar me vitin 2011-2012.



Grafiku 42. *Grupmosha e mësuesve në arsimin fillor privat, 2013-2014.*

Të dhënat e vitit 2013-2014 tregojnë se nga viti në vit ka një rënie të përfshirjes së grupmoshës nën 25 vjeç në këtë hallkë të arsimit. Kemi një stabilitet për sa i përket grupmoshave të tjera.

Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të ulët

Grafikët në vijim na japin një pasqyrë të grupmoshës së mësuesve në arsimin e mesëm të ulët sipas viteve të marra në studim.



Grafiku 43. *Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të ulët privat, 2010-2011.*

Në vitin shkollor 2010-2011 në arsimin e mesëm të ulët privat përqindja më e madhe

e mësuesve i përket grupmoshës 25-29 dhe 30-34 vjeç. Grupmosha me numrin më të vogël është ajo 35-39 vjeç. Po të bësh një renditje të grupmoshave do të vëresh se në këtë arsim e treta radhitet grupmosha mbi 60 vjeç, me 10.1%.



Grafiku 44. *Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të ulët privat, 2011-2012.*

Në vitin shkollor 2011-2012 në arsimin fillor privat përqindja më e madhe e mësuesve i përket grupmoshës 25-29 dhe 30-34 vjeç. Theksojmë se në këtë vit në arsimin e mesëm të ulët ka një rritje të numrit të mësuesve që i përket grupmoshës nën 25 vjeç. Rritje ka pësuar edhe numri i mësuesve që i përket grupmoshës 35-39 dhe 45-49 vjeç krahasuar me vitin 2010-2011. Ndërsa në këtë vit ka një numër më të vogël të mësuesve që i përkasin grupmoshave 40-44 vjeç, (rënie 3.1%), 50-54 vjeç (rënie 1.2%) dhe mbi 60 vjeç (3 %) krahasuar me vitin 2010-2011.



Grafiku 45. *Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të ulët privat, 2012-2013.*

Në vitin 2012-2013 numrin më të lartë të mësuesve në arsimin privat e përbën grupmosha 25-29 vjeç me 27.6 %, ndërsa më të ulët ajo nën 25 vjeç e 40-44 vjeç. Krahasuar me dy vitet më parë, rritja e numrit të mësuesve i përket grupmoshës 30-34,

35-39, 45-49 vjeç dhe ndërkohë kemi një rënie të numrit të mësuesve për sa i përket grupmoshave 40-44, me 4.3% më pak se në vitin 2010-2011; 55-59 me 1.4% më pak se në vitin 2010-2011 dhe mbi 60 vjeç me një rënie të numrit të mësuesve me 4.4% krahasuar me vitin 2010-2011.



Grafiku 46. *Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të ulët privat, 2013-2014.*

Në vitin shkollor 2013-2014 numrin më të lartë të mësuesve në arsimin e mesëm të ulët e përbën grupmosha 25-29 vjeç, dhe më të ulët grupmosha nën 25 vjeç. Nga viti në vit ka një rritje të përfshirjes së grupmoshës 35-39 vjeç në këtë arsim, ndërsa grupmosha 40-44 vjeç mbetet në kuotat e vitit 2010-2011 dhe përsëri ka rritje të numrit të mësuesve në grupmoshës 45-49 vjeç dhe rritje të lehtë në grupmoshat e tjera.

Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të lartë

Grafikët në vijim na japin një pasqyrë të grupmoshës së mësuesve në arsimin e mesëm të lartë sipas viteve të marra në studim.



Grafiku 47. *Arsimi privat-Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2010-2011.*

Në arsimin e mesëm të lartë privat përqindja më e madhe e mësuesve i përket grupmoshës 25-29 dhe 30-34 vjeç. Përqindja më e ulët e mësuesve i përket grupmoshës 50-54 me 7.6% e mbi 60 vjeç me 7.6%.



Grafiku 48. *Arsimi privat-Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2011-2012.*

Në arsimin e mesëm të lartë privat në vitin 2011-2012, përqindja më e madhe e mësuesve i përket grupmoshave 25-29, përkatësisht 22.8%; 30-34 e 35-39, përkatësisht 14.7%. Përqindja më e ulët e mësuesve i përket grupmoshës nën 25 vjeç, përkatësisht 3.8%.



Grafiku 49. *Arsimi privat-Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2012-2013.*

Në arsimin e mesëm të lartë privat në vitin 2012-2013, përqindja më e madhe e mësuesve i përket grupmoshës 25-29, 30-34 dhe 35-39. vjeç. Përqindja më e ulët, 7.3% i përket mësuesve i përket grupmoshës 50-54 vjeç.



Grafiku 50. *Arsimi privat-Grupmosha e mësuesve në arsimin e mesëm të lartë, 2013-2014.*

Në arsimin e mesëm të lartë privat në vitin 2013-2014, përqindja më e madhe e mësuesve i përket grupmoshës 35-39 vjeç, përkatësisht me 15%. Të dhënat tregojnë se pothuajse të gjitha grupmoshat ruajnë të njëjtat përqindje, me përjashtim të grupmoshës mbi 60 vjeç, me rreth 7% dhe grupmoshës nën 25 vjeç me 3%.

Përvoja në arsim e mësuesve

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet përvoja e mësueseve në arsimin bazë ndër vite.



Grafiku 51. *Përvoja e mësuesve në arsimin bazë ndër vite.*

Për sa i përket përvojës së mësuesve që japin mësim në shkollat private përqindjen më të lartë e kanë ato me përvojë 6 deri në 10 vjet, kjo e parë edhe sipas viteve. Po kështu një përqindje të konsiderueshme të përfshirjes në arsimin privat kanë edhe mësuesit me eksperiencë mbi 25 vite, por në qoftë se në vitin 2010-2011 kemi 22.6 % mësues të përfshirë në këtë sistem, në vitin 2012-2013 kemi një rënie prej 1.8%. Në

vitin 2010-2011 përqindjen më të lartë e kanë mësuesit me përvojë 0-5, 6-10 dhe mbi 25 vite punë. Në vitin 2011-2012 përsëri përqindjen më të lartë e përbëjnë mësuesit me përvojë 0-5, 6-10 e mbi 25 vite, por duhet të theksojmë se krahasuar me një vit më parë kemi një rënie të përqindjes së mësuesve me përvojë 16-20 dhe 21-25 vjeçare. Në vitin 2012-2013 përqindje më të lartë kanë mësuesit me përvojë nga 6 deri 10 vite. Gjithashtu ka një rritje të përfshirjes së mësuesve me përvojë 11-15 e 16-20 vite pune, rritje përkatësisht po të krahasojmë 2011-2012 me 2012-2013 me një dyfishim të numrit të mësuesve. Në vitin shkollor 2013-2014 ka një përqindje të ulët të numrit të mësuesve me përvojë 0-5 vjet e 6-10 vjet, gati një përgjysmim i tyre krahasuar me vitin 2010-2011. Një përfshirje më të madhe në këtë vit i përket mësuesve me përvojë 11-15 vjet, 16-20 vjet e 21-25 vjet. Mësuesit me përvojë mbi 25 vjet, ndonëse nga viti në vit numri ka ardhur duke zbritur, në vitin 2013-2014 është barazuar me vitin 2010-2011.



Grafiku 52. *Përvoja e mësuesve në arsimin e mesëm të lartë ndër vite*

Përvoja e mësuesve në arsimin privat e marrë sipas viteve është e ndryshme. Në vitin 2010-2011, përqindjen më të lartë e përbëjnë mësuesit me përvojë 0-5 vjet dhe më të ulët me përvojë 11-15 vjet. Në vitin 2011-2012, përqindjen më të lartë e përbëjnë mësuesit me përvojë 0-5 vjet dhe më të ulët me përvojë 16-20 vjet. Në vitin 2012-2013, përqindjen më të lartë e përbëjnë mësuesit me përvojë 0-5 vjet dhe më të ulët me përvojë 16-20 vjet. Ndërsa në vitin 2013-2014, përqindjen më të lartë e përbëjnë mësuesit me përvojë 0-5 vjet dhe më të ulët grupmosha 21-25 vjet. Ndërsa po të krahasojmë vitet e marra në studim shohim se viti 2012-2013, është viti ku ka patur numrin më të lartë të mësuesve përkatësisht 28.3%, me përvojë 0-5 vjeçare. Viti 2011-2012 është viti që ka përqindjen më të lartë , përkatësisht 20.7% të mësuesve me përvojë 6-10 vjet. Viti 2013-2014 ka përqindjen më të lartë të mësuesve me përvojë 11-15 vjeçare, përkatësisht 17.1%. mësuesit me përvojë 16-20 vjeçare kanë një përqindje më të lartë në vitin 2010-2011, përkatësisht me 13.8%. Po kështu mësuesit me përvojë 21-25 vjeçare kanë përqindjen më të lartë , përkatësisht 18.8 % në vitin 2012-2013, ndërsa mësuesit me përvojë mbi 25 vjet kanë përqindjen më të lartë, përkatësisht në vitin 2013-2014.

Përbërja e stafit

Stafi i mësuesve në shkollat private të Shkodrës është kryesisht shqiptar, por bëjnë përjashtim kolegji turk "H. R. Pasha" e shkolla tekniko-profesionale "Peter Mahringer" ku një pjesë e stafit janë të huaj.

"Stafi është me moshë mesatare të re ku 60% e mësuesve janë shqiptarë dhe 40% të huaj. Në kopsht dhe ciklin e ulët, stafi është 100% shqiptar, në 9-vjeçare dominojnë kryesisht mësuesit shqiptarë, ndërsa në të mesmen mësuesit janë të huaj kryesisht për gjuhët e huaja e shkencat ekzakte. Mësuesit shqiptarë japin lëndët letërsi, histori, shkencë toke, edukim fizik. Stafi në kopsht e arsimin bazë është me kohë të plotë, ndërsa shkollën e mesme mësuesit janë part-time (me orë)."

(A.B, drejtues Kolegji Turk)

"Kryesisht në të gjitha hallkat mësuesit janë me kohë të plotë. Theksoj se 50% e stafit janë mësues me eksperiencë dhe 50 % me master shkencor"

(L.R, drejtuese, shkolla "Përparimi")

"Stafi i shkollës përbëhet 60% e mësuesve nga Austria dhe 40% e mësuesve shqiptarë, ku këta të fundit janë me kohë të plotë e të pjesshme"

(S.B drejtuese, shkolla austriake"Peter Mahringer"

Përzgjedhja e stafit

Përzgjedhja e stafit bëhet mbështetur mbi kritere të përcaktuara. Shkolla përcakton kriteret e rekrutimit të stafit. Këto kritere ndryshojnë nga shkolla në shkollë. Përgjithësisht shkollat private janë të interesuara të rekrutojnë staf me kohë të plote. Kuptohet që në kopshte e ciklin fillor sipas raportimeve të drejtuesve stafi është më kohë të plotë, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët e të lartë nuk mungojnë edhe mësuesit part-time.

"Përzgjedhja e stafit të mësuesve bëhet në bazë të përvojës në arsim, zotërimit të gjuhës angleze dhe domosdoshmërish aftësive shumë të mira në përdorimin e kompjuterit. Një kriter tjetër është edhe mesatarja e notave të shkollës së lartë, por edhe kualifikime të tjera. Përzgjedhja bëhet me një konkurrim të hapur"

(A.B. drejtues, "Kolegji turk H.R. Pasha")

"Kuadri i shkollës është më i zgjedhuri dhe paguhet mirë. Duke filluar nga arsimi parashkollor, fillor, 9–vjeçar dhe i mesëm, mësuesit janë me arsim të lartë cilësor në shkollimin e tyre, pa përjashtim, sipas profileve dhe me tregues të lartë cilësorë në punën e tyre. Diploma me nota të ulëta "nuk pranohet", sepse kemi mundësi të zgjedhim. Gjithashtu kërkohen tregues të tjerë: etikë profesionale, disiplinë shkencore, etj. Shumë të kujdesshëm jemi në përzgjedhjen e stafit të shkollës së mesme. Rreth 40% e stafit të kësaj të fundit është me kualifikim pasuniversitar duke filluar nga titujt "master"e "doktor". Është për tu theksuar se disa nga mësuesit janë njohës të mirë të arsimit të lartë, të mesëm dhe 9-vjeçar. Në shkollën tonë numri i mësuesve part-time (me orë) është i kufizuar, pasi interesi i shkollës kërkon mësues efektivë. Këtu është fjala për personalitete që janë tërhequr si mësimdhënës në klasat e larta. Kryesisht në rekrutimin e stafit janë përdorur kriteret profesionale.

(T.Z drejtuese, shkolla "Dituria")

"Mësuesit në rradhë të parë duhet ti karakterizojë pasioni, dëshira dhe profesionalizmi. Një tjetër kriter është edhe përvoja në punë. Në shkollën dominojnë femrat kryesisht të grupmoshës 35-40 vjeç. Ne jemi të interesuar për një staf me kohë të plotë, por nuk mungojnë edhe mësuesit me kohë të pjesshme.

(T.B drejtuese, shkolla "Maria Ndihmëtare")

"Ne si drejtues i zgjedhim mësuesit duke marrë parasysh disa arritje si: rezultatet e larta në përgatitjen profesionale, kalimin me sukses të kurseve të trajnimit, një stazhi të shkurtër dhe rezultateve të punës si edhe përkushtimit e disiplinës"

(P.M, drejtuese, shkolla"Shpresa për të ardhmen")

Kualifikimi i stafit

Për mirëfunksionimin e institucioneve private një rol të rëndësishëm luan edhe kualifikimi i mësuesve. Si forma janë zgjedhur si kualifikimi i brendshëm ashtu edhe ai i jashtëm. Në institucionet private përdoren forma të larmishme për kualifikimin e mësuesve. Konferencat, orët e hapura, workshopet për integrimin e teknologjisë, metodave bashkëkohore në procesin mësimor etj, janë disa nga format që ky arsim na prezanton.

"Është ndër politikat e institucionit tonë kualifikimi i mësuesve në përdorimin e metodave, teknikave, strategjive, përdorimin e teknologjive bashkëkohore në procesin mësimor, integrimin e TIK në procesin mësimor. Një herë në muaj mësuesit sipas departamenteve zhvillojnë 2-3 seanca trajnimi për të diskutuar mbi ecurinë e planeve, zbatueshmërinë e programeve, përdorimin e mjeteve të reja laboratorike, format e reja të dhënies së lëndëve. Gjithashtu një herë në vit zhvillohet trajnimi me trajnues të huaj (anglezë, kanadezë, etj) në lidhje me metodat e reja e përdorimin me efikasitet të tyre, si dhe të atyre metodave që realizojnë gjithë përfshirjen e nxënësve, për të mos lënë asnjë nxënës jashtë orës së mësimit; përdorimin me efikasitet të smart bordit në orën e mësimit. Ne si drejtues të institucionit bashkëpunojnë me specialistë të qendrave QTKA, CDE, IZHA, të cilët ofrojnë trajnime sipas kërkesave të institucionit. Katër herë në vit shefat e katedrave (nga drejtoria përgjithshme e kolegjeve me seli në Tiranë) ndjekin orë mësimi, për të parë performancën e mësuesve. Në muajin gusht, po në Tiranë, zhvillohen 5 ditë trajnimi parapërgatitor me mësues sipas profileve për organizimin e vitit të ri shkollor. Gjithashtu është e detyrueshme që në një vit mësimor, mësuesi duhet të zhvillojë 2 orë të hapura, kalendari i të cilave afishohet që në fillim të vitit shkollor dhe të gjithë të interesuarit, përfshirë këtu kolegë, prindër, etj janë të lirë ti ndjekin këto orë. Është e detyrueshme që mësuesit e lëndëve shkencore të certifikohen në nivelin B2 sipas Oxford Placement Test, kjo për faktin se mësimet jepen në gjuhën angleze dhe kërkohet një nivel i lartë i zotërimit të kësaj gjuhe. Të gjitha trajnimet organizohen nga institucioni dhe shpenzimet mbulohen nga institucioni.

(A.B, drejtues, Kolegji Turk "H.R.Pasha").

"Krahas trajnimeve që mësuesit janë të interesuar ti ndjekin vetë, shumë efikas rezulton edhe kualifikimi i brendshëm ku mësuesit shkëmbejnë eksperiencat me njëri–tjetrin. Në periudha të ndryshme organizojmë trajnime duke ftuar edhe profesorë të universitetit sipas kërkesave të stafit" (T. B, drejtuese, shkolla "Maria Ndihmëtare").

"Kualifikimi i brendshëm është një formë që përdoret në shkollën tonë. Një ndër to ishte edhe seminari për mësuesit që jepnin lëndët teknike në gjuhën gjermane. Secili mësues dha eksperiencën e vet përmes orëve praktike. Shkëmbimi i eksperiencave dhe materialeve nxit kreativitetin në organizimin e orës.

Një tjetër aktivitet është edhe një projekt i menaxhimit të cilësisë pedagogjike (PQM), projekt i filluar më 2008, i cili kalon në disa faza dhe ka si synim grumbullimin e informacioneve mbi të nxënit, mësimin dhe shkollën me qëllim rritjen e standardeve.

Shkolla së bashku me Swisscontakt zhvilluan një projekt trajnimi për mësuesit shqiptarë. Mësues dhe mësuese nga 17 shkolla të degës së re të informatikës nga e gjithë Shqipëria morën pjesë në trajnim në fushën e IT- me tre module, nga një javë secili. Modulet u përgatitën në bashkëpunim me ministritë zvicerane dhe shqiptare të arsimit dhe mësuesit e IT në shkollën austriake. Nga ky trajnim përfituan 35 mësues shqiptarë. Nxënës të viteve të treta shërbyen si asistentë e përkthyes. Një nismë e kthyer në traditë.

Në shkollën tonë është zhvilluar konferenca e 12-të e shoqatës shqiptare të mësuesve të gjermanishtes. Në këtë aktivitet me temë "Impulse për një formim me baza të reja të mësuesve"morën pjesë 60 mësues nga Shqipëria e vendet fqinje. Në këtë konferencë u mbajtën tre referate interesantë rreth mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj së bashku me diskutim përmbyllës. Gjithashtu u prezantuan dy libra të rinj për mësimdhënien e gjuhës gjermane "Menschen" dhe "Sicher". Në fund u ofruan 4 workshope me temën në vijim: "Dëgjimi dhe kuptimi"

"Një aktivitet i rëndësishëm ishte edhe workshopi i gjuhës angleze ku morën pjesë edhe 40 mësues nga Shkodra. Këtu u prezantuan metoda të reja të mësimit të gjuhës angleze, kryesisht përmes lojërave, përdorimit të videove gjatë orës së mësimit duke filluar nga videoklipe të shkurtra deri te sekuencat e gjata filmike. Më pas edhe mësuesit patëm mundësi ti aplikonin vetë këto metoda përmes ushtrimeve praktike. Gjithashtu mësuesit morën edhe informacion mbi smart-bordin, me qëllim për një mësim aktiv e modern.

"(S.B, drejtuese, shkolla"Peter Mahringer").

Bashkëpunimi shkollë –familje

Bashkëpunimi me familjen është mjaft i rëndësishëm. Sot ka dimensione të ndryshëm bashkëpunimi, të cilët kanë evoluar dhe kanë dhënë rezultatet e veta të dukshme jo vetëm në përmirësimin e këtij partneriteti, por edhe në rritjen e rolit të shkollës e të vlerave të saj në komunitet. Shkollat private përdorin forma të larmishme komunikim me prindërit siç janë telefonatat, vizitat në shkollë e familje, shënimet individuale, takimet me prindër, mbledhjet, fletorja e komunikimit, emisionet, porositë javore, e-maili, takimet e çajit, ekskursionet, etj.

"Shkolla ka tre partnerë të fuqishëm: nxënësin, mësuesin dhe prindërit. Këta partnerë së bashku me kurrikulën përcaktojnë fatin e arsimimit të brezave. Kontakti mes këtyre partnerëve është i domosdoshëm. Një nga format që përdoret në shkollën ku unë drejtoj është biseda masive me të gjithë prindërit e shkollës 1-2 herë në vit, ku shtrohen probleme të përgjithshme për prindërit dhe ku i informojmë për specifikat e punës në shkollë. Biseda me grupe prindërish të veçantë në bazë klase apo grupe të caktuara për probleme specifike është një tjetër formë që ne përdorim. Forma të tjera mjaft rezultateve janë edhe bisedat para ngjarjeve të mëdha, si mbyllja e vitit shkollor, fillimi i vitit, fillimi i semestrit etj, biseda "sy më

sy" ose "dorë për dorë"me prindër të caktuar për probleme të veçanta të fëmijëve të tyre, në praninë e nxënësit. Ne përdorim edhe komunikimin operativ kur duam t'i informojmë prindërit për ndryshime në njohuritë shtesë që do marrin nxënësit, për plotësimin e kurrikulës, ndryshimin e orarit në shkollë, etj. Gjithashtu ata marrin edhe një informacion paraprak për çdo ndryshim në vitin e ardhshëm akademik"

(M.B drejtore, shkolla jopublike "Teuta").

"Mbaj kontakte të rregullta me familjet e nxënësve. Mendoj se suksesi i zhvillimit të çdo fëmije në fusha të ndryshme qëndron në përgjegjësinë dhe bashkëpunimin e prindërve dhe të shkollës. Mbledhjet me prindërit zakonisht i zhvillojmë në fillim të vitit, ndërsa takimet me prindër një herë në muaj, por ndodhe edhe më shpesh në varësi të problematikave. Këto takime janë shumë të rëndësishme dhe para takimit unë dhe stafi që unë drejtoj përgatitemi. Takimet individuale zakonisht i zhvillojmë në "Dhomën e prindërve". Ky është një mjedis i përshtatshëm për të siguruar efektivitetin e këtyre takimeve. Bisedat telefonike, vizitat në familje, raportet me shkrim, njoftimet e rregullta me shkrim drejtuar prindërve, bisedat e rastësishme ditore, janë forma që ne përdorim për të rritur bashkëpunimin me prindërit. Prindërit ofrojnë edhe punë vullnetare në shkollë, ndihmojnë në veprimtaritë artistike dhe shkencore të shkollës, organizojnë ditëlindjet, etj. Theksoj faktin që prindërit janë pjesë e çdo projekti që ndërmerr shkolla".

(T.Z drejtore, shkolla jopublike "Dituria").

"Me prindërit mbajmë kontakte të vazhdueshme. Zakonisht ne zhvillojmë takimin me prindërit një herë në muaj. Për probleme të veçanta komunikojmë me telefon, e-mai, etj. Nëse nxënësi vjen i papërgatitur, apo mund të ketë shqetësime të tjera, komunikojmë pothuajse çdo ditë. Çdo mësues në fillim të vitit organizon mbledhjen me prindërit. Prindërit informohen edhe për risitë që do të ketë vitin e ardhshëm si: vënia në funksionim e palestrës, ndryshimi i pagesës etj. Në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor, kemi përgatitur edhe një udhëzues për prindërit për regjimin ditor të fëmijës/nxënës. Prindërit janë mbështetës, kontribuues dhe pjesëmarrës në çdo aktivitet që organizon shkolla".

(F. Ç drejtore, shkolla jopublike "Miqësia")

"Marrëdhëniet me prindërit i kemi shumë të mira. Prindërit na mbështesin, na respektojnë, por në radhë të parë na vlerësojnë për vlerat edukative që ne përcjellim. Por ka edhe raste kur nuk gjejmë mbështetje. Përdorim forma të ndryshme komunikimi. Për nxënësit deri në moshën 9 vjeç përdorim kryesisht fletoren e komunikimit. Takimet me prindër zakonisht i zhvillojmë 1 herë në muaj. Takimet janë individuale, por në këto takime merr pjesë edhe nxënësi. Shpesh me prindërit trajtojmë tema të ndryshme me karakter edukativ. Për të inkurajuar pjesëmarrjen e prindërve ne organizojmë "Festën e familjes". Në shkollë ekziston edhe një bashkësi edukative ku krahas mësuesve, stafit drejtues, nxënësve të shkollës, ish-nxënësve janë të përfshirë edhe prindërit. Një herë në 2-3 vjet në muajin prill prindërit plotësojnë pyetësorët me qëllim marrjen e opinioneve në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Rezultatet e pyetësorit diskutohen në muajin shtator në një takim të hapur ku marrin pjesë edhe prindërit. Vazhdimisht jemi në kërkim të gjërave të reja. Në fund të fundit të gjithë së bashku kemi një qëllim dhe synojmë formimin e gjithanshëm të nxënësit"

(Motër T, drejtoreshë e shkollës jopublike "Maria Ndihmëtare").

"Shkolla jonë përdor forma të larmishme komunikimi me prindërit. Ato janë pjesë

përbërëse e shkollës dhe luajnë një rol të rëndësishëm me kontributin e tyre herë pas here, duke e bërë këtë partneritet jo vetëm funksional, por edhe të dobishëm në arritjen e suksesit të vajzave të tyre. Përveç takimeve me prindër që janë të përmuajshme (një herë në muaj), shkolla jonë ka:

*Revistën e saj "Zemzem", ku botohen krijime të nxënëseve, aktivitete të ndryshme shkollore e jashtëshkollore, rezultatet në olimpiada etj, duke pasqyruar në këtë mënyrë veprimtarinë shkollore. Një emision javor në Radio "Jehona", "**Hapa që shihen, gjurmë që lihen",** ku informacioni jepet në formë të drejtpërdrejtë mbi partneritetin shkollë-familje, sepse në rubrikat: "I ftuar në studio" dhe "Intervista e radhës" krahas të ftuarve (intelektualë të fushave të ndryshme të qytetit të Shkodrës), shpeshherë mes tyre janë edhe prindër të nxënësve"*

(A.D, drejtues medreseja e vajzave "Haxhi Sheh Shamia").

"Takimet me prindër i zhvillojmë çdo dy javë. Lajmërimi bëhet me letër ku prindi njoftohet për orën dhe vendin. Nëse kemi probleme, takimet me prindërit bëhen më të shpeshta. Prindi vjen në shkollë sa herë e ndjen të nevojshme dhe dyert saj janë gjithmonë të hapura për të. Mendoj se përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim t'i ndihmojë nxënësit. Në çdo kohë ne i informojmë ata për rezultatet e fëmijëve të tyre. Ata u përgjigjen kërkesave dhe informacioneve të ndryshme që ne u dërgojmë. Prindërit ndjekin sjelljen e fëmijëve dhe përfshihen në vendimet që merren për edukimin e tyre. Prindërit mbështesin punën tonë (vendosin rregulla për fëmijët e tyre rreth kohës së gjumit dhe asaj për të shikuar televizor, u japin rëndësi detyrave të shtëpisë, inkurajojnë sjelljet pozitive të fëmijëve) dhe na ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve.

Ata marrin pjesë me shumë dëshirë në organizimin e ditëlindjeve, panaireve, festave etj. Mbështetja e prindërve është e sa e nevojshme aq dhe e domosdoshme".

(S. L, drejtuese, shkolla private "ABC".

"Në kolegjin tonë ndiqen strategji të ndryshme për ta përfshirë prindin në jetën e shkollës. Mësuesit dhe anëtarët e drejtorisë janë të gatshëm për të biseduar në çdo kohë me prindin. Ne përdorim forma të ndryshme të komunikimit me prindërit, përfshirë këtu njoftimet me shkrim, me telefon dhe përmes e-mailit. Takimet me prindër planifikohen zakonisht çdo dy javë, por ata janë të mirëpritur në çdo çast të ditës për të diskutuar për problemet që i shqetësojnë. Do të doja të theksoja që takimet me prindër në grup, individuale etj, zhvillohen në ambiente shumë komode dhe klima e komunikimit është shumë miqësore. Shpesh ne organizojmë edhe shëtitje me nënat shtëpiake jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj. Kolegji ynë ofron edhe kurse falas për mësimin e gjuhëve të huaja (anglisht dhe turqisht) si dhe kurse kompjuteri. Mjaft të frytshme janë edhe bisedat e lira në takimet e çajit, që ne i aplikojmë për të marrë më shumë informacion për familjen, veçoritë individuale të nxënësit, interesat, hobet e tij, etj".

(A. B, drejtues, kolegji turk "H. R. Pasha").

"*Në shkollën tonë me prindërit aplikohen forma të ndryshme komunikimi. Për çdo gjë prindërit informohen me anë të telefonit, me letër, me e-mail. Në fillim të vitit shkollor zhvillohet një mbledhje ku prezantohet programi i gjithë vitit shkollor. Takimet mësues- nxënës-prind janë format më të përdorura. Të gjitha takimet zhvillohen në ambiente të veçanta. Ne i mirëpresim ata në shkollë në çdo orë të ditës, i informojmë rregullisht për gjithçka ndodh në shkollë dhe me fëmijën. Nëse fëmija ka munguar në shkollë, prindërit janë të detyruar ta shoqërojmë fëmijën në shkollë duke marrë kontakt direkt me mësuesin kujdestar. Prindërit nuk mund ta justifikojnë fëmijën as nëpërmjet letrave, as nëpërmjet telefonit, por vetëm duke kontaktuar personalisht me mësuesin kujdestar. Prindërit informohen për ecurinë e fëmijës përmes regjistrit elektronik. Secili*

nxënës ka adresën dhe fjalëkalimin e tij. Gjithashtu është detyrë e mësuesit kujdestar të informojë prindërit për çdo gjë përfshirë mungesat apo ardhjet me vonesë , si dhe një herë në tre javë me anë të celularit informon prindërit për ecurinë e fëmijës. Gjithashtu është detyrë e mësuesit kujdestar të hartojë një grafik me orën dhe datën e caktuar për secilin nxënës për takimin individual me prindin.

(R. L, drejtues, shkolla "Atë Pjetër Mëshkalla").

4.7 Nxënësi

Arsimi parashkollor

Përqindja e fëmijëve të regjistruar në kopshte publike e private

Institucionet parashkollore janë shumë të rëndësishëm dhe ndikojnë jo vetëm në zhvillimin fizik, mendor e moral, por edhe për një fillim të mirë të shkollës. Grafiku në vijim na jep përqindjen e fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike e private.



Grafiku 52. *Përqindja e fëmijëve të regjistruar në kopshte publike dhe private.*

Pjesa më e madhe e fëmijëve frekuentojnë kopshtet publike, përkatësisht 87%, ndërsa numri i atyre që frekuentojnë kopshtet private është 13%, shifër kjo që ka ruajtur një stabilitet në vite dhe tregon se numri i fëmijëve që frekuentojnë institucionet private të arsimit parashkollor është në një përqindje të ulët krahasuar me atë publik.

Sa i përket shtrirjes në fshat apo në qytet, për periudhën e marrë në studim kemi më shumë kopshte në qytet sesa në fshat. Në grafikun në vijim tregohet qartë ky raport.



Grafiku 53. *Kopshtet private: Raporti qytet – fshat.*

Të dhënat tregojnë se kopshtet private janë shtrirë si në fshat ashtu edhe në qytet. Sa i përket raportit fshat qytet, vërehet se ka një përqindje më të lartë të kopshteve në qytet, përkatësisht 75%-77% , ndërsa në fshat ka një përqindje më të ulët, përkatësisht 22.2%- 25%. Ajo që vihet re është fakti se numri i kopshteve private në qytet ka ardhur duke u rritur, ndërsa në fshat duke u ulur, përkatësisht me 2.8%.

Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte sipas grupmoshave

Në grafikun e mëposhtëm është dhënë numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte sipas grupmoshave ndër vitet e marra në studim.



Grafiku 54. *Kopshtet private - Numri i fëmijëve të regjistruar ndër vite sipas grupmoshave.*

Numri i fëmijëve që frekuentojnë institucionet private sipas grupmoshave ka ardhur duke u rritur. Po të analizojmë të dhënat sipas viteve, vërejmë se në vitin 2010-2011 fëmijët 5 vjeçarë kanë numrin më të madh, përkatësisht 173, ndërsa më të voglin ata 3 vjeçarë, përkatësisht 50. Në vitin 2011-2012 ka një rritje të numrit të fëmijëve që frekuentojnë kopshtet private, por që një interes më të madh për këto kopshte ka për fëmijët 3 vjeçarë, përkatësisht një shtim prej 32 fëmijësh krahasuar me vitin 2010-2011, ndërsa nuk ka shtim të numrit për 5 vjeçarët. Rënie e konsiderueshme vihet re në moshën 6 vjeçare, përkatësisht me 60 fëmijë më pak krahasuar me vitin 2010-2011. Edhe në vitin 2012-2013 vazhdon të jetë i lartë numri i fëmijëve 5 vjeçarë që frekuentojnë kopshtet private, përkatësisht 177, dhe shumë i ulët ata 6 vjeçarë, përkatësisht 14 fëmijë. Interes vërehet tek mosha 3 vjeçare, pasi të dhënat tregojnë se numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet private është përkatësisht 92 fëmijë, shifër që tregon një dyfishim të numrit të fëmijëve krahasuar me vitin 2010-2011. Në vitin shkollor 2013-2014, numri i fëmijëve 4 vjeçarë që frekuentojnë kopshtet private ka ruajtur një stabilitet, ka një rënie të numrit të fëmijëve 5 vjeçarë që frekuentojnë këto institucione që në gjuhën e shifrave tregojnë 153%, ndërsa ka një rritje të lehtë të numrit të fëmijëve 6 vjeçarë, rreth 5% krahasuar me vitin 2012-2013.

Përqindja e nxënësve të regjistruar në shtator në arsimin bazë

Nga viti në vit ka një rritje të përqindjes së nxënësve që frekuentojnë arsimin bazë privat. Grafiku në vijim na jep një panoramë të ndryshimeve që ndodhin në vitet e marra në studim.



Grafiku 55. *Përqindja e nxënësve të regjistruar në shtator në arsimin bazë.*

Siç edhe shihet nga grafiku ka një rritje të numrit të nxënësve që frekuentojnë institucionet private të arsimit bazë, 14% në vitin shkollor 2013-2014, ndërkohë që shifrat flasin për një rritje me 1.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit shkollor 2010-2011. Nga viti në vit ka një rritje të interesimit për institucionet private, ndonëse institucionet publike kanë shifrat më të larta për sa i përket frekuentimit.

Përqindja e nxënësve të regjistruar në klasën e parë

Përqindja e nxënësve që janë regjistruar në klasën e parë në arsimin privat, ndonëse është më e ulët se e publikut, ka pësuar rritje nga viti në vit. Grafiku i mëposhtëm na jep ndryshimet që kanë ndodhur në vite.



Grafiku 56. *Përqindja e nxënësve në klasën e parë të arsimit të detyruar.*

Numrin më të madh të nxënësve të regjistruar në klasën e parë e përbëjnë nxënësit e shkollave publike. Ajo që vëmë re është se ka një ulje prej 0.5% të nxënësve që preferojnë shkollat private në vitin shkollor 2011-2012 krahasuar me vitin shkollor 2010-2011, ndërkohë që në vitin shkollor 2012-2013 ka një rritje të atyre që preferojnë institucionet private dhe shkon në të njëjtat nivele me vitin shkollor 2010-2011. Në vitin shkollor 2013-2014, ka një rritje të numrit të nxënësve që frekuentojnë klasën e parë, rreth 13%, shifër kjo që e krahasuar me vitin 2010-2011 tregon se ka një rritje prej 1.8%.

Përqindja e nxënëseve femra

Një tregues i rëndësishëm është numri i femrave. Grafiku i mëposhtëm prezanton një përqindje më të lartë të djemve që frekuentojnë institucionet private. Edhe numri i femrave nga viti në vit ka pësuar rritje.



Grafiku 57. *Përqindja e nxënësve femra të regjistruara në shtator në arsimin e detyruar.*

Për sa i përket përqindjes së nxënëseve femrave që ndjekin arsimin publik, kjo përqindje paraqitet është më e lartë në arsimin publik, por vlen për tu theksuar se ka një stabilitet për sa i përket ndjekjes së institucioneve private nga ana e femrave, 13.2% në vitin shkollor 2010-2011 dhe ka një rritje prej 0.6% në vitin shkollor 2012-2013 krahasuar me vitin shkollor 2010-2011, ndërkohë që në vitin shkollor 2013-2014 ka një rritje prej 0.8% krahasuar me vitin shkollor 2010-2011.

Kontingjenti i nxënësve që ndjekin shkollat private

Sipas legjislacionit në fuqi prindi zgjedh arsimin që dëshiron për fëmijën e tij. Në pjesën më të madhe të shkollave, sipas pohimeve të drejtuesve, pranimet bëhen pa konkurs dhe nxënësi është i lirë të lëvizë nga publiku te privati e anasjelltas. Bëjnë përjashtim kolegji turk "H. R. Pasha", *gjimnazi privat "Atë Pjetër Meshkalla", dhe shkolla tekniko-profesionale"Peter Mahriger"* ku nxënësit pranohen me konkurs.

"Në shkollën time, sidomos në ciklin e mesëm, pranohen nxënës pa kritere të veçanta të përzgjedhjes së tyre. Në shkollë mund të regjistrohet çdo nxënës që dëshiron, pavarësisht nëse shfaq ose jo aftësi dhe përgatitje të mirë"

(L. R, drejtuese, shkolla "Përparimi")

"Në shkollën tonë nxënësit pranohen me konkurs. Me moton "Cilësia në radhë të parë" institucioni ynë aplikon metoda efikase për evidentimin dhe përzgjedhjen e nxënësve më të mirë. Duhet theksuar se me anë të provimeve të përgjithshme hyrëse, përkatësisht për klasat e 9-ta, për nxënësit më të mirë ofrohen bursa në nivele të ndryshme. Testi i pranimit zhvillohet me anë të kompjuterit. Testi i pranimit për klasat e para është një test me njohuritë bazë që kanë fëmijët e asaj moshe, për klasat e 2-ta është i përbërë nga dy teste: matematikë dhe gjuhë shqipe, ndërsa për klasat e 3-ta deri në të 9-ta përbehet nga tre teste: matematikë, gjuhë shqipe dhe anglisht. Të gjithë aplikantët, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, pasi hyjnë në testin e pranimit i cili është i detyrueshëm duhet të arrijnë pikët e nevojshme të përcaktuara më parë nga drejtoria e shkollës për të vazhduar arsimimin tek ne. Pas mbarimit të provimit faza e dytë është kalimi pranë komisionit përkatës që bën vlerësimin e rezultatit të provimit në mënyrë transparente. Aplikanti zhvillon një intervistë me komisionin i cili më pas merr vendimin për pranimin ose jo të aplikantit duke u mbështetur në bazë të pikëve që ai ka marrë në test. Faza e tretë mbas pranimit është regjistrimi në shkollë dhe firmosja e një kontrate me kusht e cila është e lidhur me performancën në rritje që duhet të tregojë nxënësi gjatë vitit shkollor. Pyetjet e provimit janë përgatitur në bazë të programit mësimor të klasës së 8-të dhe 9-të. Pjesëmarrja në provim është pa pagesë.

(A. B, drejtues, "Kolegji Turk H. R Pasha)

"Në shkollën tonë nxënësit pranohen me konkurs. Konkursi zhvillohet me shkrim. Në momentin e regjistrimit, nxënësi duhet të paguajë taksën e regjistrimit. Në momentin e regjistrimit nxënësi pajiset edhe me programin për regjistrim. Konkursi zhvillohet i ndarë në katër pjesë: (gjuhë shqipe e letërsi), (matematikë), (fizikë, biologji, kimi), (anglisht, histori e gjeografi) me 45 minuta secila.

"(R. L, drejtues, gjimnazi privat "Atë Pjetër Meshkalla").

"Nxënësit në shkollën tonë pranohen me konkurs. Provimi i pranimit në klasën e 8-të dhe 9-të të arsimit të detyruar përfshin pyetje në gjuhë shqipe dhe letërsi, anglisht, matematikë e logjikë. Nëse nxënësi fillon mësimet në këtë shkollë në klasën e 8-të, mund ta përfundojë shkollën e mesme një vit më shpejt se tani"

(S. B, drejtuese, shkolla "Peter Mahriger").

Numri i nxënësve

Mbështetur në raportimet e drejtuesve të shkollave, numri i nxënësve në shkollat private luhatet nga 15-20 nxënës. Bën përjashtim gjimnazi privat "Atë Pjetër Meshkalla" ku numri i nxënësve është më i madh dhe luhatet nga 25-30 nxënës. Kjo sipas drejtorit është rezultat i kërkesës së madhe që ka për tu regjistruar në këtë shkollë. Numri i nxënësve është një tregues që ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e mësimdhënies.

"*Mendoj se është një prioritet që ofrojnë shkollat private, ku mbipopullimi në klasa është një ndër problemet më shqetësuese të arsimit publik. Klasa me 14-15 nxënës është "luks" për mësuesin, lehtëson punën e tij ndërkohë që ai ndihet i qetë në punën e tij. Kuptohet edhe cilësia e mësimdhënies është më e lartë, i jep mundësi mësuesit të njohë më mirë nxënësit dhe aktivizimi i nxënësve është më i madh po t'i krahasojmë me shkollat publike.*

(A. B, "Kolegji Turk H. R. Pasha")

"Numri i pakët i nxënësve në klasë është një ndër përparësitë që ky arsim të ofron" (F. Ç, drejtuese, shkolla "Miqësia").

"Kemi nga 6 klasa paralele për vit me nga 28-30 nxënës"

(R. L, drejtues, gjimnazi privat "Atë Pjetër Meshkalla").

"Përparësi e shkollave private është se klasat janë më të vogla, me më pak nxënës, gjë që e lehtëson punën e mësuesit për të zhvilluar orën e mësimit dhe për të ndjekur ecurinë e nxënësit"

(T. B, drejtuese, shkolla "Maria Ndihmëtare")

"Në shkollën 9-vjeçare numri i nxënësve në klasë nuk i kalon 18, ndërsa në të mesmen deri në 20 nxënës në klasë"

(L. R, drejtuese, shkolla "Përparimi")

"Në shkollë me një numër të vogël nxënësish, nuk ka "nxënës në hije"dhe ndiqet konkretisht përparimi i çdo nxënësi".

(M. D shkolla "Zani i Shkodrës")

Nxënësit e talentuar

Shkollat private zbatojnë politika lehtësuese për nxënësit me rezultate të larta dhe të talentuar. Përveç bursave që shpesh këto institucione u akordojnë nxënësve të tyre, aplikohen çmime të cilat shpërndahen me ceremoni. Bursa u jepen edhe nxënësve që kanë rezultate të larta, por që kanë vështirësi ekonomike.

"Stimulimi ka ndikuar pozitivisht si motivues, nxitës për nxënësit që kanë tregues të mirë në sjellje, rezultate të larta në mësime, fituesve të olimpiadave, konkurseve etj. Atyre u ofrohet burse e pjesshme dhe e plotë, në varësi të rezultateve. Afro 30% e nxënësve që ndjekin kolegjin tonë janë përfitues burse. Nuk mund të lë pa përmendur edhe çmimet që u japim nxënësve. Mendoj se janë një faktor nxitës edhe për nxënësit e tjerë me qëllim përmirësimin e të nxënit të tyre".

(A. B, "Kolegji Turk H. R. Pasha")

"Ka shumë rëndësi evidentimi i nxënësve të talentuar sipas fushave dhe pastaj puna me ta. Me këta nxënës të talentuar punohet në orë të veçanta sipas një grafiku të hartuar

bashkë me mësuesit. Me qëllim stimulimin e tyre ne aplikojmë shumë çmimet, ndarja e të cilave shoqërohet edhe me ceremoni ku të ftuar janë prindër dhe sipas fushave dhe njerëz të shquar"

(L. R, drejtuese, "Përparimi")

"*20 nxënësve të shkëlqyer u akordohen bursa nga Ministria e Arsimit, Artit dhe Kulturës e Republikës së Austrisë, 6 bursa u dhanë nga Fondacioni Shkollor dhe anëtarët e këshillit të fondacionit për nxënësit me mesatare 9,5 deri 10,0. Nga fondacione të ndryshme, nxënësit që kanë rezultate të larta por kanë vështirësi ekonomike, përfitojnë bursë vjetore "*

(S. B, drejtuese, shkolla "Peter Mahriger")

Uniforma shkollore

Uniforma shkollore është detyrim në institucionet private. Ajo përcaktohet nga institucioni dhe është e ndryshme sipas stinëve. Po kështu edhe në orët e edukimit fizik nxënësit duhet të paraqiten me uniformë të njëjtë.

"Në shkollën tonë uniforma shkollore është normë për të gjithë. Drejtoria bashkë me nxënësit kanë përcaktuar ngjyrat. Kështu në stinën e pranverës dhe vjeshtës nxënësit mbajnë bluza me mëngë të shkurtra e jakë rozë, ndërsa në dimër xhupa me ngjyrë blu me stemën e shkollës. Bluzat dhe xhupat bëhen me porosi."

(T. Z drejtuese, shkolla "Dituria")

"Në ambientin e kolegjit nxënësit duhet të mbajnë uniformë. Uniforma që do të përdoret për mësim dhe aktivitete sportive përcaktohet çdo vit nga drejtoria e shkollës. Nxënësit i pëlqejnë uniformat dhe i veshin me kënaqësi. Nxënësit mbajnë pantallona të zeza dhe bluzë të kuqe, ndërsa në dimër kësaj uniforme i shtohet një xhup me ngjyrë të zezë me stemën e kolegjit. Edhe në orën e edukimit fizik nxënësit tanë përdorim kostume sportive me ngjyrë të zezë, një uniformë e domosdoshme për të gjithë nxënësit"

(A. B, drejtues, kolegji turk, H. R. Pasha)

Kurrikula shkollore

Drejtuesit e të gjitha shkollave private deklarojnë se arsimimi i nxënësve realizohet sipas kurrikulës të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Ata gjithashtu pohojnë se kurrikula shkollore në arsimin jopublik është më e pasur se në shkollën publike. Ata e pasurojnë kurrikulën shkollore në këto fusha: gjuha angleze fillon që në klasën e parë, në klasën e pestë krahas gjuhës angleze fillon mësimi i gjuhës italiane/gjermane, ndërsa në gjimnaz krahas gjuhëve të tjera mësohet edhe turqishtja. Në shkollat fetare mësohet lënda e kulturës fetare/etikë të cilat janë të detyruara, pavarësisht nga besimi. Që në klasën e parë nxënësit marrin njohuri kompjuteri, ndërsa në klasat më të larta zhvillojnë një program më të zgjeruar të lëndës së informatikës. Në shkollën austriake krahas mësimit të gjuhës gjermane, si domosdoshmëri për vijimin e studimeve në këtë shkollë, një kombinim i formimit të përgjithshëm me fokusim gjuhët e huaja me lëndët për teknologji informacioni, bën të mundur që pas mbarimit të studimeve nxënësit të pajisen me një dëftesë që njihet në Austri e EU, duke u hapur shanset jo vetëm profesionale, por edhe mundësitë për studime në Shqipëri, Austri e EU. Në kolegjin turk e shkollën austriake, ku mësimet zhvillohen në gjuhën angleze dhe gjermane, gjuha dhe letërsia shqipe, historia e qytetërimit shqiptar dhe gjeografia e Shqipërisë zhvillohen në gjuhën shqipe.

"Një kurrikul më e pasur se në shkollat publike, mendoj se është një pikë e rëndësishme që ndikon në funksionimin e këtyre shkollave. Krahas programit të detyrueshëm shkollor, një rëndësi të madhe i kushtohet mësimit të kompjuterit dhe gjuhës angleze. Për tu theksuar është mësimi i gjuhës së huaj me metoda bashkëkohore dhe në përshtatje me moshën e nxënësve. Kështu në ciklin e ulët përvetësimi i saj bëhet përmes përrallave, lojërave shumë zbavitëse dhe me metoda të studiuara nga specialistë të huaj. Këto metoda përmbajnë jo vetëm librin për nxënësin dhe mësuesin por edhe librin për ushtrimet, kasetat për të zhvilluar të dëgjuarin dhe CD për secilin nxënës. Në klasën e gjashtë lëndët zhvillohen në anglisht e shqip, veçanërisht shkencat matematika, fizika, kimia zhvillohen në gjuhën angleze. Në vitin e parë të shkollës së mesme ndiqet një program i fokusuar në mësimin e dy gjuhëve të huaja anglisht e turqisht, mjaft të rëndësishme për vazhdimin e studimeve në këtë shkollë. Në dy vitet e fundit studiohet gjuha gjermane".

(A. B, drejtues, "Kolegji Turk H. R Pasha")

"Medreseja "Haxhi Sheh Shamia", është një shkollë e mesme e përgjithshme. Gëzon statusin parauniversitar. Të gjitha lëndët e kulturës së përgjithshme (gjuha shqipe, letërsia, historia, gjeografia, matematika, fizika, kimia, biologjia, filozofia, sociologjia dhe informatika) bëhen njëlloj me shkollat tjera të mesme (gjimnazet), por zhvillohen edhe një grup lëndësh të kulturës fetare për edukimin moral dhe qytetar islam"

(K. D, drejtues, medreseja Haxhi Sheh Shamia")

"*Shkolla profesionale austriake "Peter Maringen", me profil informatikën dhe komunikimin është e para shkollë e këtij lloji në Shqipëri, e cila synon që, pas disa vitesh të mbështesë nevojat e vendit në këtë fushë*. Në klasën e 8-të dhe të 9-të *gjuha shqipe, letërsia, historia, gjeografia, matematika, fizika, kimia, biologjia, edukata qytetare, fizkultura, teknika e mediave, praktika e kompjuterit, kompetenca sociale e personale bëhen në gjuhën shqipe, ndërsa gjuha gjermane dhe komunikimi, edukimi muzikor, informatika/sistemet teknike zhvillohen në gjuhën gjermane. Në klasat e 10, 11, 12, 13 përveç lëndëve të mësipërme zhvillohen edhe këto lëndë: zhvillim software, projekte të teknikës së informacionit, sisteme informative, teknika e mediave, teknika rrjeti, praktika e kompjuterit, praktika e detyruar. Një plan mësimor të plotë të kësaj shkolle si dhe ngarkesën javore do ta gjeni ne rubrikën shtojca"*

(S. B drejtuese, shkolla austriake "Peter Mahringer)

"Në institucionin tonë arsimor shkolla fillore ka 6, ndërsa në ciklin 9-vjeçar 7 orë mësimi në ditë. Kurrikula bazë merret nga Ministria e Arsimit dhe Sportit shqiptar dhe zbatohet duke shfrytëzuar tekste dhe metoda ndërkombëtare për një numër të konsiderueshëm lëndësh.

Gjuha angleze fillon në klasën e parë me plan të intensifikuar dhe deri në klasën e pestë, synohet të arrihet niveli para-mesatar. Në klasën e gjashtë lëndët shkencore si Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë dhe Informatikë zhvillohen në gjuhën angleze, po kështu vijon deri në klasën e dymbëdhjetë. Kurrikulat janë të njëjta me ato të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Shqiptar, por tekstet janë në gjuhën angleze. Në shkollën tonë mësohet turqishtja dhe gjuha gjermane. Gjuha shqipe e letërsia, Historia, Gjeografia, Dituria e natyrës, Aftësimi teknologjik, Edukimi figurativ, Edukimi muzikor dhe Edukimi fizik zhvillohen në gjuhën shqipe, në bazë të kurrikulave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit".

(A. B, drejtues, "Kolegji Turk H.R Pasha")

"Arsimi i nxënësve, sikurse i gjithë bashkëmoshatarët e tyre në gjimnazet e tjera, realizohet sipas kurrikulës të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Nxënësit tanë angazhohen në aktivitetet shkollore dhe jashtë shkollore, kontribuojnë në çështje të ndryshme që lidhen me moshën e tyre, problematika të ndjeshme mbi fenomene që shqetësojnë shoqërinë shqiptare, çështje të lidhura me mjedisin e kështu me radhë. Përveç këtyre, me miratimin e MAS dhe të Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, këtu mësohet edhe lënda e kulturës fetare. Ne besojmë se krahas edukimit shkencor dhe lëndëve të përcaktuara nga kurrikula e MAS, kultura fetare është një plus për këto nxënës, duke i pajisur edhe me moral të lartë njerëzor"

(K. D, drejtues, Medreseja Haxhi Sheh Shamia")

"Në shkollën tonë zhvillohen të njëjtat lëndë që zhvillohen edhe në shkollat e tjera të arsimit parauniversitar, me përjashtim orët e gjuhës angleze që fillojnë që në klasën e parë dhe lënda e informatikës"

(M. B shkolla "Teuta")

"Në shkollat private zhvillohet një program më i zgjeruar i lëndëve të informatikës e gjuhëve të huaja"

(L. R , drejtuese, "Përparimi")

"Kurrikula shkollore në arsimin privat mendoj se është e pasur. Përveçse punohet për zbatimin e programeve shtetërore, për zbatimin e të cilave kontrollohemi nga DAR-i, kurrikula shkollore është e pasur, e konkretisht: Që në klasën e parë të fillores fillon mësimi i gjuhës angleze me gojë e me shkrim. Në klasën e pestë, paralelisht me të fillon mësimi i gjuhës gjermane. Që në klasën e parë marrin njohuri kompjuteri në fillim me figura, më pas në Word, Excel etj, njohuri që vijnë duke u thelluar deri në maturë. Kuptohet që klasat e larta zhvillojnë lëndën e informatikës".

(T. Z drejtore, shkolla "Dituria")

"Në gjimnazin jopublik "Atë Pjetër Meshkalla" zbatohen struktura dhe programet shtetërore për gjimnazet, por të gjithë nxënësit e shkollës do të frekuentojnë të njëjtën orë javore të lëndës etikë/ kulturë fetare pa dallim feje. Gjuhë bazë është anglishtja, por nxënësit të ndarë në grupe mund të zgjedhin italisht, spanjisht, gjermanisht e frëngjisht si gjuhë të dytë e të tretë. Një aktivitet është tërheqja shpirtërore e cila zhvillohet në vitin e parë dhe "Takoj emocionet", një projekt kurrikular që zhvillohet me nxënësit e klasave të X e XII, nën drejtimin e mësueses së psikologjisë që është edhe psikologe e shkollës. Krahas lojërave, nxënësit bëjnë drama në lidhje me një emocion të caktuar, të cilën e prezantojnë në grupe të vogla"

(R. L, drejtues, gjimnazi privat "Atë Pjetër Meshkalla").

Veprimtaritë jashtëshkollore

Aktivitetet në institucionet private vlerësohen si mjaft të rëndësishme nga drejtuesit e shkollës. Ata pohojnë larminë dhe pjesëmarrjen me dëshirë të nxënësve në to. Madje, të gjithë ndajnë pikëpamjen se organizimi i tyre i motivon për rezultate më të larta në shkollë. Drejtuesit listojnë aktivitete kulturore, sportive, panaire shkencore, të artizanatit, të bamirësisë, ekskursionet, konkurset, klubet e ndryshme, shërbimet kulturore, shkollat e verës, ditën e dyerve të hapura, etj.

"Në formimin e personalitetit të fëmijës një rëndësi të madhe i japin formimit social, kulturor e sportiv, Festimet e 28-29 nëntorit, Vitit të Ri, 7-8 marsit, 1 qershorit, ceremonitë e diplomimit, etj, janë disa nga aktivitet tona sociale. Ndër aktivitetet sociale

të shkollës theksojmë edhe shëtitjet jashtë kufijve të Shqipërisë në USA, Angli, Francë, Kosovë,Turqi, Maqedoni, Mal të Zi si dhe në mjaft qytete të Shqipërisë; shkollat e verës, panairet e bamirësisë (shkencore, të ushqimit e të punimeve të nxënësve), ekskursionet, vizitat në azilin e pleqve, jetimore, qendra me fëmijë me aftësi të kufizuara, etj.

Aktivitetet kulturore zënë një vend të rëndësishëm në institucionin tonë. Te ne funksionon klubi i TV-Kinemasë, qëllimi i të cilit është informimi i nxënësve me të rejat e botës së spektakleve dhe kinematografisë, shfaqja e filmave më të rinj të kinematografisë botërore; klubi i teatrit, i cili zhvillon aftësitë skenike dhe teatrale të nxënësve që kanë prirje në këtë fushë; klubi i Folklorit, qëllimi i të cilit është që nxënësit të argëtohen dhe të edukohen me frymën e traditës; klubi i pikturës dhe i fotografisë, i cili krahas mësimit me teknikat e të pikturuarit dhe të fotografimit, luan një rol të rëndësishëm në rritjen e interesit të nxënësit për artin vizual; klubi i gazetarisë, i cili luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e gazetës së shkollës, buletinin në të cilën pasqyrohen aktivitet e ndryshme të organizuar në shkollë; klubi i muzikës në fokusin e të cilit është përgatitja individuale e nxënësve që kanë prirje dhe talent në fushën e muzikës; klubi i radios mundëson funksionimin e radios së shkollës gjatë pushimeve të shkurta dhe të gjata; klubi i letërsisë organizon konkurse në fushën e poezisë dhe esesë brenda dhe jashtë shkollës, klubi i konkurseve, krahas organizimit të konkurseve ndërmjet klasave, organizon seminare dhe konferenca të rëndësishme për nxënësit dhe prindërit.

Aktivitetet sportive.

"Edukimi fizik i nxënësve mbetet një nga prioritetet e shkollës sonë. Shkolla ka komplekse sportive, fusha volejbolli, minifutbolli, e basketbolli, tavolina pingpongu e kënde lojërash për fëmijët e kopshtit e të fillores. Në bashkëpunim me DAR Shkodër çdo vit në ambientet e institucionit tonë zhvillohen kampionati i volejbollit për vajza dhe i basketbollit për djem ndërmjet shkollave të qytetit. Në qytetet e Tiranës dhe Shkodrës janë organizuar turnetë e futbollit, volejbollit, konkursi i balonave, si dhe gara e vrapimit të shoqëruara me stimuj materialë. Me moton "Mendje e shëndoshë në trup të shëndoshë", në kolegjin tonë funksionojnë këto klube sportive: klubi i volejbollit, basketbollit, futbollit, tenisit dhe bilardos, atletikës, aerobisë, karatesë, boksit, shahut dhe i lojërave logjike"

(A. B, Drejtues, Kolegji turk H. R. Pasha)

"Aktivitetet në shkollën tonë janë të larmishme. Këtu nuk mungojnë aktivitetet kulturore, sportive, konkurset, shfaqjet teatrale, festat kombëtare, etj" "

(T. Z, drejtuese, shkolla "Dituria")

"*Përmes aktiviteteve të shumta, organizimit të shfaqjeve teatrale, kryerjes së praktikës shkollore në kuadër të orëve praktike që kanë studentët e degës së gjermanistikës, me botimin e një sërë broshurash historiko-kulturore dhe përmes shumë aktivitetesh të tjera, përpiqemi të pozicionohemi dhe të profilizohemi përtej aktivitetit "normal" si institucion shkollor, por edhe një institucion i rëndësishëm në fushën e kulturës dhe politikave arsimore. "Austria lexon" është një aktivitet në përmbushje të misionit të institucionit në kuadrin e shkëmbimit kulturor. Aktivitete të tjera janë dita e karnavaleve, java e projektit, mjedisi, mbyllja e vitit shkollor.*

Tregu i sendeve të përdorura, një aktivitet ku nxënësit mbasi sollën në gjendje pune kompjutera, servera, printera, monitore etj, organizuan edhe shitjen e tyre.

Shkolla jonë është edhe qendër kursesh për gjuhën gjermane, jo vetëm të studentëve

fitues të degës së gjermanishtes, por edhe për nxënësit e shkollave të Malësisë së Madhe, Lezhës e Rubikut.

"Dita e gjuhëve të huaja" është një aktivitet ku të gjitha klasat kanë mundësi të tregojnë aftësitë e tyre në gjuhën gjermane dhe angleze. Që në pranverën e 2010 shkolla është qendër provimesh për diplomën austriake të gjuhës gjermane.

Dita e dyerve të hapura, një iniciativë shembullore e punës promovuese të shkollave, është një aktivitet që u mundëson të interesuarve informacion lidhur me ambientet e shkollës, strukturën, kurrikulën, etj. Të interesuarit kanë mundësi të ndjekin orë mësimore në lëndë të ndryshme, etj. Kjo shkollë nuk është "një ishull austriak", por i duhet të integrohet në mënyrë aktive edhe në politikat arsimore dhe në jetën kulturore të rajonit. Këtij qëllimi i shërbejnë projektet e bashkëpunimit dhe ndihmës, si libra për bibliotekën e universitetit, departamentin e gjermanistikës, qendrën kulturore të fëmijëve në Tiranë, shkollat 9-vjeçare, kamera për digjitalizimin e arkivimin e dokumenteve të vjetra, materiale shkollore për shkollat e fshatit, pajisje zyre për shoqatën Austri-Shqipëri, ndihma për familjet e përmbytura"

(S. Bazhdari, drejtuese, shkolla austriake "Peter Mahringer")

"Përveç lëndëve mësimore, në shkollë ka dhe shumë programe të tjera jashtëshkollore të cilat propozohen si lëndë apo orë aktivitetesh ku trajtohen probleme si alkooli, droga, apo agresiviteti. Nuk mungojnë edhe shëtitjet për të njohur nga afër qytetin dhe zonat rreth tij, si dhe aktivitetet sportive"

(R. L, drejtues, gjimnazi privat "Atë Pjetër Meshkalla").

"Në shkollën tonë zhvillohen aktivitete të shumta. Panairet tashmë janë kthyer në traditë. Nga këto do veçoja panairin artizanal në bashkëpunim me Universitetin Amerikan të Tiranës, me pjesëmarrjen e komuniteteve fetare në vend, me qëllim ripërtëritjen e artizanatit edhe në spektrin fetar. Të shumta ishin punimet me të cilat medreseistet u prezantuan në këtë panair, e ndërkohë shumë i madh ishte edhe interesimi i të pranishmëve. Nxënëset medresiste ishin përpjekur të sillnin motive të shumëllojta në këtë drejtim, të fokusuar kryesisht në punimet në qëndistari, në grep etj. Interes përbënin edhe punimet bizhuterike të këtij lloji, të cilat sillnin një estetikë dhe një finesë të dukshme. Aktivitete të tilla natyrshëm synojnë përherë të nxisin brezin e ri në ripërtëritjen e kësaj kulture, që përbën edhe një prej bazave kyçe të traditës sonë shqiptare si dhe të forcojë lidhjet dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale duke ofruar mundësi njohjesh dhe shkëmbimesh të reja eksperiencash jo vetëm në këtë drejtim, por edhe në përgjithësi në fushën e arsimit dhe të kulturës."

(K. D, drejtues, medreseja Haxhi Sheh Shamia")

Çfarë i bën të funksionojnë mirë shkollat jopublike?

Drejtuesit e shkollave jopublike ndajnë pikëpamje të njëjta për sa i përket funksionimit të këtyre shkollave. 100% e tyre rendisin udhëheqjen e fortë administrative, përvojën shekullore në edukim, ambientin e sigurt dhe të disiplinuar, kontrollin dhe vlerësimin e shpeshtë të përparimit të nxënësve, kërkesës dhe përgjegjësisë më e lartë, si faktorë të rëndësishëm të funksionimit të këtyre shkollave.

"*Mendoj se ka disa faktorë duke filluar nga udhëheqja e fortë administrative, pikësynimet e qarta, ambienti i sigurt dhe i disiplinuar shkollor, kontrolli dhe vlerësimi i shpeshtë i përparimit të nxënësve, kërkesa dhe përgjegjësia më e lartë.*

(M. D, drejtues, shkolla "Zani i Shkodrës")

"Sukseset e arritura, disiplina e rreptë, siguria, përdorimi i uniformës shkollore, mësimi i tre gjuhëve të huaja, botimet e librave të ndryshëm, përdorimi i metodave bashkëkohore në mësim, organizimi i punës së diferencuar me nxënësit më të mirë, përdorimi i teksteve bashkëkohore botuar nga ente botuese të huaja prestigjioze. Gjithashtu nxënësit tanë nuk dinë vetëm të mësojnë, por edhe të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme si konkurse, veprimtari artistike, debate, kanë klube në shkollë, sallë me TV dhe video, në oborr organizojnë lojëra sportive, etj. Janë disa nga prioritet që shkolla jonë u siguron nxënësve. Meqë shkolla jonë ka edhe konvikt, kontrolli i mësuesve dhe kujdestarëve është i madh".

(A. B, drejtues, "Kolegji Turk H.R Pasha")

"Një nga pikat e forta mendoj se është njohja individuale e secilit nxënës. Njohja nuk është një njohje thjesht me emra, por shumë më gjerë, për nivelin real të njohurive, shkallën e arritjeve të standardeve lëndore, për sjelljen dhe formimin e tyre. Kjo sepse në shkollën tonë nuk kemi shumë largime nxënësish, përveçse pranime të reja brenda kapaciteteve ekzistuese. Kështu janë shumë familje që pasi kanë sjellë njërin fëmijë, sjellin edhe tjetrin, por edhe të afërmit, komshinjtë, etj. Janë shumë familje që kanë sjellë dy apo më shumë fëmijë. Reklamën e shkollës e bëjnë vetë nxënësit e prindërit e tyre pa qenë nevoja për propagandë e njoftime në TV"

(T. Z, drejtuese, shkolla "Dituria")

"Pikë e fortë e shkollës është ruajtja e notës mesatare. Nga muaji prill deri më 25 maj të gjithë nxënësit i nënshtrohen testimeve pothuajse në të gjitha lëndët. Një drejtues përgjigjet vetëm për cilësinë e mësimdhënies"

(L. R, drejtuese, shkolla "Përparimi")

"Jo thjesht një institucion arsimor, por i mbështetur edhe te besimi, shkolla ka një mision të madh, dituri dhe besim"

(K. D, drejtues, "Medreseja Haxhi Sheh Shamia")

"Ne besojmë në njeriun, në të mirën që është brenda çdo njeriu. Për këtë arsye, besojmë në edukimin e nxënësve tanë që të arrijnë ta njohin dhe ta shfaqin këtë të mirë që është brenda tyre! Këto shkolla nuk kanë qëllim tjetër përveç realizimit të tyre, formimit të tyre të plotë. Nuk mendojnë për tjetër veçse si të përmirësojnë seriozisht metodologjinë, mësimdhënien, ambientet për ta. Të vënit në qendër nxënësin është pra esencial, përndryshe do të mohonin natyrën e vet, misionin e vet. Përsosmëria nuk është njerëzore, ndaj mendoj se diferenca qëndron në përkushtimin total të drejtuesve dhe edukatorëve, në qartësinë e qëllimeve dhe mungesën e qëllimeve të dyta, në pasionin për edukimin. Kjo i bën këto shkolla të hapura dhe në dialog për të mësuar nga përvojat e të tjerëve (të shkollave publike dhe private), i bën të gatshme për të bashkëndarë pasuritë e veta edukative.

Një tjetër element që nuk duhet anashkaluar është trashëgimia e një karizme edukative. Shumica e drejtuesve të shkollave në fjalë nuk vijnë vetëm nga përvoja personale të pasura në fushën e mësimdhënies, por nga përvoja shekullore edukimi. Shpjegohem më mirë: këta edukatorë i përkasin familjeve rregulltare, që prej shekujsh kanë ushtruar artin e edukimit në Evropë e në botë"

(T .B, shkolla "Maria Ndihmëtare)

Efektshmëria e shkollës jopublike

Drejtuesit ndajnë pikëpamje të njëjta për sa i përket efektshmërisë së arsimit jopublik krahasuar me atë publik. Ata mendojnë se ky arsim është më efektiv se ai i publik dhe për këtë rendisin faktorë të tillë si: mësues profesionalistë, përfshirje e interesim më i madhe i prindërve, lidhje më e ngushtë mësues-nxënës, mjedise funksionale e të pasura me shumë burime teknologjike, numër të vogël nxënësish, etj.

"Mendoj se po. Besoj këtu shpreh edhe mendimin e inspektorëve të MASH dhe DAR-it që kanë ushtruar ndihmë e kontroll në shumë shkolla private të qytetit tonë por edhe gjetkë. Ka rezultuar se në shkollat private punohet mirë, ka disiplinë dhe rezultate konkretisht: nxënësit kanë arritje me të larta se në shkollat publike. Ka një interesim dhe përfshirje më të madhe të prindërve, kemi mundësi të përzgjedhim mësuesit më të mirë, gjë që krijon shkolla produktive. Mësuesit e shkollave private janë më të ndjeshëm dhe mbajnë lidhje të ngushta me nxënësit e tyre. Afrojmë nxënës me notë mesatare të lartë mbi 8, klasat kanë jo më shumë se 20 nxënës dhe kanë një bazë materiale relativisht të mirë, ka më pak probleme disiplinore se në shkollat jopublike."

(M. D, drejtues, shkolla "Zani i Shkodrës"

"Një mjedis shkollor mësimor i orientuar është përgjegjës për arritje më të larta të nxënësve. Një mjedisi i pasur me shumë burime teknologjike, me mësues profesionistë për të përdorur informacionin, për të vlerësuar dhe të pajisur me aftësi për të përdorur teknologjinë janë faktorë që garantojnë sukses. Sfondi familjar, mbetet faktor i rëndësishëm dhe që garanton sukses."

(F. Ç, drejtuese, shkolla "Miqësia")

"Në shkollën çdo detyrë e nxënësit dokumentohet dhe ruhet, përfshirë testet, detyrat me shkrim, shënimet e mësuesve, komentet e tyre, si bazë e komunikimit me prindërit e deri te libreza e notave. Numri pakët i nxënësve bën që çdo ditë nxënësit të pyeten madje në çdo orë mësimi, duke ndikuar jo vetëm në përgatitjen e tyre, por kjo bën që nxënësit të kontrollohen çdo ditë.

(P. M, drejtuese, shkolla "Shpresa për të ardhmen)

KAPITULLI V

DISKUTIME

Historia e arsimit dhe e shkollës shqipe është e vjetër dhe shkon në thellësi të shekujve. Gjurmë të shkollave shqipe dhe mësimit të gjuhës amtare ndeshen shumë herët në trevat shqiptare.

Po të hedhim një vështrim në thellësi të shekujve, vëmë re se në shek. XII, në Shqipëri, përveç kulturës greko-bizantine, bashkë me ndikimin e kishës katolike, filloi të ripërhapej kultura latine-kishtare, si dhe shkrimi latinisht. Në krahinat veriore e verilindore të Shqipërisë filloi edhe shkrimi në gjuhën sllave. Në zonat e Shkodrës në këtë periudhë u ndeshën të tria kulturat: bizantine, sllave, latine.

Në shek. XIII-XIV, me lulëzimin që arritën disa qytete në trojet shqiptare, u krijuan kushte të favorshme për zhvillimin e arsimit. Shkollat që u ngritën në këtë periudhë qenë nën varësinë e institucioneve kishtare. Në këtë periudhë duket se filloi edhe përdorimi i shqipes si gjuhë e shkruar.

Problemi i shkollave nuk mund të ndahet nga problemi i gjuhës. Në trevën Shkodër – Lezhë – Tivar, duke nisur nga fillimi i mijëvjeçarit të dytë të erës sonë, për disa shekuj u përdor latinishtja si gjuhë e shkruar. Dëshmi për këtë është përkthimi latinisht (v. 1170) i kronikës së priftit të Dioklesë (1160-1180), mbishkrimi i rrasës së varrit në Shaz (1262), mbishkrimi latinisht i kishës së Shirqit nga fundi i shekullit XIII (1290), mbishkrimi i monedhës së Shkodrës. Fillimisht në shekujt XII-XIII shqipja u shkrua me alfabet latin. Kjo gjuhë tërhoqi vëmendjen e të huajve. Në "Descriptio Europae Orientalis" (1308) ndër të tjera është shkruar se *"shqiptarët kanë gjuhë të dallue (dalluar) nga latinët, grekët, sllavët, kështu që nuk merren vesh për asgjë me kombet e tjera*".

Rëndësi të madhe për traditën e vjetër të shkrimit të shqipes kanë pikërisht disa të dhëna të cilat i disponojmë dhe po i prezantojmë. Me të dhënat që disponojmë mund të themi se gjuha shqipe u shkrua për herë të parë përafërsisht në shekujt XII-XIII. Për rrjedhojë, do të ishte me vend që të supozohet se ka pasur vepra të shtypura në gjuhën shqipe edhe në fillim të shekullit XIV, madje edhe më parë dhe se këto kanë shërbyer edhe për qëllime arsimore.

Relacioni i vitit 1332 i murgut frëng Brokard ose i kryeipeshkvit të Tivarit, domenikanit Guljelm Adae në veprën "Directorium ad passagium facienda" (libri I, pjesa 8) thekson: "Lecet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant et diversam, tamen litteram latinam habent in uso et in omnibus suis libris *"Shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë alfabetin latin në përdorim dhe në tërë librat e tyre"*[250] (Shuteriqi, Dh 1976, fq. 27). Brokardi u ka dhënë rëndësi librave të shkruar shqip me alfabetin latin, por edhe shkrimeve të tjera.

250 Shuteriqi, DH, S (1976), "Shkrimet e para shqipe", Tiranë, fq. 27

Po kështu Marin Barleti (1504) përmend kronikat e shkruara në gjuhën e vendit para vitit 1469.

E kësaj periudhe është edhe "Formula e Pagëzimit" e shkruar nga drishtiani Pal Engjëlli. Pra, jemi të mendimit se mbi bazën e një përvojë të gjatë të fituar në shkrimin e gjuhës shqipe u arrit në shkrimin e dorëshkrimeve e librave.

Në shekullin e XV-të shqipja filloi të përdorej edhe në administratë dhe në këtë kohë Shqipëria kishte shumë njerëz të shkolluar.[251] (Shllaku, L (2002), fq. 52) Ky fakt dëshmon për një gjendje relativisht të zhvilluar të arsimit në Shqipëri dhe në trojet e saj, ku shkollat ishin nën kontrollin e klerit.

Vërshimi osman, i cili preku të gjitha viset ku jetonin shqiptarët, u orvat të zhdukte çdo gjurmë kulture e zhvillimi. Është kjo një ndër arsyet që gjurmët e kulturës sonë mesjetare ti kërkojmë në vendet fqinje, si në Itali, Raguzë, etj.

Shkollat kanë qenë të rralla dhe janë hapur pranë kishave dhe manastireve. Ato janë ndjekur nga fëmijët e aristokratëve për nevoja kishtare, por në shek. XIV edhe nga të rinj që nuk dëshironin të bëheshin priftërinj. Në shkollat e hapura pranë manastireve të Shën Theologut, të Navaricës, të Stillos (1275-1627), të Svërnecit (1376), krahas mësimeve fetare mësoheshin filozofia e veprat e letërsisë kristiane.[252] Në manastirin e Ardenicës (fillimi i shek. XIII-1684) është mbajtur një shkollë ku mësonin gati të gjithë klerikët e Myzeqesë. Kleri i këtyre shkollave kishte si qëllim përhapjen e shkrim-leximit në rradhë të parë në qytete dhe pastaj në fshatra të mëdha. Ndonëse përmbajtja e këtyre shkollave kishte karakter fetar, rëndësia e tyre qëndron në faktin se *"... në këto shkolla gjejmë elementet e para të një veprimtarie të organizuar kulturore-arsimore tek shqiptarët"*[253]. (Rexhepagiq, J 1970, fq.11) Kleri i famullive është marrë më së shumti me problemet e mësimit në shek. XIV-XV. Po në këto shekuj shfaqen françeskanët.

Në krahinat veriore, ku shtrihej pushteti fetar i kishës katolike, mbizotëronte gjuha latine. Në administratën shtetërore dhe institucionet e kultit islam, praktikohej gjuha turko-arabe. Në këto kushte u vështirësua shumë procesi i përpunimit të gjuhës amtare. Ajo kishte mbetur "e huaj" në vendin e vet[254] (Osmani, Sh 1998). Ajo kishte mbetur jashtë portës së institucioneve të huaja, por asnjëherë jashtë dhe asnjëherë e huaj për popullin e vet. Siç thekson edhe Prof. Sh. Osmani "*...Asnjë gjuhë nuk e zëvendësoi në folklor, asnjë gjuhë nuk mundi ta shmangte nga tryezat e kuvendet krahinore. Në vatrat e familjeve shqiptare ajo mbeti zonjë shtëpie. Thirrja e saj do të dëgjohej gjithmonë e fortë e urdhëruese në kryengritjet që asnjëherë nuk patën të sosur..."*[255] (Osmani, Sh 1998)

Shekulli i XVII-të shënon një fazë të re, e cila spikat në shtimin e numrit të botimeve dhe në nismat për hapjen e shkollave, ku krahas përfshirjes së elementit shqip kemi edhe pjesëmarrjen e një plejade të tërë figurash të shquara atdhetare.

Në botimet e autorëve shqiptarë zuri vend të ndjeshëm e të qëllimshëm elementi shqip. Botimet në gjuhën shqipe "Doktrina e Krishterë" (1618), "Rituali Roman

251 Shllaku, L (2002) "Shkollat klerikale" (Vështrim historik nga fillimet deri më 1924), Camaj-Pipa, Shkodër, fq. 52
252 Bardhyli "Hylli i Dritës" 4, Shkodër, 1938, fq. 163
253 Rexhepagiq , J (1970) "Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme, deri në vitin 1918", Prishtinë, fq. 11
254 Osmani, Sh (1998) "Reflekse etnopedagogjike", I, ISP, Tiranë.
255 Po aty fq. 38

..."(1621), "Pasqyra e të rrëfyemit" (1621) e Pjetër Budit; "Fjalori i parë shqip" dhe "Gjergj Kastrioti Epirotas" i Frang Bardhit; "Çeta e profetëve" (1683) e Pjetër Bogdanit krahas arritjeve të niveleve të reja përmbushën disa nevoja arsimore-funksionale. Me botimin e tyre dhe të disa të tjera dorëshkrimeve[256] u hodhën themelet e praktikave të punëve mësimore në gjuhën shqipe, pasi nxënësve u dhanë në dorë tekste shqipe si "*të marrinë me zgjedhunë e me xanë"* (1635) dhe "*për të marrë vesh dijenë nieri mbë giuhetë vet"* (1685). P. Bogdani thekson se e shkruan këtë vepër krahas "mbrojtjes së të shenjtës fe" ndër të tjera edhe për të luftuar verbimin e popullit nga mosdija, për të penguar zhdukjen e gjuhës shqipe, për të ndihmuar popullin që të përvetësojë dijen dhe shkencën në gjuhën amtare, për të kapërcyer mungesën e ndjeshme të librave shqip, për të përgatitur një terren të përshtatshëm që në vendin e tij të ketë shkencëtarë, dijetarë, letrarë, etj.

Këto tekste veçanërisht krijuan një bazë konkrete për gjuhën shqipe si gjuhë mësimi. Edhe një fakt tjetër. Pjetër Bogdani e përshtati mjaft mirë "Çetën e Profetëve"edhe si tekst mësimor në gjuhën shqipe, duke i dhënë rrugë proceseve e praktikave mësimore - edukative që lanë gjurmë në historinë e shkollës shqiptare. Përfshiu në të udhëzimet për ta lexuar pa gabime gjuhën shqipe, e pajisi me treguesin e zërave e të çështjeve më të rëndësishme, me citime e referenca, i shoqëroi njohuritë dhe me ilustrime të karakterit didaktik, përpunoi edhe disa shkronja të alfabetit. Gjuha e përdorur nga ai ka funksionin e simbolit shumëplanësh: trashëgimit, bashkimit, kushtrimit, mirëkuptimit, marrëdhënieve, komunikimit, transmetimit, etj; duke u shfrytëzuar si mjet transmetimi mesazhesh shkencore e arsimore. Rolin arsimor të veprës e vlerësonte si parësor, gjë që ta përforcon idenë se ky tekst do të shërbente për shkollat. Nisur nga karakteristikat që bartin këto tekste, ne bashkohemi me mendimet e studiuesve se këto tekste janë shfrytëzuar në qendrat mësimore dhe në shkollat shqipe.

Shumë të huaj kronikanë, historianë, etj, fillojnë të lëvrojnë tema shqiptare. Botimi i tyre në qendrat më të zhvilluara të shek XVII si Parisi, Londra, Frankfurti etj, ndikoi në rritjen e shkallës së njohjes së opinionit evropian pse jo duke tërhequr edhe vëmendjen e tij. Me anë të këtyre botimeve qarqet shtetërore dhe ato të hierarkisë klerikale krahas të tjerave u njohën edhe me ekzistencën e shkollave në trevat arbre, me nxënësit që ndiqnin kolegjet, etj. Në këto kushte shtypshkronjat e Evropës i bënë vend edhe botimit të librave në gjuhën shqipe. Tashmë shqipja paraqitej me veprat e Bogdanit, Budit, Bardhit, që e bënë gjuhë kulture, por njëkohësisht edhe gjuhë mësimi.

Në shekullin e XVII-të, trevat shqiptare vazhdonin të ishin nën pushtimin osman. Arsimi ishte nën administrimin e institucioneve fetare si kudo në Evropën e atyre viteve. Natyrisht këto ishin të ndara sipas feve. Nga njëra anë po përhapeshin mejtepet e medresetë që mbaheshin nga krerët myslimanë, nga ana tjetër pranë famullive e manastireve mbaheshin qendra mësimore nga kleri ortodoks dhe të tjera nga kleri katolik. Mundësitë për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe ishin vështirësuar shumë, ndërsa për organizimin e një arsimi të përbashkët shqip ose për botimin e veprave shqipe në vend as që mund të bëhej fjalë.

Ndonëse pushtimi osman ushtronte trysni të fortë për osmanizimin e kulturës shqiptare, përfaqësues të shquar të saj, si P. Budi, F. Bardhi, P. Mazrreku, A. Bogdani, Gj. Vlladanji, S. Gaspari e të tjerë jo vetëm që nuk u stepën, por përkundrazi, punuan

256 Gramatika që hartoi Andrea Bogdani mbeti dorëshkrim. Ai nuk arriti ta botojë. Pjetër Bogdani që e tregoi atë, gjatë shpërnguljeve nuk e shpëtoi dot. Ajo i humbi, siç pohon vetë, më 1683 "si kripa në ujë".

me vetëmohim për ruajtjen e identitetit dhe mëkëmbjen e kësaj kulture, duke lënë një trashëgim të pasur në fushën e botimeve shqipe, në lëmin e përpjekjeve për të organizuar arsimimin e popullatës, si dhe për të shtuar numrin e nxënësve shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Italisë[257]. Prelatët shqiptarë u dërgonin famullitarëve vartës udhëzime që të mbanin pranë vetes një numër të vogël djemsh për t'i përgatitur për klerikë. Përpjekjet në drejtim të gjetjes së rrugëve për përgatitjen e kuadrove u intensifikuan shumë në shekullin e XVII-të. Gjergj Bardhi u përpoq ta bindë Kongregacionin e Propagandës Fide, që me shpenzimet e bëra për katër nxënës të dërguar atje, të mbaheshin dhjetë nxënës në Shqipëri. Tërthorazi ai kërkonte miratimin e hapjes së një institucioni[258]. Një vit më vonë, më 1625, një tjetër shqiptar, Gjon Kolesi (ipeshkëv i Arbërisë dhe i Epirit gjatë viteve 1615-1625) projektoi ngritjen e dy shkollave në vend. Këto shkolla do të përgatitnin kontingjente nxënësish për të vazhduar kualifikimin e tyre jashtë[259], për t'u bërë pastaj mësues për të tjerët.

Qendrat mësimore u ngritën pranë institucioneve fetare. Ndonëse të dhënat për këto qendra mungojnë, botimi i "Mesharit" apo "Dita e Gjyqit" dëshmojnë se gjuha e shkruar njihej, mësohej e lexohej nga Tivari e deri në Himarë. Në këto qendra elementi shqip filloi të depërtojë si faktor praktik[260]. Përveç botimeve të cilat i cituam më lart, shumë të dhëna dëshmojnë për hapje shkollash apo qendra mësimore, për mbajtjen dhe pagesën e mësuesit nga populli, për dërgimin e nxënësve për studime në kolegje jashtë vendit, etj. Gjuha e huaj sillte shumë pengesa e vështirësi në përvetësimin e njohurive. Futja e gjuhës shqipe në shkollë tashmë shihej si domosdoshmëri. Porta e Lartë i kishte njohur Patrikanës së Stambollit hegjemoninë mbi shkollat greqishte dhe Patrikanës së Pejës mbi shkollat sllavishte. Të drejtën e hapjes së shkollave nuk ia mohoi as Vatikanit. Për vetë kushtet në të cilat gjendej popullata katolike shqiptare, Vatikani lejoi përdorimin e gjuhës së vendit krahas latinishtes e italishtes. Ky lëshim u shfrytëzua me zgjuarsi nga klerikët shqiptarë të cilët krahas botimeve hapën edhe shkolla ku shqipja filloi të zërë vend në to. Kështu u hapën shkollat në Kurbin (1632), Pdhanë afër lumit Mat (1638), ajo e Blinishtit të Zadrimës (1639). U hapën edhe qendra mësimore me një numër të vogël nxënësish në Velje të Mirditës (1692) dhe në Shkodër (1699), e cila pati natyrë private. Mësuesit ishin shqiptarë, por pati edhe mësues të huaj. Numri i shqiptarëve të shkolluar në kolegjet e shkollat e gadishullit Apenin, siç qe ai i "Shën Athanasit" (Romë 1572), Loretos (1574), kolegji i Bazilianëve (Romë 1630), Fermos (1613), Palermos (1730), ai Urban i Romës (1743), erdhi gjithnjë duke u shtuar.

Formimi i Kongregacionit të Propagandës Fide (Congregatio de Propaganda Fide, institucion në gjirin e Vatikanit) theksoi se për punën e suksesshme të misionarëve është e domosdoshme njohja e gjuhës së vendasve. Prandaj u urdhërua që peshkopët dhe kryepeshkopët që punojnë në Turqi duhet të dinë edhe gjuhën shqipe.[261] Duke mos pasur pengesa nga Kongregacioni i Propagandës Fide, i cili lejoi përkthimin e veprave fetare në gjuhën shqipe të cilat do të shërbenin si tekste mësimore dhe përdorimin e gjuhës shqipe nga kuadrot e saj, hidhen hapat e organizimit të arsimit shqip me kuadro, me tekste me përmbajtje (me gjuhë mësimi shqipen).

257 Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë/3/ "Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin e XVII", Vëll. I (1610-1634), Tiranë, 1963. Përgatitur nga I. Zamputi, Dok. Nr. 37, fq. 441
258 Po aty, dok. nr. 18, fq. 347-348
259 Po aty, dok. nr. 24, fq. 371
260 Po aty fq. 44
261 Arch. S. Congr. Acta S. C. ol.1, 21 ad.congr. dici 6 dicembris 1622, nr. 8

Më 1632 kemi një shkollë në Kurbin të Krujës, ku mësohej shqip[262](Kastrati,J 1964, fq. 34). Kjo është e para shkollë në territorin e vilajetit të Shkodrës. Shkollën e vijojnë një numër i vogël nxënësish (10 nxënës). Sipas raporteve të Mark Skurës, të datës 20. XII. 1641 dhe 7. III. 1650 që i janë dërguar Kongregatës, fëmijët në këtë shkollë kanë mësuar lexim e shkrim, kurse ata më të rriturit gramatikë, gjë që i përgjigjej shkollës së mesme. Në shkollën e Kurbinit përveç librave të tjerë, përdoreshin si tekste mësimore dhe veprat e Pjetër Bogdanit, Frang Bardhit, Pjetër Budit e ndonjë tjetër në gjuhën shqipe. Kjo përbën një dëshmi me vlerë që flet për momente të rëndësishme historike që kalonte përpunimi dhe lëvrimi fillestar i gjuhës sonë[263]. (Shllaku, L 2002, fq. 52)

Më 1638, P. Hiacinti a Sospitello O.F.M pati guximin dhe iu përvesh për të mirë të vendit një pune në vështrim të plotë kultural, duke çelë shkollën fillore në Pdhanë, (në atë kohë vend mjaft i banuar afër lumit Mat) e cila frekuentohej nga fëmijë të moshës 8-10 vjeçare. Sipas njohësve të kësaj periudhe kjo shkollë, për vetë sukseset që arriti, tërhoqi nxënës të viseve të tjera deri edhe nga Zadrima. Numri i nxënësve të jashtëm arriti në 25, fakt ky që na bën të mendojmë se duhet të kishte pasur edhe konvikt. Midis mësuesve të kësaj shkolle përmenden Benedikt Soligo, P. Filipi da Locarno O.F.M, Karl Mirandulani, Gjon Shqiptari, P. Sebastjani a Roveta O.F.M e P. Bernardni nga Roma[264]. Shkolla u mbyll pas dhjetë vitesh (1648), pasi turqit "e bënë rrafsh me dhe". Një vit më pas u hap përsëri me kërkesën dhe këmbënguljen e banorëve dhe të Leo a Çitadelës (hartues i një fjalori shqip-italisht, por që mbeti dorëshkrim) dhe vazhdoi edhe disa vite të tjera, madje thuhet se shkolla e Pdhanës "në vitin 1675 ishte ende në këmbë". Pas një ndërprerje të shkurtër ajo u çel përsëri më 1697 dhe vazhdoi edhe pas mbarimit të shekullit XVII. Themeluesit e kësaj shkolle ngritën edhe një gjimnaz[265], (Kastrati, J 1964, fq. 49) që filloi të ndiqej nga shumë të rinj që dëshironin të bëheshin klerikë. Ata filluan mësimet me ato mjete që kishin d.m.th me dorëshkrime, etj. Nga dokumentet mësojmë se këtu, përveç mësimeve fetare, jepej edhe letërsi, pa përjashtuar gjuhën amtare[266].

Tashmë në shekullin e XVII-të Zadrima u bë një truall i favorshëm për përhapjen e arsimit. Kjo zonë qe një vatër e vërtetë arsimore, pasi këtu punoi Budi e Frang Bardhi si dhe një plejadë mësuesish të pasionuar e atdhetarë të vërtetë. Në Blinisht në vitin 1639 u hap një shkollë fillore shqipe.

Hapja e shkollës së Pdhanës pati jehonë të madhe. Në këto kushte paria e Blinishtit iu drejtua P. Bonaventura da Palazzolo (një misionar françeskan, i cili erdhi në Shqipëri në krye të një çete françeskanësh, një nga bamirësit më të mëdhenj të kohës, iniciatori dhe themeluesi i shkollës së Pdhanës) që të çelte një kuvend në Blinisht dhe të merrnin ata drejtimin e moshës së re. Në pamundësi për të realizuar kërkesën e banorëve, banorët e Blinishtit iu drejtuan fretërve të kuvendit të Troshanit, të cilët pas konsultimeve edhe me Ipeshkvin e Sapës, Frang Bardhin, rreth vitit 1639, çelën një kuvend (hospic) e pranë tij edhe një shkollë të mesme "gymnasium", i cili qysh në fillim kishte 50 nxënës. Qe një shkollë mjaft e plotësuar për kohën[267] Drejtor i kësaj shkolle u emërua P. Karl Mirandulani O.F.M., i cili

262 Kastrati, J (1964) "Arsimi popullor", nr. 6, Tekste të vjetra shkollore, fq. 134
263 Shllaku, L (2002) "Shkollat Klerikale" (Vështrim historik nga fillimet deri më 1924), Camaj-Pipa, Shkodër, fq. 52
264 Mons Spila, Memorie storiche d. Prov. R. Romana, tom. II, p. 316-317, ss. n. 2
265 Kastrati, J,Vepër e cituar fq. 49
266 Po aty
267 Historiku i Arsimit të rrethit të Lezhës, fq. 24

kishte aftësi të veçanta për të mësuar moshën e re. Meqë kjo shkollë frekuentohej nga fëmijë dhe të rritur, zhvillimi i lëndëve niste duke shpjeguar në gjuhën shqipe (lingua vernacula). Mësimi qe bërë me shumë rregullsi saqë vetë turqit u thoshin banorëve të Blinishtit: "Shtazët ua patën bre germat e t'ueja veç se këta fretën rishtas ua njallën"[268]. Në këtë shkollë përveç shkrimit dhe këndimit mësoheshin edhe lëndë të tjera. Në përmbajtjen e lëndëve përfshihej edhe gjuha shqipe, ndërsa gjuha latine mësohej vetëm nga ata që do të bëheshin meshtarë. Si tekste mësimore këtu janë përdorur dorëshkrime dhe vepra të Andrea Bogdanit, Pjetër Budit, Frang Bardhit, Pjetër Bogdanit etj.[269] (Osmani, Sh 1998, fq. 49) Mendohet se kjo shkollë nuk pati jetëgjatësi për faktin se P. Karli, aty nga mbarimi i vitit 1640, është mësues në shkollën e Pdhanës. [270] (Kurti, D.1935, fq. 7)

Në fund të shekullit XVII, rreth vitit 1692 është hapur në katundin Velje të Mirditës një shkollë në të cilën mësimet jepeshin në gjuhën e vendit. Duket se ecuria e kësaj shkolle nuk ka qenë e mirë saqë e detyroi klerin të merrte masa për të përmirësuar gjendjen. Veprimtarinë e kësaj shkolle nuk mund ta ndajmë nga Kuvendi i Arbrit.

Kur u mbajt Kuvendi i Arbrit më 1703, Shqipëria kalonte kohë të vështira. Rrezikohej të humbiste gjuha shqipe, besimi i krishterë, zakonet, traditat dhe virtytet e popullit tonë. Vizitori Apostolik V. Zmajeviç në fjalën e hyrjes në Kuvend do të thoshte: "*Unë dheut rreth e rreth ju solla e gjithë mbarë e kërkova e pashë nevojte e Shqipënisë. Pashë gazepe shumë, Shehrin vu nën haraç ... kalatë e trimave rrenue…Sëmundje e murtajës që bantë kërdinë…Zemra donte me mu nda përgjysëm, e prandaj thashë:" Populli im u ba rob pse nuk pat dije*". Kuvendi vendosi të përhapej letërsia shqipe nëpërmjet veprave të Budit, F.Bardhit, akteve të Kuvendit të Arbrit. Shfrytëzimi i gjerë i shqipes së shkruar ishte detyrë parësore për të rinjtë e shkollave. Nisur nga nevoja e përgatitjes së "*priftërinjve të dijshëm, të urtë e të devotshëm…ku me zyrë e me mësime të mira rritet e mësohet fisnikërisht vegjëlia e Arbrit për lavdi të Hyut e shelbim të dheut të sinë (tonë)"*. Duke pasur parasysh nevojën e meshimit shqip, rivalitetin e klerikëve shqiptarë me ata të dërguar nga Roma si dhe përvijimin e një kontributi të shquar të disa klerikëve që aso kohe "*kishin udhëhequr popullin në luftë për të drejtat e tij*", mund të vëmë në dukje se ishte lartësuar mendimi dhe ishin rritur pretendimet ndaj përgatitjes së klerikëve vendas, kjo pjesë e detyrës që po kryente shkolla e Velës. Kuvendi porositi: "Ky mjeshtër që rri në Velë (mësuesi) kujdes të ketë për gjakona (ndihmësi i priftit. Shënimi im E.B) e …të mundohet me gjithë gjoks me i vjejtë kishës e gjithë dheut (atdheut). Kuvendi përpiqej të pajtonte detyrat kishtare me ato kombëtare e patriotike për ta vënë klerikun *"në shërbim të dheut sinë"* dhe shkollën*"me i vjejtë kishës dhe gjithë dheut*".

Lidhur me programin, mësuesit porositen që "shkollarët mbasi të kenë xanë me shkrue e me këndue (shqip), mjeshtri t'ua mësojë gramatikën e ti bajë me xanë gjuhën latine në mos tepër mirë, bare (të paktën) nevojshëm". Sistemi shkollor mendohet të ketë qenë më i lartë se një shkollë fillore. Kjo jo vetëm për traditën e shkollave pararendëse të Pdhanës e të Blinishtit, por sepse të mësuarit e shkrim-këndimit shqip, të gramatikës e më pas të latinishtes, të veprave shkencore e të

268 Orbis Seraphicus, PP. Marcellinus a Civetia et Theophilus Domenichelli O.F.M De Miss, FF. Minorum. Lib. IV, FQ. 443, n. 50

269 Osmani, Sh (1998) "Reflekse etnopedagogjike 1", Tiranë, fq.49

270 Kurti, D.O.F.M (1935). "Vepra kulturale e elementit katolik në Shqipëri", Shkodër, fq.7

manualeve shkollore të hartuara pikërisht për këto shkolla, të mësuarit e katekizmit e të teksteve, të rregullave e të praktikave profesionale, të një literature relativisht të gjerë, me siguri kërkonin një vijimësi të gjatë mësimi. Mendohet se shkolla e Velës ka qenë në nivelin e një "gjimnasiumi".

"Ne vj. 1698 a aty pari gjejmë se P. Filipi prej Shkodret 0.F.M. çilë shi në Shkodër nji shkollë private e mson fmit e tregtarëve e të pasanikve"[271] (Kurti, D&Sirdani, M 1999, fq. 13) Në revistën "Hylli i Dritës", Patër Anton Gega shkruan "Një shkollë tjetër, krejt private, na del në shesh në Shkodër nga marimi i këtij shekulli (bëhet fjalë për fundin e shek. XVII, shënimi im E.B), mbi të cilin jemi tue folë P.Filip do Locarno kishte marrë me vedi nji djaloç prej Shqipnie, i cili mbaroi këndimin me 19.08.1698, kje shugurue meshtar e i thoshin émnit P.Filipi prej Shkodre. Aso kohe, familja e Kolë Kamsit (Cola Cambesi) tué kenë e dame né shéj për bâmirësí ndaj misionarvet, xuer prej ipeshkvit të Tivarit, që P. Filipi t'u shejonte në Shkodër. Por sa mbrríni, me një herë P. Filipi xûni vend në shpí të familjes Kamsi, çili një shkollë për me msue fmít, ashtu u shërbej edhe katolikvet[272]

Në gjysmën e parë të shekullit të XVII-të edhe në jug të Shqipërisë filloi ngritja e mësonjëtoreve, ku u vërejt edhe elementi shqip. Pikërisht këto mësonjëtore ishin jashtë hegjemonisë së Patriarkanës së Stambollit. E kësaj periudhe është shkolla e Himarës ku më pas do të jepte mësim Nilo Katalano (1693-1694)[273] (Shuteriqi, Dh 1963). Shkolla e Himarës u ndoq nga nxënës që vinin nga Saranda, Lukova, Nivica, Piqerasi, Lëkurasi, Kudhësi etj. Vlen të theksohet që për nxënësit e këtyre shkollave ai përgatiti "Fjalorin shqip-italisht dhe italisht-shqip (mbetur në dorëshkrim) dhe "Sprovë e gramatikës Shqipe". Më pas ai çeli edhe një shkollë në Dhërmi, ku u grumbulluan 80 nxënës shqipfolës. Nga ndjekjet që i bënte pushtuesi mbajtja e tyre në këmbë u bë e pamundur.

Në fundin e shekullit të XVI-të hapen shkollat e para turke, ndërsa në shekullin e XVII-të numri i tyre rritet me shpejtësi. Në vend funksiononin edhe shkolla të tjera ku nuk mësohej gjuha shqipe. Të tilla qenë shkollat pranë manastireve ortodokse në Shqipërinë jugore dhe të Mesme dhe mejtepet e medresetë pranë xhamive që u shtrinë në tërë vendin. Me gjithë luftën që iu bë gjuhës shqipe, me kalimin e kohës, edhe në këto shkolla ajo filloi të futej, sidomos në shekullin e XVIII-të.

Si forma të organizimit të punës së shkollës në vendin tonë ishin mejtepet dhe më vonë medresetë. Në këto shkolla në këtë periudhë nuk mësohej shqipja. Shtrirjen e shkollave që administrohen nga kleri mysliman në shek. XVII-të e jep funksionari i Portës së Lartë, Evlija Çelebiu në librin e tij "Udhëtimet", 1902, përkthyer pjesërisht në gjuhën shqipe".[274] (Çelebi, E 1930) Evlija Çelebiu (Dervish Muhamet Zilli, 1611-1684)[275], që vizitoi Shqipërinë më 1662-1670, dëshmon në librin e tij me përshtypje se ekzistonin kudo në trevat shqiptare mejtepe e medrese. Ai ndalet thjesht në pasqyrimin numerik të shkollave me karakter fetar, por nuk flet fare për arsimimin në gjuhën shqipe në qendrat qytetare që kishte vizituar. Meqë ai ishte i ngarkuar nga oborri perandorak

271 Kurti, D&Sirdani, M (1999) "Mbi kontributin e elementit katolik në Shqipëri", Tiranë, fq. 13
272 Revista "Hylli i Dritës", viti VIII, mars 1932, nr. 3, fq. 138
273 Shuteriqi, Dh, S "Shkrimi i shqipes dhe shkolla në bregdetin himariot gjatë shekujve XVII-XVIII", gazeta "Mësuesi". Tiranë, 28. VI dhe 5. VII. 1963
274 Çelebi , E (1930) "Sejjahatnamesi" Shqipnia para dy shekujsh, Tiranë.
275 Çelebi, E inspektor pranë oborrit perandorak të sulltanit, i ngarkuar me detyrën e relatuesit mbi gjendjen e trevave që e interesonin Portën e lartë. Autor i një vepre në dhjetë vëllime me përshtypje udhëtimi nga vende të ndryshme të Evropës, Azisë dhe Afrikës në mes të të cilave gjenden edhe përshkrime mbi Shqipërinë, me të dhëna edhe për shkollat në territoret shqiptare.

i Portës së Lartë për të vizituar vende të ndryshme, nuk qe i interesuar të pasqyronte mësimin e kësaj gjuhe. Ai e pa arsimin në kuadrin e politikës së pushtuesit, pasi Porta e Lartë nuk e shihte me sy të mirë arsimimin në gjuhën shqipe. Popullsisë shqiptare jomyslimane i kishte dhënë të drejtën për të hapur institucione arsimore në gjuhët greke e latine, ndërsa myslimanët të mësonin në gjuhët arabisht, persisht e turqisht, por jo shqip.

Më e organizuar dhe më me nivel përdorimi të gjuhës shqipe u bënë shkollat me alfabet turko-arab, në Shkodër në shekullin e XVIII-të, ku funksiononte një "Kompleks arsimor dhe kulturor". Kjo dukuri nuk është e rastit, por është e lidhur me lulëzimin e Pashallëkut të Bushatllinjve. Medresetë e hapura prej tyre qenë vepra shqiptare ku mësimi bëhej shqip. Hapja e medresesë së Qafës në gjysmën e dytë të shekullit XVIII nga Mehmet pashë Plaku dhe më vonë asaj të Pazarit nga Kara Mahmut Pasha janë shprehje e kujdesit të tyre, që krahas synimeve fetare të realizoheshin edhe ato arsimore-kulturore për të përgatitur kuadro që t'u shërbenin proceseve ekonomike e shoqërore, politike e atdhetare. Këto shkolla ishin në rang arsimi të mesëm. Programet e tyre qenë cilësisht të mira, përmbanin lëndë fetare për shkencat shoqërore dhe natyrore, gjuhë të huaja të lindjes e të perëndimit. Përgatitnin hoxhë, mësues e nëpunës për administratën shqiptare të kohës e të mëvonshme dhe studentë për shkollat e larta jashtë vendit. Këto shkolla fituan opinion pozitiv, sepse gradualisht nxënësit u drejtuan dhe u mësuan nga drejtorë e mësues shqiptarë, me programe e tekste në gjuhën shqipe[276](Osmani, Sh 1994, fq. 337). Ngritja e bibliotekës në qendër të pazarit të Shkodrës është e lidhur me emrin e Mustafa pashë Bushatit (sundoi në vitet 1812-1831). Ilo Mitkë Qafëzezi shkruan ndër të tjera se Mustafa pasha që zotëronte shumë gjuhë të huaja, "*ka pasur në sarajet e tij në Shkodër një bibliotekë të madhe*"[277]. (Qafëzezi, M, I 1936, fq.126-127) Biblioteka përfshinte libra dhe dorëshkrime kryesisht në gjuhët e lindjes: arabisht, persisht, osmanisht dhe në gjuhë të tjera pa përjashtuar përpjekjet e para në gjuhën shqipe.[278] (Osmani, Sh 1994)

Përpjekjet për zhvillimin e gjuhës së shkruar shqipe nuk pushojnë. Autorë shqiptarë, nga zona të ndryshme të Pashallëkut, vazhduan kush më herët e kush më vonë të hartojnë fjalorë e gramatika. Hartimi i fjalorëve dygjuhësh dhe i gramatikave, dëshmojnë se shqipja parapëlqehej si gjuhë mësimi. Një fjalor të tillë përgatiti më 1835 Shemimia[279]. Në bibliotekën e Shkodrës vepra Vehbije (Dhuratë) e Tahir efendi Gjakovës ishte e njohur që më 1835. Më vonë punën e vazhdoi Daut Boriçi. Ai hartoi dy abetare dhe një gramatikë të vogël të gjuhës shqipe, të cilën nuk e përfundoi.

Më 1745, në lagjen Tophanë, funksiononte fshehurazi një shkollë shqipe me 30 nxënës, me mësues Jak Kolë Kamsi. Shkolla ishte nën ndikimin e klerit, kurse mësimi ishte laik. Për mësuesin dihen pak gjëra, por i rëndësishëm është fakti se ky mësues nuk dinte gjuhë tjetër veç shqipes, e nuk ka dyshim mësimet zhvilloheshin në këtë gjuhë.[280]

276 Osmani, Sh (1994) "Kompleksi mësimor kulturor i Pashallekut të Bushatllinjve të Shkodrës", Seminari i parë ndërkombtar "Shkodra në shekuj", Shkodër, fq. 337

277 Qafëzezi, M, I (1936) "Dhaskal Gjoka …Një histori e pedagogjisë dhe e kulturës në Shqipëri 1637-1902, Korçë, fq. 126-127

278 Osmani, Sh(1994) "Kompleksi mësimor kulturor i Pashallekut të Bushatllinjve të Shkodrës", Seminari i parë ndërkombtar "Shkodra në shekuj", Shkodër, 1994.

279 AQSH. Fondi 65, dosja 70, fq. 1-63

280 Kabineti pedagogjik i Shkodrës,"Historiku i arsimit i rrethit Shkodër" pj. I, 1980, fq. 7

Me kërkesat e vazhdueshme të popullit, edhe në fshatra u hapën shkolla të tilla siç qe shkolla në Sheldi, më 1775, drejtuar nga kleriku Nikollë Kançi.[281]

Në gjysmën e parë të shek. të XIX-të në Shkodër hapen 12 shkolla private (8 për djem e 4 për vajza) të drejtuara nga mësues vendas dhe të ardhur, të cilët bënë një shërbim me vlerë në përhapjen e shkrimit dhe këndimit, sidomos në gjuhën amtare dhe edukimin atdhetar të fëmijëve. Qendrat e para mësimore (private) me mësues vendas si Gegë Kodheli, Gjon Shkrumi, Jak Kraja, Zef Kamsi, Gaspër Benusi e zhvilluan mësimin në gjuhën shqipe. Këta mësues paguheshin nga vetë qytetarët shkodranë.

Nga këto, pati jetën më të gjatë, ishte më e rregullta, me një përmbajtje didaktike, shkolla që hapi Gjergj Benusi më 1836, fillimisht në gjuhën italiane e më pas në gjuhën shqipe. Gjergji ka qenë nënshtetas i huaj nga Rivognio d'Istrias që ndodhet pranë qytetit të Triestes së Italisë.

"…Tue qenë se nxanësit e shkollës së Gjergj Benusit u shtuen tepër…u pa nevoja, në vitin 1856, më thirrë dhe mësues të tjerë nga jashtë…Shkodranët çuen e muerën këta tre mësues Mark Rebeskinin, Gjuriqin, Luigj Katraniqin dhe, bashkë me Gjergj Benussin që gjendej në Shkodër, hapën një shkollë me katër klasë…Disa shkodranë dhanë 40 napolona, por meqenëse kjo shumë nuk mjaftonte, është qeveria austriake që mori përsipër pagesën e rrogave të mësuesve. Kjo shkollë nuk pati jetë të gjatë, pse tre mësuesit e parë u mërzitën dhe shkuen ndër vendet e veta, tue mbetë prap vetëm Gjergj Benussi, i cili kishte nxanë shqip dhe ishte ba gjymës shkodran, mbasi emni i tij ishte lidhë me fatin e qytetasve"[282].

Më pas shkollën e vijoi i biri, Gaspri: "…vijon zejën e tet, tue mbajtë për 12 vjet rresht një shkollë private shqipe në shtëpinë e vet…"[283]. Në këtë shkollë mësonin fëmijë të moshave të ndryshme, por të ndarë në klasa të veçanta. Për nxënësit nuk kishte libra, por ata punonin me fletore. Të gjithë e kanë njohur si mësues të mirë. Qe mësues i nderuar i gjuhës shqipe, qytetar i ditur dhe i kulturuar i kohës, i cili ka dhënë një kontribut të çmuar në botimin e abetareve dhe librit "Sccibptari i msuem n'ghiuh t'vet" (1890) me alfabetin e shkodranishtes së vjetër. Në vitin 1897 e riboton me disa përmirësime. Në këtë vepër lartëson bukurinë e gjuhës shqipe dhe cilësohet si një libër i nevojshëm për shkolla e popull. Vetë ai botoi libra në ndihmë të përvetësimit të njohurive nga nxënësit.[284] (Kazazi, Nj 1997, fq. 113-114) Ishte ndër të vetmit shkodranë që bashkëpunoi me Shoqërinë e Bukureshtit. Puna e palodhur e Gaspër Benussit u ngrit nga dëshira për ta parë vendin tonë dhe gjuhën e vet "Të nderueme". Ai ka "…shum uzdaj (besim, shënimi im E.B) qi fjet fare s'ka me ndei e ka për ta nderue gjuhën e vet…"

Këto qendra të vendosura në lagje të ndryshme të qytetit zhvilluan një veprimtari të kufizuar, u përkrahën nga vetë qytetarët shkodranë, qëndruan të hapura privatisht deri në vitin 1885, vit në të cilin tregtarët shkodranë dhe kleri i lartë, duke parë që mësuesit nuk plotësonin kërkesat e kohës, me ndërmjetësinë e konsullit thirrën nga jashtë mësues të huaj, që filluan nga puna në vitin shkollor 1855-1856. Populli i Shkodrës e deshi shkollën, e kërkoi mësimin, pagoi privatisht mësuesin derisa erdhi koha kur të huajt hapën shkolla fillimisht në gjuhë të huaj, pastaj në gjuhën amtare.

281 Po aty, fq. 7
282 Dituria: "Gjergj Benussi", vol. III-Janar 1928, Nr. 3, fq. 90
283 Dituria: "Gjergj Benussi", vol. III-Janar 1928, Nr. 3, fq. 90
284 Kazazi, Nj "Revista Pedagogjike", Nr. 4, 1997, fq. 113-114

Austro-Hungaria, duke shfrytëzuar të drejtën e saj të Patronatit që nga viti 1615 në Shqipëri, përkrahu kishat dhe klerikët shqiptarë, duke mbajtur shkolla katolike. Që në vitin 1848 qeveria Austro-Hungareze hartoi ligjin, sipas të cilit "*në shkollat fillore fëmijët duhet të mësonin gjuhën amtare*"[285] (Dizdari, I 1995). Ky ligj u thellua edhe më 1867 dhe 1876. Që nga kjo kohë e më vonë Austro-Hungaria bën përpjekje serioze për hapjen e shkollave shqipe.

Më 2 gusht 1859 hapet në Shkodër Seminari Papnor Shqiptar. Përveç latinishtes në këtë shkollë është mësuar edhe gjuha shqipe. Lëndën e gjuhës shqipe e kanë dhënë mësues të nderuar, si At Justin Rrota, Dom Ndre Mjeda, At Anton Xanoni, Jak Jungu. Ky i fundit është i përmendur për veprat "Elementet gramatikore të gjuhës shqipe"(1881), "Fjalor i vogël shqip-italisht"(1895). Këta punëtorë të zellshëm të shqipes, gjuhëtarë, autorë tekstesh etj, edukuan tek nxënësit dashurinë për gjuhën amtare.

Më 1861 u hap e para shkollë popullore nga etërit franceskanë. Kështu iu dha fund shkollave private të lagjeve me një mësues dhe u çel një shkollë e vetme për të gjithë banorët.

Në 50 vjetorin e shkollës më 1911 u shfaq melodrama "Shqyptari i gjytetnum", ku Fishta shkruante: "N'mitetqindgjashtëdhetenji, françeskajt e shqyptaris, çilen n'Shkodër, t'thuesh, n'do ksolla, N'Gjuhadol, ma të parat shkolla. T'parat shkolla popullore, Ku, pa pare e dhanti dore, Zu shqyptarve me u dhanë msimi, …Kjo pat kenë, shkolla ma e parë, Qi mund quhej popullore; Edhe s'parit n'ket msojtore,- Për me folë veç kah Gegënia-Në gjuhë shqypeu msuene fmija, Si e nep ligjë Pedagogjia". Më 24 dhjetor 1880 shkrimtari Leonard de Martino ishte i pari që shfaqi një dramën baritore në gjuhën shqipe. Më 1902 emërohet drejtor Gjergj Fishta, i cili e vendosi gjuhën shqipe si gjuhë mësimi të detyruar. Më 1910 u futën në përdorim tekstet shkollore të hartuara nga shoqëria "Bashkimi". Këtu dhanë mësim mësues klerikë e laikë, ku përmendim: Mati Logorecin, Gaspër Benusin, Gaspër Beltojën, etj. Numri i nxënësve kishte shkuar në një vit deri në 200.

Më 1875 etnit jezuitë hapën edhe një shkollë fillore. Dy vite më vonë u hap "Kolegja Saveriane". Gjuha shqipe u dha si lëndë e veçantë që me krijimin e saj. Që nga viti i parë amza dhe regjistrat e notave kanë pasur dhe shtyllën e shqipes, po kështu edhe librezat dhe të ndarit e çmimeve vjetore kanë pasur çmime të veçanta për gjuhën shqipe. Në tre vitet e para lëndën e gjuhës e dha Luigj Maca, më 1880-1881 Jak Jungu, 1881-1884 Dedë Pazi. Jezuitët shtypën në shtypshkronjën e tyre disa libra fetarë në gjuhën shqipe.

Shqipja nisi të mësohej dhe të lexohej edhe nëpër fshatra ose qendra të tjera të banuara të Shkodrës. Këto shkolla drejtoheshin nga kleri e subvencionoheshin nga Austro-Hungaria. Të tilla shkolla shqipe qenë ajo e Shirokës (1874), e Troshanit (1882), e Bajzës në Kastratit (1883), Blinisht (1891), Selcës së Këlmendit (1891). Për këtë shkollë shkruhet: ... "Në vitin 1893 P. Joakin Serreqi O.F.M. ndreq në Selcë një shkollë me lokal të mjaftueshëm për 50 xânsa". Po në këtë vit edhe P. Basil Chiaroni, O.F.M kishte çelur një shkollë shqipe në Hot (Traboin) të Pllanës (1898)[286]. Në një dokument të vjetër të nxjerrë nga regjistri i famullisë së Shirokës, fq. 22 thuhet: "Shkolla ose msojtorja për djelm, fill në vjetin 1874 kje çilë e mbajtë prej meshtarëvet që shërbejshin si famullitarë. Kështu djelmnia e Shirokës pat rasë të mirë me xanë shkrue, me lexue e pak aritmetikë".

285 Dizdari, I (1995) "Një traditë e hershme që duhet ripërtërirë", dorëshkrim, Shkodër.
286 Prendushi, M "Studime Historike", Nr. 3-1974, fq. 77

Me interes janë shkollat femërore private shqipe si ajo e Kushe Micës (1859), e Tina Nikës (1860), Tereze Bërdicës, Stigmatineve, shkolla e vashave në Korçë, etj që kanë luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm në përhapjen e arsimit shqip, por edhe për arsimimin e femrës.

Edhe Mësonjëtorja shqipe e Korçës ka qenë institucion privat. Sipas modelit të saj të tjera shkolla private vijuan të hapen pas saj, si në Pogradec më 14 mars 1887, në Ohër, Rekë, Treskë dhe u bënë përgatitje edhe në Elbasan, Leskovik, Ersekë. Më 1889 u hap Mësonjëtorja Kombëtare e Prizrenit (shkollë private). Në shumë qytete e fshatra të Shqipërisë si në Berat, Vlorë, Fier, Elbasan, Dibër, Çamëri, Skrapar, Kolonjë, Luaras, Treskë, Selenicë, etj ishin çelur shkolla ilegale shqipe të cilat funksiononin pa lejen e qeverisë osmane dhe në kundërshtim me politikën e saj. Shumë nga këto shkolla e patën jetën e shkurtër, pasi vështirësitë qenë të mëdha.

Gjatë periudhës së Pavarësisë 1912-1939 nga shteti shqiptar janë bërë përpjekje serioze për të kodifikuar sistemin dhe strukturën e arsimit tonë. Vendimi i parë shtetëror për shkollat private është ai i datës 13 shtator 1913, i marrë nga Ministria e Arsimit e Qeverisë së Vlorës. Është për t'u theksuar se vetëm disa muaj pas shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, kjo Ministri lejonte shkollat e veçanta (të huaja) *"vetëm nëse do t'i nënshtroheshin kontrollit shtetëror"*[287] (Rev. Shkolla kombëtare, 1918, fq. 60)

Periudha 1912-1920 është faza e parë e përpjekjeve për shkollë laike, të cilat vazhduan dhe u thelluan gjatë vitit 1924. Në fund të viteve '20, me çeljen e shkollave të huaja dhe prirjen për shtimin e tyre, lëvizja për kombëtarizimin e arsimit mori një vrull të dukshëm. Shumë autorë argumentonin se Shqipërisë i duhej një shkollë ku të drejtonte shteti, sepse shkolla e shtetit ishte e vetmja vatër e formimit të njëtrajtshëm kombëtar të brezave, ku përmblidheshin fëmijë të të gjitha besimeve fetare. Nën moton se arsimi fillor ishte gjëja më delikate dhe më e shenjtë për një komb, ata argumentonin se shkollat fillore private përgatisnin breza heterogjenë duke kërkuar që kalamajtë t'i mësonte shteti në mënyrë uniforme, me kulturë kombëtare pa gardhe fetare e ndarje besimesh.

Në një raport të Ministrisë së Arsimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme me nr. 1752, dt. 21.1.1923, flitet për shkollat shtetërore dhe private në Shqipëri. Në periudhën nga viti 1924-1929 kemi një rritje të institucioneve private nga 44 (viti shkollor 1924-1925) në 51(viti shkollor 1928-1929). Në shkollat e mesme kemi rritje të numrit të nxënësve nga 361 (viti shkollor 1924-1925) në 382 (viti shkollor 1928-1929), rritje të numrit të mësuesve nga 49 (viti shkollor 1924-1925) në 62 (viti shkollor 1928-1929), po kështu edhe të numrit të femrave mësuese nga 13 (viti shkollor 1924-1925) në 60 (viti shkollor 1928-1929).

Më 26 prill 1933, u mbylljen të gjitha shkollat private në Shqipëri. Viti shkollor 1933-1934, fillonte vetëm me shkolla shtetërore. Reforma e Ivanajt qe radikale. Ajo rroku të gjitha dukuritë e punës së shkollës. Nisma e Ivanajt pati edhe kundërshtarë. Reforma preku dhe alarmoi qarqet drejtuese të shkollave private dhe të huaja brenda dhe jashtë vendit. Kleri katolik në Shkodër, me përkrahësit e tij dhe përfaqësues të minoritetit grek në Gjirokastër, iu kundërvunë ashpër reformës. Pas dy vitesh, çështja e shkollave private mori karakter ndërkombëtar, sepse në një anë kleri katolik, me përkrahjen e heshtur nga diplomacia italiane dhe qeveria greke në anën tjetër, iu drejtuan Lidhjes së Kombeve në Gjenevë. Komiteti i Lidhjes iu drejtua Gjyqit Ndërkombëtar të Hagës, i cili e zgjidhi çështjen në të mirë të kërkesës greke, me 8 vota pro dhe 3 kundër.

287 Revista "Shkolla kombëtare", (1918), Viti I, nr. 17-18. Tiranë, 1 Qershor

Lidhja e Kombeve plotësoi kërkesën greke për minoritetin e tyre në Shqipëri dhe nuk pyeti për çështjen e shkollimit shqip. Qeveria shqiptare iu nënshtrua vendimit të Gjyqit Ndërkombëtar dhe shkollat private minoritare greke u rihapën. Me dekretin mbretëror të 9 majit 1936 u rihapën shkollat private të klerit katolik, të vendosura në parim nga Gjyqi Ndërkombëtar i Hagës.

Deri në vitin 1939 në Shqipëri kishte disa shkolla fillore private të cilat punonin sipas programeve të shkollave fillore shtetërore. Përveç shkollës fillore me konvikt, të mbajtur nga familja amerikane Kenedi në Korçë, që dallohej për kushte shumë të mira të gjithanshme, u dalluan edhe shkollat e klerit katolik në Shkodër, si ato të urdhrit jezuit dhe françeskan, të cilat u dalluan për tekste, mjete mësimore, pajisje për mësim dhe veprimtari të shumta e të pasura artistike, kulturore e sportive. Mësuesi i shkollave jezuite ishte shumë autoritar dhe krejt i pavarur në punën e tij. Në shkollë mbizotëronte një disiplinë rigoroze.

Në shkollat private, të huaja ose vendëse, falë angazhimit të madh të nxënësve dhe të vetë drejtorive të shkollave, veprimtaritë jashtëmësimore ishin më të shumta, më të larmishme dhe me nivel të lartë. Për nga programi i pasur dhe serioziteti i zbatimit tyre, veprimtaritë jashtëmësimore nuk dalloheshin nga vetë procesi mësimor, pra konsideroheshin si shkollë e dytë për nxënësin. Vendin e parë e zinin shkollat e klerit katolik në Shkodër, kryesisht të Urdhrit Jezuit. Në shkollën teknike të Tiranës, veprimtaritë jashtëmësimore arritën një nivel të lartë, të paparë në Shqipëri deri në fund të Luftës së II Botërore.

Çështja e arsimimit të femrës zuri vend edhe në Parlamentin shqiptar të viteve 1921-1924. Në një nga seancat parlamentare të vitit 1921, u kërkua çelja në shkallë vendi e shkollave të reja fillore femërore, si edhe çelja e një shkolle normale femërore për përgatitjen e mësueseve; u shtrua si domosdoshmëri ngritja metodike e kuadrit arsimor në shkollat ekzistuese, u miratua çelja e shkollës normale femërore private "Kyrias". Më 2 tetor 1922, u hap në Tiranë shkolla normale femërore private me emrin "Instituti Kyrias" e tipit të kolegjit amerikan. Përveç mësueseve shqiptare dhanë mësim edhe mbi dhjetë mësuese të huaja. Për sa i përket strukturës dhe programit, ajo ishte baras me një akademi femrash, e ngjashme me shkollat evropiane bashkëkohore. Vend të rëndësishëm në program zinin historia e gjeografia e Shqipërisë dhe letërsia shqipe, që zhvilloheshin në gjuhën amtare.

Për hapjen, funksionimin dhe vazhdimin e shkollave private kanë ekzistuar disa rregulla shtetërore, dispozita të veçanta, etj. Dokumentet historike e arsimore flasin rreth krijimit të një përvoje të re e të panjohur. Në "Rregulloren për shkollat private të minoriteteve " të Ministrisë së Arsimit të Mbretërisë Shqiptare (1935) dalin në pah disa veçori që duhet të kishin shkollat private të minoritetit. Sipas kësaj rregulloreje përcaktohej se numri i fëmijëve duhet t'i përfshijë të dy sekset që kanë mbushur moshën ligjore të detyrimit shkollor. Për mësuesit që do të punonin në këto shkolla merrej miratimi nga Ministria e Arsimit, të cilës i dërgohej emri dhe jetëshkrimi i shkurtër i tyre. Edhe në nenet e tjera theksohet se kërkohet zbatimi i dispozitave ligjore të Ministrisë së Arsimit. Kjo rregullore tregon sesa rëndësi i jepej figurës së mësuesit dhe rolit të tij si realizues i procesit të mësimit dhe të edukimit të nxënësit. Mësuesit duhet të kishin figurë të pastër dhe të mos ishin implikuar në organizata të huaja, në dëm të interesave dhe të integritetit kombëtar. Ata duhet të paguhen vetëm nga popullsia e vendit që e ka hapur shkollën minoritare. Kjo rregullore shprehte edhe kujdesin për arsimimin e të gjithë fëmijëve dhe suksesin e tyre. Është me interes të ndalemi te "Ligji

mbi ndërtesat shkollore dhe orendive të tyre", në nenin 1 të të cilin shkruhet: "Ndërtesat e shkollave fillore ngrihen të reja ose meremetohen e përmbahen (mirëmbahen E. B) me shpenzimet e popullsisë së lagjeve të qyteteve dhe të katundeve"[288]. Për sa i përket kuadrit arsimor që do të punonte në këto shkolla, pavarësisht nga theksimet e ndryshme, kujdesi ishte i përhershëm. Kërkesa për një mësues të përgatitur lidhej edhe me synimin që niveli i nxënësve të rritej sa më shumë.

Në këtë periudhë kemi hapjen edhe të medreseve, të cilat u konceptuan, u organizuan, u administruan dhe u drejtuan si shkollë moderne, me programe, me tekste e mësues shqiptarë. Dokumentacioni i këtyre shkollave qe tepër i rregullt, me amzë, regjistra, orar, dëftesa e karakteristika nxënësish. Ato ndodheshin në lokale të përshtatshme me orenditë e nevojshme. Kuadri qe i plotë, me drejtor, mësues të lëndëve të kulturës së përgjithshme e fetare si dhe me mësues kujdestarë. Kjo shkollë punonte me një plan mësimor të studiuar, që përmbante mbi 20 lëndë, shkenca shoqërore, shkencat natyrore, lëndë fetare dhe gjuhë të huaja. Raportet e gruplëndëve ishin të arsyeshme e të rregullta, pasi nxënësit merrnin kulturë të gjerë të përgjithshme e të mjaftueshme fetare, mësoheshin e edukoheshin dhe përgatiteshin edhe shpirtërisht.

Për edukimin e përgjithshëm të nxënësve kanë ndihmuar edhe veprimtaritë e shumta e të larmishme jashtëshkollore, si: bisedat, ekskursionet, puna me librin në bibliotekën e shkollës, kremtimi i festave fetare e kombëtare, shfaqjet e grupit artistik, ndeshjet sportive, vizitat në familjet e nxënësve fshatarë tek nxënësit qytetarë, ceremonitë e mbylljes së vitit shkollor, etj.

Të gjithë nxënësit vishnin uniformën shkollore, ishin të pajisur me kartën e studentit me fotografi e të dhëna të tjera të shumta. Ata dalloheshin për rregull, disiplinë, studim, përparim e pastërti. Ceremonitë e fundit të vitit ishin tepër festive, prekëse e mbresëlënëse dhe me pjesëmarrjen e mësuesve, nxënësve, prindërve, qytetarëve, Komunitetit Bamirës, të autoriteteve fetare lokale e qendrore. Në vitin 1944-45 nxënësve të dalluar iu dhanë dhurata me rastin e mbylljes së vitit shkollor.

Reforma arsimore e vitit 1946, në kuadër të afirmimit të karakterit laik dhe shtetëror të shkollës, i hapi rrugën mbylljes së shkollave fetare e private.

Zhvillimi i institucioneve arsimore private parauniversitare pas viteve '90

Ndryshimet demokratike të viteve '90-të sollën në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës kërkesën për rivendosjen e kësaj alternative arsimi e cila, siç edhe u parashtrua më sipër, në Shqipëri ka fillesa të hershme.

Alternativa e arsimit privat në Shqipëri lindi si një nevojë e domosdoshme që shumë përfaqësues të fushës së arsimit në të gjitha nivelet, në bashkëpunim me ata të fushës së biznesit, e ndjenë për të dhënë kontributin e tyre në këtë fushë. Pas vitit 1991, hapja e institucioneve jopublike arsimore u shfaq si nevojë dhe kërkesë shoqërore (ISP, 2003)[289] dhe u sanksionua me ligj.

Kuptohet që kalimi nga një sistem ekonomik i centralizuar në ekonomi tregu, u pa si një premisë pse jo edhe për të siguruar fitime financiare. Kuptohet që për tu vënë në jetë këto interesa, kërkohej krahas një strategjie të qartë, edhe hartimi i programeve në lidhje me masat që duhet të ndërmerreshin për stimulimin e kësaj alternative që

288 Ministria e Arsimit: "Ligja mbi ndërtesat shkollore dhe orendive të tyre"
289 ISP(2003), Guida "Arsimi në Shqipëri", Tiranë, , Ilar fq. 30

ndonëse me fillime të hershme, paraqiste vështirësi, pengesa dhe shumë të panjohura për sistemin arsimor shqiptar.

Së pari, mungonte baza ligjore sa i përket licencimit, por edhe funksionimit të arsimit jo publik.

Së dyti, mungesa për një periudhë të gjatë, pothuajse 50 vjeçare e funksionimit institucioneve jo publike paraqiste probleme për sa i përket organizimit dhe funksionimit të tyre.

Së treti, ekzistonte mungesa e besueshmërisë nga ana e investitorëve dhe biznesmenëve për ndërmarrjen e iniciativave të tilla.

Së katërti, mungonte infrastruktura fizike, si godinat, pajisjet, të cilat kërkonin investim fillestar të konsiderueshëm, ndërkohë burimet financiare ishin të pakta, mungonte ligji dhe praktikat e privatizimit për godinat ekzistuese, ekzistonte frika në radhët e investitorëve mbi sigurinë e investimit, mungonin procedurat ligjore për lejimin e ndërtimeve në zona të ndryshme të vendit.

Së pesti, mungesa e mësimdhënësve të kualifikuar, pasi ky konsiderohej faktor kyç e shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen dhe suksesin jo vetëm në ndërtimin e një shkolle me vlera, por edhe në zhvillimin e biznesit të filluar.

Të gjithë këta elementë kishin nevojë të harmonizoheshin në një kornizë të veçantë ligjore, me anë të së cilës do të bëhej i mundur funksionimi normal i një alternative të tillë të sistemit arsimor. Kjo gjë do të përfaqësonte edhe një standard që duhet krijuar për përfshirjen e Shqipërisë në vendet demokratike evropiane dhe integrimin e saj në të ardhmen në BE.

Në fazën e parë shkollat jopublike patën një lulëzim dhe ky erdhi kryesisht si pasojë e kushteve që siguronin këto shkolla, për më tepër që pas viteve ’90 gjendja e shkollave publike, edhe si pasojë e lëvizjeve të mëdha demografike, u përkeqësua. Mjafton të përmendim faktin se numri i nxënësve për klasë mesatarisht arriti në mbi 52 nxënës, kushtet fizike të shkollave ishin shumë të papërshtatshme, deri aty sa klasat nuk kishin as bankat e mjaftueshme për t’u ulur nxënësit. Pikërisht hapja e këtyre shkollave krijoi një lehtësi për shtetin duke mundësuar “Shfryrjen e mbipopullimit të shkollave publike” duke marrë në konsideratë edhe pamundësinë e shtetit për të ndërtuar shkolla të reja në periudhën që po kalonte vendi.

Në vitet 1990-1995, alternativën e re të arsimimit e përkrahën fillimisht komunitetet fetare si, shoqata dhe fondacione të ndryshme, persona juridikë të huaj, të cilët themeluan shkolla fetare / Medrese. Gradualisht, pas viteve 1998-1999, kjo alternativë filloi të shihej me interes edhe nga personat juridikë ose fizikë vendas, prirje e cila u zhvillua edhe më shumë pas vitit 2000. Pas vitit 1997 shohim një intensifikim të përhapjes së këtyre shkollave. Kriteret lehtësuese për licencimin e shkollave jopublike ishin pjesë e politikave të zhvillimit e konsolidimit të sistemit arsimor. Nëpërmjet këtyre politikave, shteti plotësoi arenën e konkurrencës në edukim me aktorë të munguar prej shumë kohësh.

Në mungesë të një legjislacioni, që rregullonte raportet ndërmjet organeve drejtuese të arsimit dhe subjekteve private (komunitete fetare, shoqata, fondacione, persona fizikë apo juridikë), në këto vite është operuar mbi bazën e marrëveshjeve ndërmjet palëve. Rregullimi i parë ligjor u bë me ligjin datë 21.06.1995, “Për sistemin arsimor parauniversitar”. Ndërsa në Kushtetutën e Shqipërisë shkruhet *: “Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat*

krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit."

Më tej, në vitin 1998, në ligjin mbi arsimin parauniversitar, rregullohet nga MASH-i funksionimi i Institucioneve Arsimore Plotësuese Jopublike. Gjithashtu, ekzistojnë udhëzime për ekuivalentimin e shkollave të mesme jopublike me shkollat e mesme të përgjithshme publike dhe me disa nga llojet më të kërkuara të arsimit teknik e profesional publik. Me daljen e

Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 248, datë 28.05.1999, *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për funksionimin e institucioneve arsimore jopublike dhe të institucioneve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj"*, baza ligjore e miratimit dhe e funksionimit të arsimit jopublik konsiderohet përgjithësisht e plotësuar.

Organet përgjegjëse për institucionet arsimore private parauniversitare janë Këshilli i Ministrave, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale e Rinisë dhe institucionet në varësi të ministrive, ku mund të përmendim Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore dhe Zyrat e Punës.

Kuadri ligjor i përgjithshëm për hapjen dhe funksionimin e institucioneve parauniversitare jo publike

Për hapjen dhe funksionimin e institucioneve parauniversitare jo publike ekziston një kuadër ligjor i kompletuar që përfshin: Nenin 57, pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 8387, datë 30.07.1998, *"Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995*, "*Për sistemin arsimor parauniversitar"* dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 358, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar dhe licencimi i tij bëhet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 *"Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"*.

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 28.05.1999*, "Për kriteret e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore private parauniversitare dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj",* udhëzimin numër 33 datë 1.11.2010 *"Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare"*, ligjin nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, udhëzimin nr. 6, datë 14.03.2003, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale *"Për regjistrimin e institucioneve të AFP"*, udhëzimin nr. 1590, datë 04.08.2008, të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale *"Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional"*.

Institucionet arsimore private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare, ose që themelohen apo administrohen nga bashkësitë fetare, hapen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, mbështetur në kërkesën e përfaqësuesve të bashkësive fetare. Kriteret dhe procedurat e hapjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Shkollat private, në të cilat mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, ose që lëshojnë

diplomë të huaj apo të ngjashme me të, hapen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit. Kriteret dhe procedurat e hapjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kushtet për të hapur një shkollë private

Për të hapur një shkollë private subjekti aplikon pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Leja për hapjen e shkollës private jepet kur planet, programet mësimorë dhe kushtet e realizimit të tyre nuk bien në kundërshtim me interesat kombëtare, me legjislacionin shqiptar, rendin publik, etj. Në shkollat ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, gjuha dhe letërsia shqipe, historia e kombit shqiptar dhe gjeografia e Shqipërisë zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe. Subjekti aplikues duhet të jetë i regjistruar në gjykatë si person juridik dhe të ketë të përcaktuar në objektin e aktivitetit të tij hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar. Ai duhet të plotësojë kushtet fizike, duke siguruar një godinë të përshtatshme për shkollë, si dhe të pajisur me bazë materiale dhe didaktike, të ketë kurrikula të përshtatshme për nivelin përkatës si edhe stafin e duhur mësimdhënës. Subjekti aplikues duhet të plotësojë formularin e vetëdeklarimit dhe dokumentacionin teknik. Licencimi i institucioneve private bëhet nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit, sipas vendimit të ministrit. Institucioni arsimor privat fillon veprimtarinë e tij vetëm pas marrjes së licencës. Licencimi i tij bëhet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 "*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"*. Verifikimi i përmbushjes së standardeve normative të infrastrukturës të objektit shkollor realizohet nga një person juridik apo fizik i licencuar pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 42, datë 16.1.2008 *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari në ndërtim*". Subjekti i licencuar kontrollon, nëse aplikuesi disponon lejen higjieno-sanitare dhe vërtetimin nga njësia e pushtetit vendor për mbrojtjen kundër zjarrit. Personi fizik ose juridik i licencuar përgatit një relacion, i cili i bashkëlidhet dokumentacionit të aplikimit.

Gjithashtu, objekti që të funksionojë si institucion arsimor duhet të plotësojë disa standarde normative duke filluar nga madhësia e klasave, nyjet hidrosanitare, palestra, ndriçimi, etj. Objektet arsimore duhet të jenë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore dhe të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për nxënësit duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. Objektet arsimore të jenë të pajisura me gjenerator dhe depozitë uji dhe të kenë sistem ngrohjeje.

Hapja dhe ushtrimi i veprimtarisë së institucioneve arsimore private pa licencën përkatëse, përbën kundërvajtje administrative. Kundërvajtësi dënohet me dënim administrativ kryesor gjobë, në vlerën nga 500.000 deri në 1.000.000 lekë, dhe me dënim administrativ plotësues "ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarisë".

Në rast të pezullimit dhe/ose heqjes së një licence, njësia arsimore vendore përkatëse i vendos nxënësit në institucione të tjera arsimore, publike ose private. Shpenzimet për përfundimin e një viti shkollor, për të gjithë nxënësit e regjistruar në atë shkollë private, përballohen nga garancia bankare e institucionit arsimor privat të mbyllur. Modalitetet e transferimit të nxënësve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Kërkesat që duhet të plotësojë stafi

Mësuesit duhet minimalisht të kenë arsimimin përkatës për lëndën që do të mbulojnë ndërkohë që preferohet staf i kualifikuar në fushat e mësimdhënies. Stafi që do të angazhohet në mësimdhënie bëhet evident në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës si dhe në Drejtorinë Arsimore Rajonale përkatëse apo Zyrën Arsimore, ku gjithashtu raportohen edhe ndryshimet që bëhen në stafin mësimor.

Për shkollat private, programet e të cilave janë të njëjta me ato të shkollave publike, mësuesit duhet t'u nënshtrohen dhe të zotërojnë kualifikime të njëjta si edhe mësuesit e shkollave publike. Jo më pak se 60% e stafit mësimdhënës duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë.

Kontrolli i shtetit mbi arsimin privat

Ministria e Arsimit dhe e Sportit, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit dhe organeve të saj arsimore në rrethe, kontrollon periodikisht procesin mësimor laik në shkollat private, për të verifikuar realizimin e kërkesave të planit e të programeve mësimore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Organet kontrolluese kompetente kontrollojnë gjithashtu dokumentacionin që duhet të jetë në ruajtje, si regjistër amze, indeks alfabetik, statistika të numrit të nxënësve dhe të mësuesve, regjistra të veçantë dhe të përkohshëm, planet mësimore dhe programet lëndore të zbatuara çdo vit shkollor, rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit, kriteret për pranimin e nxënësve dhe të mësuesve, Kontratat me prindërit për shërbimet arsimore apo shërbime të tjera jashtëshkollore që ofron, kontratat e punës me mësuesit me kohë të plotë apo të pjesshme

Po kështu, drejtoria e tatimeve kontrollon subjektin për respektimin e shlyerjeve të detyrimeve tatimore.

Financimi publik dhe i granteve

E gjithë barra e financimit për institucionet arsimore private parauniversitare është tërësisht e subjekteve të cilët e krijojnë aktivitetin. Financimi mbështetet nga prindërit e nxënësve ose nga donatorë të ndryshëm. Sipas ligjit "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, ministria mbështet financiarisht, sipas mundësive dhe programeve të miratuara, institucionet arsimore private vendase, të cilat janë jofitimprurëse dhe kanë të paktën pesë vjet që funksionojnë si institucione private. Sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, mbështetja financiare për shkollat private diferencohet sipas renditjes së tyre në provimet kombëtare të arsimit bazë ose të maturës shtetërore, si dhe në testimet ose konkurset ndërkombëtare. Gjithashtu shkollat private e përdorin mbështetjen financiare vetëm për nxënësit e shkëlqyer në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nga viti 2009, një fond modest është dhënë nga Shteti Shqiptar edhe për institucionet parauniversitare të ngritura nga bashkësitë fetare për të ndihmuar në pagesën e mësuesve, që parashikohet në Ligjin nr. 10 140 datë 15.05.2009, Neni 4.

Shteti duhet të financojë domosdoshmërish arsimin privat, pasi ky i fundit ofron një formim të plotë për fëmijët që e frekuentojnë, dhe ndërkohë bëhet edhe për arsimin shqiptar në përgjithësi një shtysë, një nxitje për të përmirësuar cilësinë e arsimit. Në fakt, mendoj se një shtet demokratik duhet t'i ofrojë qytetarëve të vet edhe mundësi

konkrete për ta zgjedhur arsimin që e sheh të nevojshëm për fëmijën e tij dhe ndihma e Shtetit bën të mundur që faktori ekonomik të mos bëhet diskriminues.

Në nenin 5 të Ligjit 69, 2012, mbi të drejtën për arsimim lexojmë:

"1. *Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptar, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike a fetare, gjendja ekonomike a sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.*

2. *Në shkollat publike arsimi i detyrueshëm dhe arsimi i mesëm i lartë janë falas.*[290]*"*

Një shtet që mendon të ardhmen e vet, i shikon, ashtu si parashikon pika 1, e nenit 5, të gjithë qytetarët si të barabartë, krijon politika për të zgjeruar gjithnjë e më tepër mundësitë për arsimim cilësor për çdo qytetar të tij. Arsimi privat në fakt është në shërbim të qytetareve, të dijes dhe të së ardhmes, prandaj ata duhet të ecin së bashku dhe të kontribuojë për të njëjtin qëllim. Kjo do të ishte zbatim koherent i ligjit, kjo do të thotë mundësi të barabarta dhe konkrete. Shteti nuk mund të rëndojë mbi familjet që zgjedhin arsimin privat duke "vjelur" prej tyre taksat që shërbejnë edhe për të paguar arsimimin e fëmijëve në shkollat shtetërore, kur në realitet këta nxënës nuk i kushtojnë shtetit asgjë.

Shteti ynë, siç e theksova edhe me lart, me ligjin e 2009, ka bërë disa hapa në këtë drejtim në lidhje me financimin e institucioneve arsimore të varura nga bashkësitë fetare. Ky është një hap i lavdërueshëm. Por në fakt duhet konsideruar edhe një aspekt tjetër, ai i interesit. Këto shkolla janë në interes të shtetit dhe përfitimet janë edhe të vlerësueshme ekonomikisht. Mjafton të marrim në konsideratë faktet: *Sa nxënës janë në arsimin privat? Sa* mësues janë *punësuar? Sa do t'i kushtonte shtetit nëse ky sektor të mos ekzistonte dhe do t'i duhej të mendonte për infrastrukturën, formimin, bazën materiale dhe rrogat e mësuesve?* Ndaj mendojmë që shoqëria jonë civile duhet të reflektojë dhe të kuptojë thelbin e kësaj kërkese të drejtë dhe politikat e shtetit të shprehin konkretisht dhe në mënyrë domethënëse respektimin e së drejtës për edukim. Familjet kanë të drejtë të zgjedhin edukimin për fëmijët e vet, jo vetëm familjet që janë në gjendje ekonomike por edhe ato në vështirësi duhet të kenë mundësinë të zgjedhin edukimin që më tepër i përputhet dëshirave që ata kanë për fëmijët e tyre.

Gjithashtu ky vullnet i mirë, e sidomos konkret, i Shtetit duhet dhënë pa kushte. Po në Ligjin e 69, 2012 për arsimin parauniversitar, "*Mbi mbështetjen financiare për arsimin para-universitar privat",* në nenin 39 lexojmë:

1. "Ministria mund të mbështetë financiarisht institucionet arsimore private vendase, të cilat janë jofitimprurëse dhe kanë të paktën pesë vjet që funksionojnë si institucione private. Sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, mbështetja financiare për shkollat private diferencohet sipas renditjes së tyre në provimet kombëtare të arsimit bazë ose të maturës shtetërore, si dhe në testimet ose konkurset ndërkombëtare".

2. *"Shkollat private e përdorin mbështetjen financiare vetëm për nxënësit e shkëlqyer* në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare*".*

290 Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", neni 5, pika 1, 2

I shprehur kështu ky vullnet nuk i përgjigjet problemit dhe mbetet në Ligj thjesht si një dëshirë ose mundësi e Shtetit për të ndihmuar arsimin privat jofitimprurës, por sidomos duke konsideruar kushtet e vendosura për të dhënë një kontribut të tillë, në vend që të ndihmojnë mund të nxisin një konkurrencë të pafrytshme.

Tarifat në shkollat private

Institucionet arsimore private parauniversitare dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare licencohen përkundrejt tarifave të përcaktuara. Tarifat e regjistrimit në shkollat private shqiptare ndryshojnë sipas niveleve arsimore që ofrojnë, kushteve fizike, cilësisë së arsimit të ofruar, kushteve shtesë të ofruara dhe vendndodhjes.

Mbështetja për familjet në nevojë

Për mbështetjen e familjeve në nevojë nuk ka ndonjë program të veçantë, përjashtuar rastin e teksteve mësimorë për arsimin e detyruar. Sipas kësaj skeme librat janë falas. Nuk ka ndonjë skemë tjetër të çfarëdo forme për të mbështetur familjet më të ardhura të pakta për shkollimin e fëmijëve të tyre në shkollat private.

Ekuivalentimi i kurrikulave dhe kualifikimit

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, kurrikula e përdorur në shkollat private në shumicën e rasteve është e njëjtë me atë te shkollave publike. Përjashtim bëjnë shkollat që ofrojnë lëndë fetare dhe disa shkolla të huaja në kurrikulën e të cilave ka edhe lëndë në gjuhë të huaj, por edhe në këto raste, ato janë të kontrolluara dhe miratuara nga organet përkatëse shtetërore. Për tipe të njëjta shkollash zakonisht ka ekuivalencë programesh dhe module të njëjta kualifikimi. Në rastet kur ka lëndë të ndryshme, ekuivalenca bëhet me anë të provimeve plotësuese.

Organizimi i provimeve dhe certifikatat/dëftesat e lëshuara për nxënësit

Organizimi i provimeve në shkollat private përkon me provimet e shtetit dhe sistemi i vlerësimit ndjek të njëjtat kritere dhe modele si në shkollat publike.

Lidhur me certifikatat dhe dëftesat, çdo shkollë private lëshon Certifikatat dhe Dëftesat përkatëse bazuar në një model të unifikuar dhe miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Certifikatat e formimit profesional gjithashtu lëshohen në bazë të modelit të përcaktuar nga vetë institucioni. Në të dy rastet, certifikatat dhe dëftesat e lëshuara nga shkollat private kanë të njëjtën vlerë me ato të lëshuara nga shkollat publike.

Lëvizja e mësuesve nga sektori publik në atë privat

Bazuar në legjislacionin ekzistues është e mundur që mësuesit të lëvizin nga sektori publik në atë privat dhe anasjelltas, ose të punojnë njëkohësisht në të dy sistemet. Në rastin kur mësuesit punojnë njëkohësisht në të dy sistemet, ata duhet të deklarohen

dhe të paguajnë kuotën shtesë të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për pagën e deklaruar në sektorin privat.

Ecuria e institucioneve të arsimit jopublik parauniversitar pas viteve '90, sipas treguesve të shtrirjes, funksionimit dhe zhvillimit të tyre.

Mbështetur në rezultatet e studimit vërejmë se:

Ka një rritje të numrit të institucioneve të arsimit parauniversitar të hapura nga viti 1995 deri në vitin 2012. Numri i licencave nga viti në vit ka pësuar rritje duke shënuar numrin më të lartë të licencave në vitet 2007 (N=52) dhe 2002 (N=50), ndërsa numri më i vogël i institucioneve të licencuara është në vitin 1996, vit në të cilin u licencuan vetëm 2 institucione.

Ka një rritje të kërkesave për të gjitha institucionet duke filluar nga kopshtet, shkollat 8/9 vjeçare, gjimnazet, shkollat profesionale, shkollat fetare dhe shkollat social kulturore.

Nga viti në vit ka një rritje të kërkesave për kopshte private. Numrin më të lartë të licencave e kemi në vitin 2001, ku në shkallë Republike jepen 22 licenca dhe në vitin 1996 jepet vetëm 1 licencë. Në vitin 2001 jepet vetëm 1 licencë për shkollë të cu, numër që mbetët i njëjtë edhe në vitet 2005 e 2006. Pas një ndërprerje në 2006, në vitin 2012 jepet leja për 1 shkollë të tillë.

Sa i takon shkollave 8/9 vjeçare, në vitin 2002 licencohen 18 institucione të tilla, që përbën edhe numrin më të lartë, ndërsa në vitet 1996 dhe 2011 kemi numrin më të ulët, vetëm 1 licencë. Në vitin 2007, jepen 16 licenca për gjimnaze, që përbën edhe numrin më të lartë të licencave të dhëna ndër vite dhe pothuajse në vite numri i tyre luhatet nga 5-7.

Shkollat fetare kanë numrin më të vogël, 2 në vitin 1995 dhe 3 në 1998. Ajo që vihet re është se në vitet në vijim nuk ka kërkesa për hapje të tyre në Republikë dhe numri i tyre ka mbetur i njëjtë, 5 gjithsej.

Ka një rritje të interesit për shkolla profesionale. E para licencë në shkallë republike është dhënë në vitin 2000, kur u licencua vetëm një shkollë profesionale. Po kështu edhe në vitet 2000, 2001, 2002, 2004 kemi nga 1 të tillë, ndërsa në 2007 kemi dhënien e 4 licencave, në 2010, 5 licenca dhe 2012, 1 licencë.

Në vite të ndryshme ka dhënie licencash edhe për institucione social kulturore private, numri i të cilave luhatet nga 1-3. Viti 2002 shënon vitin kur jepet për herë të parë licencë për 3 institucione të tilla, po kështu edhe në vitin 2003. Ndërsa në vitet 2005, 2006, 2007 e 2008 hapen nga një në çdo vit.

Sa i përket numrit të institucioneve të arsimit parashkollor, kemi një numër më të madh të këtyre në qytet (N=106, viti 2014-2015), se në fshat (N=16, viti 2014-2015). Krahasuar me vite më parë, vërehet se kemi një ulje të numrit të kopshteve. Kjo shpjegohet me faktin se në kuadrin e reformave të ndërmarra nga qeveria shqiptare në fushën e arsimit, një sërë institucionesh u mbyllën sepse nuk plotësonin standardet, këtu përfshihen edhe kopshtet private. Viti 2010-2011 është viti ku kemi numrin më të madh të kopshteve, si në qytet (N=146), ashtu edhe në fshat (N=25).

Në arsimin bazë numrin më të madh të këtyre institucioneve e përbëjnë ata të arsimit publik, ndërsa numri i tyre në arsimin bazë privat (N=121). Në vitin shkollor 2009-2010 kemi numrin më të lartë të institucioneve jopublike të arsimit bazë, në gjuhën e

shifrave (N= 141), shifër kjo që tregon se krahasuar me vitin shkollor 2004-2005 numri i tyre pothuajse është dyfishuar. Në vitin 2014-2015 kemi një rënie të numrit të këtyre institucioneve (N=121), rënie që vërehet edhe në arsimin publik (N=1372).

Numri i gjimnazeve publike në arsimin e mesëm është më i lartë (N=327, viti 2014-2015) në raport me arsimin e mesëm jopublik (N=108, viti 2014-2015). Sa i përket numrit të gjimnazeve publike në vite nga analiza arrihet në konkluzionin se ata nga viti në vit kanë ruajtur stabilitet me një rritje të numrit të gjimnazeve, 1-4 gjimnaze, ndërsa numri i gjimnazeve private nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, madje është dyfishuar. Në vitin 2014-2015 kemi rënie të numrit të gjimnazeve, si në atë publik ashtu edhe në atë jopublik. Numri i institucioneve private të arsimit profesional ndonëse nuk ka pasur stabilitet ndër vite ka shënuar një rritje të numrit të këtyre shkollave deri në vitin shkollor 2012-2013, gjë që tregon rritjen e interesit edhe për shkollat profesionale. Theksojmë se numri i këtyre shkollave është shumë më i ulët se ai i gjimnazeve private. Në vitin shkollor 2014-2015 ka një rënie të numrit të shkollave të mesme profesionale private (N=7), gjë që vihet re edhe në arsimin profesional publik.

Sa i përket numrit të institucioneve sipas llojit në arsimin parashkollor, përqindja që zënë institucionet parashkollore publike luhatet nga 44% (viti shkollor 2003-2004) deri në 50% (viti shkollor 2014-2015), ndërsa përqindja e institucioneve jopublike luhatet nga 23% (viti shkollor 2010-2011) deri në 38% në vitin shkollor 2003-2004. Theksojmë se në vitin shkollor 2014-2015 kjo shifër bie në kuotat e 28%.

Sa i përket raporteve të arsimit publik me jopublik, nga analiza e rezultateve ky raport është 90% e zënë institucionet e arsimit publik dhe 10 % ato të arsimit privat.

Nga analiza e raporteve statistikore, në nivel Republike, rezulton se pjesëmarrja e mësueseve femra në arsimin parashkollor privat është 100% femra. Në arsimin bazë jopublik ka një përfshirje të madhe të femrave si në fshat ashtu edhe në qytet, që në gjuhën e shifrave luhatet nga 82% në vitin 2004-2005 deri në 83% në vitin 2014-2015. Në arsimin e mesëm jopublik, nga analiza e rezultateve na rezulton se në qytet përqindja e femrave luhatet nga 58% në vitin 2004-2005 dhe 66% në vitin 2014-2015, ndërsa në fshat 51% në vitin 2004-2005 dhe 63% në vitin 2014-2015, gjë që tregon se ka një përqindje të lartë të përfshirjes së mësueseve femra në sistemin e arsimit jopublik.

Niveli arsimor i mësuesve

Në arsimin parashkollor jopublik, mësueset janë edhe me arsim të mesëm, por edhe të lartë. Nga analiza e rezultateve, rezulton se nga viti në vit në kopshtet jopublike ka një rënie të përqindjes së mësueseve me arsim të mesëm nga 59% në vitin 2004-2005 në 17 % në vitin shkollor 2014-2015 dhe rritje e përqindjes së mësuesve me arsim të lartë nga 41% në vitin shkollor 2004-2005 deri më 82% në vitin 2014-2015, gjë që tregon se në këtë nivel të arsimit gjithnjë po tentohet të përfshihen mësuese me arsim të lartë.

Në arsimin bazë jopublik mësuesit janë me arsim të mesëm dhe atë të lartë. Rezultatet tregojnë se në arsimin bazë jopublik vërehet edhe prania e mësuesve me arsim të mesëm dhe të lartë, por ka një përqindje më të ulët të mësueseve me arsim të mesëm, krahasuar me ato me arsim të lartë. Për periudhën e marrë në studim vihet re se nga viti në vit në shkollat jopublike të arsimit bazë ka një rënie të përqindjes së mësueseve me arsim të mesëm nga 14% në vitin 2004-2005 në 7 % në vitin shkollor 2014-2015 dhe rritje e

përqindjes së mësuesve me arsim të lartë nga 86% në vitin shkollor 2004-2005 deri më 93% në vitin 2014-2015.

Në arsimin e mesëm jopublik rezultatet tregojnë se mësuesit janë me arsim të mesëm dhe të lartë, por përqindja e mësuesve me shkollë të mesme në këtë cikël shkollimi është mjaft e ulët, ulje që ka ardhur duke pësuar rënie nga viti në vit dhe që në gjuhën e shifrave luhatet nga 1% në vitin 2004-2005 në 2% në vitin 2014-2015.

Numri i nxënësve

Rezultatet tregojnë se numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet jopublike është rritur ndjeshëm nga viti në vit, gjë që në gjuhën e shifrave flitet nga 395 në vitin 1997-1998, në 5340 në vitin 2014-2015; po kështu numri i nxënësve në arsimin bazë nga 288 në vitin 1997-1998, në 20643 në vitin 2014-2015; në arsimin e mesëm nga 628 në vitin 1997-1998, në 13867 në vitin 2014-2015. Në arsimin bazë jo publik nuk ka dallime për sa i përket përqindjes së nxënësve në cikin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët (3%, viti 2014-2015), gjë që tregon se kemi një ruajtje të kontingjentit të nxënësve, apo edhe një vazhdimësi për sa i përket cikleve.

Sa i përket numrit të institucioneve jopublike të arsimit parashkollor numri i tyre ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Kështu nga 5 institucione parashkollore në vitin 1997-1998 arritën në 106 në vitin 2014-2015. Në arsimin bazë, nga 6 institucione në vitin 1997-1998 arritën në 121 në vitin 2014-2015. Në arsimin e mesëm, nga 1 institucion në vitin 1997-1998 arritën në 116 në vitin 2014-2015.

Numri i mësuesve

Rritje nga viti në vit ka edhe sa i përket numrit të mësuesve. Kështu në arsimin parashkollor, nga 89 në vitin 1997-1998 arritën në 345 në vitin 2014-2015. Në arsimin bazë, nga 41 mësues në vitin 1997-1998 arritën në 1872 në vitin 2014-2015. Në arsimin e mesëm, nga 26 mësues në vitin 1997-1998 arritën në 1533 në vitin 2014-2015. Duhet të theksojmë se në vitin shkollor 2014-2015 ka një rënie të numrit të institucioneve të arsimit jopublik, në të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e reformave të ndërmarra nga qeveria shqiptare, reforma që u shoqëruan edhe me mbylljen e disa institucioneve të arsimit parauniversitar jopublik, veçanërisht ato të arsimit të mesëm të lartë.

Arsimi jopublik në rrethin e Shkodrës

Në këtë pjesë do të pasqyrohen gjetjet që kanë të bëjnë me arsimin jopublik në rrethin e Shkodrës, sipas indekseve analitikë e sintetikë, për periudhën 2010-2015.

Institucionet (kopshte, arsimi 9 vjeçar, arsimi i mesëm)

Kopshte

Në rrethin e Shkodrës ka më shumë kopshte private të hapura në qytet sesa në fshat, raporti 7/2, ku 7 janë hapur në qytet dhe 2 prej tyre janë në fshat. Këto kopshte janë hapur pas vitit 1998 dhe bazuar në analizën e bazës së të dhenve, janë urdhrat fetarë/misionarë që janë nismëtarët e parë të hapjes së kopshteve private, ndërsa kopshtet e tjera hapen pas vitit 2006.

Në arsimin bazë po nga analiza e bazës së të dhënave të DAR-it Shkodër, arrijmë në konkluzionin se nga 15 shkolla private që ushtrojnë aktivitetin e tyre në rrethin e Shkodrës, vetëm njëra është në fshat dhe funksionon si shkollë e ciklit fillor, ndërsa 6 shkolla janë shkolla të bashkuara me të mesmen. Ndër pionieret e këtij arsimi pas viteve '90 në Shkodër është padyshim medreseja *"Haxhi Sheh Shamia"*, e pasuar me shkollat e urdhrave fetarë të besimeve të ndryshme. Shkollat private të hapura në periudhën nga viti 2001-2004 janë shkolla fillimisht vetëm të ciklit të ulët dhe pas vitit 2005 funksionojnë si shkolla 9- vjeçare.

Në arsimin e mesëm, po nga analiza e bazës së të dhënave të DAR-it Shkodër, arrijmë në konkluzionin se në Shkodër janë hapur dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre 9 shkolla private, të gjitha në qytet. Edhe në arsimin e mesëm shkollat e para janë fetare. Mbizotërojnë gjimnazet dhe vetëm njëra është shkollë tekniko-profesionale. Bëhet fjalë për shkollën Austriake *"Peter Mahringer"*, një pioniere e një sistemi të ri në edukimin profesional, e cila e filloi aktivitetin në vitin 2007.

Infrastruktura *(mjediset, klasat, mjetet mësimore dhe didaktike)*

Mbështetur në raportimet e drejtuesve të shkollave të marra në shqyrtim, infrastruktura përbën një pikë të fortë të institucioneve private. Në shkollat private godinat janë të reja në masën 100%, kanë arkitekturë specifike për një institucion arsimor dhe janë vazhdimisht objekt përmirësimi e zgjerimi. Ndërtesat shkollore janë të standardeve bashkëkohore dhe ofrojnë mjedise të brendshme e të jashtme në funksion të mësimdhënies dhe të edukimit të nxënësve. Në këto institucione, sipas raportimit të drejtuesve të shkollës, nuk ka mungesa për sa i përket mjediseve si klasat, laboratorët, bibliotekat, palestrat, etj. Vetëm një drejtor raporton praninë e një auditori në shkollën e tij, gjimnazi *"Atë Pjetër Mëshkalla"*. Po nga drejtuesit e shkollave private raportohet se në shkollat që drejtojnë ka laboratorë për lëndët e biologjisë, fizikës, kimisë, me pajisje bashkëkohore, ndërsa laborator për mësimin e gjuhëve të huaja raportohet vetëm nga një drejtor gjimnazi. Sallat e kompjuterëve, ku çdo nxënës ka nga një kompjuter në dispozicion, raportohen në të gjitha shkollat. 4 salla projektesh, dy salla Software-sh, një laborator CISCO, një laborator elektronik, një sallë e madhe me postacione kompjuteri, ku nxënësit mund të ulen gjatë orëve të pushimit, raportohen nga drejtuesja e shkollës austriake. Kuptohet që prania e sallave të informatikës lidhet me destinacionin e shkollës. Vetëm një drejtues raporton praninë e kabinetit të punës dhe edukimit muzikor, si dhe një salle për veprimtari jashtëshkollore. *(gjimnazi "Përparimi")*

Në të gjitha shkollat raportohet prania e një baze materiale funksionale të përzgjedhur në bazë të kërkesave të higjienës shkollore, që plotësojnë më së miri nevojat mësimore të nxënëseve, si dhe prania e aparateve të projeksionit. Vetëm dy drejtues deklarojnë praninë e smart bordeve në shkollat e tyre *(kolegji turk dhe shkolla austriake*) si dhe sallat e multimedias *(kolegji turk dhe "Atë Pjetër Mëshkalla")*. Vetëm një drejtues raporton se e shkollës shfrytëzohen gjatë gjithë verës. *(shkolla "Maria Ndihmëtare")*

Të gjithë drejtorët raportojnë praninë e bibliotekës, të pajisur me literaturë shkencore, letrare artistike për mësues dhe nxënës, ndërsa vetëm një drejtor raporton praninë e kompjuterëve në bibliotekë, të cilët mund të përdoren pa pagesë nga nxënësit (shkolla "Atë Pjetër Mëshkalla")

Sipas raportimeve të drejtuesve të gjitha shkollat kanë sistem ngrohjeje, por vetëm

një drejtues raporton se në shkollën që drejton ofrohen mjedise me ngrohje gjeo-termike (shkolla austriake).

Në shkolla funksionojnë palestrat, me dhoma zhveshjeje për vajza e djem, të cilat përdoren jo vetëm për zhvillimin e orëve të edukimit fizik, por edhe për aktivitetet sportive, aktivitete të kohës së lirë, etj.

Numri i klasave

Sa i përket numrit të klasave, nga analiza e bazës së të dhënave të DAR-it Shkodër, studimi evidenton se ka një ruajtje të numrit të klasave si në arsimin bazë, si në atë të mesëm nga viti në vit, ndërkohë që institucionet private më të preferuara në rrethin e Shkodrës janë: *"Zemra e Krishtit*", kolegji turk *"Hasan Riza Pasha" dhe medreseja " Haxhi Sheh Shamia*"; për arsimin bazë edhe kolegji turk *"Hasan Riza Pasha", medreseja "Haxhi Sheh Shamia", shkolla tekniko-profesionale "Peter Mahringer" dhe "Atë Pjetër Meshkalla"për arsimin e mesëm.*

Shërbimet shkollore (transporti, trajtimi me ushqim, shërbimi mjekësor dhe psikologjik)

Mbështetur në deklarimet e drejtuesve të shkollave arrihet në konkluzionin se në të gjitha shkollat 9-vjeçare shërbimi i transportit ofrohet dhe konsiderohet i domosdoshëm me përjashtim të shkollave të mesme ku vetëm një përqindje e ulët e ofrojnë këtë shërbim. Tarifat e këtij shërbimi në asnjë rast nuk përfshihen në tarifën e shkollimit. Pagesa varet nga institucioni.

Trajtimi me ushqim i nxënësve raportohet vetëm në tre shkolla private: kolegji turk *"Hasan Riza Pasha", shkolla tekniko-profesionale "Peter Mahringer" dhe "Atë Pjetër Meshkalla".*

Drejtuesit raportojnë se në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar ofrohet shërbimi psikologjik, por që në shkollat e mesme psikologu jep edhe lëndën e psikologjisë. *(Shkolla "Atë Pjetër Meshkalla").* Të gjithë drejtorët bien dakord për domosdoshmërinë e këtij shërbimi dhe nga të gjithë ai vlerësohet si shumë i rëndësishëm, ndërsa kur bëhet fjalë për problematikat me të cilat përballet një psikolog ata ndajnë pikëpamje të ndryshme.

"I vjen në ndihmë jo vetëm mësuesve për trajtimin e nxënësve të vështirë problematikë, por ofron edhe shërbim të specializuar për nxënësit për çdo problem që ato paraqesin."

Me vitet e para, organizohen ushtrime për menaxhimin e konflikteve për përforcimin e identitetit të grupit, lojëra, workshope, etj. Shërbimi psikologjik fokusohet në nxitjen dhe zhvillimin mendor e fizik të nxënësve, si dhe në ndihmesën dhe mbështetjen që jep për rritjen e cilësisë së procesit të mësimnxënies dhe mësimdhënies, u vjen në ndihmë nxënësve të viteve të para të ardhur nga rrethinat, fshatra apo zona malore pasi këta *nxënës kanë shumë probleme me përshtatjen qoftë me mjedisin, qoftë me shoqërinë".*

Kujdesi shëndetësor

Drejtorët raportojnë në mënyrë unanime se kujdesi shëndetësor ofrohet si shërbim në të gjitha shkollat private të Shkodrës. Në çdo shkollë ka një dhomë të ndihmës së parë, ku ofron shërbim një mjek/infermier. Gjithashtu në çdo klasë ekziston kutia e

ndihmës së parë.

Financimi

Për sa i përket financimit, raportohet se të gjitha shkollat private kanë një buxhet që mbulon shërbime të caktuara. Ligjërisht shteti nuk ka asnjë detyrim të mbështetë shkollat private të licencuara, pasi nuk ka asnjë fond publik që të derdhet në arsimin privat. Në këto kushte e gjithë barra e financimit për institucionet arsimore private parauniversitare është tërësisht e subjekteve të cilët e krijojnë aktivitetin. Financimi mbështetet nga prindërit e nxënësve ose nga donatorë të ndryshëm. Prindërit për shërbimin që u ofrohet paguajnë shuma të caktuara të cilat ndryshojnë nga shkolla në shkollë, varen nga hallka e sistemit dhe nga tarifa që cakton shkolla. Vetëm dy drejtues raportojnë se nxënësit mund të paguajnë shuma modeste duke i dhënë mundësinë të gjithë të interesuarve, pavarësisht nga niveli i tyre ekonomik, të ndjekin këto shkolla*"(medreseja Haxhi Sheh Shamia" dhe"Maria Ndihmëtare").* Shpesh tarifat që paguajnë prindërit janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet, prandaj drejtuesit vazhdimisht janë në kërkim të donatorëve *(shkolla "Atë Pjetër Mëshkalla").* Që më 2009 me miratimin e ligjit nr 10 140 datë 15.05.2009, një fond modest është dhënë edhe nga Shteti Shqiptar për të ndihmuar në pagesën e mësuesve të institucioneve arsimore të drejtuara nga ente të kishës katolike, konkretisht 4000 lekë të reja për person*("Maria Ndihmëtare").*

Drejtuesit

(niveli arsimor, të dhëna demografike)

Drejtimi i shkollës vlerësohet nga drejtuesit si një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm i shkollave private. Ato në mënyrë unanime bien dakord se ecuria e shkollës varet shumë nga niveli arsimor i drejtuesve, profili i shkollës, përvoja, aftësitë menaxheriale, etj. Mbështetur në pohimet e vetë drejtuesve rezulton se 100% e tyre kanë mbaruar fakultet mësuesie dhe kanë përvojë mbi 15 vjeçare si mësues dhe drejtues, ndërkohë që një përqindje e konsiderueshme kanë studiuar dhe janë specializuar në shtete të rajonit si Austria, Turqia apo Italia. Referuar bazës së të dhënave të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Shkodrës, drejtuesit e shkollave private të qytetit të Shkodrës janë 40% të huaj dhe 60% shqiptarë dhe se në drejtim kemi më shumë femra se meshkuj. Mbështetur në rezultatet, në arsimin privat në vitin shkollor 2013-2014 numri i femrave drejtuese shkon në 80%, një shifër e lartë kjo krahasuar me arsimin publik në të cilin numri i femrave drejtuese është 43%.

Mësuesit

(arsimimi, të dhëna demografike, niveli arsimor i mësuesve sipas cikleve të shkollimit, grupmosha e mësuesve, përvoja e mësuesve në arsim, përbërja e stafit, përzgjedhja e stafit, kualifikimi stafit, komunikimi me prindërit)

Mbështetur në analizat e rezultateve, rezulton se në arsimin bazë ka një përqindje të lartë të femrave në arsimin privat (80%, viti shkollor 2013-2014). Po kështu edhe për arsimin e mesëm të lartë (75%, viti shkollor 2013-2014).

Niveli arsimor i mësuesve në kopsht, ciklin fillor, arsimin e mesëm të

ulët dhe arsimin e mesëm të lartë privat

Po sipas analizave të rezultateve, në arsimin parashkollor dhe në arsimin fillor jopublik ka një përqindje të lartë të mësueseve me arsim të lartë (96%, viti shkollor 2013-2014). Ndërsa në arsimin e mesëm të ulët përqindja e mësuesve me shkollë të lartë është shumë më e lartë (99%, viti 2013-2014), ndërsa në arsimin e mesëm të lartë (99.5%, viti 2013-2014). Mësues me arsim pedagogjik janë vetëm 4% në arsimin parashkollor dhe arsimin fillor, dhe vetëm 1% në arsimin e mesëm të ulët. Pra si konkluzion mund të themi se në shkollat jopublike të rrethit Shkodër mësuesit e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar janë me arsim të lartë.

Grupmosha e mësuesve në kopsht, ciklin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë privat

Grupmoshat më të preferuara në kopsht dhe arsimin fillor privat janë grupmosha 30-35 dhe 35-39 vjeç. Në këto nivele arsimi nuk preferohet grupmosha nën 25 vjeç dhe mbi 60 vjeç, duke hedhur poshtë pretendimin se në këtë arsim aktivizohen mësues në pension, për shkak se paguhen më pak.

Në arsimin e mesëm të ulët grupmoshat më të preferuara janë 25-29 dhe 30-34vjeç, ndërsa analiza tregon se të gjitha moshat e tjera kanë një përfaqësim pothuajse të njëjtë. Në këtë nivel arsimi analiza tregon se ka një përfshirje edhe të grupmoshës nën 25 vjeç në kuotat e 5%. Po në të njëjtat nivele është përfaqësimi i grupmoshës nën 60 vjeç.

Në arsimin e mesëm të lartë ka një përfaqësim të të gjitha grupmoshave në të njëjtat nivele.

Në arsimin bazë privat, preferohen mësues me përvojë 11-15 vite dhe mbi 25 vite, gjë që ta përforcon idenë se në arsimin jopublik drejtuesit janë të interesuar të punësojnë stafe me përvojë, pasi kjo ndikon edhe në mbarëvajtjen dhe suksesin e këtyre shkollave.

Në arsimin e mesëm të lartë privat preferohen edhe mësues me pak përvojë, si edhe ata me përvojë mbi 25 vjeçare. Preferenca e mësuesve pa përvojë lidhet me faktin se është më i lehtë rekrutimi i tyre se i mësuesve me përvojë disavjeçare, pasi këta të fundit preferojnë më shumë arsimin publik, si rezultat edhe i një pune më të garantuar. Fakti që në këtë hallkë aktivizohen mësues të sapodalë nga bankat e shkollës ka një ndikim pozitiv për sa i përket punësimit të të rinjve.

Mbështetur në raportimet e drejtuesve në shkollat private të rrethit të Shkodrës stafi është kryesisht shqiptar dhe i huaj *(kolegji turk "H.R.Pasha"* raporti është 60/40, dhe te shkolla tekniko-profesionale *"Peter Mahringer"* raporti është 40/60). Mësuesit shqiptarë japin lëndët e gjuhës shqipe e letërsisë, historinë e qytetërimit shqiptar, shkencën e tokës, edukimin fizik, kjo në përputhje me Ligjin nr. 8387, datë 30.07.1998, "Për sistemin arsimor parauniversitar, neni 44, pika 3"

Drejtuesit raportojnë se është vetë institucioni që përcakton kriteret e rekrutimit të stafit, kritere që ndryshojnë nga shkolla në shkollë. Ndër kriteret ata rendisin përvojën në arsim, aftësi shumë të mira në përdorimin e kompjuterit, mesataren e notave të shkollës së lartë, por edhe kualifikime të tjera, etikë profesionale, disiplinë shkencore. Vetëm 1 drejtues raporton se një kriter që marrim parasysh janë rezultatet e punës së tij. Po kështu 1 drejtues raporton se një kriter që marrin parasysh është edhe njohja shumë e mirë e arsimit të lartë, të mesëm dhe 9-vjeçar. Përgjithësisht shkollat private janë të interesuara të rekrutojnë staf me kohë të plotë. Të gjithë drejtuesit raportojnë

se në kopshte e ciklin fillor stafi mësimor është i punësuar më kohë të plotë, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët e të lartë nuk mungojnë edhe mësuesit me kohë të pjesshme. Drejtuesit raportojnë se mbi 75 % e stafit është me kohë të plotë. Edhe në këtë pikë ka një përputhshmëri mes veprimtarisë së këtyre institucioneve me kriteret e përcaktuara në ligjin "*Për sistemin arsimor parauniversitar", ku 60% e stafit* mësimdhënës duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë. Drejtuesit e shkollave private kanë më shumë mundësi në përzgjedhjen e stafit.

Sipas raportimeve të drejtuesve, ndonëse për kualifikimin e mësuesve format e përdorura mbeten të ngjashme me shkollat publike, përsëri ky arsim na prezantohet me "modele" të larmishme. Në kolegjin turk "*Një herë në muaj mësuesit sipas departamenteve zhvillojnë 2-3 seanca trajnimi për të diskutuar mbi ecurinë e planeve, zbatueshmërinë e programeve, përdorimin e mjeteve të reja laboratorike, format e reja të dhënies së lëndëve. Për të parë performancën e mësuesit, shefat e departamenteve duhet ta ndjekin mësuesin në 4 orë mësimore, ndërkohë* që *një trajnim parapërgatitor 5 ditor i paraprin fillimit të vitit të ri shkollor.* Çdo mësues *në një vit shkollor është i detyruar të zhvillojë 2 orë të hapura, kalendari i të cilave afishohet që në fillim të vitit shkollor dhe të gjithë të interesuarit, përfshirë këtu kolegë, prindër, etj janë të lirë në ndjekjen e këtyre orëve. Kjo është një praktikë pozitive pasi krahas rritjes së performancës së mësuesve, ndikon edhe në përfshirjen e prindërve, një mundësi kjo për përmirësimin dhe arritjen e standardeve. Të gjitha shpenzimet për trajnimet mbulohen nga institucioni, një standard ky që tregon se* po punohet për përafrimin me botën për sa i përket plotësimit të këtij standardi.

Një risi që ky arsim ofron është edhe projekti i menaxhimit të cilësisë pedagogjike (PQM), projekt i filluar më 2008, i cili kalon në disa faza dhe ka si synim grumbullimin e informacioneve mbi të nxënit, mësimin dhe shkollën me qëllim rritjen e standardeve. (Shkolla austriake). Po kjo shkollë në bashkëpunim me organizata që ofrojnë trajnime dhe ministritë shqiptare dhe zvicerane të arsimit, zhvilluan një projekt trajnimi për mësuesit shqiptarë të degës së re të informatikës në fushën e IT-së me tre module, nga një javë secili. Nxënës të shkollës shërbyen si asistentë e përkthyes. Një nismë e shkëlqyer jo vetëm në drejtim të shkëmbimit të përvojave, por edhe në përfshirjen e nxënësve të shkollës në aktivitete të tilla, ku edhe nxënësve u ofrohet një mundësi më shumë për të praktikuar jo vetëm gjuhën, por edhe në shpalosjen e aftësive profesionale. Po kështu në këtë shkollë janë zhvilluar workshope, konferenca me mësues të gjuhës gjermane, etj. Nga prezantimi i mësipërm arrijnë në përfundimin se shkollat private gradualisht po kthehen edhe në qendra trajnimi, qendra kërkimore të cilat do të luajnë një rol të rëndësishëm jo vetëm në shkëmbimin e eksperiencave, por edhe në qendra ku do të përpunohet mendimi pedagogjik.

Bashkëpunimi shkollë–familje-komunitet është një çështje mjaft e rëndësishme, pasi nëse shkolla nuk bashkëpunon me komunitetin ajo nuk do të jetë kurrë një shkollë efektive dhe nga ana tjetër edhe komuniteti po nuk bashkëpunoi me shkollën nuk do të arrijë kurrë të jetë një shoqëri e zhvilluar dhe as e integruar në shoqëritë e zhvilluara. Drejtuesit raportojnë se në shkollat private përdoren forma të larmishme komunikimi me prindërit, siç janë telefonatat, vizitat në shkollë e familje, shënimet individuale, takimet me prindër, fletoret e komunikimit, porositë javore, e-mailit, takimet e çajit, ekskursionet. Ndërsa mbështetur në raportimet e tyre, po japim ato forma komunikimi që janë specifike për arsimin jopublik si *fletorja e komunikimit*, e cila në shkollën *"Dituria"* përdoret për të gjithë sistemin 9 –vjeçar, ndërsa në shkollën *"Maria*

Ndihmëtare" përdoret vetëm në arsimin fillor.

Takimet prind–prind (punë vullnetare, përfshirje në projekte, kurse falas). Kjo është një e veçantë që ofrohet vetëm nga sistemi jopublik. Këtë formë e përdorin kryesisht për prindërit e nxënësve të sapoardhur *("Dituria"),* por edhe puna me projekte, puna vullnetare janë forma që rritin jo vetëm bashkëpunimin mes prindërve, por edhe i ndihmojnë të reflektojnë për probleme të ndryshme (*"Maria Ndihmëtare",Kolegji turk "H.R.Pasha","ABC").* Kurset falas (gjuhë të huaj e kompjuter për prindërit) aplikohen nga Kolegji *turk "H.R. Pasha"* si një politikë efikase për të rritur bashkëpunimin me prindërit.

Revista dhe emisionet radiofonike janë një risi që e ofron Medreseja e vajzave "Haxhi Sheh Shamia". Në *revistën "Zemzem"* botohen krijime të nxënëseve, aktivitete të ndryshme shkollore e jashtëshkollore, rezultate në olimpiada etj, duke pasqyruar në këtë mënyrë jetën shkollore. Ndërsa emisioni javor në Radio *"Jehona",* "*Hapa që shihen gjurmë që lihen"***,** në rubrikat: "I ftuar në studio" dhe "Intervista e radhës" krahas të ftuarve (intelektualë të fushave të ndryshme të qytetit të Shkodrës), shpeshherë ka edhe prindër të nxënësve, të cilët janë pjesë e mendimeve dhe sugjerimeve për shkollën.

Komunikimi elektronik – është një avantazh tjetër i shkollave jopublike, ku disa prej tyre e përdorin më shpesh për të informuar prindërit për ndryshime të mundshme ditore, javore etj, por edhe për probleme të tjera që shqetësojnë mësuesit dhe prindërit.

Konferencat –karakteristikë e shkollës jopublike "Maria Ndihmëtare". Formë efikase dhe shumë e përdorur, ku trajtohen tema të ndryshme me karakter edukativ, gjatë të cilave përgatiten, diskutojnë, bëjnë pyetje të ndryshme dhe reflektojnë së bashku prindër, mësues, nxënës.

*Pyetësorët***-** përdoren në fund të vitit shkollor nga disa shkolla jopublike *("Maria Ndihmëtare", Kolegji turk "H.R.Pasha"*) për të matur punën e shkollës dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimit që shkolla ofron.

*Ekskursionet me/për prindërit***-** realizohen edhe në shkollat publike, por specifike e shkollave jopublike është se ata ftojnë vetëm prindërit në udhëtime joformale me qëllimin e mirë të rritjes e thellimit të partneritetit. *(Kolegji turk "H.R.Pasha", "Dituria", "Miqësia")*

Nxënësit

(kontingjenti që ndjek shkollat private, numri i nxënësve, nxënësit e talentuar, uniforma shkollore, kurrikula, veprimtaritë jashtëshkollore)

Nxënësit frekuentojnë edhe arsimin publik dhe atë privat. Institucionet parashkollore janë shumë të rëndësishëm dhe ndikojnë jo vetëm në zhvillimin fizik, mendor e moral, por edhe për një fillim të mirë të shkollës. Bazuar në analizën e rezultateve arrijmë në përfundimin se në vitin shkollor 2013-2014, kanë ndjekur institucionet parashkollore 13% e fëmijëve, shifër kjo që tregon se numri i fëmijëve që frekuentojnë institucionet private të arsimit parashkollor është në një përqindje të ulët krahasuar me atë publik.

Të dhënat tregojnë se kopshtet private janë shtrirë si në fshat, ashtu edhe në qytet. Sa i përket raportit fshat qytet, vërehet se ka një përqindje më të lartë të kopshteve në qytet, përkatësisht 75%-77% , ndërsa në fshat ka një përqindje më të ulët, përkatësisht 22.2%- 25%. Ajo që vihet re është fakti se numri i kopshteve private në qytet ka ardhur duke u rritur, ndërsa në fshat duke u ulur, përkatësisht me 2.8%.

Sa i përket grupmoshës së fëmijëve që frekuentojnë këto institucione, këto institucione frekuentohen pothuajse nga të gjitha moshat, por numrin më të madh e përbën grupmosha 4 dhe 5 vjeç. Kjo shpjegohet me faktin se prindërit i dërgojnë në këtë moshë në kopsht pasi i përgatisin për klasën e parë.

Nxënës të regjistruar në arsimin bazë privat në Shkodër, mbështetur në të dhënat e DAR-it Shkodër, janë 14% për vitin 2013-2014, shifër kjo që ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Megjithatë shifrat më të larta raportohen në arsimin bazë publik.

Edhe në klasën e parë, 13% e nxënësve që fillojnë klasën e parë frekuentojnë arsimin jopublik, gjë që tregon se ruhet e njëjta përqindje e fëmijëve që frekuentojnë kopshtet private në arsimin bazë. Për sa i përket raportit meshkuj-femra, përqindjen më të lartë e përbëjnë djemtë (86%, viti shkollor 2013-2014), në raport me vajzat (14%, viti shkollor 2013-2014). Nuk jemi në gjendje të shpjegojmë nëse kjo pjesëmarrje e ulët e femrave është si rezultat i mosdëshirës së prindërve për ta frekuentuar këtë klasë në shkollë private, meqë mund ta konsiderojnë shpenzim të tepërt, apo është e lidhur me numrin e lindjeve, si rezultat i të cilave ka pasur më shumë lindje meshkujsh se femrash.

Sipas legjislacionit në fuqi, prindi zgjedh arsimin që dëshiron për fëmijën e tij. Në pjesën më të madhe të shkollave, sipas pohimeve të drejtuesve, pranimet bëhen pa konkurs dhe nxënësi është i lirë të lëvizë nga publiku te privati e anasjelltas. Vetëm drejtuesit e kolegjit turk "H. R.Pasha", *gjimnazit privat "Atë Pjetër Meshkalla"dhe shkollës tekniko-profesionale"Peter Mahriger"* raportojnë se në shkollat e tyre nxënësit pranohen me konkurs. Për tu theksuar është se në kolegjin turk nxënësit e klasave të para, të treta e të nënta i nënshtrohen konkursit, i cili kalon në tre faza, provimi, paraqitja para komisionit dhe faza e tretë ku bëhet firmosja e një kontrate me kusht, e cila është e lidhur me performancën në rritje që duhet të tregojë nxënësi gjatë vitit shkollor. Kjo përbën një risi për sistemin tonë arsimor. Gjithashtu pjesëmarrja në provim është pa pagesë *(kolegji turk) dhe* me pagesë *("Atë Pjetër Meshkalla")*. Mënyra e zhvillimit dhe lëndët për të cilat testohen nxënësit janë të ndryshme.

Po nga raportimet e drejtoreve dhe analizës së bazës së të dhënave arrijmë në përfundimin se në shkollat private ka një numër të vogël nxënësish, gjë që në perceptimin e drejtorëve, ndikon jo vetëm në marrëdhënien mësues-nxënës, por edhe në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit.

Sa i takon nxënësve të talentuar, institucionet aplikojnë politika mbështetëse për vijimin dhe zhvillimin e talentit të nxënësve. Mbështetja me bursa të pjesshme dhe të plota, në varësi të rezultateve, çmimet në olimpiada apo konkurse ndërkombëtare (kolegji turk), ndarja e të cilave bëhet me ceremoni janë elementë që ndikojnë në stimulimin, motivimin e nxënësve për të rritur rezultatet, por edhe si faktorë nxitës për nxënësit e tjerë. Aplikohen gjithashtu edhe orët e konsultimeve sipas një grafiku të parapërcaktuar.

Domosdoshmëria e uniformës raportohet nga 100% e drejtuesve. Ata raportojnë se nxënësit kanë uniforma që i përdorin sipas stinëve. Ato janë të ndryshme dhe është vetë institucioni që përcakton uniformën. Uniforma është e përcaktuar edhe për zhvillimin e orëve të edukimit fizik.

Drejtuesit e të gjitha shkollave private deklarojnë se arsimimi i nxënësve realizohet sipas kurrikulës të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Gjithashtu pohojnë se kurrikula shkollore në arsimin jopublik është më e pasur se në shkollën publike. Ata e pasurojnë kurrikulën shkollore në këto fusha: gjuha angleze fillon që në klasën e

parë, në klasën e pestë krahas gjuhës angleze fillon mësimi i gjuhës italiane/gjermane, ndërsa në gjimnaz krahas gjuhëve të tjera mësohet edhe turqishtja. Në shkollat fetare mësohet lënda e kulturës fetare/etikë të cilat janë të detyruara, pavarësisht nga besimi. Që në klasën e parë nxënësit marrin njohuri kompjuteri, ndërsa në klasat më të larta zhvillojnë një program më të zgjeruar të lëndës së informatikës. Në shkollën austriake, krahas mësimit të gjuhës gjermane, si domosdoshmëri për vijimin e studimeve në këtë shkollë, realizohet një kombinim i formimit të përgjithshëm me fokusim gjuhët e huaja me lëndët për teknologji informacioni.

Aktivitetet në institucionet private vlerësohen si mjaft të rëndësishme nga drejtuesit e shkollës. Ato pohojnë larminë dhe pjesëmarrjen me dëshirë të nxënësve në to. Madje ata të gjithë ndajnë pikëpamjen se organizimi i tyre i motivon nxënësit për rezultate më të larta në shkollë. Drejtuesit listojnë aktivitete kulturore, sportive, panaire shkencore, të artizanatit, të bamirësisë, ekskursionet, konkurset, klubet e ndryshme, shërbimet kulturore, shkollat e verës, ditën e dyerve të hapura, etj. Për tu evidentuar është se në shkollat private funksionojnë klube të ndryshme si i folklorit, i muzikës, pikturës, kinematografisë, fotografisë, teatrit, etj; klubet sportive si ai i tenisit, futbollit, atletikës etj; të cilat ndikojnë fuqishëm te nxënësit. (kolegji turk). Meqenëse në kolegjin turk ka komplekse sportive, fusha volejbolli, minifutbolli, e basketbolli, në bashkëpunim me DAR-in Shkodër, çdo vit në mjediset e tij zhvillohen kampionati i volejbollit për vajza dhe i basketbollit për djem ndërmjet shkollave të qytetit. Shkollat private janë nismëtare të bashkëpunimit publik-privat.

Përmes aktiviteteve të shumta, organizimit të shfaqjeve teatrale, kryerjes së praktikës shkollore në kuadër të orëve praktike që kanë studentët e degës së gjermanistikës, përgatitjes së një serie broshurash historiko-kulturore, po sipas pohimeve të drejtuesve, institucionet private gradualisht po pozicionohen dhe profilizohen përtej aktivitetit "normal" jo vetëm si institucione shkollore, por edhe si institucione të rëndësishme në fushën e kulturës dhe politikave arsimore.

Gjithashtu kjo shkollë është kthyer në një qendër të mësimit të gjuhës gjermane, për gjithë veriun e Shqipërisë. Shkolla austriake nuk është "një ishull austriak", por i duhet të integrohet në mënyrë aktive edhe në politikat arsimore dhe në jetën kulturore të rajonit. Ajo është shembull për sa i përket projekteve të bashkëpunimit dhe ndihmës, kryesisht në bazë materiale si libra për bibliotekën e universitetit, departamentin e gjermanistikës, qendrën kulturore të fëmijëve në Tiranë, shkollat 9-vjeçare, kamera për digjitalizimin e arkivimin e dokumenteve të vjetra, materiale shkollore për shkollat e fshatit, pajisje zyre për shoqatën Austri-Shqipëri, ndihma për familjet e përmbytura.

Sa i përket funksionimit të shkollave private, drejtuesit e tyre ndajnë pikëpamje të njëjta pasi 100% e tyre rendisin këto faktorë: udhëheqjen e fortë administrative, përvojën shekullore në edukim, pikësynimet e qarta, një mjedis të sigurt dhe të disiplinuar shkollor, kontroll dhe vlerësim të shpeshtë të përparimit të nxënësve, kërkesë dhe përgjegjësi më të lartë. Vetëm 1 drejtues raporton "*Jo thjesht një institucion arsimor, por i mbështetur edhe te besimi*".

Drejtuesit ndajnë pikëpamje të njëjta për sa i përket efektshmërisë së arsimit jopublik krahasuar me atë publik. Ata mendojnë se ky arsim është më efektiv se ai i publik dhe për këtë rendisin faktorë të tillë si: mësues profesionalistë, përfshirje e interesim më i madh i prindërve, lidhje më e ngushtë mësues-nxënës, mjedise funksionale e të pasura me shumë burime teknologjike, numër të vogël nxënësish, etj.

KRAHASIMI I ARSIMIT PRIVAT SHQIPTAR ME ARSIMIN PRIVAT TË VENDEVE TË BE

Matrica e mëposhtme jep pamjen e plotë të këtij krahasimi.

Indekset	Arsimi jopublik Evropian	Arsimi jopublik shqiptar	Diferencat
Shpërndarja e nxënësve sipas sektorëve	• Në të gjitha vendet e BE-se më shumë se 90% e nxënësve të shkollave të arsimit fillor dhe të mesëm dhe të ulët ndjekin sektorin e institucioneve publike.	Në Shqipëri frekuentojnë institucionet e arsimit jopublik parauniversitar 6% e fëmijëve në arsimin parashkollor, 7.2 % në arsimin bazë, 9.3% në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe 8% në arsimin e mesëm profesional.	**Vihet re se ka diference në përqindje. Në vendet e BE-së 10%, në Shqipëri 8%.**
Shpërndarja e nxënësve sipas tipit të shkollës që ata ndjekin	• Ndërmjet institucioneve arsimore private mund të dallohen ato të cilat marrin ose jo ndihmë financiare nga shteti. • Në Gjermani ose Portugali është e pamundur të bësh dallim ndërmjet nxënësve që ndjekin institucionin arsimor privat që merr fonde nga shteti dhe atë që nuk merr fonde nga shteti.	Shteti financon bashkësitë fetare për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, para-universitar dhe universitar, që zotërohen drejtpërdrejt ose përmes organizatave jo fitimprurëse të krijuara dhe të administruara nga bashkësitë fetare, dhe që janë të miratuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose nga Këshilli i Ministrave". Ky kontribut përgjithësisht mbulon rreth 5% të shpenzimeve.	Në vendet e B-së kemi shkolla private që marrin ndihme nga shteti, kurse në Shqipëri shteti financon bashkësitë fetare për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, para-universitar dhe universitar, kontribut i cili mbulon vetëm 5% të shpenzimeve.

Korniza kryesore legjislative	Në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ligji e lejon që të ngrihen shkolla private. Kjo jo gjithmonë është e përcaktuar qartë, por është e nënkuptuar në kushtetutë nga fakti i shprehur në kushtetutë për afirmimin e të drejtës së zgjedhjes dhe lirisë së arsimimit.	1. Nenin 57, pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. 2. Ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995, "Për sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar me anë të Ligjit nr. 8387, datë 30.07.1998, "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995, "Për sistemin arsimor parauniversitar" dhe vendimet e Këshillit të Ministrave nr 358, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar dhe Licencimi i tij bëhet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë". 3. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 28.05.1999, "Për kriteret e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore private parauniversitare dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj". 4. Udhëzimi numër 33 datë 1.11.2010"Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare. 5. Ligji nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" 6. Udhëzimi nr. 6, datë 14.03.2003, i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale "Për regjistrimin e institucioneve të AFP". 7. Udhëzimi nr. 1590, datë 04.08.2008, i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale "Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional".	Legjislacioni Evropian detyron shtetin të sigurojë ose japë fonde publike edhe për sektorin privat. Në Shqipëri shteti është i detyruar të mbështesë me ligj vetëm shkollat publike.

Kushtet për të hapur një shkollë private	• Pothuajse në të gjithë Bashkimin Evropian, shteti kontrollon themelimin e të gjithë institucioneve private. • Ndërsa pranohet një minimum bazë i kushteve që duhet të plotësojnë të gjitha shkollat private që ofrojnë shkollim për nxënësit në arsimin e detyruar, për ato shkolla private që marrin fonde publike, këto kushte forcohen me shumë dhe duhet të përputhen, ose të jenë më të larta se ato që plotësojnë shkollat publike. Aprovimi ose autorizimi zyrtar, ne varësi të kërkesave rregullatore, duhet të bëhet i njohur publikisht. Autorizimi mund të anulohet kur shkolla ndërpret së plotësuari një ose më shumë nga kushtet të cilat në mënyrë origjinale justifikojnë dekretimin e tij (Danimarkë, Spanjë, Itali, Luksemburg, Austri dhe Britani).	• Subjekti i cili kërkon të hapë një shkollë private aplikon pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. • Leja për hapjen e një shkolle private jepet kur planet, programet mësimore dhe kushtet e realizimit të tyre nuk bien në kundërshtim me interesat kombëtare, me legjislacionin shqiptar, me rendin publik, normat morale dhe higjienën, si dhe kur sigurohen kushtet materiale të domosdoshme së bashku me personelin e nevojshëm mësimor. • Subjekti aplikues duhet të jetë i regjistruar në gjykatë si person juridik. • Ai duhet të plotësojë kushtet fizike, duke siguruar një godinë të përshtatshme për shkollë, si dhe të pajisur me bazë materiale dhe didaktike, të ketë kurrikula të përshtatshme për nivelin përkatës për të cilin kërkon të pajiset me leje funksionimi, si dhe stafin e duhur mësimdhënës. • Subjekti aplikues duhet të plotësojë kriteret dhe dokumentacionin e mëposhtëm: a) Formulari i vetëdeklarimit. (b) Dokumentacioni teknik.	Nuk ka diferenca themelore.
Kërkesat lidhur me stafin	• Në të gjitha shtetet evropiane ka dy kërkesa bazë; a) Profesionalizmi i duhur ose kualifikimet akademike; b) Karakteri i mirë moral dhe bindës ndaj ligjit.	• Subjektet, që kërkojnë të marrin leje për hapjen e institucioneve arsimore private, duhet të provojnë se kanë personel pedagogjik me arsimin përkatës e me kualifikimin e duhur. • Për shkollat private, programet e të cilave janë të njëjta me ato të shkollave publike, mësuesit duhet t'u nënshtrohen dhe të zotërojnë kualifikim të njëjtë si edhe mësuesit e shkollave publike.	Nuk ka diferenca.
Kushtet fizike të shkollave	• Ndërtesat, pajisjet, shëndeti dhe siguria. • Numri i nxënësve në klasë. ▯ Ndërtesat: Në pjesën më të madhe të vendeve, standarde te tilla si ndërtesat, pajisjet, shëndeti dhe siguria janë themelore kur hapet një shkollë private që ofron shkollim për arsimin e detyruar. ▯ Numri i nxënësve në klasë. Numri i nxënësve merret ne konsideratë. Në disa vende një kusht për krijimin e një shkolle private, që merr financim nga shteti, është kontingjenti minimal i nxënësve.	• Nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit janë përcaktuar edhe disa standarde normative për objektet që do të funksionojnë si institucione arsimore private. • Kushtet fizike të nevojshme për hapjen e një shkolle apo kopshti privat janë: klasat, nyjet hidrosanitare, edukimi fizik, ndriçimi, minimumi i klasave, ndihma e shpejte, mbrojtja kundër zjarrit, ngrohja-ftohja,etj.	Diferenca vihet re ne numrin e nxënësve. Në disa vende të BE-së ka një numër limit të caktuar të nxënësve si kusht që të funksionojë një shkollë private. Në Shqipëri nuk ka një kusht të tillë.

Kërkesat lidhur me përmbajtjen	• Edhe pse në shumë vende të Bashkimit Evropian liria për edukim është vendosur dhe zbatuar në parimet kushtetuese, në pak vende të tjera është shteti që vendos të paktën qëllimet dhe objektivat bazë të edukimit kur krijohen shkollat private të arsimit të detyruar. • Vendet ku detyrimet ligjore të shkollave private, për sa i përket përmbajtjes arsimore, zgjerohen aq sa janë të parashikuara në qëllimet dhe objektivat e shkollave publike.	• Planet dhe programet mësimore, si dhe kushtet e realizimit të tyre, nuk duhet të bien në kundërshtim me interesat kombëtare, legjislacionin shqiptar, rendin publik, normat morale dhe higjienën, si dhe të jenë të shoqëruara me kushtet materiale të domosdoshme si dhe personelin e nevojshëm mësimor. • Në një shkollë private në gjuhë të huaj, gjuha dhe letërsia shqipe, historia e kombit shqiptar dhe gjeografia e Shqipërisë zhvillohen detyrimisht në shqip. • Për shkollat e tjera private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare ose në të cilat mësimi bëhet edhe në gjuhë të huaj kriteret dhe procedurat caktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave. • Shkolla private duhet të miratojë në MAS lëndët mësimore, listën e teksteve bazë, listën e bazës materiale dhe didaktike. Në rastet e shkollave fetare duhet të merret miratimi nga Sekretariati Shtetëror i Fesë, për planet mësimore, programet lëndore dhe tekstet jolaikë.	Nuk ka diferenca themelore
Kontrolli i shtetit	• Në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, veprimtaria e institucioneve arsimore private, në nivelin arsimor të detyruar, kontrollohet nga shteti përmes legjislacionit dhe inspektimit. Përgjegjësia për kontrollin e arsimit privat i takon Ministrive ose Departamenteve qeveritare ose mbi nivelin lokal të qeverisë. • Duke folur në përgjithësi, brenda vendeve, ato tipe shkollash të cilat kanë ngjashmërinë më të madhe me shkollat shtetërore, ose që gëzojnë nivelin më të madh të mbështetjes financiare shtetërore, në krahasim me te tjerat, janë subjekt i kontrollit, i cili ka një fushë të gjerë, i zgjeruar sidomos mbi kurrikulën. • Në shume vende, administrimi financiar kontrollohet vetëm aty ku shteti jep subvencionim.	• Ministria e Arsimit dhe e Shkencës nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit dhe organet e saj arsimore në rrethe, konkretisht Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, kontrollon periodikisht procesin mësimor laik në shkollat private, për të verifikuar realizimin e kërkesave të planit e të programeve mësimore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit. • Organet kontrolluese kompetente kontrollojnë edhe dokumentacionin që duhet të jetë në ruajtje. • Drejtoria e tatimeve kontrollon subjektin për respektimin e shlyerjeve të detyrimeve tatimore.	Diferenca themelore ka të bëjë me faktin që në disa vende te BE-së kontrolli financiar ushtrohet vetëm mbi shkollat private që marrin fonde publike.

Mbështetja e arsimit privat me fonde publike	• Në Greqi, Itali, me disa përjashtime, nuk ka shkolla private të cilat marrin mbështetje financiare nga autoritetet publike. • Shumica e sekteve dhe shkollave te tjera, ne Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut, financohen nga fondet publike. • Ne vende te tjera te BE-së, fondi i dhënë si ndihmë financiare për institucionet private jepet ose i ndarë në kategori të ndryshme shpenzimi, ose si ndihmë financiare globale, e cila mbulon kategori të ndryshme, ose si grand lokal në përputhje me numrin e nxënësve dhe koston për nxënës në arsimin publik. Ndihma mbulon nga 50-80% të shpenzimeve operative.	Ligjërisht, shteti mbështet financiarisht, sipas mundësive dhe programeve të miratuara, institucionet arsimore private vendase, të cilat janë jofitimprurëse dhe kanë të paktën pesë vjet që funksionojnë si institucione private. Sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, mbështetja financiare për shkollat private diferencohet sipas renditjes së tyre në provimet kombëtare të arsimit bazë ose të maturës shtetërore, si dhe në testimet ose konkurset ndërkombëtare. Gjithashtu, në ligj përcaktohet se shkollat private e përdorin mbështetjen financiare vetëm për nxënësit e shkëlqyer në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.	Mbështetja e arsimit privat me fonde publike përbën diferencën themelore të krahasimit të arsimit privat evropian dhe atij shqiptar.
Tarifat e regjistrimit	• Në institucionet private, të cilat marrin pak, ose asnjë fond nga autoritetet publike, vendosen tarifat e regjistrimit. • Dallohen dy grupe vendesh: (1) ato ku regjistrimi është falas (si në sektorin e arsimit publik) dhe (2) ato ku paguajnë prindërit. • Në vendet ku institucionet private marrin fonde publike arsimi është falas, pavarësisht se cilën shkollë frekuentojnë nxënësit. Megjithatë, në shumicën e vendeve prindërit kontribuojnë vullnetarisht për koston e arsimit. • Në Evropë, ka edhe vende ku institucionet private vendosin tarifa edhe në qoftë se financohen nga shteti. Nivelet e tarifës janë të kufizuara.	• Tarifat e regjistrimit në shkollat private shqiptare ndryshojnë sipas niveleve arsimore që ofrojnë, kushteve fizike, cilësisë së arsimit të ofruar, kushteve shtesë të ofruara dhe vendndodhjes. Këto tarifa përballohen nga prindërit.	Diferenca është në faktin që në arsimin privat evropian, një pjesë e tarifave ose komplet tarifa përballohet nga shteti.
Mbështetja e familjeve në nevojë	• Pothuajse të gjitha vendet Evropiane mbështesin me asistencë financiare direkte (kesh), e cila u jepet prindërve të fëmijëve ose vetë fëmijëve në arsimin e detyruar, pavarësisht se cilin sektor ndjekin, atë publik apo privat. • Në varësi të vendit, asistenca financiare mund të marrë formën e lehtësimit të taksave, ndihmës financiare, ose huave.	• Lidhur me mbështetjen e familjeve në nevojë nuk ka ndonjë program të veçantë, përjashtuar rastin e teksteve mësimore për arsimin e detyruar. Sipas kësaj skeme librat janë falas. • Nga ana tjetër, nuk ka ndonjë skemë tjetër të çfarëdo forme për të mbështetur familje më të ardhura të pakta për shkollimin e fëmijëve të tyre në shkollat private.	Ka diferenca

Ekuivalenca e kurrikulave	• Në disa vende, kurrikulat e arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të ulët janë të njëjta si në sektorin e shkollave publike dhe në ato private. • Në raste të veçanta, detyrimet lidhur me planin mësimor privat janë të limituara vetëm ne minimumin e planit mësimor. • Shkollat private që marrin fonde publike duhet të jenë konform qëllimeve të sektorit publik. • Në disa vende shkollat private janë të lira t'u ofrojë nxënësve një plan mësimor ndryshe nga ai i aplikuar në sektorin e arsimit publik. Kjo liri është e limituar me pranueshmërinë për grante.	• Në përputhje me legjislacionin shqiptar, kurrikula e përdorur në shkollat private shqiptare në shumicën e rasteve është e njëjtë me atë te shkollave publike. Përjashtim bëjnë shkollat që ofrojnë lëndë fetare dhe disa shkolla të huaja. Për tipe të njëjtë shkollash zakonisht ka ekuivalence programesh dhe module të njëjtë kualifikimi. Ne rastet kur ka lëndë të ndryshme ekuivalenca bëhet me anë të provimeve plotësuese.	Nuk ka diferenca themelore.
Organizimi i provimeve	• Në fund të arsimit 8/9 vjeçar, në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian nxënësit nuk marrin dëftesë. • Arsimi i detyruar vazhdon si arsim i dytë (ose si tre vitet e fundit te arsimit te mesëm në sistemin me një strukturë). • Caktimi i dëftesës është përgjegjësia e vetme e institucionit. Organizimi dhe vlerësimi që të çon drejt dëftesës i takon secilit institucion, qoftë në sektorin publik apo atë privat. • Dallohen dy grupe vendesh: a) Vendet ku organizimi i testeve është i përbashkët në të dy sektorët. b) Vendet që ndjekin një vlerësim të vendosur nga institucioni.	• Organizimi i provimeve në shkollat private në Shqipëri përkojnë me provimet e shtetit dhe sistemi i vlerësimit ndjek të njëjtat kritere dhe modele si në shkollat e arsimit publik. • Lidhur me Certifikatat dhe Dëftesat, çdo shkolle private lëshon certifikatat dhe dëftesat përkatëse bazuar në një model të unifikuar dhe miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit. • Certifikatat e formimit profesional gjithashtu lëshohen në bazë të modelit që përcakton vetë institucioni. Ne të dy rastet, certifikatat dhe dëftesat e lëshuara nga shkollat privat kanë të njëjtën vlerë si edhe ato të lëshuara nga shkollat publike.	Nuk ka diferenca themelore.
Statusi i mësuesit	• Edhe pse ndonjëherë procedurat e rekrutimit ndryshojnë, kualifikimet e kërkuara për punësim si mësues në shumicën e vendeve janë të njëjta me sektorin publik. Në disa vende nuk ka kërkesa shtetërore për sa i përket kualifikimit të stafit mësimdhënës në shkollat private.	Në Shqipëri, procedurat e rekrutimit ndryshojnë sipas shkollave, kualifikimet e kërkuara për punësim si mësues janë të njëjtë me sektorin publik. Në disa shkolla ka kërkesa specifike për sa i përket kualifikimit të stafit mësimdhënës në shkollat private.	Nuk ka diferenca themelore.

Levizja e mësuesve midis sektorit publik dhe privat	• Në Britani, për mësuesit në shkollat private që nuk marrin fonde publike nuk është e nevojshme të kenë të njëjtat kualifikime si ato të kërkuara në sektorin publik. • Në disa vende, mësuesit kanë mundësinë të transferohen nga një sektor në tjetrin, si dhe të mbajnë nivelin e vjetërsisë dhe të drejtat e tyre që i kanë fituar gjatë gjithë karrierës. • Në Danimarkë, mësuesi që ka kualifikime mund të lëvizë nga një sektor në tjetrin. • Në Greqi nuk është e mundur transferimi nga sektori publik tek ai privat, por është e mundur nga privati tek publiku.	Bazuar në legjislacionin ekzistues është e mundur që mësuesit të lëvizin nga sektori publik në atë privat dhe anasjelltas, ose të punojnë njëkohësisht në të dy sistemet.	Nuk ka diferenca themelore.

KAPITULLI VI

PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në paraqitjen e historisë së arsimit privat u përpoqëm të zbulojmë vlerat, rëndësinë, kontributin që ai ka dhënë në zhvillimin e arsimit kombëtar, mbasi historia e tij është e gjatë, plot sakrifica dhe shumë e larmishme. Pas shfrytëzimit të burimeve bibliografike, paraqitjes, analizës dhe përgjithësimeve të tij, arrijmë në disa përfundime.

Shkollat private kanë qenë pjesë e sistemit arsimor në periudha të ndryshme historike, kanë krijuar historikun e tyre duke u bërë pjesë e arsimit kombëtar dhe mendimit pedagogjik shqiptar.

Edukimi i breznive iliro-shqiptare ka qenë një proces i gjatë, që ka nisur prej shekujsh. Që herët në trevat tona flitet për instruktorë, individë, që kanë luajtur rolin e mësuesit. Kolonitë helene dhe shkollat e tyre të bregdetit kanë luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm në historinë e Ilirisë, në vendosjen e kontakteve mes kulturave, por edhe në zhvillimin e shkollave.

Marrëdhëniet e Shqipërisë që në kohë të hershme kanë qenë të pashkëputura me botën perëndimore, marrëdhënie ekonomike, tregtare, kulturore, fetare, etj. Kultura, në të gjitha shfaqjet e saj, ka qenë një shprehje e vetë identitetit të popullit shqiptar si popull evropian, duke iu nënshtruar edhe arsimimit që jepej në një kontekst të caktuar, po ashtu thellësisht evropian.

Në shtetin e arbrit, duhet të kenë filluar të shkruajnë gjuhën amtare paraardhësit tanë, gjë që jo vetëm pohohet nga studiues të ndryshëm: "Ata duhet të kenë nisur me kohë të shkruajnë gjuhën amtare", (Shuteriqi, Dh, 1964), por edhe nga njoftimi i Brokardit (1332), apo formula e pagëzimit e Pal Engjëllit (1462), apo shkrimet e hershme të dokumentuara deri tani si Meshari i Buzukut (1555).

Zhvillimi i shkollave nuk ka qenë i ndryshëm nga vendet perëndimore, pavarësisht se ka pasur mangësi në trajtimin e tyre. Njerëz të ditur e shtrinë veprimtarinë e tyre jo vetëm në trojet ku kishin lindur, por edhe në qendra të rëndësishme të brigjeve të Adriatikut. Qendra të rëndësishme si: Venediku, Padua, Raguza, Spliti, Budva etj. u dhanë mbështetje banorëve të ardhur nga Shkodra e Drishti, pas pushtimit osman,dhe ata u bënë pjesë aktive e jetës së atyre qyteteve të rëndësishme mesjetare. Në trevat e Venedikut, ndeshemi me piktorë, arkitektë, filozofë, noterë, diplomatë të cilët vinin nga qytete të përmendura si Shkodra e Drishti, pa lënë pas dore edhe Durrësin. Përmendim Barlecin, Biçikemin, Gjon Gazullin, Mikel Marulin, Leonik Tomeun, Vinçens Kamsin, që më 1489 merr doktoratën në filozofi në Padua, duke patur si dëshmitarë shkodranët Bononinus Nicolaus Scutarensis dhe Marin Barlecin[291](Cituar nga Kamsi W, 2013, fq.

291 Lucia Nadin (2008) "Migrazioni e integrazione. Il caso degli albanesi a Venezia (1479-1552)", Roma, Bulzoni.

12, referuar Lucia, N, 2008, fq.57). Kjo presupozon një përgatitje që në Arbëri, pasi nuk ka si të shpjegohet ndryshe arritja në këtë shkallë të dijes.

Në shkollat e Arbërisë, në periudhën e mesjetës, programet nuk ishin të ndryshme nga shkollat e tjera të Evropës, mbasi këto shkolla ishin nën varësinë e kishës. Sistemi i shtatë arteve të lira trivium (gramatikë, retorikë e dialektikë) dhe quadrivium (aritmetikë, gjeometri, astronomi e muzikë), duke ruajtur latinishten si gjuhë kulture u pranua dhe u përshtat nga etërit e kishës. Shkrimet e lëna nga Barleci, Biçikemi, Dh. Frëngu, Pal Engjëlli etj, dëshmojnë se latinishtja ishte gjuhë kulture e nuk mungonin në të njëjtën kohë shkrimet e shqipes. Pa këtë traditë të mirë nuk do të kishim vepra të tilla si Meshari (1555), doktrinat, Ritualin Romak, Çetën e Profetëve (1685) etj.

Ky zhvillim këputet nga vërshimi i turqve. Shekulli XVI nuk dha shenja për vijimësinë e rrugës së nisur, ashtu siç po ndodhte në vendet e Evropës.

Në shekullin e XVII-të shohim se bëhen hapa të rëndësishëm. Me gjithë vështirësitë e panumërta, në këtë shekull dolën në dritë një sërë dokumentesh që dëshmojnë për lëvrimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Pavarësisht trysnisë së pushtuesit, u hapën qendrat e para mësimore, fillimisht me një numër të kufizuar nxënësish dhe kryesisht në periferi. Të kësaj periudhe janë shkolla fillore e Kurbinit (1632), e Velës (Mirditë) (1660), e Korçës (1637), e Pdhanës (1638), fillimisht si shkollë fillore e më pas edhe si shkollë e mesme, në Blinisht, në Janievë të Kosovës (1671), Tophanë (1689), etj.

Me rëndësi për ekzistencën dhe zhvillimin e shkollave ka tekstografia shkollore, e cila në këtë periudhë merr zhvillim të dukshëm. Klerikët shqipëruan tekste nga gjuhët e huaja dhe zhvilluan në shkollat e hapura prej tyre edhe lëndë shoqërore edhe natyrore. Në shkollat fillore shërbyen librat që u botuan në gjuhën shqipe, ndërsa në shkollat e mesme përdoreshin jo vetëm libra fetarë, por edhe autorësh klasikë. Kërkesat e vazhdueshme për libra, pagesat për ta, shumëllojshmëria e titujve dëshmojnë hovin e këtyre shkollave, që synonin edukimin dhe përgatitjen e gjithanshme të nxënësve.

Sa i takon zhvillimit të shkollës, na duket i drejtë dhe i padiskutueshëm mendimi i studiuesit Kolec Cefa se "një popull me rrajë të vjetra në trolln e vet etnik, me histori, tradita dhe me bashkëjetesë greke e romake, me krishtënim apostolik, nuk ka si mos me pasë zanafillë të vjetër arsimore"[292]

Krahas klerikëve katolikë e ortodoksë, filluan të gjallërohen edhe klerikët myslimanë, të cilët krahas problemeve fetare u morën edhe me veprimtari arsimore në mejtepe e medrese. Në këtë periudhë mejtepet e medresetë marrin një shtrirje mjaft të gjerë, ndërsa shkollat katolike, fillore dhe të mesme, gjallërohen. Në shkollat fillore islame filloi edhe përdorimi i gjuhës shqipe. Numri i tyre ka ardhur vazhdimisht duke u rritur. Mësuesit e tyre kanë ushtruar dy detyra: të klerikut dhe të mësuesit. Këtu është e domosdoshme të bëj një sqarim lidhur me interpretimin që i është bërë shkollave të kësaj periudhe. Autorë të ndryshëm, që janë marrë me historikun e shkollave, kanë dhënë emërtime dhe kategorizime të ndryshme. Mendoj se shkollat janë shqiptare ose të huaja. Shkollat janë shqiptare kur çelen nga shqiptarë dhe drejtohen nga ato ose nga shteti, kanë programe shtetërore, tekste të miratuara, gjuhën shqipe si gjuhë mësimi e mësues shqiptarë. Shkollat shqiptare përfshijnë shkollat shtetërore dhe private. Shkollat private mund të jenë laike ose fetare. Shkolla fetare janë shkolla që nxjerrin meshtarë apo hoxhallarë. Pra janë në shërbim të fesë. Kuptohet që në shekujt XVI-

292 Çefa, K (2013) *"Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII"*, Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVII, Tiranë

XIX, nuk lejoheshin të hapeshin shkolla shqipe, pasi nuk mund të hapje shkollë pa lejen e Sulltanit. Këto shkolla, që hapeshin brenda në qelë, nuk mund ti quajmë fetare. Në këto shkolla mësohej shkrim, këndim, njohuri aritmetike e doktrina e krishterë, latinisht e italisht. Lëndët fetare mësoheshin më vonë. Vërtet ato nuk mund të hapeshin si shkolla shqipe, vetëm me motive fetare, vetëm të quajtura "fetare", madje edhe në lutjet e tyre famullitarët kështu i kërkonin. Turqit nën peshën e kapitulacioneve lejuan hapjen e tyre, por këto shkolla nuk ishin fetare. Vërtet i hapnin famullitarët, por ato kishin synim kombëtar. Ato u bënë vatra të përhapjes së arsimit dhe kulturës në popull, pasi jo të gjithë nxënësit që frekuentuan këto shkolla ndoqën rrugën e meshtarisë, por u bënë mësues për të tjerët. Këto shkolla u hapën nga kleri me ndihmën financiare të Vatikanit, Austro-Hungarisë, tregtarëve, madje edhe të popullit. Ndërsa shkollat e huaja janë shkollat greke, turke, italiane, dhe sllave, të cilat janë hapur nga shtetet respektive. Këto shkolla janë hapur, financuar, administruar nga shteti italian, grek, turk e sllav. Mësuesit ishin të huaj e mësimin e zhvillonin në gjuhë të huaj. Organizmat fetarë morën në dorë shkollimin e fëmijëve dhe të rinjve. Kleri i hapte, i subvencionone, përcaktonte edhe programet. Koncilet kishtare dhe sinodet kanë lënë vazhdimisht detyrë hapjen e shkollave. Nuk mund të lëmë pa përmendur se shumë shkolla u mbajtën nga populli, tregtarë e fshatarë, madje aty këtu fshatarët kishin krijuar edhe një arkë të përbashkët për mbajtjen e shkollës (si në Shirokë të Shkodrës).

Shkollat dhe arsimi në shekujt XV- XVIII janë djepi historik i arsimit tonë. Kuptohet që shkollat e kësaj periudhe kanë pasur specifikat e tyre të zhvillimit në përmbajtje dhe metoda. Si e tërë Evropa gjatë mesjetës, edhe tek ne arsimi dhe shkolla u zhvilluan në përmbajtje e organizime kuadër, nën drejtimin e klerit, për vetë rrethanat e kohës. Krahas detyrës fetare, klerikët ushtronin edhe detyrën e mësuesit. Një tipar masiv i këtyre mësuesve qenë ndjenjat atdhetare, dashuria për atdheun, gjuhën shqipe që ushqyen edhe tek brezat e rinj. Këto klerikë këmbëngulën që shërbesat fetare edhe veprimtaritë mësimore të zhvilloheshin në gjuhën shqipe. Këto shkolla patën karakter kombëtar, pasi patën meritën e ruajtjes dhe lëvrimit të gjuhës shqipe, trashëguan vlerat kombëtare të kulturës duke krijuar në shekujt në vijim breza të tërë të rinjsh jo vetëm të shkolluar, por edhe intelektualë të kohës. Shkolla e Kurbinit, e dokumentuar më 1632, është sythi i arsimit kombëtar, e para shkollë shqipe. Shkolla shqipe, ndonëse me një shtrirje të rrallë, ka ekzistuar edhe gjatë pushtimit osman, duke përballuar edhe presionet e Patrikanës Greke.

"Mësonjëtorja Kombëtare e Korçës", si shkolla e parë laike, përpjekje dhe fryt i rilindësve tanë, nuk duhet ngatërruar me shkollën e parë shqipe, pasi shkolla shqipe ka pasur para mësonjëtores së Korçës. Shkollat e shekullit të XVII-të, vatra diturie në mesjetë, ishin ato që vunë themelet e arsimit tonë kombëtar.

Mohimi, shtrembërimi dhe keqinterpretimi që i është bërë vite me rrallë veprimtarisë së tyre, madje duke e prezantuar edhe Shqipërinë si një vend me traditë shumë të varfër në fushën e arsimit, kanë ndikuar në shtrembërimin e atyre të vërtetave që ka ardhur koha t'i themi në mënyrë që brezat të mos bien në gabime të tilla. Rilindësit, në rrethanat e pushtimit dhe duke njohur mirë gjendjen e arsimit dhe të shkollës, projektuan platformën e zhvillimit të arsimit, zbatimin e së cilës e filluan me një model shkolle me karakter kombëtar, laik e demokratik. Hapja e mësonjëtores së Korçës është padyshim një ngjarje e madhe për arsimin, dijen dhe veçanërisht për gjuhën e shkruar shqipe pasi nëpërmjet saj shënohet një moment kulmor emancipimi i shoqërisë si e para shkollë laike në Shqipëri. Mbështetur në dokumente pohojmë se gjuha shqipe është mësuar më herët në shkolla katolike, në nisje në shkollat e Veriut dhe më pas edhe në Shqipërinë e Jugut.

"Mësonjëtorja e parë shqipe" e Korçës bëri një hap shumë përpara në kushtet që kalonte vendi në atë periudhë. Në ndryshim nga shkollat shqipe të Pdhanës, Kurbinit, Janievës, Blinishtit, ajo krijoi modelin e shkollës shqipe me tekstet e kolosëve të Rilindjes sonë Kombëtare, Naimit, Samiut, etj, duke ngritur të parin institucion kombëtar e duke legalizuar krenarinë e të arsimuarit në një shkollë shqiptare.

Arsimi shqiptar në këto vite ka pasur një vulë perëndimore të qartë. Ata që vunë themelet e arsimit shqiptar qenë, thuajse pa përjashtim, njerëz të përgatitur në shkolla perëndimore, dhe sollën në arsimin shqiptar botëkuptimin e qytetërimit perëndimor dhe metodat pedagogjike moderne. Shkodra qe gjithmonë një dritare e hapur nga perëndimi. Ndër shkollat fetare të Françeskanëve dhe të Jezuitëve kultura klasike, sidomos latine, gjeti djepin e parë.

Shkollat private deri në vitin 1946 kanë qenë të kategorive të ndryshme, nga ai parashkollor, fillor e deri tek ai i mesëm, dhe kanë pasur shtrirje të gjerë në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe në të gjitha trojet shqiptare, duke u paraprirë shkollave shtetërore. Ato kanë krijuar themelet e mësimit në gjuhë të huaj dhe në gjuhën shqipe, duke i dhënë kësaj të fundit gjithnjë përparësi me kalimin e viteve.

Përmbajtja e këtyre shkollave gjithnjë ka ardhur duke u përmirësuar, duke rregulluar raportet ndërmjet lëndëve formimit të përgjithshëm kulturor me atë estetik, fizik dhe edukatën e punës; shkencave natyrore dhe atyre shoqërore, etj. Lëndët me karakter kombëtar kanë pasur më shumë vend në planin e këtyre shkollave. Pozitiv ka qenë edhe mësimi i gjuhëve të huaja, të cilat nga njëra anë kanë shërbyer si mjete studimi, kontakti me kulturat, por edhe mundësi për të vazhduar studimet e larta jashtë Shqipërisë.

Këto shkolla si në drejtim të paraqitjes së nxënësve, të pajisjes së tyre me bazë materiale e didaktike e laboratorike, në drejtim të rregullit e disiplinës, të plotësimit me mjedise të përshtatshme, me biblioteka e salla shfaqjesh, salla studimi, konvikte etj, kanë qenë shembull i përparuar për kohën. Shkollat private kontributin më të madhe e kanë në arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve, pajisjen e tyre me një formim kulturor, me norma morale e qytetare, me dashurinë për vendin, me dëshirën për dije e përparim, e vlerësuar kjo edhe nga populli.

Një rol të rëndësishëm këto shkolla e kanë luajtur edhe në arsimimin e femrës, pasi siç thotë edhe prof Jup Kastrati "Aty u arsimuan me kujdes jo vetëm si zonja shpijash, por edhe nana shqyptare".

Shkollat private shqipe kishin traditë të mirë, si në veri, ashtu edhe në jug, si nga numri, ashtu nga llojshmëria dhe kohëzgjatja e tyre. Këto shkolla të hapura dhe të mbajtura nga populli, të huajt, kleri apo shteti kanë pasur kuadro të përgatitur nga ana profesionale, shkencore dhe kulturore. Në bankat e këtyre shkollave u përgatitën atdhetarë të shquar e të devotshëm për çështjen kombëtare, burra shteti, intelektualë të shquar, personalitete të letrave dhe udhëheqës shpirtërorë, të cilët kudo ku kanë studiuar dhe më pas punuar, përhapën edhe përvojën e këtyre shkollave.

Shkollat private kanë dhënë ndihmesën e tyre në përhapjen e kulturës, dijes e përparimit, përmes funksionimit të shtypshkronjave, botimit të gazetave, revistave, ngritjes së bibliotekave, shoqërive artistike, kulturore e sportive, duke kontribuar kështu në gjallërimin e jetës kulturore e atdhetare në zona të ndryshme të vendit si dhe u kanë qëndruar rrebesheve të kohërave, qëndrimeve mohuese të vlerave arsimore, me gjithë pezullimin e veprimtarisë së tyre në periudha të caktuara.

Nga viti 1946 shkollat private u mbyllën për tu rihapur rihapur pas viteve '90. Periudha pas viteve '90 shënoi epokën e arsimit jopublik në vendin tonë, që me hapa

shumë të shpejtë arriti të bëhet i dëshirueshëm për të gjithë. Në një vend të tillë, me të tillë historik të sistemit arsimor, nuk qe shumë e vështirë shfaqja e këtyre institucioneve private. Gjatë viteve 1991-1993, në Shqipëri janë hapur disa shkolla të nivelit 8-vjeçar e të mesëm. Neni 65 i Ligjit nr. 7952 "Për sistemin arsimor parauniversitar", datë 21.06.1995, e mbështeti vazhdimin me ligj të këtyre shkollave. Në këtë nen shkruhej: "Shkollat private ekzistuese të hapura në periudhën 1991-1993 u nënshtrohen të gjitha dispozitave të këtij ligji. Shqyrtimi i kërkesave për vazhdimin dhe funksionimin e shkollave private ekzistuese të hapura në periudhën 1991-1993, dhe ekuivalentimi i diplomave të lëshuara nga këto shkolla bëhet brenda një periudhe 3 mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji".

Karakteristikë kryesore është rritja dhe zgjerimi i tij në të gjitha drejtimet. Ai ka prekur të gjitha nivelet e cikleve shkollore, duke filluar nga kopshtet, arsimi i detyruar, arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe profesional. Ky arsim zë 8% në sistemin tonë të edukimit.

Ekziston një bazë ligjore e plotësuar për sa i përket licencimit, organizimit dhe funksionimit të institucioneve jopublike private. Ndryshimet demokratike të viteve '90-të sollën në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës kërkesën për rivendosjen e arsimit jopublik, duke u paraqitur edhe kërkesat e para për krijimin e një alternative të re arsimimi, përveç atij publik. Në mungesë të një legjislacioni, që rregullonte raportet ndërmjet organeve drejtuese të arsimit dhe subjekteve private (komunitete fetare, shoqata, fondacione, persona fizikë apo juridikë), në këto vite është operuar mbi bazën e marrëveshjeve ndërmjet palëve. Rregullimi i parë ligjor u bë me ligjin datë 21.06.1995, "Për sistemin arsimor parauniversitar". Ndërsa në Kushtetutën e Shqipërisë shkruhet: "Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit."[293]

Miratimi dhe hapja e shkollave private, sipas specifikës, është kompetencë e Ministria e Arsimit dhe e Sporteve dhe në raste të veçanta e Këshillit të Ministrave. Ministria e Arsimit dhe Sportit jep lejen për hapjen e shkollave private kur të gjitha lëndët zhvillohen në gjuhën shqipe. Këshilli i Ministrave jep leje si për shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhë të huaj, ashtu për ato ku zhvillohen lëndë fetare.

Dhënia e lejes nuk është një procedurë formale, pa përgjegjësi, përkundrazi, si në të gjitha vendet e botës, leja nuk jepet kur ka tendenca territoriale shoviniste, kur shtrembërohet historia, kur ka qëllime denigruese për figura të kulturës, shkencës dhe artit kombëtar si dhe kur bien në kundërshtim me interesat tona kombëtare. Ligji kërkon zbatimin me rigorozitet të legjislacionit shqiptar, së bashku me kushtet ku do të zhvillohet veprimtaria mësimore dhe një kuadër të kualifikuar për të ushtruar veprimtarinë mësimore. Në të gjitha shkollat private, po sipas ligjit të arsimit parauniversitar, lëndët që do të zhvillohen në gjuhën shqipe janë: gjuha shqipe dhe letërsia, historia e kombit shqiptar, gjeografia e Shqipërisë. Kontrolli i procesit mësimor, si në vendet evropiane, bëhet nga MAS-i dhe DAR-t/ZA-të. Në këto shkolla kryhen testime, kontrollohet i gjithë dokumentacioni i shkollës, përfshirë amza, regjistra, etj, verifikohet plotësimi i kërkesave të planit e programeve, si në arsimin bazë ashtu edhe në shkollën e mesme. Në legjislacionin shqiptar, shteti, përmes organizmave si MAS dhe njësive arsimore vendore, kujdeset për nxënësit që vazhdojnë institucionet arsimore private në disa drejtime: njohjen e dëftesave, garanton kalimin nga publiku te privati e anasjelltas, merr masat për sistemimin e nxënësve në shkollat publike në raste mbylljeje/pezullimi

293 Kushtetuta e Shqipërisë, neni 57, pika 6.

të veprimtarisë së këtyre institucioneve si dhe plotësimin e boshllëqeve që nxënësit mund të kenë nga shkolla private. Miratimi i ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" është një arritje e legjislacionit tonë për këto shkolla duke iu përgjigjur aspekteve të standardeve evropiane për institucionet arsimore private.

Studimi evidenton se nuk ka dallime për sa i përket bazës ligjore, licencimit, dokumentacionit, kërkesave në lidhje me stafin, kurrikulat, dhënies së certifikatës dhe lëvizjes së mësuesve nga publiku te privati e anasjelltas.

Numri i shkollave private në shkallë Republike nga viti në vit ka ardhur duke u rritur. Mbështetur në analizën e bazës së të dhënave të MASH-it, vitet 2002 e 2007 janë vitet ku kemi numrin më të madh të institucioneve arsimore parauniversitare private në Shqipëri. Çdo vit ka një interes për sa i përket niveleve të institucioneve arsimore private (kopshte, shkolla 8/9 vjeçare, të mesme) dhe sipas llojit të shkollës (kopsht, shkollë e ciklit të ulët, shkollë 9-vjeçare, gjimnaz, gjimnaz me kohë të shkurtuar, gjimnaz sportiv, shkollë profesionale, shkollë fetare, shkollë social –kulturore, institucion plotësues). Vitet e fundit është rritur interesi ndaj shkollave të mesme teknike dhe profesionale private. Sot në Shqipëri kemi larmi të pranisë së numrit të institucioneve arsimore private, shpërndarjes gjeografike të tyre, në çdo zonë urbane dhe deri diku edhe në zonat rurale. Në Shqipëri evidentohen 343 institucione të arsimit jo publik parauniversitar. Në institucionet jo publike parauniversitare, numri i institucioneve parashkollore/ kopshtet arrin 106, i shkollave 9-vjeçare 121, ndërsa shkolla të mesme të përgjithshme e profesionale evidentohen 116. Krahas rritjes të numrit të këtyre institucioneve, nga viti në vit, vërehet edhe një zgjerim i hapësirës gjeografike. Fillimisht ato ishin të hapura në qendrat e mëdha të vendit, gjë që shpjegohet me faktin se krahas krijimit të një konceptimi të mirë për arsimin privat, mundësitë ishin më të mëdha për të gjetur kontingjent nxënësish, si rezultat i rritjes së numrit të popullsisë në këto qendra. Sot cikle të veçanta i kemi të përhapura edhe në zonat rurale, kryesisht kopshte e shkolla të ciklit të ulët. Një tjetër veçori e arsimit privat në Shqipëri është prania e institucioneve arsimore private të huaja krahas atyre shqiptare, siç është kolegji turk, pjesë e kolegjeve arsimore Gjylistan, si dhe shkolla austriake e themeluar nga Ministria e Arsimit Artit dhe Kulturës Austriake në Bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në Shqipëri.

Numri i mësuesve dhe i nxënësve nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, gjë që tregon se ka interes për këtë alternativë arsimi dhe prindërit janë të interesuar të shkollojnë fëmijët e tyre edhe në institucionet e arsimit jo publik. Në to puna është më intensive, sepse mësuesi vihet përballë kërkesave të dyfishta, që burojnë nga kërkesa e prindërve parapagues.

Hapja e institucioneve jo publike në fushën e arsimit ka ndikuar në rritjen e konkurrencës, pasi prezenca e dy alternativave të funksionimit të sistemit arsimor ndikon në këtë drejtim. Institucionet arsimore private janë pjesë integrale e sistemit kombëtar të arsimit, por ato gëzojnë një autonomi organizative dhe operative.

Në aspektin infrastrukturor, institucionet private ofrojnë bazë materiale të pasur, të plotësuar me bibliotekën e shkollës, me materiale për nxënësit dhe literaturë pedagogjike për mësuesit. Kabinetet e informatikës funksionojnë veç për shkollën 9-vjeçare dhe veç për shkollën e mesme, ndërkohë që funksionojnë edhe kabinetet e bio-kimisë, fizikës, edukimit muzikor, sallat për veprimtari ekstrakurrikulare, palestrat, terrenet sportive, etj. Institucionet jopublike të arsimit parauniversitar mundësojnë

masivizimin e përdorimit të tabelës elektronike dhe programeve interaktive lidhur me të, laboratorë bashkëkohorë, klasa me pak nxënës që luhaten nga 10-20, si dhe staf të zgjedhur dhe të përkushtuar, si edhe mjedise të sigurta. Infrastruktura e përshtatshme mundëson shpalosjen e plotë të vlerave profesionale të mësuesve, ndërsa të punuarit me klasa me pak nxënës, i jep mundësi mësuesit t'i aktivizojë më tepër nxënësit, t'i ndihmojë më shumë, t'i kontrollojë çdo ditë dhe të njohë mirë psikologjinë e tyre.

Këto shkolla kanë pikësynime të qarta në raport me nxënësit, që shprehen në vizionin e tyre ku krahas arsimimit të nxënësve, ato synojnë përgatitjen e nxënësve vizionarë, socialë, të sjellshëm, të respektueshëm e tolerantë ndaj çdo kombësie, race, besimi dhe feje, qytetarë të emancipuar dhe të mbushur me dashuri për atdheun, që respektojnë bazat e shtetit demokratik e ligjor, e që kudo ta përfaqësojnë Shqipërinë me dinjitet, breza me ndjenja të dashurisë dhe miqësisë mes popujve, duke respektuar arritjet dhe vlerat kulturore të tyre. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është shtrirë gjerësisht në sistemin arsimor jopublik, duke u bërë kështu motori i modernizimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollat private. Në disa shkolla private të përdoren teste të standardizuara për të përcaktuar kompetencat e nxënësve.

Shkollat private gëzojnë liri më të madhe për sa i përket kushteve të punësimit të stafit, si dhe në aspektin e kurrikulave. Emërimi i kuadrit bëhet mbi bazën e përvojës, profesionalizmit dhe integritetit. Shkollat jopublike nënshkruajnë kontrata individuale me mësuesit, të cilat janë lehtësisht të zgjidhshme. Personeli i punësuar në institucionet jopublike është kryesisht i përgatitur në universitetet shqiptare dhe të huaja. Mësuesit, në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, janë me arsim të lartë dhe vitet e fundit vërehet tendenca është për ulje të numrit të mësuesve me shkollë të mesme, si dhe në pension. Mësuesit e shkollave private kanë më shumë autonomi në klasë dhe më shumë ndikim mbi kurrikul. Në këto shkolla ofrohen mësues ambiciozë, të cilët trajnohen vazhdimisht. Trajnimet organizohen gjatë gjithë vitit bazuar në nevojat e stafit, duke bërë të mundur përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përditësimin e njohurive metodologjike të mësuesve. Për të ndihmuar mësuesit dhe për t'u siguruar se procesi i mësimdhënies është në përputhje me standardet e kërkuara, mësuesit monitorohen rregullisht nga anëtarët e drejtorisë. Gjithashtu, monitorimet e rregullta në mes te kolegëve dhe sesionet e orëve studimore luajnë një rol shumë të rëndësishëm në këmbimin e përvojave dhe përmirësimin e cilësisë së njëri-tjetrit.

Shkollat private zbatojnë programet e mësimore dhe kurrikulat në tërësi si shkollat publike, por janë vendosur disa lëndë shtesë ose fakultative, që variojnë nga shkolla në shkollë. Kështu ato kanë shtuar lëndë si "Njohuri për kompjuterin", ku 95% e tyre e fillojnë që në klasën e parë të ciklit të ulët, 100% e tyre kanë futur gjuhën e huaj që në klasën e parë fillore, apo që në fillore është shtuar si lëndë dansi, apo lëndë të veçanta në fushën e artit, kulturës dhe sportit. Është e rëndësishme të veçojmë se, mësimi i gjuhëve të huaja bëhet sipas metodave dhe teksteve më të përparuara të shtëpive botuese të njohura ndërkombëtare. Në shkollat fetare, lëndët fetare nuk zënë më shumë se 30% të numrit të përgjithshëm të orëve javore. Kuptohet që programet fetare miratohen nga Komiteti Shtetëror për kultet, i cili bashkëpunon me MAS-in për mësimin, lëndët fetare si dhe disa gjuhë të huaja (gjuha turke, arabe e greke) apo edhe lëndë të tjera profesionale me përmbajtje fetare. Në shkollat private janë planifikuar orë shtesë me nxënësit që paraqesin vështirësi, si dhe disa shkolla jopublike mund të ofrojnë aktivitete me interes për nxënësit, të tilla si artet, muzika, sporti, etj.

Në këto shkolla është bërë i mundur realizmi i një sërë programesh të reja, siç është regjistri elektronik, të cilat do t'i japin mundësi në kohë reale jo vetëm drejtuesve që të njihen me ecurinë e përditshme të çdo shkolle, por edhe prindërve që të njihen me ecurinë e përditshme të fëmijëve në shkollë, si edhe qeverisë që të nxjerrë nga kjo ecuri e përditshme të gjitha të dhënat e nevojshme për të ndërtuar një material statistikor jashtëzakonisht inovativ dhe jashtëzakonisht të vlefshëm për procesin të mirëqeverisjes së shkollës.

Shkolla private ka fleksibilitet në organizimin e saj, duke prezantuar një shumëllojshmëri formash e modelesh të vlefshme edhe për arsimin publik. Gjithçka varet nga vizioni i drejtuesve. Ato shërbejnë si një lloj modeli për arsimin publik. Në shkollat private ka më shumë përgjegjësi, pasi mësuesi nuk e ka të sigurt vendin e punës. Gradualisht nxënësit e këtyre shkollave po lidhen edhe me biznesin dhe po mësojnë si ti ndërtojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Arsimi jopublik ka marrë një shtrirje të gjerë duke zënë një vend të konsiderueshëm në arsimin shqiptar. Mbipopullimi i shkollave publike, ku shpesh kemi klasa me një numër relativisht të lartë nxënësish, dhe ku mësuesit e kanë të vështirë për tu përkujdesur për të gjithë, por edhe mjaft dukuri shqetësuese të përhapura tek të rinjtë, sidomos në shkollat e mesme, bën që prindërit të gjejnë rrugë të tjera për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Në shkollat private ka një klimë më të favorshme për të mësuar, duke përfshirë sigurinë më të madhe dhe më pak probleme të shkaktuara nga nxënësit që kanë qëndrime neglizhuese ndaj të mësuarit ose ndërveprime negative me mësuesit. Investimet si dhe shërbimet janë më të mëdha në shkollat private, ku në mjaft raste ato ofrojnë edhe shërbime të tjera shtesë si grumbullimin dhe shpërndarjen e nxënësve me shërbim transporti.

Këto shkolla ofrojnë pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme, që sipas hulumtimeve të fundit, vihet re se fëmijët që marrin pjesë në programe jashtë mësimit janë më aktivë dhe kanë qëndrim më pozitiv ndaj mësimit, arrijnë rezultate më të larta dhe përjetojnë një ndjenjë më të lartë të përmbushjes, kompetencës dhe vetëvlerësimit.

Pranimi në një shkollë private është plotësisht në gjykimin e vetë shkollës. Në një pjesë të konsideruar të shkollave private përzgjedhja e nxënësve bëhet përmes konkurseve të pranimit nga një komision i posaçëm pedagogjik, ku, përveç nivelit të njohurive, në prezencë edhe të psikologes së shkollës, testohet edhe inteligjenca e tyre. Shkolla private financohen kryesisht nga prindërit dhe donacione të ndryshme. Disa shkolla private u ofrojnë nxënësve bursa studimi, në varësi të rezultateve si dhe talentit që mund të ketë nxënësi. Disa shkolla private janë më të favorizuara si rezultat i prestigjit dhe statusit social të "lidhjes me shkollën e vjetër"; infrastrukturë më të mirë dhe shumë objekte (p.sh. palestra, fusha, pishina, etj), mësues më të paguar; dhe/ose besimi se shkollat private ofrojnë një cilësi më të lartë të arsimimit.

Përvetësimi i gjuhëve të huaja, përdorimi i kompjuterëve, aftësitë profesionale që këto shkolla ofrojnë nxënësve mundësinë për të ndjekur shkollat e larta jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet perëndimore e më gjerë. Nxënësit janë më të aftësuar në sensin praktik. Kjo e lidhur me ekzistencën e një baze të fuqishme materiale dhe me interesin e tyre.

Drejtuesit e shkollave private dhe mësuesit kanë ndikuar me mendimin shkencor dhe përvojën e tyre pedagogjike për arsimimin e brezit të ri, me dimensione reale dhe kërkesa bashkëkohore. Në këto shkolla pasqyrohet modeli i drejtuesit si menaxher dhe i drejtuesit pedagogjik.

Shkollat private zgjerojnë mundësitë për një përgatitje më të lartë të nxënësve të talentuar, pasi japin dije të nivelit bashkëkohor dhe hapin mundësi zgjedhje në profile të ndryshme. Këto shkolla ofrojnë teknologjinë më të përparuar të kohës, me salla interneti dhe tabela interaktive, gjuhë të huaj, ku përveç gjuhës së detyruar dhe asaj me zgjedhje, ka lëndë të cilat studiohen në gjuhë të huaj, gjë e cila e ndihmon nxënësin të jetë një qytetar i të gjithë botës, konsultime me pedagogë të Universiteteve dhe mësues të zgjedhur për t'u përgatitur për olimpiadat, bashkëpunim mësues - nxënës për pjesëmarrje dhe konkurrim në projekte brenda dhe jashtë vendit, veprimtari të shumta letrare, artistike, shkencore dhe sportive, ekskursione brenda dhe jashtë vendit, vizita në universitete të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit, për të njohur dhe zgjedhur se ku do të vazhdojmë studimet e larta. Puna e diferencuar organizohet në klasë e jashtë saj, sidomos orën e shtatë, së bashku me kurset falas në lëndët bazë si gjuhë, matematikë, biologji, fizikë, gjuhë e huaj etj, ku nxënësit mbulojnë boshllëqet e tyre, duke arritur më të përparuarit dhe, duke fituar vlera të veçanta nga puna në grupe. Këto shkolla ofrojnë mundësi më të mëdha për të zhvilluar dëshirat dhe aftësitë e nxënësve duke u marrë në letërsi, art, muzikë, shkencë dhe sport.

Nxënës e mësues janë të lirë të shprehin lirshëm mendimet e tyre pozitive apo negative. Ndërsa në arsimin publik nuk e kemi një situatë të tillë. Mësues dhe nxënës, nuk janë në të njëjtën pozitë.

Hapja e shkollave private ka bërë nga njëra anë që shteti të lehtësohet nga pikëpamja financiare, duke u krijuar mundësi organeve arsimore që këto fonde t'i kalohen arsimit publik. Kostoja për shpenzime të disa dhjetëra mijëra nxënësve, fondi i pagave për disa mijëra mësues, veç personelit ndihmës, fondi për mbi 400 ndërtesa që duhen rikonstruktuar apo mirëmbajtur e kompletuar me orendi shkollore, si dhe të tjera si uji, dritat etj, tani mbulohen nga iniciativa private, e cila në këtë fushë, ka përparësi në sigurimin e ngrohjes dhe të transportit krahasuar me shkollat publike. Në institucionet jopublike aktivizohen në punë 3750 mësues, duke zbutur disi problemet sociale, madje në disa shkolla paguhen më mirë se në shkollat publike. Për këtë kuadër arsimor jepen edhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore, të cilat shteti nuk do t'i merrte, siç nuk do të merrte as taksat e tyre, në qoftë se do të ishin në pritje për punë, përveç disa qindra milionave nga tatimet e detyrimet e tjera tatimore bashkiake që arsimi privat i jep shtetit, shto këtu edhe taksat vendore.

Në vendet e BE-së arsimi privat zë rreth 10%. Studimi identifikon se në Shqipëri arsimi privat zë 8%. Në vendet e BE-së, legjislacioni e detyron shtetin të sigurojë ose të japë fonde publike edhe për sektorin privat të arsimit, kurse në Shqipëri shteti financon bashkësitë fetare për pagat e mësuesve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar, që zotërohen drejtpërdrejt ose përmes organizata jo fitimprurëse të krijuara dhe të administruara nga bashkësitë fetare dhe që janë të miratuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose nga Këshilli i Ministrave. Ky kontribut përgjithësisht mbulon rreth 5% të shpenzimeve të institucionit. Gjithashtu sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, mbështetja financiare për shkollat private diferencohet sipas renditjes së tyre në provimet kombëtare të arsimit bazë ose të maturës shtetërore, si dhe në testimet ose konkurset ndërkombëtare. Gjithashtu, po sipas legjislacionit, shkollat private e përdorin mbështetjen financiare vetëm për nxënësit e shkëlqyer në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në Shqipëri nuk ka numër limit të nxënësve në klasë që të funksionojë si shkollë private, ndërsa në vendet e BE-së duhet të ketë një numër limit nxënësish, si kusht

që të funksionojë si shkollë private. Në disa vende të BE-së, shteti ushtron kontroll vetëm në ato institucione që marrin fonde publike, ndërsa në Shqipëri shteti kontrollon pagesën e taksave dhe sigurimet shoqërore për stafin si dhe tatim-fitimin. Legjislacioni evropian detyron shtetin të sigurojë ose të japë fonde publike edhe për sektorin privat. Në Shqipëri shteti mbështet me ligj vetëm shkollat publike. Në vendet e BE-së, një pjesë e tarifave ose komplet tarifa e shkollimit përballohet nga shteti.

Institucionet jopublike të arsimit parauniversitar janë në përpjekje për të marrë eksperiencat dhe modelet më të mira botërore. Ato janë në një përpjekje të eksperimentimit apo të aplikimit të modeleve të reja. Organizimi, llojet dhe format e sistemit arsimor jopublik janë të krahasueshme me standardet evropiane. Nuk ka dallime për sa i përket bazës ligjore, licencimit, dokumentacionit, kërkesave në lidhje me stafin, kurrikulave, dhënies së certifikatës dhe lëvizjes së mësuesve nga publiku te privati e anasjelltas. Shkolla jopublike gëzon autonominë shkollore, jo pa influencë në arritjen e sukseseve, pasi këto shkolla kanë hapësira vendim-marrëse, të cilat kanë çuar në marrjen e përgjegjësive të mëdha, përgjegjësi të cilat kanë rritur cilësinë e shërbimit. Institucionet private të arsimit parauniversitar përgjithësisht kanë ecur në drejtim të rritjes së tyre, në përmirësimin e kushteve fizike të godinave shkollore, me zgjerimin e bazës material-didaktike, me kualifikimin e stafit dhe të gjithë personelin mësimdhënës e ndihmës, me hartimin dhe përmirësimin e rregulloreve të brendshme të funksionimit ditor të shkollës, duke krijuar edhe një sistem pune dhe traditë funksionimi në varësi të kushteve konkrete dhe përvojës e kontributit të çdo mësuesi.

REKOMANDIME

1. Një mbështetje më e mirë e shtetit për këtë sektor, si rezultat i tendencës në rritje të arsimit privat. Kjo për arsye se arsimi privat është një alternativë që sjell progres në fushën e arsimit dhe duhet parë si element i demokracisë dhe ekonomisë së tregut.
2. Të nxitet dhe të ndihmohet iniciativa private në arsim, si alternativë që duhet mbështetur, pasi është ndër të vetmit sektorë privatë që kryejnë detyrë të rëndësishme në interes të drejtpërdrejtë të formimit të brezit të ri.
3. Njohja dhe zbatimi i praktikave botërore, ku shteti jo vetëm nuk u kërkon asgjë, por përkundrazi i mbështet shkollat private duke i ndihmuar deri në masën 80% të shpenzimeve, do të përbënte një kontribut me vlera në drejtim jo vetëm të përmirësimit të cilësisë së shërbimit, por edhe mbarëvajtjes së këtyre shkollave.
4. Duke pasur parasysh faktin që Shqipëria po shkon drejt integrimit evropian, është e domosdoshme që në buxhetin e viteve që pasojnë të fillojë të planifikohet mbështetja buxhetore edhe për arsimin privat, mbështetje e cila mund të jetë përmes planifikimit të granteve publike për shkollat private në bazë të kritereve të caktuara, rimbursimit të shpenzimeve të caktuara për arsimin privat të detyrueshëm, përjashtuar investimet, mbështetjes së sektorit të arsimit privat me kredi afatgjata, mbështetjes së prindërve në pagesën e tarifave të regjistrimit në shkollat private në një masë të caktuar sipas nivelit të arsimit parauniversitar. Shkollat private duhet të financohen pjesërisht nga shteti e pjesërisht nga prindërit, duke u krijuar mundësi edhe familjeve me të ardhura të pakta ti shkollojnë fëmijët e tyre në këto shkolla, një mënyrë kjo për familjet në nevojë, por me fëmijë të talentuar.
5. Një mbështetje financiare më e mirë e shtetit për arsimin jopublik përbën një domosdoshmëri. Kjo për arsye se jo vetëm që është alternativë që sjell progres, por edhe si një mënyrë për rritjen e standardeve që kjo alternativë ofron.
6. Legjislacioni shqiptar duhet të garantojë mbështetjen me ligj të arsimit privat me fonde për nivele dhe kritere të caktuara. Shteti duhet të garantoje mosdiskriminimin e nxënësve në arsimin parauniversitar, për të përfituar nga fondet publike, pavarësisht se ku e ndjekin këtë arsim në sektorin publik apo privat. Për këtë është e nevojshme amendimi i legjislacionit ekzistues për arsimin parauniversitar.
7. Ngritja e një shoqate të arsimit privat në rang kombëtar, funksioni i së cilës krahas rritjes e partneritetit midis shkollave publike dhe private, duhet të synojë

përfshirjen ligjërisht në proceset arsimore si pjesë aktive e komisioneve të ndryshme në arsim dhe komisioneve që vendosin për licencimin e shkollave private.

8. Përmirësime të mundshme të Ligjit "Për sistemin arsimor parauniversitar", për sa i përket funksionimit të institucioneve private si dhe të marrjes së masave për kundërvajtje administrative, ndaj drejtuesve apo administratorëve të institucioneve arsimore jopublike, duke përfshirë edhe hapjen e tyre pa leje, pasi kështu zbehin rëndësinë e arsimimit të mirëfilltë të brezit të ri.
9. Përcaktimi, në akte nënligjore, i përqindjes së ndryshimeve që mund t'i bëjnë institucionet arsimore private planit mësimor, në mënyrë që ato të shpalosin individualitetin e tyre, t'u përgjigjen kërkesave të ekuivalentimit në të gjitha nivelet e arsimit dhe të kenë një lirshmëri e pavarësi më të madhe në planet e programet e tyre.
10. Rritja e shkëmbimeve ndërmjet institucioneve publike e jopublike. Përvoja e mirë e krijuar në disa institucione arsimore jopublike në bashkëpunimin me institucione të huaja, në organizimin e seminareve kualifikuese, në ndjekjen e shkollave verore për kualifikim jashtë vendit, mund të shërbejë si shembull edhe për institucionet publike.
11. Nga ana tjetër, shteti ka detyrime ndaj arsimit privat si për ta inkurajuar, ashtu edhe sponsorizuar e për ti krijuar lehtësira fiskale, pasi përgjegjësia dhe detyrimi i shtetit ndaj fëmijëve dhe nxënësve në çdo kategori dhe formë arsimimi është plotësisht i njëjtë dhe i barabartë.
12. Shteti duhet të inkurajojë zgjerimin e këtij lloj arsimimi në të gjithë nivelet, veçanërisht atë profesional, duke mbuluar një pjesë te shpenzimeve të shkollave të suksesshme private.
13. Shfrytëzimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës që ofron ky sektor do të përbënte një kontribut me vlera jo vetëm në drejtim të bashkëpunimit publik-privat, por edhe në drejtim të aftësimit profesional të mësuesve. Këto shkolla mund të kthehen në laboratorë të përpunimit të mendimit dhe përvojës pedagogjike shqiptare, brenda së cilës të eksperimentohen dhe të jepen modele paraprirëse për shkollat tona kombëtare.
14. Shkollat jopublike duke qenë më fleksibël dhe më novatore lidhur me aspekte të ndryshme të procesit edukues e arsimor të jenë nismëtare në dhënien e përvojës së tyre edhe për shkollat publike.
15. Kthimi i shkollave private në qendra trajnimi dhe/apo qendra kërkimore, roli i të cilave do të konsistojë jo vetëm në shkëmbimin e eksperiencave, por edhe në qendra ku do të zhvillohet mendimi pedagogjik.
16. Të krijohen mundësi më të mëdha për trajnimin e kualifikimin e mësuesve. Një rubrikë e veçantë në buxhetin e këtyre shkollave për mbështetjen dhe mbulimin 100% të shpenzimeve të kualifikimit të mësuesve do të përbënte një kontribut për rritjen e standardeve që ofron ky shërbim.
17. Informimi i saktë, i plotë dhe i qartë i mbarë opinionit publik lidhur me realizimin e standardeve (ato të arritjes, shërbimet dytësore, mësimdhënie, në nxënie, infrastrukturë) përbën një domosdoshmëri. Kjo duhet të bëhet e mundur

përmes renditjes së shkollave bazuar në vlerësime profesionale nga agjenci apo qendra vlerësimi.

18. Sigurisht duhet të pranojmë që edhe pse konkurrenca bën që të punohet shumë në arsimin privat, vlefshmëria në pikëpamje të cilësisë duhet të jetë një prioritet i monitorimit të vazhdueshëm, të bazuar në indikatorë të besueshëm. Vlerësimi i vazhdueshëm i këtyre shkollave do të motivonte punën e mësuesve dhe drejtuesve të tyre, duke nxjerrë dhe duke përmirësuar në të njëjtën kohë edhe shumë probleme që lidhen me këtë lloj arsimimi.

19. Sugjerime për studime të mëtejshme mund të përfshijnë studime në rang kombëtar lidhur me zbatimin e standardeve aktuale në institucionet jopublike parauniversitare, cilësinë e efektivitetin e shërbimit të ofruar në këto institucione, problematikat, nivelin e kënaqësisë së mësuesve, etj.

BIBLIOGRAFI

1. Adhami, S (1989) "*Voskopoja në shekullin e lulëzimit të saj*", Tiranë
2. AIH *"Gjirokastra në Shekuj*"dhe *"Histori e letërsisë"*
3. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *"Fjalori Enciklopedik", (*2009) Koliqi H& Kazazi, Nj, Kristalinë K-H, Tiranë.
4. AMSH Dosja e arsimit e shek. XIX. Letër e Tina Nik Gjergjit, datë 28 prill 1889
5. Annuari Statistikor i Republikës Popullore të Shqipërisë, kap. 12, Tiranë 1959
6. AQSH, D. 156, F. 295, V. 1924,
7. AQSH, F. 251, D. 300, V. 1923, Fl. L-3
8. AQSH, F. 295, V. 1924, D. 112
9. AQSH, F. 295, V. 1925, D. 156. Fl. 10
10. AQSH, F. 669, D. 47, V. 1925
11. AQSH, Fondi 259, viti 1921, dos. 46
12. AQSH. Fondi 65, dosja 70
13. Arch. S. Congr. Acta S. C. ol.1, 21 ad. congr. dici 6 dicembris 1622, nr. 8
14. Archives du Ministére des Affaires Etrangéres, Janina1882 (dokumenta të mikrofilmuara, pranë Arkivit të Institutit të Historisë, Tiranë)
15. Arkivi Françeskan në Shkodër
16. Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, dosje 1/15, dok. 752
17. Arkivi i Muzeut të Shkodrës, dosja nr. 1, Fondi i Arsimit
18. Arkivi i Muzeut të Shkodrës, Dosja e Arsimit, Nr. 4562/2
19. Arkivi i Muzeut të Shkodrës, Arkivi i Vjenës
20. ASHSH, FESH, (Botim i ri) zëri i hartuar nga H. Koliqi dhe Nj. Kazazi, Tiranë, 2009, Vëll. III
21. ASHSH, FESH-2 Botim i ri (Grup autorësh), (2008)Tiranë, Vëll. II, Zëri është punuar nga Villy Kamsi
22. Basileiou, K. Zaride (1978) *Grammata apo to Devino (1753-1792) gia to klerodotema tou Spyrou Rizou*, në: "Thesaurismata"15.

23. Beqja, H (1988) *Edukata me syrin e popullit. = Hulumtime dhe përsiatje rreth edukatës dhe pedagogjisë popullore*. / M. Mato. - Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë

24. "Besa Shqyptare", Shkodër, 27 maj 1913, nr. 6, kryeartikull: *Dita e djeshme*

25. Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë/3/"*Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin e XVII*", Vëll. I (1610-1634), Tiranë, 1963. Përgatitur nga I. Zamputi, Dok. nr. 18.

26. Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë/3/*Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin e XVII"*, Vëll. I (1610-1634), Tiranë, 1963. Përgatitur nga I. Zamputi, Dok. Nr. 37

27. Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë/3/*Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin e XVII",* Vëll. I (1610-1634), Tiranë, 1963. Përgatitur nga I. Zamputi, Dok. NR. 44

28. Bushati, H. (1998) "*Shkodra dhe motet*", vëll. II, Shkodër

29. Bushati, H (1973): "*Gjendja Arsimore e Shqipërisë në periudhën osmane*", dorëshkrim.

30. Cohen, Louis (2000) *Research methods in education*/Louis Cohen, Lawrence Manion, and Keith Morrison. - 5th ed.

31. Coyne, I., (1997). *Sampling in qualitative research. Purposeful and theoretical sampling; merging or clear boundaries?,* Journal of Advanced Nursing, 26

32. Çefa, K (2013) "*Në zanafillat historike të arsimit tonë në trevat veriore deri në shek. XVIII"*, Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVII, Tiranë

33. Çelebi , E (1930) "*Sejjahatnamesi"*, Shqipnia para dy shekujsh, Tiranë.

34. DAR, Shkoder DATABASE, (2010-2011; 2011-2012; 2012-2013; 2013-2014), darshkoder.arsimi.gov.al

35. Dedei, S. (1999), *Zhvillimi i arsimit në Mesjetë në Shqipëri*, "Revista Pedagogjike", nr. 2, Tiranë

36. Dedej, S (2001*) "Arsimi dhe mendimi pedagogjik në Mesjetë",* Tiranë

37. Dituria: *"Françeskanët në Shqipëri",*vëll. 3, nr. 3, Tiranë, 1927

38. Dituria: "*Gjergj Benussi*", vol. III-Janar 1928, Nr. 3.

39. Dizdari, I (1995) *"Një traditë e hershme që duhet ripërtërirë*", dorëshkrim, Shkodër.

40. Dizdari, I.(1988), *"Historiku i shkollës Pedagogjike*", Pjesa III, dorëshkrim, Shkodër

41. Ernest Koliqi (1972) "*Gjellë e* ämbëlsina të ven*dit tonë*", "Shejzat",I, Nr 1-4

42. Fishta, At Gj.(1924), *"Mrizi i Zanave",* Shkodër.

43. EU Eurydice: Key Data on Education in Europe, 2005. http://www.eurydice.org/index.shtml

44. EI Resolutions http://www.ei-ie.org/worldcongress/uk/resolutions02.html

45. "Fiamuri i Arbërit", Viti III, Nr. 6, datë 15 gusht 1887.

46. "Fletore Zyrtare", viti XII, Nr. 21

47. Fulz- Kantos, J (1994), Kryqi i Kuq Shqiponja e Zezë

48. Gazeta "Shqiptari", 9 tetor 1888

49. Gazeta "Shqiptari" e Bukureshtit, viti I, nr. 4, datë 11 vjeshtë e I, 1888.

50. Gegaj, A (1932) *"Vepra arsimore e françeskajvet në Shypni në shekullin e XVII*", Revista "Hylli i Dritës", viti VIII, Nr. 3

51. Gjergji, S. (2013) *Stublla me Kolegjin e Shën Lukës,* 1584, "Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVIII", Tiranë

52. Gjyshja, T (1959) *"Me rastin e 90 vjetorit të shkollës së Tinës së Nikës",* Arsimi Popullor, Nr. 3

53. Gjyshja, T (1961*) "Qendra mësimore e Kushë Mices* në Shkodër gusht 1859", "Shkodra 1961", Nr. 6

54. Gjyshja, T (1963) "*Shkollat e para femërore në Shkodër deri në vitin 1912*", Arsimi Popullor, Nr. 13

55. Gogaj, I (14 prill 1995): *"Mësuesi atdhetar veteran i shkollës shqipe*", Gaz."Rilindja

56. Grameno, M (1905) *"Mallkimi i gjuhës shqipe"*, Bukuresht

57. Grup autorësh, (2003) *"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*", MASH, ISP, Vëllimi I, Tiranë

58. Guerini, P *(Aktet e vizitës kanonike në Arkidioçezin e Shkodrës*", 1883, Fondi i Austro-Hungarisë.

59. Guerini, P (*Aktet e vizitës kanonike në Arkidioçezin e Shkodrës",* 1897 , Fondi i Austro-Hungarisë.

60. Gurakuqi, K (1928) *"Françeskanët në Shqipëri*", Diturija, nr. 3, vëll 3, fq. 95

61. Gurakuqi, K (1928),"*Françeskanët në Shqypni*","Dituria", nr.3 dhe Shejzat (1995), nr 1-2

62. Haus-Hof-und Staatsarchiv-PolitischesArchiv- Albanien (më tej HHStAPAA). Informacion i konsullit austro-hungarez të Janinës Nr. 40/res, datë17 tetor1894

63. Historiku i Arsimit të rrethit të Lezhës

64. Hoti V (2002) "*Luigj Gurakuqi-për shkollën e arsimin kombëtar*", Camaj-Pipaj, Shkodër

65. *Instituti Kyrias, kolegj për vajza, (themeluar më 1891),* Kamëz - Tiranë, 1931

66. ISP (2003), Guida "*Arsimi në Shqipëri*", Tiranë, Ilar

67. Jahrbuch 2010-2011, Österreichische Schule "Peter Mahringer", Höhere technische Schule für Informationstechnologie

68. Jahrbuch 2011-2012, Österreichische Schule "Peter Mahringer", Höhere technische Schule für Informationstechnologie

69. Jahrbuch 2012-20113, Österreichische Schule "Peter Mahringer", Höhere

technische Schule für Informationstechnologie

70. Kabineti pedagogjik i Shkodrës, (1980) "*Historiku i arsimit i rrethit Shkod*ër" pj. I.

71. Kadiu, A(2002*) "Shkolla private-jopublike*", Tiranë

72. Kadiu, A. (1996) "*Dibra e Madhe*", (monografi), Tiranë, 1996

73. Kanini, I (2001), "*Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës I Botërore*", Tiranë

74. Karafili, Ll (Bardhyli), (1938), Hylli i Dritës, 4, Shkodër, 1938

75. Karafili, Ll (Bardhyli),(1938) "*Historija e bibliotekave në Shqipëri*", Hylli i Dritës, nr. 6, Shkodër

76. Karalewskij, C (1911) "*La msisione greco-cattolica della Cimarra nell'Epiro nei sec.XVI-XVII,* në "Bessarione", anno XV, fashik. 2

77. Karalewskij, C (1911) "*La msisione greco-cattolica della Cimarra nell'Epiro nei sec. XVI-XVII"*, në "Bessarione", anno XV, fashik. 2

78. Kastrati, J (1963) "*Kontribut për historinë e arsimit në rrethin e Shkodrës deri në vitin 1912"*, Arsimi Popullor, Tiranë

79. Kastrati, J (1964) "*Tekste të vjetra shkollore",* Arsimi popullor, nr. 6

80. Kazazi, Nj (2014) *"Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër"* (Nga fillimet e tij deri në vitet '20 të shek. XX) Monografi, Shkodër

81. Koci, K (1961) *"Mësonjëtorja shqipe e Korçës",* Arsimi popullor, nr. 3, Mars

82. Kola, Gj.(1941) *"Shkolla shqipe françeskane e Gjergj Fishta*", në "Gjergj Fishta", Tiranë

83. Kolegja Saveriane ndër 50-vjetët e para, Shkodër, 1928

84. Koliqi, H (2012) *"Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*", Prishtinë

85. Kraja , M (2008) "*Pedagogji e zbatuar",* Tiranë

86. Kraja, M (1993) *"Mësuesit për kombin shqiptar"*, Tiranë

87. Kraja, M (2002) "*Bij të Lunxhërisë për arsimin shqip*", Tiranë

88. Kurti, D&Sirdani, M (1999) "*Mbi kontributin e elementit katolik në Shqipëri*", Tiranë

89. Kurti, D. (1993), "*Shkolla françeskane*", Kumbona e së dielës, Shkodër, 7(13),

90. Kurti, D.,& Sirdani, M (1999) "Mbi kontributin e elementit katolik në Shqipëri", Tiranë

91. Kurti, D.O.F.M (1935) "Vepra kulturale e elementit katolik në Shqipëri", Shkodër

92. Kushtetuta e Shqipërisë, neni 57, pika 6

93. Letër drejtuar Guerinit më 9 mars 1881, Arkivi i Muzeut të Shkodrës, Fondi i Arsimit

94. Ligji nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e*

Shqipërisë", neni 70, "*Shkelja e kërkesave ligjore nga institucionet arsimore private*", pika 5

95. Ligji Nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", neni 5, pika 1, 2

96. Ligji nr. 8387, datë 30.07.1998, "Për sistemin arsimor parauniversitar"

97. Ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995, "*Për sistemin arsimor parauniversitar"*

98. Ligji nr. 8387, datë 30.07.1998, Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995, *"Për sistemin arsimor parauniversitar"*

99. Ligji nr. 10081, datë 23.2.2009 "*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*".

100. Ligji Nr. 10 140 datë 15.05.2009 "*Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me këshillin e ministrave"*

101. Lika, Q (1998) *Tradita të tolerancës ndërfetare në qytetin e Shkodrës*, "Shkodra në shekuj", vëll I, Seminari i Dytë Ndërkombëtar, Shkodër

102. Lucia Nadin (2008) *"Migrazioni e integrazione. Il caso degli albanesi a Venezia (1479-1552)",* Roma, Bulzoni

103. Luka, D (2013) *"Shkolla shqipe e Kurbinit*", "Shkollat shqipe të trevave shqiptare në shekujt XVI-XVIII", Tiranë.

104. Luli, F. Dizdari. I, Bushati, N.(1997) *"Në kujtim të brezave",*Shkodër

105. Luli, L (2002) *"Kontributi shpirtëror e kulturor i Bushatlinjve*", Kumtari 8, Shkodër

106. Malaj, V. (1995) "*Meshari" i Gjon Buzukut - monument i kulturës shqiptare*, Ulqin, fq. 180

107. Marko P (1963) *"Shkolla e parë shqipe tre shekuj më parë",* Fletë nga historiku i shkollës, Tiranë, fq. 8

108. MASH (2003) "*Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*", Vëll. 1, Tiranë

109. MASH Raport vjetor statistikor i arsimit (2003-2004)

110. MASH Raport vjetor statistikor i arsimit (2004-2005)

111. MASH Raport vjetor statistikor i arsimit (2005-2006)

112. MASH Raport vjetor statistikor i arsimit (2006-2007)

113. MASH Raport vjetor statistikor i arsimit (2008-2009)

114. MASH Raport vjetor statistikor i arsimit (2009-2010)

115. MASH Raport vjetor statistikor i arsimit (2010-2011)

116. MASH Raport vjetor statistikor i arsimit (2011-2012)

117. MASH Raport vjetor statistikor i arsimit (2012-2013)

118. MASH Raport vjetor statistikor i arsimit (2014-2015)

119. Mbretëria Shqiptare (1933) "*Ligjet e Arsimit*", Tiranë.

120. Mbretëria Shqiptare. Ministria e Arsimit (1935): *"Rregullore mbi shkollat*

private të minoriteteve", Tiranë.

121. Mikel Prenushi *"Vështrim historik mbi zhvillimin e arsimit në Shkodrën e shek. XIX"*, Studime historike, nr. 3,1974,fq75

122. Ministria e Arsimit: *"Ligja mbi ndërtesat shkollore dhe orendive të tyre"*

123. Mons Spila, Memorie storiche d. Prov. R. Romana, tom. II, p. 316-317, ss. n. 2

124. MPSH, D.1/5, dok.742

125. Nisbet, J. and Watt, J. (1984) Case study. In J.Bell, T.Bush, A.Fox, J.Goodey and S.Goulding (eds) *Conducting Small-scale Investigations in Educational Management.* London: Harper &. Row

126. Orbis Seraphicus, P. Marcellinus a Civetia et Theophilus Domenichelli O.F.M De Miss, FF. Minorum. Lib. IV, fq. 443, n. 50

127. Osmani, Sh (1994) "*Kompleksi mësimor kulturor i Pashallëkut* të *Bushatllinjve* të *Shkodrës"*, Seminari i parë ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", Shkodër

128. Osmani, Sh (1998) "*Reflekse etnopedagogjike I*", Tiranë

129. Papapano, TH. (1963) *"Shkollat e para shqipe në rrethin e Gjirokastrës",* Arsimi Popullor, Nr. 3.

130. Pepa, S. (1993), *"Kumbona e së Diellës*", Nr. 6

131. Pepo, P (1967) "*Materiale dokumentare mbi veprimtarinë e zanatçinjve të Korçës e të Voskopojës"*, në "Studime historike"1967, nr. 1, fq. 169-171

132. Pipa, F (1962) *"Një shekull shkollë shqipe*", 1861-1961", Romë

133. "*Programi i shkollave tregtare në Kolegjë* të *Sh.F. Saverit*", (1921) Shkodër

134. *Pjesë nga Relacioni i prefektit të misioneve françeskane në Shqipëri drejtuar kongregacionit të propagandës Fide* (7 mars 1650), në "Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë", vëll. III (1506-1839), Tiranë, 1962, fq. 193

135. Ragin, C. C. (1992). *Introduction: Cases of "What is a case?*" In C. C. Ragin, & H.S. Becker (Eds.), What is a case? Exploring the foundations of social inquiry, New York: Cambridge University Press.

136. *"Reforma e sistemit arsimor parauniversitar",* Raport paraprak, Tiranë, Maj 2014

137. Rexhepagiq, J. (1970) *"Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*", Prishtinë

138. Revista "Përparimi" (1915) *"Do mësuesa t'hershëm* në Shkodër", nr. 2, 6, 10 Shkodër .

139. *"Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në Shekullin e XVII",* vëllimi II (1634-1650), Tiranë, 1965

140. Schmitt, O. J (2012) *"Shqiptarët, një histori midis Lindjes dhe Perëndimit"*, Tiranë

141. Skura, M (1965)*"Relacion i Mark Skurës drejtue Kongregacionit të Propagandës Fide mbi vizitën e kryeme nëpër dioçezet e Shqipënisë së Mesme*", vëll. II (1634-1650); Në Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë

Veriore dhe të mesme sh. XVII, V. II, (1634-1650), Tiranë

142. Sylejmani, F. (1979) *"E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës"*, Insituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë

143. *"Shkollat turke në Shkodër"* (1973), dorëshkrim, pranë Institutit të Studimeve Pedagogjike, Tiranë

144. Shllaku, L (2002) *"Shkollat klerikale"(Vështrim historik nga fillimet deri më 1924),* Shkodër

145. Shuteriqi, S. Dh (1976*) "Shkrimet e para shqipe",* Tiranë

146. Shtjefni, K *"Shkodra në shënimet e mia",* "Bot impex", Shkodër

147. Udhëzim nr. 33 datë 1.11.2010, kreu *"Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licencë* të *institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare"*

148. Udhëzim nr. 6, datë 14.03.2003, e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale *"Për regjistrimin e institucioneve të AFP*".

149. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 28.05.1999, *"Për kriteret e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore private parauniversitare dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj".*

150. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 26.5.2009 *"Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta"*

ANEKS

Intervistë me drejtues të shkollave jopublike në Shkodër

Përshëndetje,
Unë quhem Eranda Bilali, pedagoge pranë Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Intervista zhvillohet në kuadër të një studimi për përgatitjen e tezës së doktoratës me temë: "Arsimi jopublik parauniversitar - alternativë me vlera në integrimin dhe zhvillimin e sistemit arsimor". Qëllimi i këtij studimi është të përshkruaj dhe analizojë organizimin dhe funksionimin e sistemit të arsimit jopublik parauniversitar në nivel kombëtar, duke u bazuar në zhvillimin historik të tij, nga fillimet e deri në ditët e sotme, si dhe përmes të dhënave e indikatorëve analitikë dhe sintetikë për çdo etapë e nivel shkollimi, duke analizuar veçanërisht arsimin privat në rrethin e Shkodrës si një rast përshkrues studimor. Një nga objektivat e studimit është përshkrimi dhe analizimi i organizimit dhe funksionimit të institucioneve jopublike të arsimit parauniversitar në rrethin e Shkodrës, për çdo etapë apo nivel shkollimi.

a. Emri/Mbiemri:_____
b. Gjinia: _____
c. Mosha:_____
d. Niveli i arsimimit: 1. I mesëm 2. I lartë 3. Pasuniversitar
e. Profesioni :_____
f. Sa vite pune keni në fushën e arsimit? _____vite.
g. Sa vite pune keni në këtë institucion? _____vite.
h. Pozicioni aktual i punës pranë institucionit ku ju punoni:_____.

Pyetje të përbashkëta

1. Kur është hapur institucioni që ju drejtoni?
2. A ka institucioni juaj infrastrukturën e nevojshme për të funksionuar si institucion arsimor? Çfarë mjedisesh ofron ai?
3. Çfarë shërbimesh ofrohen në institucionin tuaj? Cili është përceptimi juaj për shërbimet që shkolla juaj ofron (ushqim, transport, shërbim psikologjik, kujdes shëndetësor)?
4. Si i siguroni fondet për mbarëvajtjen e institucionit?
5. Sa është numri i stafit, me kohë të plotë ose të pjesëshme, shqiptar apo i huaj?
6. Çfarë politikash ndjek institucioni juaj në përzgjedhjen e stafit mësimor?
7. Cilat forma përdor institucioni juaj në lidhje me kualifikimin e stafit?

8. Çfarë formash përdoren në institucionin tuaj për të realizuar bashkëpunimin shkollë-familje?
9. Cili është kontigjenti i nxënësve që ndjek shkollën jopublike dhe a ka përcaktuar institucioni kritere për pranimin e tyre?
10. Çfarë politikash zbatohen në institucionin që ju drejtoni për nxënësit me rezultate të larta dhe të talentuar?
11. Sa i përket uniformës, a është e detyruar dhe si e përcaktoni atë?
12. Çfarë kurrikule përdorni në institucionin që ju drejtoni? A ka ndryshime me institucionet publike dhe ku konsistojnë këto ndryshime?
13. Po aktivitetetet jashtëshkollore, si realizohen në institucionin tuaj?
14. Sipas mendimit tuaj, çfarë e bën të funksionojë mirë shkollën jopublike?
15. Cili është mendimi juaj në lidhje me efektshmërinë që arsimi jopublik ofron?

Ju falënderoj për kontributin Tuaj
Eranda Bilali